   - U zbatuan me korrektësi jo vetëm procedurat ligjore të dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KQV në Vendin e Numërimit të Votave por edhe procesi i numërimit të votave (në asnjë VNV nuk ngeli pa u numëruar asnjë kuti votimi e marë në dorëzim e rregullt).
   - Nuk u shpallën të pavlefshme zgjedhjet në asnjë zonë zgjedhore me përjashtim të një qendre votimi e cila nuk ndikoi në rezultat.

Në referim të rekomandimeve të OSCE ODIHR, KQZ në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar ka organizuar dy tryeza pune, për administrimin e zgjedhjeve, me fokus rritjen e paavarësisë, paanësisë dhe profesionalizmit të trupave zgjedhore dhe ka nxjerr dy rekomandime të rëndësishme:

- Paavarësia e trupave zgjedhore, arrihet me ndryshimin e formulës për përbërjen e tyre. Anëtarët e trupave zgjedhorë, duhet të jenë jo partiak.
- Ritja dhe konsolidimi i profesionalizmit të administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, arrihet nëpërmjet krijimit të një Qendre Trajnimi Zgjedhor dhe Edukimit të Shtetasve. Kjo Qendër, duke patur mision trajnimin e administratës zgjedhore dhe edukimin e shtetasve, do të realizojë forcimin e kulturës zgjedhore dhe do të certifikojë burimet njerëzore që mund të angazhohen si komisionerë zgjedhorë të së ardhmes.

Në vështrim të përgjithshëm krahasues, të raportit të OSCE-ODIHR 2011 me atë të vitit 2015, dhe me fokus rekomandimet përkatëse, evidentohet zvogëlimi "sasior" i rekomandimeve, nga 27-23, tregues ky për adresimin dhe zgjidhjet e dhëna për rekomandime të mëparshme.

Reforma zgjedhore e ardhshme duhet të adresojë, rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it; rritje e mëtejshme e pavarësisë së administratës zgjedhore në të gjitha nivelet; të përmirësohet përputhshmëria e kuadrit ligjor ekzistues; si dhe rritje të kapaciteteve të administratës zgjedhore.

1.1.2 Parlamenti

Kuvendi i Shqipërisë, si organi më i lartë ligjvënës në vend, luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri. Kuvendi është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike në vend, për realizimin e reformave të domosdoshme në dobi të zhvillimit të vendit dhe integrimit në Bashkimin Europian. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ushtron edhe funksionin e kontrollit politik ndaj qeverisë si dhe monitoron zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit europian, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Gjatë vitit 2015, funksionimi i Kuvendit është përmirësuar në të gjithë treguesit e performancës së tij, në veçanti, në drejtim të përmirësimit të transparencës së procesit ligjvënës sikundër vlerësuar nga raporti i Komisionit Europian i vitit 2015, si dhe duke ndërmarrë masat e nevojshme për adresimin e rekomandimeve të Komisionit Europian, kryesisht në drejtim të miratimit të ligjeve të nevojshme për plotësimin e 5 prioriteteve për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në, forcimin e kontrollit politik mbi Qeverinë, forcimin e mëtejshëm të rolit të Kuvendit në procesin e integrimit, rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile, si dhe forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve administrative të institucionit.

Gjatë vitit 2015 Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar 241 akte parlamentare (125 ligje, 99 vendime dhe 17 rezoluta). Gjithashtu, janë miratuar 5 ligje të cilat kërkonin shumicë të cilësuar, një pjesë e të cilave ishin të parashikuara në Udhërrëfyesin për 5 prioritetet e Komisionit Europian, si Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili është një nga masat e parashikuara në prioritetin 1 të Udhërrëfyesit.

Kuvendi i Shqipërisë më 27 Nëntor 2014 ka miratuar vendimin Nr 96/2014 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë". Përmbushja me sukses e objektivit të parë (Hartimi i Analizës së Sistemit të Drejtësisë) dhe të dytë (Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit) të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, tashmë i ka hapur rrugë punës për përmbushjen e objektivit të tretë të procesit: hartimit të amendamenteve kushtetuese dhe ligjore në fushën e sistemit të drejtësisë.

Në vijim të mbledhjes së datës 28 Shtator 2015, të këtij Komisioni, i është dërguar Komisionit të Venecias pranë Këshillit të Evropës kërkesa për opinion, nëse zgjidhjet kushtetuese të propozuara nga grupi i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, për reformimin e sistemit të drejtësisë, janë në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane në

fushat përkatëse. Gjithashtu janë dërguar pranë këtij Komisioni, komentet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim për këto projekt amendamente. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, ka prezantuar projekt amendamentet kushtetuese në sesionin e 104-ët plenar të Komisionit të Venecias, i cili u zhvillua në datat 23 – 24 Tetor 2015. Ndërkohë në datat 2 – 3 Nëntor, raporterët e caktuar nga Komisioni i Venecias, zhvilluan një vizitë në kuadër të kërkesës për opinion, gjatë të cilës takuan përfaqësues tëInstitucioneve të Sistemit të Drejtësisë (anëtarë të Komisionit të Posaçëm, Presidentin, anëtarë të KLD, Ministrin e Drejtësisë, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, et) dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Paralelisht me procesin e dhënies së opinionit nga Komisioni i Venecias, amendamentet Kushtetuese po i nënshtrohen një procesi të gjerë të konsultimit publik, të ndara sipas 7 shtyllave, i cili ka filluar në muajin Nëntor 2015 dhe ka vazhduar deri në fillim të muajit Dhjetor 2015. Tryezat po zhvillohen në nivel qendror (Tiranë) dhe në nivel rajonal, në disa prej qyteteve kryesore të vendit ku janë të lokalizuara qendrat universitare dhe përbëjnë rrethe të rëndësishme gjyqësore (Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër, Elbasan, etj), me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve, përmbaruesve, juristëve, pedagogëve dhe studentëve të Fakulteteve të Drejtësisë, përfaqësuesve të Shoqërisë Civile, etj. Dy prej tryezave qendrore janë zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

Projekti me amendamentet kushtetuese i është dërguar gjithashtu për konsultim 1800 adresave të rrjetit të konsultimit publik.

Procesi i punës për hartimin e projektligjeve është i organizuar në 7 paketa ligjore mbështetur në 7 shtyllat e Strategjisë së Reformës. Në varësi të kompleksitetit, rëndësisë dhe nevojës që paraqesin për ndryshim sa i takon aspektit kohor, puna për hartimin e projektligjeve të identifikuara si pjesë e paketës së reformës në sistemin e drejtësisë do të organizohet në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Fillimisht janë identifikuar disa prej projetkligjeve prioritare afatshkurtër, një pjesë e te cilave janë pjesë e masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për përmbushjen e 5 prioriteteve Komisionit Evropian (përkatësisht prioritetit 2), për të cilat është parashikuar afati i draftimit brenda muajit Dhjetor të këtij viti, si psh Projektligji për Statusin e Magjistratëve, Projektligji për Organet e Mirëqeverisjes, Projektligji për Prokurorinë, Projektligji për Policinë Gjyqësore, Projektligji për Gjykatën Kushtetuese, etj. Koordinimi i procesit për përgatitjen e paketave ligjore drejtohet nga bashkëkryetarët e Grupeve të Punës (Grupi i punës sëEkspertëve tëNivelit tëLartë), përkatësisht një ekspert i nivelit të lartë vendas dhe një ndërkombëtar. Brenda paketës ligjore për cdo ligj të vecantë janë ngritur nëngrupe pune, të përbërë nga ekspertë të nivelit të lartë dhe ekspertë të Sekretariatit Teknik, të cilët do të hartojnë projektin dhe do të organizojnë punën për konsultimin e tij. Grupet e punës do të konsultojnë në mënyrë të vazhdueshme materialet e punuara me Bërthamën Think Tank për secilin projektligj**,** e cila përbëhet nga konsulentë të ndryshëm, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, përfaqësues të grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile, etj si dhe me përfaqësuesit e Institucioneve Mbështetëse (Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme, ILDKPKI, etj).

Gjatë vitit 2015, Kuvendi ka vijuar me efikasitet të plotë kontrollin parlamentar mbi ekzekutivin, si dhe kontrollin dhe ndërveprimin me institucionet kushtetuese, apo ato të krijuara me ligj. Komisioni për Integrimin Europian (KIE) ka luajtur një rol kyç për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integrimit europian të Shqipërisë.

Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor të punës së Kuvendit në procesin e integrimit Europian, është miratuar ligji Nr.15/2015 datë 5.3.2015 "*Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian*". Pranë Kuvendit të Shqipërisë është ngritur Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian,si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian, e cila nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integrimit europian. Gjatë vitit 2015, Këshilli Kombëtar ka zhvilluar 3mbledhje me qëllim diskutimin e ecurisë së procesit të integrimit europian, dhe masat e ndërmarra nga Qeveria për përshpejtimin e reformave të nevojshme për plotësimin e prioriteteve kyce për hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Pas publikimit të Raportit të vitit 2015 të Komisionit Europianpër Shqipërinë, Kuvendi ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të këtij Raporti me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të dhëna si dhe përmirësimin e përformancës së tij, sipas standardeve më të mira demokratike.

Pavarësisht përmirësimeve të dukshme në funksionimin e Kuvendit vitet e fundit, konsolidimi i mëtejshëm i demokracisë dhe i parlamentarizmit në Shqipëri, si dhe faza e re në të cilën ka hyrë Shqipëria pas marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE, bashkë me sfidat që etapat e ardhshme të këtij procesi paraqesin për Kuvendin, e bëjnë të domosdoshme vazhdimin e përmirësimit të funksionimit të Kuvendit, me qëllim që të ushtrojë më mirë funksionin ligjvënës dhe të mbikëqyrjes parlamentare, ashtu siç rekomandon dhe Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2015, dhe si orientojnë praktikat më të mira të parlamenteve europiane.

Puna në këtë drejtim do të përqendrohet kryesisht në objektivat dhe masat e mëposhtme:

- Forcimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit përmes: shqyrtimit më cilësor të legjislacionit gjatë procesit legjislativ; përmirësimit të procedurave legjislative dhe bazës metodologjike të punës së Kuvendit me qëllim për të garantuar një përafrim më efektiv të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian; miratimit të Kodit të Sjelljes për deputetët;
- Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, përmes: forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rolit kontrollues të Kuvendit mbi veprimtarinë e qeverisë, përmes përdorimit më intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar; ngritjes së komisioneve hetimore, në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese; forcimit të rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me ekzekutivin dhe institucionet kushtetuese apo të krijuara me ligj me qëllim që të sigurohet ndjekja në vazhdimësi e rezultateve të tyre;
- Miratimi i kuadrit ligjor për adresimin e çështjes së individëve me rekorde kriminale, të cilët mbajnë një post publik ose kërkojnë të zgjidhen apo të emërohen në një post të

tillë, me qëllim rritjen e besimit të qytetarëve tek përfaqësuesit politikë dhe institucionet publike;

- Forcimi i transparencës në veprimtarinë e Kuvendit përmes: rritjes së aksesit të publikut tek veprimtaria parlamentare dhe publikimit të rregullt dhe në kohë të dokumenteve parlamentare; forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e tjera të interesit; hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Komunikimit të Kuvendit; projektimit dhe zbatimit të teknologjive të reja në fushën e informatizimit dhe të automatizimit në Kuvend, nëpërmjet: sistemit audio-video, sistemit elektronik të votimit, sistemeve informatike (softëare dhe hardëare), duke i integruar ato me platformën e-Parlament;
- Forcimi i autonomisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit nga qeveria, përmes rishikimit të kuadrit kushtetues dhe ligjor ekzistues lidhur me buxhetin e shtetit dhe hartimit të një ligji të veçantë për buxhetin e Kuvendit;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit, përmes: përmirësimit të menaxhimit të brendshëm të trajnimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të Kuvendit; hartimit dhe miratimit të Planit të Trajnimit të stafit të Kuvendit për vitin 2016; organizimit të trajnimeve të specializuara në çështjet e BE-së me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe të ekspertizës të stafit të Kuvendit që mbulon çështjet e integrimit evropian, vecanërisht aspektet e përafrimit të legjislacionit si një nga detyrimet kryesore të përcaktuara në MSA.

1.1.3 Qeveria

Qeverisja qendrore përcakton vizionin dhe politikat kyçe, si dhe propozon legjislacionin për forcimin e demokratizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Qeverisë/Këshillit të Ministrave (që përbëhet nga Kryeministri, Zv. Kryeministri dhe Ministrat e Kabinetit) parashikohet në dispozitat themelore kushtetuese, si edhe në Ligjin Nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Përshpejtimi i reformave dhe përgatitja e vendit për t'iu bashkuar Bashkimit Europian mbetet prioriteti madhor i Qeverisë së Shqipërisë.

Ky prioritet do të ndiqet përmes objektivave dhe masave politike të mëposhtme:

- pjesëmarrje konstruktive në Dialogun e Nivelit të Lartë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së për pesë prioritetet e mbetura për hapjen e negociatave dhe përshpejtimin e reformave përkatëse;
- hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020
- forcimi i Departamentit të Zhvillimit të Programimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave;
- ngritja dhe funksionimi i strukturave institucionale të nevojshme për fillimin e procesit *screening* dhe negociatave të anëtarësimit në BE;
- përmbushja e mëtejshme e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit;
- përmirësimi dhe rritja e eficiencës në koordinimin dhe monitorimin e procesit të integrimit europian si element kyç për shpejtimin e procesit të integrimit në BE;

- përshpejtimi i harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së në përputhje me nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- forcimi i bashkëpunimit me vendet dhe vendet kandidate të rajonit, në kuadrin e shkëmbimit të përvojave dhe teknikave më të mira për procesin e përafrimit të legjislacionit europian;
- forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore në përgatitjen për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE-së;
- zhvillimi i takimeve periodike të strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri të ngritura në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit dhe Nënkomitetet);
- përgatitja e një databaze me legjislacionin e përafruar dhe shkallën e përafrimit, ku të kenë akses të gjitha ministritë e linjës, institucionet e tjera qendrore dhe institucionet e pavarura;
- trajnimi i nëpunësve të administratës publike mbi çështjet e integrimit europian;
- trajnimi i mëtejshëm i stafit të Departamentit të Përkthimit mbi përdorimin e softuerëve të specializuar të përkthimit;
- koordinimi i punës për përkthimin e *acquis* të BE-së me autoritetet kompetente të Qeverisë së Kosovës, në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit;
- përgatitja për nxitjen dhe akreditimin e strukturave të nevojshme për të përfituar nga IPA 2014-2020;
- rritja e sensibilizimit dhe komunikimit me palët e interesuara në lidhje me procesin e integrimit, si edhe përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin nga marrja e statusit kandidat dhe anëtarësimi në BE.

Qeveria ka rishikuar mekanizmat koordinues, me qëllim adresimin e prioriteteve kombëtare në kuadrin aktual të marrëdhënieve Shqipëri-BE. Siç parashtrohet në Pjesën 1 të Planit, me Urdhër të Kryeministrit Nr. 107, datë 28.02.2014, Ministria e Integrimit Europian, në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës, është përgjegjëse për përgatitjen në kohë dhe propozimin e masave adekuate që garantojnë zbatim të shpejtë të kriterit politik.

Pushteti vendor në Shqipëri organizohet në dy nivele: a) 61 bashki, dhe b) 12 qarqe.
Baza ligjore për organizimin dhe funksionimin e tij është:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Europiane për Autonominë Vendore";
- Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" me ndryshime;
- Ligji 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) janë përgjegjëse për zbatimin e një pjese të madhe të legjislacionit të përafruar me *acquis* të BE-së, që përfshin fusha të rëndësishme si:
    - infrastruktura dhe shërbimet publike lokale;
    - shërbimet sociale në nivel lokal, shërbimet kulturore dhe sportive;
    - zhvillimi ekonomik vendor;
    - rendi publik dhe siguria;

- arsimi parashkollor dhe parauniversitar;
- sistemi i kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtja e shëndetit publik;
- kujdesi social;
- mbrojtja e mjedisit.

Për të forcuar njësitë e qeverisjes vendore, Qeveria ka miratuar strategjinë ndërsektoriale të decentralizimit dhe qeverisjes vendore me VKM 691, dt. 29.07.2015. Kjo strategji do të mbështesë përmbushjen e objektivave dhe masave konkrete për përmirësimin dhe koordinimin ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore, sidomos në fushat e administratës publike në nivel vendor, shërbimeve publike, decentralizimit fiskal, dhe integrimit europian; rritja dhe përshtatja e mbështetjes buxhetore dhe kapaciteteve fiskale sipas nevojave të zonave specifike të vendit; rritja e transparencës së NjQV-ve dhe inkurajimi i monitorimit dhe denoncimit qytetar; ngritja e sistemit të zyrave unike të shërbimeve në çdo bashki dhe njësi administrative me përdorimin e teknologjisë ICT (one stop shop); promovimi i masave kundër politizimit dhe korrupsionit; forcimi i kapaciteteve të stafit të NjQV-ve mbi legjislacionin dhe politikat e BE-së, me synim përmbushjen e standardeve.

1.1.4 Administrata Publike

Reforma e administratës publike si një prioritet thelbësor për hapjen e negociatave të pranimit në BE ka përparësi të lartë për Qeverinë shqiptare, e cila synon të zhvilloje një administratë publike në kuadër të Hapësirës Administrative Evropiane dhe në përputhje me të, që të sigurojë shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe të përputhet me kërkesat e integrimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efiçente. Në këtë kontekst Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike, e cila u miratua më 15 Prill 2015, VKM nr. 319 fokusohet në këto fusha:

- Politik-bërja dhe cilësia e legjislacionit;
- Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike;
- Shërbimi Civil: menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Procedurat administrative dhe mbikëqyrja.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike 2015-2020 është një sfidë e rëndësishme për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare në fusha të ndryshme, si dhe për të arritur objektivat dhe rezultatet e përcaktuara. Për këtë arsye, monitorimi i zbatimit të saj është një detyrë e rëndësishme e cilat duhet të përmbushet. Me asistencën e OECD/SIGMA, është përgatitur një sistem monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë që përfshin një Pasaportë Indikatorësh të cilët përcaktojnë mënyrën e matjes së rezultateve në bazë vjetore.

Siç u përmend në Progres Raportin e fundit të Komisionit Evropian, *Shqipëria është deri diku e përgatitur n*ë drejtim të reformës në administratën publike.***Është bërë progress i pëlqyeshëm****në fushat e priotiteti kyç të reformës në administratën publike, sidomos për implementimin e një strategjie për një reformë gjithëpërfshirëse dhe implementimin e Kodit të ri të Proçedurave Administrative".* Ndër te tjera, raporti theksoi hapat që duhet të

ndërmerren në mënyre që të realizohet prioriteti kyc në administratën publike, duke u fokusuar në mënyrë të vecantë mbi pikat e mëposhtme:
→ *të vazhdojë të dëshmojë një proces transparent dhe të bazuar në merita për rekrutimin dhe shkarkimin e nëpunësve civilë në të gjitha institucionet shtetërore, me qëllim arritjen e objektivit për një administratë publike profesionale dhe të depolitizuar;*
→ *të bëjë publike informacione të sakta mbi shërbimin publik me anë të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, dhe ta lidhë atë me sistemin e thesarit;*
→ *të përgatitet për zbatimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative, dhe paralelisht të rishikojë dhe përafrojë pjesën tjetër të legjislacionit përkatës.*

Ligji i shërbimit civil është në përputhje me parimet e Administratës Publike ndërkohë qëzbatimi i legjislacionit dhe monitorimi i tij është thelbësor. Miratimi dhe zbatimi i Ligjit të ri për Shërbimin Civil që hyri në fuqi më 26 shkurt 2014 ishte një reformë e nevojshme ligjore për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të administratës publike. Pas zbatimit të këtij legjislacioni të ri dhe sfidat e hasura, u kryen disa ndryshime në Ligjin për Shërbimin Civil. Në përputhje me to, legjislacioni dytësor përcjellës është duke u përshtatur në mënyrën e duhur.

Si një monitorues i pavarur i menaxhimit të shërbimit civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i emëruar nga Parlamenti në fund të vitit 2014, është plotësisht funksional dhe ka paraqitur tashmë raportin e parë në Parlament. Gjatë vitit 2015, Komisioneri ka kryer një numër inspektimesh në institucionet e administratës shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore dhe organet e pavarura, me qëllim sigurimin e zbatimit të duhur të legjislacionit të shërbimit civil.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike do të vazhdojë të ofrojë trajnime sipas programit të saj të trajnimit për të rritur më tej cilësinë e kurrikulave. Më shumë se 1000 ditë trajnimi janë ofruar dhe katër kurset e para në platformën e-learning janë tashmë në dispozicion. Duke patur parasysh rëndësinë e ofrimit të programeve të trajnimit të avancuar për menaxherët e nivelit të lartë drejtues, module të ndryshme trajnimi janë aktualisht duke u pilotuar me qëllim ofrimin e një programi të cilësisë së lartë.

Një tjetër hap i rëndësishëm është ndërmarrë drejt sigurimit të emërimeve dhe lirimeve të drejta të nëpunësve civile. Urdhri i miratuar i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në zbatimin e vendimeve të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit të shërbimit civil, ka për qëllim të përcaktojë rregullat për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve së formës së prerë në favor të nëpunësve civilë, të cilët kanë fituar çështjet në gjykatë, duke përckatuar në këtë mënyrë një procedure konkrete mbi këtë çështje.

Procedurat e reja të rekrutimit në përputhje me dispozitat e legjislacionit po zhvillohen tashmë prej mbi një viti. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër, ka pasur përmirësime në mënyrat e administrimit të procedurave të rekrutimit nga Departamenti i Administratës Publike. Çdo aplikant është në komunikim të vazhdueshëm me DAP gjatë gjithë procesit të rekrutimit duke filluar nga faza e parë e aplikimit, deri në përfundimin e të çdo procedure rekrutimi.

Me qëllim rritjen e transparencës gjatë procedurave të rekrutimit, është krijuar një sistem aplikimi online i cili është plotësisht funksional dhe të gjitha aplikimet për pozicionet e shërbimit civil janë kryer përmes tij.Vlerësimi i testeve me shkrim mbështet nga një sisteme elektronik, ndërkohë që çdo fletë testimi është anonime dhe e koduar, duke siguruar anonimitet të plotë gjatë procedurës së vlerësimit.Departamenti i Administratës Publike është duke punuar në bërjen funksional të një sistemi të përmirësuar aplikimi për pozicione vakante në shërbimin civil, i cili pritet të vihet në zbatim në Mars të vitit 2016. Ndër të tjera, me qëllim që të rritet më tej cilësia dhe transparenca e procesit të vlerësimit për testet e shkruara, po punohet për të krijuar dhe për të bërë funksional një 'bank-pyetjesh' (question-bank) e cila do të mundësojë gjenerimin automatik të pyetjeve në varësi të grupit të pozicioneve vakante dhe fushave të njohurive përkatëse.

Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është shtrirë në të gjitha ministritë e linjës dhe Kryeministri, si dhe institucionet në varësi të tyre.Ndërkohë, procesi i plotesimit të sistemit me të dhënat e punonjësve ka përfunduar për Kryeministrinë dhe ministritë e linjës dhe po punohet për të bërë të njëjtën gjë për institucionet e varësisë.SIMBNJ është lidhur me sistemin e Thesarit dhe është në fazën e pilotimit të gjenerimit të pagave për të punësuarit për Kryeministrinë dhe ministritë e linjës nëpërmjet sistemit. Brenda fundit të vitit 2016, të gjitha institucionet e pavarura, si dhe njësitë e qeverisjes vendore do të përfshihen në HRMIS dhe për këtë arsye, duke filluar nga Dhjetor 2015 do të zhvillohen trajnime me përfaqësues nga të gjitha institucionet.

Gjatë vitit 2016, Departamenti i Administratës Publike do të vazhdojë të sigurojë zbatimin rigoroz të ligjit *"Për nëpunësin civil"* (ndryshuar) dhe aktet nënligjore shoqëruese, duke koordinuar punën e tij me të gjitha njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore për të unifikuar dhe për të vepruar në përputhje me të gjitha procedurat, në mënyrë që të përmirësohet performanca e Administratës Publike.

Objektivat kryesore të DAP-it për vitin 2016 do të jenë të lidhura drejtëpërdrejtë me masat e nevojshme për të siguruar që të gjitha masat e parashikuara të finalizohen dhe zbatohen në mënyrën e duhur duke u fokusuar, ndër të tjera, në vazhdimin e zbatimit të ligjit të shërbimit civil, kryerjen e procedurave të drejta të rekrutimit , dhe funksionalitetin e plotë të HRMIS.

1.1.5 Avokati i Popullit

Krijimi i institucionit të Avokatit të Popullit është parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Funksionimi i këtij institucioni rregullohet nga ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Avokati i Popullit në mënyrë aktive promovon të drejtat e njeriut, në veçanti ato të grupeve më vulnerabël, dhe bashkëpunon intensivisht me shoqërinë civile. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Për të forcuar rolin e Avokatit të Popullit, parashikohen prioritetet dhe masat e mëposhtme:

- informimi i Avokatit të Popullit në kohën e duhur për propozimet përkatëse legjislative në mënyrë që të mundësohet dhënia e komenteve;
- përmirësimi i shqyrtimit nga Kuvendi i raportit të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit;
- mbështetje për institucionin përmes rritjes buxhetore dhe parashikimit të personelit për zyrat rajonale.
- përmirësime të ligjit organik nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, bazuar në rekomandimet e projektit Euralius.

1.1.6 Shoqëria Civile

Zhvillimi i sektorit të organizatave të Shoqërisë civile në Shqipëri ka qenë i lidhur me nisma dhe ndryshime ligjore të cilat janë përpjekur të krijojnë një mjedis mundësues për organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Në lidhje me lirinë e organizimit, Shqipëria ka një kuadër ligjor, sipas të cilit çdo person ka të drejtë të themelojë shoqatë, fondacion dhe qendër për çfarëdo qëllimi të lejuar nga ligji.

Krijimi i Sektorit të Shoqërisë Civile si pjesë e Ministrisë së Integrimit Evropian. Ky sektor është përgjegjës për komunikimin e integrimit në BE të SHC në Shqipëri, për koordinimin e pjesëmarrjes së SHC në cështje që lidhen me Integrimin Europian, si dhe financimin dhe monitorimin e fondeve të IPA-s për shoqërinë civile.

Miratimi i Ligjit "Për krijimin dhe funksionin e Këshillit Ekonomik Kombëtar" në mars 2014 i cili garanton bashkëpunimit institucional dhe të partneritetit publik-privat për zhvillimin e politikave ekonomike, për garantimin e dialogut dhe këshillimit ndërmjet organeve të administratës shtetërore dhe sektorit privat, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat në këtë proces

Miratimi i Ligjit Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", në nëntor 2014, si pjesë e iniciativës globale Partneritet për qeveri të hapur. Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe me efektivitet ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

Në lidhje me kuadrin fiskal, miratimi i Ligjit "Për TVSH-në", në prill 2014, ka patur një rëndësi të vecantë. Ligji përjashton organizatat e shoqërisë civile nga detyrimi për TVSH, për rastet e pagesave të përfituara nga kuotizacionet (nëse kanë të tilla), ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, me perjashtim të rasteve kur këto organizata përfitojnë pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike.

Është miratuar Udhërrëfyesi për krijimin e një mjedisi mundësues për ShC, në maj 2015. Ky dokument përbën një instrument të rëndësishëm për orientimin e aksioneve nga ana e Qeverisë, me qëllim vendosjen e mekanizmave të duhur të bashkëpunimit mes shoqërisë

civile dhe qeverisë, për përfshirjen e shoqërisë civile në dhënien e kontributit për zhvillimin e vendit drejt anëtarësimit në BE.

Udhërrëfyesi fokusohet në nëntë fusha prioritare të identifikuara përmes takimeve të hapura konsultative me OSHC-të dhe diskutimeve mes përfaqësuesve të qeverisë, Delegacionit dhe donatorëve, si edhe bazuar në analizën e raporteve, studimeve dhe vlerësimeve të sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri. Të nëntë fushat prioritare mishërojnë parimet dhe objektivat e përcaktuara në Udhëzimet mbi mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile 2014-2020, të cilat janë konceptuar si kuadër për vendet aspirante duke identifikuar përqasje në nivel kombëtar.

Ndërkohë, ka filluar puna me BE-në për zbatimin e paketës së Asistencës Teknike për vënien në jetë të masave të parashikuara në Udhërrëfyes.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Në shtator të vitit 2014 u krijua Grupi Teknik i Punës, me pjesëmarrës anëtarë të Task Forcës së SHC, Kryeministrinë, Ministrinë e Integrimit, Ministrinë e Mirëqënies Sociale, AMSHC për të për hartimin e draftligjit për këshillin e shoqërisë civile. Puna për hartimin e draftligjit është përfunduar në shkurt 2014, pas diskutimeve bashkëpunuese dhe punës në grup midis palëve.

Gjatë periudhës mars – prill 2015, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) ndërmorrën rreth nëntë takime konsultative me përfaqësues nga shoqëria civile në të gjithë vendin. Ligji për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile u miratua në muajin nentor 2015 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian

Mbas kalimit në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë, datë 5.3.2015, ligji nr.15/2015 “Për Rolin e Kuvendit në Procesin e Integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” parashikon në nenet 6, 7 dhe 8 ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian. Siç edhe parashikuar në këtë ligj, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian është struktura më e lartë këshillimore në fushën e integrimit evropian, që monitoron dhe jep udhëzime strategjike mbi procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke garantuar konsensusin dhe bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore, partive politike dhe shoqërisë civile në këtë proces. Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian në aktivitetin e tij synon të nxisë dhe përshpejtojë realizimin e reformave madhore të nevojshme në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

1.1.7 Sistemi Gjyqësor - (shih gjithashtu kapitullin 23 të PKIE)

Me vendimin nr.96/2014 Kuvendi i Shqipërisë miratoi krijimin e një komisioni të posaçëm (Komiteti ad hoc) "Për reformimin e sistemit të drejtësisë." Mandati i Komisionit është të analizojë situatën aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë; të identifikojë problemet dhe nevojat për përmirësim; të hartojë një dokument strategjik mbi

objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë; propozojnë një paketë të plotë të projektligjeve që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë edhe ato kushtetuese. Ministria e Drejtësisë merr pjesë aktive përmes përfaqësuesve të saj në grupet e punës të ngritura në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për reformën në drejtësi.

Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar një dokument analitik mbi gjendjen aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë e cila ka shërbyer si bazë për punën e nivelit të lartë të grupit të punës, i ndihmuar nga Sekretariati Teknik në Komisioni e posacëm parlamentar ad hoc, për të identifikuar problemet dhe nevojat për përmirësim.

Pas një diskutimi gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët kombëtarë, partnerët ndërkombëtarë dhe palët e tjera të interesuara dhe publiku, Komiteti Ad Hoc ka miratuar vendimin nr.14, datë 30.07.2015, "Për miratimin e dokumentit" Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri ".

Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit për zhvillimin e një strategjie për reformën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, janë hartuar nga Niveli Grupit të Ekspertëve të Lartë me ndihmën e Sekretariatit Teknik, në përmbushjen e fazës së dytë të funksionimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentarë të Reformës në Sistemin e Drejtësisë.Bazuar në çështjet dhe shqetësimet e identifikuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë, Strategjia përcakton objektivat e përgjithshme dhe specifike të reformës në sistemin e drejtësisë dhe ndërhyrjet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore për realizimin e këtyre objektivave.Dokumenti analitikë i sistemit të drejtësisë në Shqipëri, si dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri ", janë miratuar në parim me vendimin nr. 15, datë 30.07.2015 të Komisionit të Posaçëm për Reformën e Sistemit të Drejtësisë dhe do të shërbejë si dokument udhëzues për fazën e tretë, e cila është një fazë që përkon me hartimin e një pakete ndryshimesh ligjore dhe kushtetuese. Ato mbeten të hapura për komente dhe sugjerime për përmirësim.

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë do të vazhdojë tëorganizojë procesin e konsultimit publik dhe konsultimin me ekspertizën ndërkombëtare sidhe të vlerësojë e reflektojë përfshirjen e tyre në këto dokumente.

Më28.9.2015Komisioni Parlamentar AdHoc ika kërkuarKomisionit të Veneciasopinionin e tijmbiprojekt-amendimet dhe çështjet kushtetuesetë hartuara nga Grupi i Punës i Ekspertëve tëNivelittë Lartë.

Në përmbushje të objektivit (fazës) të tretë, grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, bazuar në gjetjet e Dokumentit të Analizës së Sistemit (të përgatitur gjatë fazës së parë) dhe në zbatim të objektivave të Dokumentit Strategjik (të përgatitur gjatë fazës së dytë), do të bëjë hartimin e paketës së projektligjeve të nevojshme për reformimin e sistemit të drejtësisë.Reforma në drejtësi është hartuar në 7 shtylla kryesore të cilat plotësojnë ndërtimin e sistemit të drejtëisë në vend. Plani i Veprimit përmban një listë të detajuar të masave ligjore për tu miratuar në 2016.

Etika profesionale është një nga lëndet e përfshira në programin e trajnimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Etika profesionale zhvillohet në vitin e parë si lëndë vjetore e cila në total përfshin 72 orë mësimore. Duhet evidentuar se ky ndryshim është bërë këtë vit akademik, pasi në vitet e mëparshme ajo ishte pjesë e programit si lëndë semestrale dhe përfshinte 32 orë mësimore.

Gjithashtu, kandidatët për magjistratë të vitit të tretë si dhe gjyqatërt dhe prokurorët në detyrë, si pjesë e programit të Trajnimit Vazhdues, ndjekin rregullisht trajnimet me temë Etikën profesionale, e cila është zhvilluar në mënyrë të përsëritur në Shkollën e Magjistraturës në bashkëpunim me partner ndërkombëtarë.

Në Shkollë ka një program trajnimi për praktiken gjyqësore të Gjykates Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por trajnimi për EU Acquis është i kufizuar. 11% e gjyqtarëve të nivelit të parë dhe të dytë marrin pjesë në trajnime të vazhdueshme për të drejtën e BE-së.

Një rëndësi e vecantë në këtë vit të ri akademik i është kushtuar të drejtës së Bashkimit Europian dhe ndikimit të saj në përmirësimin apo përqasjen me legjislacionin shqiptar.

Analiza krahasimore, evidentimi i parimeve dhe praktikave të përbashkëta, analizimi i bashkëpunimeve që vijnë si rrjedhojë e nënshkrimit të Konventave dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me aktet komunitare janë tema për të cilat ka një interes të shtuar dhe për këtë arsye Shkolla e Magjistraturës i ka parë me prioritet për ti bërë pjesë të Programit të Trajnimit Vazhdues dhe është kërkuar/ofruar asistencë nga ekspertë ndërkombëtar.

Konkretisht, temat që trajtojnë të drejtën e Bashkimit Europian zënë 54% të të gjitha temave të parashikuara. Në mënyrë më të detajuar:

Në 14 tema trajtohet vetëm e drejta e BE, nga të cilat 8 tema trajtojnë ligjet, konventat dhe praktikën e Bashkimit Europian dhe 6 tema trajtojnë të drejtat e njeriut sipas legjislacionit të BE.

Në 24 tema analizohet e drejta e BE në lidhje/krahasim me legjislacionin shqiptar apo ndikimi i saj në legjislacionin shqiptar me qëllim përafrimin e këtij të fundit, nga të cilat 10 tema trajtojnë legjislacionin penal dhe bashkëpunimin në fushën penale, 9 tema trajtojnë parimet dhe praktikat e përbashkëta në fushën civile, administrative dhe kushtetuese, si dhe 5 tema trajtojnë ndikimin e këtyre parimeve në ndryshimin e legjislacionit shqiptar që priret të përafrohet dhe reflektojë parashikimet e legjislacionit apo akteve të BE.

Shqiperia akoma nuk merr pjese ne Rrjetin Evropian per Trajnimet Gjyqesore.

Aktualisht është përgatitur i gjithë dokumentacioni sipas procedurës që kërkohet për të marrë statusin e vendit vëzhgues në Rrjetin Evropian për Trajnimet Gjyqësore dhe është dërguar aplikimi në EJTN.

1.1.8 Politikat Kundër – Korrupsionit - (shih gjithashtu kapitullin 23 të PKIE)

Lufta kundër korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare. Politikat kundër-korrupsionit synojnë reduktimin e korrupsionit në mënyrë progresive, duke rritur integritetin e institucioneve dhe promovimin e qeverisjes përmes përmirësimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve, zbatimit të ligjit dhe transparencës. Pavarësisht të gjitha masave të marra për të reduktuar korrupsionin dhe për të rritur transparencën dhe hetimet, korrupsioni vazhdon të jetë një fenomen i përhapur gjerësisht. Deri tani puna është fokusuar në identifikimin e mangësive përsa i përket bashkëpunimit midis institucioneve, në krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe në zhvillimin e hetimeve proaktive, si një parakusht për krijimin e një historiku rezultatesh *(track record)* të ndjekjes efektive penale në të gjitha nivelet, veçanërisht në ato fusha ku ekziston një perceptim i fortë publik për korrupsion.

Gjithashtu, Shqipëria është aktualisht në raundin e katërt të vlerësimit të GRECO, dhe ka marrë 10 rekomandime të cilat duhet të plotësohen brenda vitit 2016 lidhur me konfliktin e interesit në Deklarata e aseteve, rregullat etike dhe kodin e sjelljes në fushën e parlamentarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Qeveria shqiptare ka marrë një sërë masash konkrete që janë provë e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin në vend. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore vepron si Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), duke siguruar një bashkërendim të të gjitha përpjekjeve dhe politikave kundër korrupsionit në nivel kombëtar. Ka përfunduar hartimi i Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit 2015 – 2020 dhe Plani përkatës i Veprimit 2015 – 2017,e cila është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.247, dt.20.3.2015dhe është ngritur rrjeti i koordinatorëve dhe pikave të kontaktit kundër-korrupsionit si në institucionet e pavarura ashtu dhe ato ekzekutive, përfshi qeverisjen vendore, në nivel prefekture. Pas miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të krijohet Forumi Konsultativ për Politikat kundër Korrupsionit i cili do të ketë në përbërjen e tij dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit ka një qasje prej tre-aspektesh që përfshin: parandalimin, ndërshkimin dhe ndërgjegjësimin.

Në kuadër të parandalimit janë parashikuar disa masa legjislative, përfshi atë për mbrojtjen e informatorëve të rasteve të korrupsionit i cili pritet të miratohet në Dhjetor 2015, miratimi i plotë i ligjit për të drejtën e informimit si dhe ligji për konsultimin publik në 2014, pëfshihen në qasjen parandaluese. Për zbatimin e këtyre masave legjislative, institucionet janë angazhuar për rritjen e transparencës në veprimtarinë shtetërore, përfshi këtu aksesin në informacion për shërbimet e ndryshme apo për planifikimin dhe përdorimin e fondeve shtetërore. Gjithashtu, Qeveria synon rritjen e kapaciteteve të institucioneve për kontrollin dhe inspektimin e brendshëm, si dhe për vlerësimin e riskut për korrupsion në institucionet e administratës shtetërore. Në lidhje me statistikat e harmonizuara dhe historikun e rezultateve *(track record)* për çështjet e korrupsionit, grupi i punës i kryesuara nga Ministria e Drejtësisë kanë siguruar të dhëna në mënyrë periodike, si dhe kanë hartuar një metodologji për raportimin e të dhënave të konsoliduara për korrupsionin. Ky sistem elektronik, i quajtur sistemit elektronik për regjistrimin dhe ndjekja e të dhënave mbi rastet e korrupsionit dhe Statistikave të Harmonizuar, është krijuar si bazën e të dhënave shtetërore me anë të

Vendimit të Këshillit të Ministrave, no.824 datë 07.10.2015, i cili ka hyrë në fuqi më 14.10.2015 , ku KKKK është emëruar si administrator të sistemit.

Në kuadër të parandalimit të korrupsionit, është konsideruar i i rëndësishëm roli i Inspektoratit të Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesit (ILDKPKI). Në vijim të ndryshimeve ligjore që janë bërë me synim përmirësimin e kontrollit të pasurive, në kuadrin e luftës kundër korrupsionit, vlerësohet aktiviteti i ILDKPKI, i cili gjatë 2014 ka treguar një rritje të konsiderueshme në numrin e zyrtarëve që ka kontrolluar, si dhe të masave të tjera administrative dhe kallëzimeve penale pranë Prokurorisë. Prioritetet e ILDKPKI lidhen me përmirësime ligjore në vijim të rekomandimeve të ndryshme (GRECO, projekti ACFA) etj. për zbatimin më të mirë të kuadrit ligjor për konfliktin e interesit dhe për deklarimet e pasurive.

Gjithashtu, ILDKPKI ka si prioritet dixhitalizimin e proceseve të deklarimit të pasurive (deklarimin online) për të mundësuar rritjen e efikasitetit të ILDKPKI si dhe për të mundësuar në afat të gjatë publikimin e deklaratave të interesave private pa kërkesë. Më tej, synohet rritja e kapaciteteve të ILDKPKI për zbulimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve të interesave rast pas rasti si dhe bashkëpunimi më i ngushtë me institucionet e tjera për shkëmbimin e informacionit për rastet e konfliktit të interesave, sidomos në fusha me risk për korrupsion. Me miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e informatorëve të rasteve korruptive, roli i ILDKPKI-së fuqizohet më tej si organi i pavarur i cili do të monitorojë dhe zbatojë këtë kuadër ligjor.

Në kuadër të ndëshkimit të korrupsionit është synuar hetimi dhe goditja e veprimeve korruptive në sektorët e shërbimit publik si dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Gjithashtu, janë përmirësuar kapacitetet për hetimet proaktive për rastet e korrupsionit dhe krimeve të zyrtarëve në detyrë, ndërsa fokusi në goditjen e korrupsionit në nivele të larta dhe në sistemin gjyqësor do vazhdojë të mbetet prioritet gjatë 2016 - 2017. Gjatë vitit 2014 është arritur objektivi i Policisë të Shtetit për rritjen e hetimeve proaktive prej 5%.

Më tej është synuar rritja e integritetit të punonjësve të Policisë, përmes reformimit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, përmes miratimit në të ligjit Nr. 70/2014 dhe shndërrimit të Shërbimit në një agjenci të mbikëqyrjes së jashtme qytetare të Strukturave.

Shërbimi ka parandaluar, zbuluar dhe goditur veprimtaritë e kundërligjshme të nëpunësve të Policisë dhe ka treguar rritje në cilësinë dhe efikasitetin e punës së tij, sidomos në fushën e korrupsionit.

Amendimet ligjore do të propozohen brenda muajit mars të vitit 2016 për krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit do të rrisë luftën kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor, në nivelet e larta si dhe tek të zgjedhurit vendorë. Për këtë qëllim janë përcaktuar dhe disa indikatorë të matshëm si psh: Numri i rasteve të evidentuara për korrupsion dhe krime të kryera nga zyrtarët në detyrë, numri i operacioneve policore dhe i hetimeve proaktive në këtë fushë do të jetë 5% më shumë se ai i një vit më parë.

Në fushën e ndëshkimit të korrupsionit nga organet e drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë ka rritur kompetencat e Gjykatës së Krimeve të Rënda në luftën kundër korrupsionit, përmes miratimit të ligjit nr. 21/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ndryshon nenin 75 (a) duke zgjeruar kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda për të përfshirë veprat penale të korrupsionit për zyrtarët e lartë. Në kuadër të përmirësimit të transparencës, Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2014 ka instaluar sistemin elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore (ICMIS) në 34 gjykata (përfshirë edhe gjykata administrative dhe Gjykatën e Lartë), pra në 90 % të gjykatave. Gjithashtu, sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore (RDA) është instaluar në 26 gjykata (68% të gjykatave). Brenda gjashte mujorit të parë të vitit 2015, sistemi audio të jetë instaluar në të gjitha gjykata.

Objektiv madhor në kuadër të ndëshkimit të korrupsionit është edhe reforma në drejtësi e cila pritet të ndërmarrë ndryshime ligjore në fushën e ndëshkimit të korrupsionit, në vlerësimin e gjyqtarëve, parandalimin e korrupsionit në gjyqësor, si dhe në hetimin e korrupsionit.

Përsa i përket veprimeve edukuese dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit parashikohen një seri masash për të forcuar rolin e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit si dhe në rritjen e pjesëmarrjes e bashkëpunimit të publikut në luftën kundër korrupsionit. Aktualisht po zbatohen dhe është planifikuar një plan masash edukuese në formatin e një fushatë kombëtare të ndërgjegjësimit për rastet korruptive dhe prezantimi i mjeteve inovative për denoncimin e korrupsionit. Pjesë e këtij plani masash është iniciativa e re e Qeverisë për të pasur një portal unik për denoncimin e korrupsionit, ëëë.stopkorrupsionit.al, portal i cili u prezantua publikisht në 2 shkurt 2015.

Gjithashtu, në mars të vitit 2015, një mekanizëm reagimi SMS u prezantua në spitale dhe të gjitha zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në nivel qendror dhe rajonal. Kjo procedurë shërben për të mbledhur mendimet e kënaqësisë së qytetarëve për shërbimet e ofruara nga këto institucione publike dhe të raportojë çdo rastet e ryshfetit e kërkuara nga zyrtarët publikë.

1.1.9 Lufta Kundër Krimit të Organizuar

Sfera e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme është gjithashtu një fushë prioritare e qeverisë shqiptare, si dhe një element shumë i rëndësishëm në përmbushjen e standardeve në kuadër të integrimit të Shqipërisë dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë pjesë e 5 prioriteteve kyçe të adresuara nga Udhërrëfyesi dhe Progres Raporti i Komisionit Evropian 2015. Dispozitat MSA-së e detyrojnë Shqipërinë të angazhohet në promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët për çështjet që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandës, trafikimit të paligjshëm të armëve dhe automjeteve, e të tjera si stabiliteti.

Shqipëria është e angazhuar për të çuar përpara rezultatet pozitive të arritura dhe për të adresuar rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2015.

Rezultatet e arritura në vitet e fundit demonstrojnë përparimin e bërë në bashkëpunim me policinë dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ngritja e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit për të siguruar zbatimin e rreptë të ligjit është prioritet i adresuar në planin e veprimit në vijim. Bashkëpunimi ndër-institucional, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë ka vazhduar të japë rezultate të mira në aspektin e operacioneve, arrestimeve dhe hetimeve të përbashkëta, përfshi edhe hetimin e pasurive kriminale.

Referuar çështjeve anti-trafik, koordinimi i përpjekjeve në nivel kombëtar është adresuar në një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë jo vetëm institucionet publike, por edhe shoqërinë civile dhe publikun e gjerë.

Strukturat shtetërore shqiptare janë plotësisht të angazhuara në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme, duke synuar arritjen e standardeve të kërkuara. Ndryshimet strukturore dhe ligjore në policinë e shtetit dhe në prokurori kanë ndodhur në kuadër të intensifikimit të luftës kundër krimit të organizuar. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe protokolle me Europol-in, me Italinë dhe Greqinë.Gjatë vitit 2015 janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Malin e Zi, Maqedoninë, Kroacinë dhe Kosovën.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (ZKKA) e ka rigjallëruar këtë mekanizëm kombëtar referimi, për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore me një intensifikim të aktiviteteve në fushën e parandalimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut, dhe ka finalizuar strategjinë e re Kombëtare dhe Planin e Veprimit për 2014-2017, e cila është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave më datë 26.11.2014. Tre njësi të lëvizshme janë krijuar në Tiranë, Vlorë dhe Elbasan, që ka çuar në rritjen e identifikimeve të viktimave dhe viktimave të mundshme. Janë intensifikuar hetimet për veprat penale kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik. Qeveria shqiptare po zbaton me sukses planin kombëtar kundër lëndëve narkotike dhe, bashkëpunimi me vendet e tjera ka çuar në rezultate të suksesshme edhe në këtë fushë. Megjithatë, qeverisë shqiptare do t'i duhet të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të rritur rezultatet në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, të tilla si rritja e hetimeve proaktive, duke përdorur teknika të veçanta të hetimit, rritjen e ndërgjegjësimit ndërmjet institucioneve të ndryshme, intensifikimin e bashkëpunimit me vendet fqinje dhe vendet e tjera të BE-së për këto çështje.

Për vitin 2016, objektiv mbetet thellimi i luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, për plotësimin e këtij prioriteti janë parashikuar:

- Forcimi i luftës kundër trafiqeve të paligjshme, pastrimit të parave dhe përmirësimi i implementimit efektiv të ligjit anti-mafia, nëpërmjet ndryshimeve ligjore, që do të rezultojë në rritjen e treguesve.
- Thellimi i mëtejshëm i luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike duke synuar në reduktimin e ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm, me fokus në trafikun e drogave të forta, heroinë dhe kokainë duke intensifikuar punën me partnerët ndërkombëtarë.

1.1.10 Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Respektimi i të drejtave themelore në institucionet penitenciare është një komponent i rëndësishëm për përmbushjen e kritereve të përcaktuara në udhërrëfyesin e Bashkimit Evropian.Në funksion të përmbushjes të rekomandimeve për forcimin e respektimit të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve, me urdhër Nr. 10427 Prot. datë 23.04.2015 është miratuar Plani i Veprimit të Rekomandimeve të Progres Raportit të Komisionit Evropian, i cili adreson masa konkrete në përmbushje të rekomandimeve, sipas afateve kohore të mirë përcaktuara.

Me mbështetjen financiare të delegacionit të Bashkimit Evropian në muajin dhjetor 2015 do të fillojë aplikimi i projektit të binjakëzimit për reformën në sistemin e burgjeve në të cilat janë përcaktuar gjashtë shtylla kryesore: 1. Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore sipas *acquis communataire*; 2. Ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve; 3. Menaxhimi i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe grupeve vulnerabël; 4. Krijimin e një sistemi të pavarur inspektimi dhe monitorimi për burgjet; 5. Platformë e integruar për komunikimin me publikun; 6. Forcimin e zbatimit të dënimeve alternative.

Mbipopullimi është një problematikë e ndjeshme për të gjithë sistemin penitenciar. Duke qenë se kjo çështje kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka ndërmarrë një studim mbi shkaqet dhe efektet e mbipopullimit në sistemin e burgjeve. Ky studim është shoqëruar me hartimin e dokumentit të politikave "***Për uljen e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale".*** Nëpërmjet këtij dokumenti synohet të prezantohet situata aktuale e zbatimit të politikave penale apo praktikave të organeve të drejtësisë penale që ndikojnë në shtimin e fluksit të popullimit në burgje dhe në institucionet e paraburgimit, si dhe të propozohen rekomandime mbi çështje që duhet të bëhen objekt i rivlerësimeve të mëtejshme nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale në vend. Konkluzionet e studimit do të bëhen publike për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Dokumenti i Politikave do të shoqërohet me një Plan Veprimi, ku do të adresohen masat konkrete për uljen e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore në përmbushje të çdo aktiviteti që do të ndërmerret.

Gjithashtu hapja e institucionit të ri në Shkodër do të ndikojë në uljen e mbipopullimit.

Forcimi i bashkëpunimit me Institucionin e Avokatit të Popullit mbetet një nga prioritetet e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. DPB është angazhuar maksimalisht për plotësimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nëpërmjet azhurnimit të përvitshëm të Planit të Veprimit me masa konkrete, sipas rekomandimeve të AP. Pjesë e procesit të administrimit të dhënave statistikore mbi bashkëpunimin me AP ka qenë administrimi i një database mbi numrin e vizitave monitoruese të kryera nga AP, numrin dhe përqindjen e rekomandimeve të përmbushura.

Në funksion të masave për rritjen e kapaciteteve të stafit të sistemit të burgjeve për respektimin e çështjeve të privatësisë dhe konfidencialitetit të bisedave të paraburgosurve dhe të dënuar është dërguar për zbatim në të gjitha IEVP-të Udhëzuesi "Mbi konfidencialitetin dhe standardet profesionale të stafeve në burgje" (miratuar me urdhrin nr. 1606 Prot. datë 24.02.2015).Ky udhëzues përcakton standardet e sjelljes dhe disiplinës të personelit të sistemit të burgjeve dhe të ruajtjes së privatësisë dhe konfidencialitetit, si dhe standardin e sigurisë dhe të gjitha standardet e tjera, që lidhen me trajtimin e të burgosurve.

Neni 28 i Ligjit Nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" parashikon "trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, apo të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm duhet të trajtohen në një institucion mjekësor të posaçëm".Ndërtimi i një institucioni të posaçëm po ndiqet me preçedëncë nga Ministria e Shëndetësisë.

Për të lehtësuar qëndrimin e personave me probleme të shëndetit mendor në burgje, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka marrë një sërë masash si: **i.** Janë hapur Sektorë të Kujdesit të Veçantë për të sëmurët mendor në 8 IEVP (Durrës, Krujë, Ali Demi, Elbasan, Korçë, Peqin, Jordan Misja, Lezhë); **ii**. Duke qenë se IEVP Krujë, Peqin ka numrin me të lartë të personave me probleme të shëndetit mendor dhe ka mungesë të mjekëve psikiatër jo vetëm në sistemin penitenciar por edhe në strukturat e shëndetit publik, këto pacient konsultohen nga mjekët psikiatër të institucioneve shtetërore dhe mjekëve psikiatër të IEVP, sipas një grafiku të përcaktuar. Aktualisht në sistemin e burgjeve janë 4 mjek psikiatër (në IVSHB, Lezhë, Durrës dhe Korçë), të cilët kryejnë konsulta psikiatrike sipas problematikave të paraqitura; **iii.** Në muajin janar 2015, është miratuar manuali për trajtimin personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe parandalimin e vetëvrasjes në sistemin penitenciar. Ky manual synon ngritjen e kapaciteteve të stafit të burgjeve përnjohjen legjislacionit kombëtar mbi shëndetin mendor, njohjen e keqperceptimeve, sjelljeve vetdëmtuese dhe ndërgjegjësimit për rastet e vetëvrasjeve. Stafi i burgjeve është trajnuar mbi aftësive bazë intervistuese, parandalimin e krizave, rreziqet dhe menaxhimi i rreziqeve, dallimin e shenjave dhe simptomave të llojeve të ndryshme të sëmundjeve mendore, ruajtjen e një shëndeti pozitiv mendor, llojet bazë të kujdesit/menaxhimit, praktikat referuese dhe materialet përkatëse, planet e kujdesit; **iv**.Në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit janë hartuar udhëzues dhe protokolle, për mënyrën e trajtimit të këtyre pacientëve.

Gjatë vitit 2015 me investim të fondeve të buxhetit të shtetit u rikonstruktuan plotësisht ambientet e Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale "Jordan Misja", Tiranë.

Gjatë vitit 2015 u ndërmor një nismë e rëndësishme që kishte për qëllim forcimin e marrëdhënieve të personave me liri të kufizuar me familjarët e tyre.Kjo nismë u jetësua përmes zbatimit të programit "Prindërimi në distancë", i cili konsistoi në përshtatjen e ambienteve të takimit të personave të dënuar dhe të paraburgosur me familjarët e tyre. Pjesë e kësaj nisme ishte gjithashtu përshtatja e një ambienti të ri takimesh të miturve në Institutin e të Miturve në Kavajë me familjarët e tyre, i cili synonte krijimin e një atmosfere sa më miqësore.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është e angazhuar që të sigurojë një gamë të gjerë të programeve ndërhyrëse për personat në konflikt me ligjin, të cilat janë të fokusuara në uljen e recidivizmit, sigurinë e komunitetit dhe parandalimin e krimit nëpërmjet kontrollit, mbikëqyrjes, rehabilitimit dhe përgatitjes për ri-integrim të kësaj kategorie.

Në funksion të zbatimit të programeve të ri-integrimit për kategorinë e personave me liri të kufizuar pas lirimit të tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka qenë aktive në ndërmarrjen e nismave të bashkëpunimit me institucioneve përgjegjëse dhe aktorëve aktivë në çështjet e ri-integrimit të personave në konflikt me ligjin. Pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në nëntor të vitit 2014, është rritur angazhimi për zbatimin e programeve të ri-integrimit fillimisht për kategoritë me nevoja më specifike për mbështetje, si të miturit dhe gratë. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka bashkëpunuar gjatë vitit 2015 me disa agjenci që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut si UNICEF, Save the Children (SCH) dhe USAID, për zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit për të miturit dhe gratë para dhe pas lirimit të tyre nga burgu.

Tabela mbi rastet e ri-integrimit të miturve të menaxhuara në terren gjatë periudhës 2014-2015

	Raste të menaxhuara në total	***Raste suksesi***	***Regjistruar në shkollë***	***Regjistruar në kurse të formimit profesional***	***Trajnimi në vendin e punës***
2014	79	35	14	15	6
2015	82	46	19	21	6

Në funksion të rritjes së kapaciteteve të stafeve të IEVP mbi instrumentet e punës për përgatitjen për ri-integrim të fëmijëve në konflikt me ligjin, janë zhvilluar trajnime me pjesëmarrje ndërinstitucionale me përfaqësues të sistemit të referimit në nivel lokal si Zyrat e Punës, Qendrat e Formimit Profesional, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Komuniteti i bizneses, Shërbimi i Proves etj.Në bashkëpunim me OJQ janë ofruar shërbime në zgjidhjen e konflikteve, diversionit dhe drejtësisë restauruese, ndihmës psikologjike dhe ligjore dhe gjithashtu ngritjen e kapaciteteve të stafit të burgjeve për të drejtat e të miturve.

Me mbështetjen financiare të organizatave UNDP dhe **Assist Impact është zbatuar** një projekt që synon fuqizimin e sistemit të referimit për vajzat dhe gratë në konflikt me ligjin në IEVP "Ali Demi", Tiranë. Me mbështetjen e Komitetit Holandez të Helsinkit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të Holandës, po zbatohet një projekt që ka për objekt forcimin e kapaciteteve të administratës të IEVP Vlorë dhe Lezhë për përgatitjen për ri-integrim të miturve. Trajnimi i stafeve mbështetet në modelet bashkëkohore të ri-integrimit të miturve, siç janë *YOU-TURN* dhe *EQUIP*. Në bashkëpunim me Save the Children janë në proces të hartimit të manualit "*Mbi mekanizmin e sistemit të referimit për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin",* si dhe protokollit përkatës. Manuali dhe protokolli udhëzues kanë për qëllim të lehtësojnë procesin e ri-integrimit të fëmijëve në konflikt me ligjin në Shqipëri, duke koordinuar shërbimet mbështetëse në nivel lokal.

Në zbatim të rekomandimeve të raporteve vlerësuese të Komisionit Evropian për Shqipërinë, ku nënvizohet domosdoshmëria e përmirësimit të *kuadrit ligjor të skemës së shpërblimit të punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve*, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka planifikuar për vitin 2016, hartimin e projekt VKM-së "Për nxitjen e punësimit dhe shpërblimin për punën e të dënuarve dhe të paraburgosurve". Ky proces po kryhet në konsultim me dokumentet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe do të përfshijë konsultimin me grupet e interesit. Kjo VKM ka për objekt përcaktimi i rregullave, kritereve dhe procedurave të punësimit të dënuarve dhe të paraburgosurve, për maksimizimin e potencialeve të aftësimit profesional dhe punësimit, duke rritur mundësitë për punësim, gjatë dhe pas lirimit nga burgu. VKM synon implementimin e një politike të re punësimi për të burgosurit, që do të synojë krijimin e një kornizë bashkëpunimi, e do të inkurajojë lidhjet mes sektorit publik dhe privat, duke siguruar mundësi konkrete që të burgosurit të integrohen në mjedisin real të punës. VKM do të krijojë mundësi për lidhje produktive me tregun e punës dhe punëdhënësit, si dhe një shpërblim të drejtë për punën e kryer, për t'iu dhënë të burgosurve mundësi më të mira të zhvillimit të aftësive të tyre, të cilat përputhen me këtë treg.

Institucioni i Shërbimit të Provës ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve që kanë të bëjnë me misionin e vet Institucionit, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, lirive themelore, si dhe rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve dhe krijimin e një sistemi të sigurt dhe të efektshëm për të gjithë shoqërinë nëpërmjet zhvillimit të programeve të rehabilitimit social.

Insitucioni ynë si pjesë e reformës në drejtësi dhe në zbatim të rekomandimeve të Këshillit Evropian ka hartuar një draft- paketë ligjore e cila është dërguar në Ministrinë e Drejtësisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, shoqërisë civile dhe faktorit ndërkombëtar. Kjo paketë ligjore do të shërbejë për plotësimin e kuadrit ligjor të veprimtarisë së Shërbimit të Provës, respektimit më të mirë të të drejtave të të dënuarve me dënime alternative, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shoqërinë civile në zbatim të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykatat penale.

Në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave sociale, fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes sociale, në termin afatshkurtër, është zbatimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standardeve, duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, përmirësimin e legjislacionit në fushën e ndihmës dhe shërbimeve sociale, monitorimin e zbatimit të legjislacionit aktual, si dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave të zbatimit të legjislacionit.

Në fushën e të drejtave të njeriut do të ndërmerren masa si më poshtë:

Hartimi i një Plani të ri Veprimi për Fëmijë 2016-2020 si dhe përmirësimi i Ligjit Nr 10347 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" me qëllim forcimin e i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke krijuar mekanizma të rregullta të kontrollit dhe monitorimit të punës sëNjësitve për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF-të) në nivel vendor dhe, duke siguruar alokimin e duhur të buxhetit për funksionimin e NJMF-ve;

Tashmë është zhvilluar një draft dokument për Sistemin e Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri. Ky dokument do të kontribuojë në Planin Kombëtar të Veprimit për Fëmijë 2016-2020 dhe në hartimin e ligjit për mbrojtjen e Fëmijëve. Fushat kryesore prioritare të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, në të cilat fokusohet ky dokument janë:

- Një qeverisje e përgjegjshme dhe role e përgjegjësi të mirëpërcaktuara.
- Masa efektive për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës ndaj fëmijëve.
- Sistemet miqësore të drejtësisë për fëmijët

Plani i Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 – 2020. Plani i Veprimit ka një fokus të vecantë te përmirësimi i të dhënave dhe statistikave, strehimi dhe arsimi janë fushat kryesore të ndërhyrjes.

Ministria e Zhvillimit Urban ka hartuar Projektstrategjinë për Strehimin Social, bashkë me Planin e saj të Veprimit, miratimi i së cilës pritet të bëhet në 2016. Ky dokument strategjik, i pari në llojin e tij, në mënyrë parësore është i fokusuar në zgjidhjen e nevojave për strehim, me fokus të veçantë për grupet në pozita të pafavorizuara.

Kjo strategji është në përputhje të plotë me Planin e Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 – 2020, si dhe ka përfshirë të gjitha rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të shoqërisë civile, duke u kthyer në një dokument gjithëpërfshirës. Ndër të tjera Projektstrategjia e Strehimit Social ka parashikuar:

- Ofrimin e ndihmës për grupet në pozita të pafovorizuara, sikurse familje nga Komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë qiranë e strehimit social, e cila arrihet nëpërmjet bonusit të qirasë;
- Përmirësimi i kushteve të strehimit të familjeve të Komunitet Rom dhe Egjyptian (përmes granteve të vogla për bashkitë: infrastrukturë, ujësjellës – kanalizime, pajisje hidrosanitare ose ndërtime të reja).

Në këtë mënyrë, Strategjia për Strehimin Social e Republikës së Shqipërisë është konceptuar në bazë të parimeve orientuese sipas të cilave duhet të ketë një paketë të përgjithshme të strehimit që të jetë e gatshme, e arritshme, e përballueshme financiarisht dhe adekuate. Pikënisja për hartimin e vizionit, qëllimit dhe objektivave të strategjisë është nevoja urgjente që ka vendi për të rishikuar dhe përmirësuar kuadrin ekzistues institucional, ligjor dhe rregullator të sektorit të strehimit.

Në zbatim të Ligjit Nr. 93/2014, datë 24.7.2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara" janë hartuar akte nënligjore për Personat me Aftësi të Kufizuar mbi të dhënat statistikore, organizimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar dhe aksesueshmërinë. Paketa kuadër e ligjit do të vazhdojë të plotësohet me akte të tjera nënligjore.

Në fushën e të drejtave të grave, luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje do të ndërmerren veprime për të:

- Nxitur dhe promovuar barazinë gjinore, nëpërmjet fuqizimit të mekanizmave shtetërore dhe integrimit gjinor në politika dhe programet buxhetore.
- Parandaluar dhe luftuar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje nëpërmjet shtrirjes dhe fuqizimit të mekanizmave të koordinuar për mbrojtjen, mbështetjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave.

Në kuadër të mbrojtjes nga diskriminimi për personat LGBT- Do të vijohet me aktivitetet në zbatim të Planit të Veprimit për personat LGBT 2015 – 2020, ndërgjegjësimin e publikut, ngritjen e kapaciteteve të punonjësve.

Në fushën e mbrojtjes sociale objektivi afatgjatë është reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale në tre drejtime kryesore:

Shtrirja e skemës së re të ndihmës ekonomike në të gjithë vendin nëpërmjet përdorimit të regjistrit elektronik. Kjo skemë përmban kritere të lehtësuara, rrit eficencën dhe transparencën e sistemit, shmang abuzivitetin, përdor një formule të pikëzura në përzgjedhjen e përfituesve dhe kryen verifikime elektronike me sistemet e tjera të dixhitalizuara.

Ngritja e regjistrit elektronik të aftësisë së kufizuar i cili do të mundësojë ruajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar si edhe dizenjimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga modeli mjekësor drejt atij social.

Reformimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror nëpërmjet decentralizimit dhe de-institucionalizimit duke synuar kalimin drejt shërbimeve alternative të përkujdesit të tilla si shërbimet shtëpi-familje, kujdestaria e përkohshme, shërbimet ditore / në komunitet, etj.

Ndërsa objektivi afatgjatë i qeverisë shqiptare mbetet skema e sigurimeve shoqërore duke reformuar shtyllën e pensioneve publike për të krijuar një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, futjen graduale të planeve të përfitimeve suplementare të menaxhuara nga entitetet/njësitë jo publike, krijimi i llogarive personale për secilin kontribuues dhe marrës, duke arritur transparencë maksimale, një skemë dhe sistem që përgatitet për bashkëpunimin me vendet e BE-së (në përputhje me Nenin 99 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit).

Ndër prioritetet kryesore në kuadrin e procesit të integrimit evropian është përmirësimi i mëtejshëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, në përmbushje të detyrimeve dhe standarteve ndërkombëtare, si dhe realizimi në praktikë të këtyre të drejtave.

Në këtë kuadër objektiv i rëndësishëm është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave mbi respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve, nëpërmjet qartësimit dhe forcimit të kuadrit ligjor ekzistues përmes një proçesi të gjerë konsultimi dhe duke marrë parasysh rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare

Në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim intensiv me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë identifikuar mjetet teknike dhe ligjore për të bërë të mundur mbrojtjen e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që hidhen në portale elektronike. Mbetet e pritshme që brenda muajin janar 2015 të fillojë konfigurimi i ri i vendimeve të anonimizuara në portalet elektronike.

Në lidhje me monitorimin dhe raportimin, Shqipëria, veçanërisht MIE do të raportojë në kontekstin e Dialogut të Nivelit të Lartë. Përveç kësaj, raportimi shtesë do të jetë në dispozicion në kuadrin e Këshillit të SA, mbledhjeve të Komitetit dhe kontakteve të rregullta në nivel pune.

1.2 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare

Shqipëria luan një rol të rëndësishëm dhe konstruktiv në rajon. Interesi i saj kryesor është një rajon i qëndrueshëm ku paqja, marrëdhëniet social-ekonomike dhe kulturore, si dhe marrëdhëniet e qëndrueshme të përfitimit të ndërsjellë me fqinjët të mbizotërojnë. Marrëdhëniet e mira të fqinjësisë dhe bashkëpunimi me vendet e rajonit dhe, në veçanti, me vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të jenë një nga prioritetet e politikës së jashtme shqiptare, sidomos, në kuadër të procesit të integrimit në BE.

Gjithashtu, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare, qeveria shqiptare do të angazhohet plotësisht për të rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, duke iu përgjigjur programeve të partnerëve rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë, në përputhje dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (nenet 1, 2, 4, 13 dhe 81 i MSA-së). Veç kësaj, ajo do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm, si në kuadrin ligjor dhe institucional për ta bërë bashkëpunimin më efektiv dhe të plotë në këtë fushë.

Objektivi i Shqipërisë është që nëpërmjet angazhimit aktiv në të gjitha forumet dhe nismat rajonale të kontribuojë me qëndrime parimore dhe të balancuara për çështje të ndryshme.

Nëpërmjet aktivitetit të saj në këto forume rajonale, Shqipëria synon promovimin e zhvillimit ekonomik rajonal përmes projekteve të përbashkëta në fusha të tilla si energjia dhe transporti.

Shqipëria vazhdon të lobojë për përfaqësimin e Kosovës në organizatat rajonale dhe nismat që kontribuojnë për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Shqipëria kontribuon në mënyrë aktive dhe luan një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit në rajon. Shqipëria ka marrë pjesë në takimet e të gjitha niveleve në kuadër të nismave rajonale, si SEECP - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, CEI - Nisma e Evropës Qendrore, AII - Iniciativa Adriatiko - Joniane, RCC - Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, BEDZ - Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi, MARRI – Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, Procesi i Berlinit, Bashkëpunimi i Përforcuar në kuadër të Procesit të Stabilizim - Asocimit (ECSAP) dhe më tej, duke qenë e përfshirë në mënyrë aktive në procesin e bashkëpunimit rajonal. Ministria e Punëve të Jashtme po planifikon organizimin e një takimi rajonal të Ministrave të Punëve të Jashtme në formatin WB6, i cili parashikohet të zhvillohet më 30-31 mars 2016.

Shqipëria do të marrë më tepër përgjegjësi në aspektin e bashkëpunimit rajonal dhe do të rrisë praninë e saj aktive dhe kontributin në iniciativat rajonale. Më 13 nëntor 2015, në Pragë, u nënshkrua marrëveshja për krijimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Është vendosur që selia e Fondit të jetë në Tiranë dhe Drejtori i parë Ekzekutiv të jetë një diplomat shqiptar.

Në vijim të Konferencës së Vjenës (27 gusht 2015) dhe të Deklaratës së Përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), Shqipëria po luan një rol aktiv për realizimin e këtij objektivi, sipas modelit të Zyrës Rinore Franko-Gjermane (FGYO). Po punohet që kjo zyrë të ketë dy seli, në Tiranë dhe Beograd.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Shqipëria kontribuon në mënyrë aktive për bashkëpunimin rajonal dhe luan një rol të rëndësishëm drejt procesit të pajtimit në rajon. Shqipëria ka marrë pjesë në takimet e të gjitha niveleve në kuadër të nismave rajonale, si: SEECP - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, CEI - Iniciativa e Evropës Qendrore, AII - Iniciativa Adriatik dhe Jon, KBR - Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, BEDZ - Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi, MARRI – Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, Procesi i Berlinit, Nisma e Ballkanit Perëndimor (ECSAP) dhe më tej, duke qenë e përfshirë në mënyrë aktive në procesin e bashkëpunimit rajonal.Ministria e Punëve të Jashtme po planifikon organizimin e një takimi rajonal të Ministrave të Punëve të Jashtme në formatin ËB6, i cili parashikohet të zhvillohet më 30-31 mars 2016.

Shqipëria do të marrë përgjegjësi më tepër në aspektin e bashkëpunimit rajonal dhe do të rrisë praninë e saj aktive dhe kontributin në iniciativat rajonale. Më 13 nëntor 2015, në Pragë, u nënshkrua marrëveshja për krijimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.Është vendosur që në Tiranë të vendoset selia e tij dhe Drejtori i parë Ekzekutiv, të jetë një diplomat shqiptar.

Në vijim të Konferencës së Vjenës (27 gusht 2015) dhe të Deklaratës së Përbashkët për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), Shqipëria po luan një rol aktiv për realizimin e këtij objektivi sipas modelit të Zyrës Rinore Franko-Gjermane (FGYO). Po punohet që kjo zyrë të ketë dy seli, në Tiranë dhe Beograd.

Sa i përket Politikës së Përbashkët te Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP), gjatë vitit 2015 Shqipëria u bashkua me të gjitha deklaratat dhe vendimet përkatëse te Këshillit. Objektivi dhe orientimi ynë janë që politika jonë e jashtme të harmonizohet në mënyrë progresive me politikën e jashtme të BE, duke kontribuar në vijimësi në përshpejtimin e procesit të integrimit të Shqipërisë.

Lidhur me Politikën e Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë së BE-së, vendi do të synojë rritjen e kapaciteteve dhe të nivelit të pjesëmarrjes në misionet civile dhe ushtarake të BE-së.

Qeveria shqiptare do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në të gjitha ngjarjet që lidhen me zbatimin e suksesshëm të projekteve (TAP) Gazsjellësit Trans Adriatik - dhe (IAP) Ionian Adriatic Pipeline.

Shqipëria do të vazhdojë të nxisë marrëdhëniet e shkëlqyera dhe vëllazërore me **Republikën e Kosovës** me synim rritjen ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përshpejtimin e procesit të integrimit Evropian. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë dialogun e vazhdueshëm të nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Shqipëria ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë fort Kosovën në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe në integrimin Euroatlantik të saj.

Marrëdhëniet me **Malin e Zi** do të vazhdojnë të përbëjnë një bazë solide për marrëdhënie të mira fqinjësore, të zhvilluara përmes një dialogu intensiv politik dhe të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar. Shqipëria ka dhënë dhe jep një mbështetje të fortë dhe të vazhdueshme në rrugën e anëtarësimit të plotë të Malit të Zi në NATO.

Marrëdhëniet me **Maqedoninë** karakterizohen nga një nivel shumë i mirë i dialogut politik dhe me kontaktet të shpeshta të nivelit të lartë politik, i cili do të forcohet edhe më tej në frymën e dialogut konstruktiv politik. Të dy vendet synojnë intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare me Maqedoninë. Shqipëria mbështet integrimin europian dhe euro-atlantik të Maqedonisë si dhe mbështet zbatimin e marrëveshjeve në Shkup, më 2 qershor dhe 15 korrik 2015, të arritura nga katër partitë kryesore të Maqedonisë me ndërmjetësimin e Komisionierit të BE-së për Zgjerimin, si dhe marrëveshjen e 6 nëntorit 2015, për kapërcimin e krizës politike në këtë vend.

Marrëdhëniet me **Kroacinë** vlerësohen si të shkëlqyera dhe me ecuri pozitive ndër vite. Kroacia ka qenë një zë i rëndësishëm në favor të axhendës së integrimit europian të Shqipërisë.

Marrëdhëniet me **Sllovenin**ë konsiderohen shumë të mira, të qëndrueshme, pa asnjë çështje të hapur. Midis palëve është zhvilluar një dialog politik konstruktiv, si në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe, ashtu edhe për situatën në rajon dhe më gjerë.

Shqipëria dhe **Greqia** vlerësojnë rëndësinë strategjike të marrëdhënieve mes tyre dhe kanë vullnetin politik për të gjetur zgjidhje me interes të ndërsjelltë për problemet e së kaluarës, në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Shqipëria mbetet e angazhuar për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Republikën e **Serbisë**, dhe forcimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Shenjë e këtij impenjimi ishte edhe vizita e Kryeministrit Rama në Beograd në nëntor të vitit 2014.

Dëshirojmë të kemi një dialog të hapur politik, me qëllim krijimin e një atmosfere të qëndrueshme besimi, sinqeriteti dhe respekti reciprok, jo vetëm si një kontribut në marrëdhëniet tona dypalëshe, por edhe në atë të sigurisë rajonale dhe stabilitet në rajon.

Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me **Bosnjë - Hercegovinën**, intensifikimi i dialogut politik dhe kontakte në çdo nivel në të ardhmen është prioritet i politikës rajonale të Shqipërisë. Ne kërkojmë një qasje të drejtë dhe konstruktive nga BiH për pjesëmarrjen e Kosovës në të gjitha nismat dhe aktivitetet rajonale.

Shqipëria do të vazhdojë të ndjekë intensifikimin e marrëdhënieve me partnerë të tjerë në rajon. Intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike dhe shkëmbimeve me **Italinë** dhe **Turqinë** mbeten gjithashtu vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë.

2. KRITERI EKONOMIK

Ky seksion i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian jep një vlerësim dhe tablo të punës, arritjeve dhe përparimit të Shqipërisë në zbatimin e reformave ekonomike, si parakusht për përmbushjen e kritereve të Kopenhagenit. Gjithashtu, kjo pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, duke qenë në përputhje të plotë me Programin Kombëtar të Reformës Ekonomike dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, ve theksin te prioritetet për periudhën në vijim, me qëllim forcimin e konkurrueshmërisë dhe funksionimit të ekonomisë së tregut. Që Shqipëria të integrohet me sukses në BE, është tepër e rëndësishme që të zbatohen plotësisht reformat e nevojshme ekonomike, politike dhe institucionale.

2.1 Ekonomia e tregut funksionale

Vlerësimi i rishikuar i Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal i Ministrisë së Financave në nëntor të vitit 2015, konfirmoi një rritje ekonomike të përmirësuar (në vlerën 2.1% për vitin 2014 dhe 2.6% për të gjithë vitin 2015) dhe me presion të ulët inflacionist (me inflacion mesatar 1.6% për vitin 2014 dhe 1.8% për vitin 2015). Kërkesa agregate po ashtu parashikohet të performojë më mirë se në viti 2014 (me një rritje prej 2.6%), ndërkohë që për vitin 2015 ajo është parashikuar të performojë pothuajse identikisht si një vit më parë, pa ndonjë rritje për t'u theksuar duke pasqyruar një situatë të qendrueshme ekonomike dhe një besim të vazhdueshëm nga këndvështrimi i konsumatorit. Rikuperimi i kredive, është pasuar nga një përmirësim tejet i dukshëm gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2015 me një mesatare rreth 2.3%% dhe ky përmirësim është vënë re nën këto ritme edhe përgjatë 3M të tretë të vitit (ku gjatë muajve korrik dhe gusht ky indikator u rrit respektivisht me 0.2 dhe 1.2%. Duhet theksuar se në 3-mujorin e tretë është vënë re një rënie gjatë muajit shtator prej -1.8%, por kjo kërkon kohë për t'u konfirmuar nëse do të vijoi të jetë një trend rënës.

Sipas Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2014, aktiviteti ekonomik u rimëkëmb, pas ngadalësimit të 2 viteve më parë. Kjo pasi kërkesa e brendshme u rrit sërish, duke zëvendësuar tregtinë e jashtme si nxitësin kryesor të rritjes. Rritja në vitin 2015 përshpejtoi ritmin, me një rritje të PBB-së prej 2.8% gjatë tremujorit të parë. Të dhënat e fundit tregojnë për një prirje të ngjashme edhe gjatë tremujorit të dytë. Gjatë këtij viti, struktura e rritjes është më e balancuar, e mbështetur nga kërkesa e brendshme dhe ajo e jashtme. Punësimi u rrit gjatë vitit, por norma e papunësisë mbetet e lartë, rreth 17%. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, ekonomia shqiptare vazhdon të karakterizohet nga kapacitetet e pashfrytëzuara në tregjet e kapitalit dhe të punës. Presionet modeste të kërkesës janë reflektuar në normat shumë të ulta të rritjes së inflacionit bazë. Gjithashtu, presionet e dobëta inflacioniste nga jashtë, bashkë me çmimet e ulta të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare janë një faktor tjetër që rezultojnë në inflacion të ulët. Inflacioni mesatar vjetor ishte 1.8% gjatë tetë muajve të parë të vitit 2015

Shkalla e lartë e papunësisë edhe pse dukshëm në rënie, nga 18.3 në 17.3% në 3-mujorin e dytë të vitit 2015, si edhe ndikimet e mjedisit të jashtëm, kanë ndikuar që ekonomia e vendit të luhatet relativisht pak nën potencialin e saj. Sipas Bankës Botërore (qershor 2015), rritja reale ekonomike prej 1.9 përgjatë vitit 2014 është mbështetur nga kërkesa së brendshme e

mbështetur nga politika fiskale dhe reforma strukturore, si dhe nga një rritje e konsumit dhe investimeve private.

Rritja ekonomike në kushtet e konsolidimit fiskal pritet të mbështetet nga efektet pozitive të përmirësimit të klimës së biznesit, zgjerimit të hapësirës së kreditimit të ekonomisë nëpërmjet zëvendësimit të huamarrjes së qeverisë në tregun e brendshëm me financime nga tregjet ndërkombëtare ku në nëntor të vitit 2015 përfundoi procesi i (t emetimit të Eurobondit), rritjes së investimeve publike (sidomos në sektorin e infrastrukturës), një kuadri akomodues të politikës monetare për periudhën afatmesme në vijim, si dhe zbutjes së rreziqeve të jashtme (rimëkëmbja ekonomike në Itali dhe Greqi, politika monetare akomoduese të BQE).

Po kështu pritet një rritje e aktivitetit ekonomik në vend si pasojë e marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE që prej qershorit të vitit 2014, si rrjedhojë e uljes së kërkesës nga ana e qeverisë për huamarrje në tregun e brendshëm, çka do të rrisë ofertën për sektorin privat, dhe si pasojë e paketave mbështetëse në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si: manifaktura, turizmi, bujqësia dhe sektorë të tjerë në rritje.Në të njëjtën kohë, qeveria shqiptare duke mbajtur parasysh edhe rekomandimet e berë në Progres Raport, është e angazhuar të ruaj hapësirat fiskale për rritjen e investimeve publike duke siguruar që performanca e të ardhurave të mbetet në rrugën e duhur, duke lejuar realizimin e shpenzimeve kapitale të buxhetuara fillimisht.

Ekonomia shqiptare ka treguar themele të shëndosha ekonomike dhe financiare, pavarësisht kontekstit sfidues makroekonomik në të cilën po përballet. Inflacioni ka qëndruar në nivele të ulëta gjatë gjysmës së parë të këtij viti, për shkak të presioneve inflacioniste të dobëta dhe pritjeve të ankoruara për inflacion. Megjithatë, gjatë 3-mujorit të tretë vihet re një nivel më i përafërt me nivelin e targetuar të Bankës së ShqipërisëDuke pasur parasysh mjedisin me inflacion të ulët, Banka e Shqipërisë sërish ndoqi një politikë monetare lehtësuese. Me qëllimtë ulë kostot e financimit në ekonomidhe të stimulojë kërkesën, nëpërmjet rritjes së konsumit dhe të investimeve dhe mirëankorimit të pritjeve inflacioniste, gjatë vitit 2015, banka qendrore më 4 nëntor ka ulur normën bazë me nga 0.25 pp, duke e çuar atë në nivelin më të ulët historik prej1.75

Sipas publikimit të fundit të INSTAT-it, rritja ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2015, krahasuar me të njëjtin 3M të një viti më parë ka qenë +2.82%, pas një rritje prej +3.3% ne tremujorin e mëparshëm. Ekonomia shqiptare pritet të rimëkëmbet gradualisht gjatë vitit 2015. Rritja ekonomike për vitin 2015 është parashikuar të jetë 2.7%, ndërsa parashikimi për 2016 është 3.4% (Banka Botërore). Me pagesat e detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit, qeveria po injekton likuiditet në ekonomi dhe po nxit rritjen ekonomike.

Kjo situatë pozitive rritje, është kontribut kryesor i degëve të ekonomisë si: Industria me +0.96 pikë përqind, Administrata Publike, Arsimi dhe Shëndetësia me +0.39 pikë përqind dhe Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi me +0.39 pikë përqind. Degët që kontribuan negativisht në rritjen ekonomike ishin: Shërbimet Gjithsej me -0.11 pikë përqindje, Subvencionet me -0.08 pikë përqindje dhe Informacioni dhe komunikimi me -0.07 pikë përqindje.

Aktiviteti Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit në tremujorin e dytë të vitit 2015, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë pati një rënie prej 0.76%. Grupi i Industrisë, Energjisë dhe Ujit pati rritje me 6,28 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2014 ku ndikimin kryesor në këtë rritje e ka dhënë nën grupi Energjia elektrike e cila në vetvete shënoi një rritje 61,07 %.

Aktiviteti i Ndërtimit në tremujorin e dytë të vitit 2015 pati rritje prej 24,49 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2014. Grupi i degëve Tregti, Hotele, Restorante dhe Transport pati një rritje prej 1,02 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Grupi i degëve Informacioni dhe Komunikacioni u shfaq me një rritje prej 0,22 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 përkundrejt tremujorit të dytë të vitit 2014. Aktiviteti Financiar dhe i Sigurimit ka shënuar një rritje prej 4,43 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Aktiviteti i Pasurive të Paluajtshme ka shënuar një rritje prej 0,34 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Grupi i degëve Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative u shfaq me një rënie prej 0,30 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 përkundrejt tremujorit të dytë të vitit 2014. Grupi i Administratës Publike, Arsimit dhe Shëndetësisë në tremujorin e dytë të vitit 2015 pati rritje me 4,17 % kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2014. Grupi Shërbime të tjera si Arte dhe argëtim, Aktivitete të tjera shërbimi, Aktivitete të familjes, Aktivitete të familjes për përdorim të vet, Aktivitete të organizatave ndërkombëtar, në tremujorin e dytë të vitit 2015 pati rënie me 0,79 % kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2014. Taksat dhe Subvencionet mbi produktet në tremujorin e dytë të vitit 2015 patën respektivisht, rënie me 5,21 % dhe rënie me 11,64 % kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2014.
parë.

Përgjatë vitit 2015, qeveria nënshkroi marrëveshje me FMN-në dhe me Bankën Botërore, të cilat lidheshin me sektorët fiskal – financiar dhe real të ekonomisë së vendit. Këto marrëveshje jo vetëm injektojnë likuiditet në ekonomi, por kontribuojnë edhe në konsolidimin fiskal dhe menaxhimin e shëndoshë të financave publike, si edhe mbështetin reformat strukturore në sektorë kyçë si energjetika, ndërkohë që monitorojnë qëndrueshmërinë e borxhit publik. Programi trevjeçar me FMN-në përqendrohet në rritjen ekonomike dhe konsolidimin fiskal.

Gjatë këtyre tre viteve, qeveria shqiptare duke mbajtur parasysh edhe rekomandimet e bëra në Progres Raport, do të fillojë uljen e borxhit publik nga 72.6% që është në vitin 2015, nën 68% të PBB-së deri në vitin 2017 dhe në 63.9% në vitin 2018. Faktorët kryesorë që do të mbështesin arritjen e objektivit të uljes së borxhit janë: (i) lufta e vijueshme dhe pa tolerancë ndaj evazionit fiskal; (ii) reformimi i mënyrës së përdorimit të fondeve publike me qëllim rritjen e eficencës dhe efektivitetit të tyre; si dhe (iii) ndërmarrja e reformave të rëndësishme tatimore

Në vlerësimin e fundit, FMN theksoi se programi është në rrugën e duhur. Bazuar në këto premisa, *Standard and Poor's* e përmirësoi vlerësimin për borxhin e Shqipërisë nga“negativ”

në “stabël”.Ndërkohë që Shqipëria arriti të emetojë me sukses Eurobondin e dytë në Nëntor të vitit 2015.

Përgjatë vitit 2015, zhvillimet e deritanishme ekonomike tregojnë se ekonomia shqiptare ka hyrë nën një ritëm të qëndrueshëm rritje dhe norma të ulëta inflacionit. Dobësia ciklike e ekonomisë vazhdon të gjenerojë presione të pakta për rritjen e punësimit, të pagave dhe të kostove të prodhimit. Gjithashtu, ambienti i jashtëm përcjell presione të dobëta inflacioniste në vend. Nën veprimin e faktorëve të kërkesës dhe ofertës, çmimet e konsumit kanë shënuar rritje të ulëta gjatë tremujorëve të fundit. Norma më e fundit e inflacionit rezultoi 2.2 %në muajin tetor2015. Nivelet e ulëta të inflacionit duket se kanë ndikuar në persistencën e pritjeve të ulëta inflacioniste gjatë tremujorëve të fundit (inflacioni mesatar për periudhën janar – tetor shënoi vlerën 1.9 %.

Politika monetare ka vijuar të ruajë kahun stimulues për të mbështetur kërkesën e brendshme dhe për të mundësuar ankorimin e pritjeve inflacioniste pranë objektivit. Norma bazë e interesit qëndron aktualisht në nivelin 1.75. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë vazhdon të orientojë publikun e pritjet në tregjet financiare mbi kahun e pritur të politikës monetare.

Politika monetare stimuluese ka sjellë rënien e normave të interesit në tregun financiar në nivelet e tyre më të ulta historike.

Projeksionet më të fundit sugjerojnë një rritje graduale të inflacionit përgjatë tremujorëve të ardhshëm, duke konverguar drejt objektivit në një periudhë afatmesme. Rritja ekonomike pritet të jetë më e lartë, e shoqëruar me përmirësime të treguesve të tregut e punës. Nga ana tjetër, inflacioni i importuar pritet të mbetet i ulët, ndërsa pritjet inflacioniste të zhvendosen gradualisht drejt objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Në përputhje me objektivin e saj afatmesëm të inflacionit dhe në mbështetje të kërkesës agregate, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare akomoduese që nga gjysma e vitit 2011. Kjo politikë ka patur si synim: (i) të ulë kostot e financimit në ekonomi dhe të stimulojë kërkesën, nëpërmjet rritjes së konsumit dhe të investimeve; (ii) të përmirësojë fluksin e parasë të agjentëve ekonomikë, duke çliruar fonde financiare të cilat mund të përdoren po ashtu për rritje konsumi e investimesh; dhe, (iii) të mbajë të ankoruara pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë. Gjithashtu, politika monetare lehtësuese stimulon përmirësimin e bilancit tregtar, duke ofruar një kanal tjetër për rritjen e kërkesës agregate.

Aktualisht, norma bazë e interesit qëndron në një nivel të ulët prej 1.75%. Për më shumë, vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë shoqërohen me injektim likuiditeti dhe udhëzime mbi drejtimin e politikës monetare.. Huatë në Lek janë rritur - duke dyfishuar pjesën e tyre në totalin e portofolit të kredive. Megjithatë, duhet theksuar se kredidhënia po tregon sërish shenja rënëse, ku gjatë muajve shtator-tetor ka performuar negativisht në terma vjetore, kjo ecuri duket të jetë përcaktuar nga kushte akoma të shtrënguara të kredisë bankare, si dhe nga kërkesa e dobët për financim nga bizneset.Sipas monedhave, vihet re se performanca e mirë e kredisë në lekë nuk ka mundur të kompensojë tkurrjen e ndjeshme të kredisë në valutë. Rritja reale e PBB-së është projektuar të ndjekë një trajektore rritëse gjatë periudhës 2016 – 2018. Kërkesa e brendshme pritet të jetë nxitësi kryesor i rritjes përgjatë

periudhës 2016-2018 me një nivel mesatar prej 3.5%. Kjo e fundit parashikohet të përfitojë nga politika monetare zgjeruese, përmirësimi i besimit dhe rritja e investimeve të huaja direkte (që për periudhën 2016-2018 pritet të jetë në nivelin mesatar prej 11.5% të PBB-së, me një rritje prej 0.5 pikë përqindje nga niveli mesatar i periudhës 2015-2017).Gjithashtu, kërkesa për eksportet shqiptare duhet të përfitojë nga rimëkëmbja globale dhe nga përmirësimet në konkurrueshmërinë e çmimeve. Hendeku i prodhimit parashikohet të mbyllet në fund të vitit 2016. Ndërsa rritet përdorimi i resurseve, punësimi, pagat dhe kostot e punës priten të rriten. Inflacioni projektohet të arrijë objektivin në fund të vitit 2017.

2.1.1 Zhvillimet në lidhje me bilancin e pagesave

Pozicioni neto i defiçitit të llogarisë korente për gjysmën e parë të vitit 2015 ishte 423.3 milionë euro. Defiçiti i shënuar ka rënë këtë vit me një ngushtim mesatar vjetor prej 30.5%.

Si raport me PBB-në nominale, defiçiti i llogarisë korente u vlerësua në rreth 8.6%.

Sipas zërave të nën-llogarive, kontributin primar në ngushtimin e defiçitit të llogarisë korente e ka dhënë deficit më i ulët i eksporteve neto dhe një surplus më i lartë i llogarisë sekondare të të ardhurave. Nga ana tjetër, llogaria e të ardhurave primare dha një efekt të kundërt në defiçitin e llogarisë korente. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për tremujorin e parë 2015 mbetën në të njëjtin nivel të së njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm. Në të kundërt, ngushtimi i theksuar i importeve të shërbimeve kontribuoi në rënien e importeve totale me rreth 6.4% në terma vjetorë. Bilanci negativ llogarisë së të ardhurave primare u thellua, në krahasim me tremujorin e parë 2014. Nga ana tjetër, të ardhurat sekondare u rritën me 21.8% në terma vjetorë, si rezultat i rritjes së qëndrueshme të remitancave.

Hyrjet neto të llogarisë së kapitalit arritën 47.3 milionë euro këtë vit, nga 2.4 milionë euro gjatë gjysmës së parë të vitit të kaluar. Në llogarinë financiare, pozicioni neto shënoi një rënie vjetore në asete prej 19%. Hyrjet neto në llogarinë e kapitalit dhe atë financiare financuar plotësisht defiçitin e shënuar në llogarinë korente. Investimet e huaja direkte neto u rritën me rreth 35% në terma vjetorë, si rezultat i investimit të intensifikuar në industritë minerare dhe të naftës. Defiçiti i llogarisë korente u financua kryesisht nëpërmjet hyrjeve jo-rritëse të borxhit. Varësia nga hyrjet rritëse të borxhit ka rënë disi krahasuar me gjysmën e parë të vitit të mëparshëm. Asetet e rezervave janë rritur me 128 milionë euro gjatë gjysmës së parë të këtij viti.

2.1.2 Klima e biznesit

Në vijim të rekomandimit ERP 6, Qeveria shqiptare mbështet përmirësimin e përgjithshëm të klimës së biznesit nëpërmjet bashkimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit në një institucion të vetëm, Qendra Kombëtare e Biznesit, do të kryejë si one-stop-shop funksionet e dy institucioneve. Aktualisht projektligji "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" është miratuar në parlament nëpërmjet ligjit 131/2015 dhe përgatitja e akteve nënligjorenëzbatim të tij është në proces.

- Këshilli Ekonomik Kombëtar është një platformë plotësisht funksionale që institucionalizon diskutimet dhe bashkëveprimet midis institucioneve shtetërore dhe komunitetit të biznesit i cili deri në Nëntor 2015 ka realizuar 13 takime, ku ndër çështjet kryesore të trajtuara kanë qenë :investimet e huaja direkte, zhvillimi i sektorit të turizmit, paketa fiskale 2016, reforma për ekonominë informale, inovacioni kundër korrupsionit
- Këshilli i Investimeve është krijuar në bazë të VKM Nr 294, datë 08.04.2015 "Për krijimin e Këshillit të Investimeve". Këshilli Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e BERZH për intensifikimin e dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të promovuar qeverisjen e mirë. Pas takimit të lancimit te Këshillit të mbajtur më 15 prill 2015, ai mbajti takimin e parë më 1 korrik 2015. Këshilli i Investimeve miratoi metodologjinë e punës (Rregullorja e brendshme). Tema e takimit të parë ishte diskutimi i Reformës së Derregullimitt, me qëllim për të zvogëluar rrezikun dhe koston për bizneset. Informacion mbi veprimtarinë e Këshillit të Investimeve është dhënë në faqen e saj: www.investment.com.al..Procesi i pagimit të detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit po ecën normalisht. Është paguar me sukses shuma e borxheve e planifikuar për vitin 2015.
- *One stop shop për biznesin* po ngrihet në kuadrin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me qëllim që të lehtësohet më tej ofrimi i informacionit dhe shërbimeve përmes një sporteli të vetëm. Në këtë kuadër, në mbështetje të paketës fason, është ngritur një help desk themeluar për të siguruar informata dhe materiale shpjeguese për paketën legjislative të miratuar. Gjithashtu, është krijuar dhe një fushatë informimi përmes telefonit për të siguruar mbështetje për paketën fason, ku janë kontaktuar rreth 150 subjekte çdo muaj. Paketa e masave për paketën fason eshtë duke u implementuar. Nga 32 masa, aktualisht janë implementuar 27 dhe eksportet janë rritur nga 495 mln Euro në vitin 2013 në 614 mln Euro
- Drejtoria e Planifikimit dhe Prioritizimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka hartuar Metodologjinë për Raportimin, Monitorimin dhe Vlerësimin e Investimeve Publike, të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 159, datë 9.05.2014, ku përcaktohen rregullat, afatet dhe standartet e raportimit nga ana e ministrive dhe institucioneve buxhetore, si dhe klasifikimi i projekteve per efekt monitorimi. Në përputhje me klasifikimin e projekteve, për projektet e klasifikuara si prioritare dhe me impakt të konsiderueshëm në ekonomi, (projektet me vlerë mbi 700 milion lekë ose eq. 5 milion Euro) raportohet mbi bazë javore, ndërsa për të gjitha projektet e tjera raportohet në bazë mujore (pavarësisht burimit të financimit). Raportet e monitorimit sigurojnë informacion periodik për ecurinë financiare dhe realizimin fizik të projekteve të investimeve publike në funksion të përmirësimit të procesit të planifikimit të investimeve.

2.1.3 Rezervat ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, borxhi bruto i jashtëm i Shqipërisë arriti një total prej EUR 7,257 milionë euro, vlerësuar në 71.7% ndaj PBB-së nominale dhe duke u rritur me 9.1% në terma vjetorë. Sipas ndarjes sektoriale, raporti i borxhit të qeverisë në borxhin e

jashtëm total është 38.7%; ai i korporatave *deposit- taking* është 17.9%; sektorët e tjerë 19.2%; IHD-të 23.2%; dhe autoriteti monetare 1.1%. Sipas instrumenteve të investimit, kategoria e "investimeve të tjera" mbulon rreth 68.6% të stokut total të borxhit të jashtëm.

Ndërkohë, sipas strukturës të maturitetit, borxhi afatgjatë mbulon 79.6% të totalit të borxhit të jashtëm bruto, duke u rritur me 0.7 pikë përqindje krahasuar me fundin e tremujorit të dytë të vitit 2014.
Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2015, stoku i rezervave ndërkombëtare bruto ishte 2,388 milionë euro, duke u rritur me 18.6% në terma vjetorë. Treguesit e përshtatshmërisë së rezervave shfaqen në nivele të mjaftueshme, ndërkombëtarisht. Kështu raporti i stokut të rezervave ndërkombëtare ndaj borxhit afatshkurtër rezulton 161.7%. Stoku i rezervave është i mjaftueshëm të mbulojë 6.2 muaj të importeve të mallrave dhe shërbimeve.

2.1.4 Kuadri i kursit të këmbimit dhe zhvillimet e fundit

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2015, valuta kombëtare u zhvlerësua përkundrejt valutave të tjera kryesore të huaja. Norma nominale e kursit të këmbimit u zhvlerësua me 2.7% mesatarisht në terma vjetorë. Kjo performancë u diktua tërësisht nga dobësimi i Lekut përkundrejt dollarit amerikan (22.7% në terma vjetorë), ndërkohë që kursi i këmbimit EUR/ALL mbeti pothuajse i qëndrueshëm. Kursi i këmbimit USD/ALL në tregun e brendshëm ka reflektuar trajektoren e kursit të këmbimit EUR/USD në tregjet ndërkombëtare të këmbimit. Në terma realë, zhvlerësimi i Lekut ishte i përmbajtshëm në 1.6% në terma vjetorë, kryesisht i nxitur nga normat më të larta të inflacionit, krahasuar me ato të shënuara në vendet e eurozonës.

2.1.5 Papunësia

Pjesëmarrja në fuqinë e punës, e vlerësuar në rreth 63% në terma mesatarë gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, ndoqi prirjen rritëse të shënuar në vitin 2014. Fuqia e punës u rrit, si rezultat i rritjes së numrit të personave të punësuar, krahasuar me të njëjtën periudhë 1 vit më parë. Industria përpunuese dhe ndërtimi shënuan rritjen vjetore më të lartë në punësim gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015.

Tabela 1. Struktura e punësimit

Punësimi sipas aktivitetit ekonomik (% në punësimin total 15 -64 vjeç)	**2014 T2**	**2015 T2**
Bujqësia	43.2	40.5
Industria përpunuese	8.1	9.3
Minierat, elektriciteti, gazi dhe uji	2.8	2.5
Ndërtimi	6.4	7.3
Shërbimet e tregut	22.2	22.9
Shërbimet jo të tregut	16.7	17.3

Burimi: INSTAT, Vrojtimi tremujor i Fuqisë së Punës T2 2015.

Papunësia u luhat rreth 17.9% gjatë vitit 2014 dhe ra në 17.3% gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 sipas vlerësimeve të vrojtimit të fuqisë së punës. Megjithatë, norma e papunësisë është sipër mesatares prej 16% të vlerësuar për periudhën 2012 – 2014. Papunësia e të Rinjve

rezultoi rreth 34.2%, një normë më e lartë kjo se papunësia për personat 30 - 64 vjeç, e cila është 12.1%. Gjithashtu, vrojtimi i fuqisë së punës tregon një ngushtim në hendekun e punësimit gjinor gjatë gjysmës së parë të vitit 2015.

Tabela 2. Të dhënat e tregut të punës (mosha 15 -64 vjeç).

(In %)		**Norma e Papunësisë**	**Norma e Punësimit**	**Norma e pjesëmarrjes në Fuqinë e Punës**
2012	**T1**	13.4	58.2	67.1
	T2	13.7	56.8	65.8
	T3	14.1	54.2	63.1
	T4	14.1	54.4	63.4
2013	**T1**	14.8	52.8	62.0
	T2	16.4	49.9	59.7
	T3	17.2	48.6	58.6
	T4	17.1	48.2	58.1
2014	**T1**	18.6	47.1	57.9
	T2	17.7	50.5	61.3
	T3	17.4	52.3	63.4
	T4	18.0	52.1	63.6
2015	**T1**	17.3	52.1	63.0
	T2	17.3	52.7	63.7

Burimi: INSTAT, Vrojtimi tremujor i Fuqisë së Punës T2 2015.

2.1.6 Inflacioni

Presionet inflacioniste kanë rezultuar të ulëta gjatë tetë muajve të parë të vitit 2015. Rënia e çmimeve të lëndëve të para, inflacioni i ulët i importuar dhe stabilizimi i pritshmërive të inflacionit në një nivel të ulët kanë kontribuar në rezultatin e një inflacioni të moderuar.

Treguesit vazhdojnë të shfaqin një ambient të moderuar inflacionist. Nga këndvështrimi makroekonomik, rritja e ngadaltë e çmimeve pasqyron efektin e një kërkese të dobët agregate si dhe çmimet relativisht të ulëta në tregjet botërore.

Inflacioni mesatar vjetor ishte 1.8% për periudhën Janar – Gusht 2015, duke mbetur më ulët se objektivi i Bankës së Shqipërisë. Pas një trajektore rritëse deri në muajin Prill 2015 (2.3%), inflacioni u stabilizua në nivele të ulta gjatë muajve në vijim. Inflacioni aktual I muajit Gusht qëndron në 1.9%. Çmimet e ushqimeve të freskëta kanë nënvizuar këtë trend të inflacionit gjatë këtyre muajve. Oferta më e ulët e prodhimeve bujqësore – për shkak të përmbytjeve – rezultoi në një inflacion më të ulët të çmimeve të ushqimeve të papërpunuara, i cili në muajin Prill 2015 kishte kontribuar me 2.3 pikë përqindje në inflacionin total. Rimëkëmbja e prodhimit bujqësor lehtësoi presionet inflacioniste në këto çmime. Kontributi i inflacionit të ushqimeve të papërpunuara u ul në 1.2 pikë përqindje gjatë muajit Gusht. Nga ana tjetër, inflacioni i kategorive të tjera mbeti i moderuar; ku çmimet e naftës dhanë një kontribut negativ; shërbimet dhe çmimet e rregulluara dhanë një kontribut pozitiv në inflacion.

Presionet e çmimeve nga ana e kërkesës janë stabilizuar në nivele të ulta, ku inflacioni bazë qëndron në 0.34% mesatarisht për tetë muajt e parë të vitit, duke rezultuar lehtësisht më lartë se ai i së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, por ende më ulët se trendi historik.

Dobësia ciklike e ekonomisë shqiptare vazhdon të diktojë presionet e ulta inflacioniste, duke u reflektuar në një rritje të vogël të pagave, kostove të prodhimit dhe inflacionit bazë.

Banka e Shqipërisë parashikon një rritje graduale të inflacionit, duke iu afruar kështu objektivit në fund të vitit 2017. Megjithatë, në periudhën afatshkurtër, inflacioni parashikohet të mbetet poshtë objektivit, pasi rritja ekonomike do mbetet poshtë potencialit, si dhe inflacioni jashtë dhe pritshmëritë mbi të janë të ulëta. Në projektimin e Bankës së Shqipërisë, mbyllja e hendekut te prodhimit gjatë mesit të vitit 2016 do të ushtrojë presione rritëse në inflacion.

2.1.7 Politika monetare

Politika monetare nxitet nga objektivi i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve sipas kuadrit të shënjestrimit të inflacionit. Procesi vendimmarrës udhëhiqet nga devijimi i inflacionit nga objektivi prej 3% në periudhën afatmesme.

Parashikimi i inflacionit më të ulët se objektivi dhe transmetimi i dobët i politikës monetare në ekonomi kanë ndikuar në politikën monetare. Rritje poshtë potencialit, inflacioni i ulët i jashtëm, dhe pritshëmritë e ulta të inflacionit kanë rezultuar në presione të dobëta inflacioniste. Duke pasur në konsideratë këtë panoramë, politika monetare ka mbetur akomodative përgjatë vitit 2015. Norma bazë e interesit është në nivelin më të ulët historik prej 2.0% në, që nga muaji Janar 2015. Lehtësimi i politikës monetare është nxitur Lehtësimi i politikës monetare është përforcuar nga orientimi për të ardhmen i tregjeve financiare. Me qëllim ankorimin e pritshmërive inflacioniste, Banka e Shqipërisë ka deklaruar se do të vazhdojë të zbatojë një politikë monetare akomoduese për disa periudha më tej.

2.1.8 Vlerësimi i miksit të politikës makroekonomike

Politika monetare zgjeruese e Bankës së Shqipërisë është justifikuar nga mos arritja e inflacionit objektiv, si dhe nga pozicioni ciklik i dobët i ekonomisë. Kjo politikë ka për qëllim të sigurojë mbështetje kundërciklike ndaj ekonomisë, duke gjeneruar kushtet e nevojshme të financimit, si dhe inçentivat e shpenzimeve dhe investimeve për të mbështetur kërkesën agragate. Njëkohësisht, politika fiskale ka ndjekur një trajektore konsoliduese me qëllim reduktimin e vulnerabiliteteve në lidhje me një borxh të lartë. Në periudhën afatgjatë, konsolidimi i treguesve fiskalë pritet të kontribuojë pozitivisht në reduktimin e primeve të rrezikut në ekonomi, duke forcuar stabilitetin makroekonomik dhe duke rritur shpenzimet dhe investimet e sektorit privat.

Sipas Bankës së Shqipërisë, ky miks i politikave është i përshtatshëm. Në total, miksi i politikave mbetet zgjerues, me qëllim mbështetjen e kërkesës agregate dhe gjenerimin e rritjes jo – inflacioniste dhe punësimit në ekonomi. Në terma të përbërjes të miksit të

politikave, ai adreson vulnerabilitetet në lidhje me borxhin publik, ndërkohë që mundohet të lehtësojë bilancet e sektorit privat dhe sektorit bankar , me qëllim gjenerimin e rritjes.

Sipas Ministrisë së Financave, gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2015, rritja ekonomike shënoi një nivel relativisht të lartë rritjeje 2.82%, krahasuar me të njëjtin 3M të një viti më parë.

Politikat makroekonomike janë shtyrë nga nevoja për të mbështetur rritjen ekonomike të qëndrueshme afatmesme. Në procesin e përgatitjes së politikave të përshtatshme, çështjet kyçe kanë qenë ruajtja e stabilitetit të çmimeve të konsumit, borxhit publik dhe sistemit financiar.

Duke pasur parasysh se pritshmëria për inflacionin mbetet e ankoruara mirë, politika monetare është lehtësuar me qëllim që të mbështetë rimëkëmbjen ekonomike. Më 28 janar 2015, norma bazë e interesit është ulur me 0.25 pikë përqindje në 2%, në përpjekje për të stimuluar kërkesën agregate. Cikli lehtësues është shoqëruar me disa masa të kujdesshme makro të cilat synonin të nxisin kreditimin e ekonomisë. Politikat monetare dhe makro kanë dhënë rezultate pozitive, duke ulur koston e kreditimit në monedhën vendase, si dhe ngadalësim të shtimit të kredive me probleme. Efekti në rritjen e kërkesës agregate ka qenë i dobët, ndërsa përmirësimi këtij komponenti pritet gjatë vitit 2015. Këto vendime kanë peshuar me kujdes ekuilibrin mes riskut dhe stabilitetit financiar. Përveç kësaj, autoritetet janë të angazhuara për zbatimin e rekomandimeve në vijim të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar me FMN-në dhe BB-së, me qëllimin për të forcuar rregullimin mbikëqyrës dhe sistemin financiar në përgjithësi.

Ndërkohë, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të përdorë strategjinë e komunikimit mbi orientimin e publikut për politikën monetare në të ardhmen, me qëllim ankorimin e pritjeve inflacioniste dhe nxitjen e kërkesës agregate. Megjithatë këto masa kanë patur ndikim të dobët në rritjen e kërkesës agregate, për shkak të perceptimit për rrezik të lartë dhe gatishmërisë së ulët të agjentëve ekonomikë për të marrë përsipër rrezik.

2.1.9 Politika fiskale

Politika Fiskale do të jetë kryesisht e fokusuar drejt konsolidimit fiskal në periudhën afat-mesme. Objektivi kryesor është rduktimi i nivelit të borxhit nën 60% të PBB-së për periudhën afatmesme. Gjithashtu, do të synohet të përcaktohen arsyet kryesore që lidhen me deficitin nëpërmjet politikave mbi shpenzimet dhe mbledhjes së taksave dhe nëpërmjet zgjerimit të manaxhimit të financave publike, si dhe nëpërmjet reformave mbi grumbullimin e të ardhurave. Skenari bazë synon të arrijë një nivel të deficitit prej 3.9% të PBB-së për vitin 2015, nga 5.1% të PBB-së që ishte në vitin 2014. Konsolidimi fiskal do të vazhdoj edhe në vitin 2016 dhe 2017 duke synuar nivelet prej 2.6 dhe 1.3 % të PBB-së.

Politika fiskale shtrënguese e planifikuar për periudhën afat-mesme do të reflektohet kryesisht një nivel të palëvizshëm të konsumit publik. Konsumi privat pritet të rimëkëmbët gradualisht, ndërkohë që besimi i konsumatorit pritet të përmirësohet dhe taksat e ndërmarra nga qeveria për vitin 2015 do të konsiderohen si masa drastike që nuk do tëpërsëriten në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, politika monetare akomoduese e planifikuar për periudhën afat-

mesme, për aq kohë sa nivelet inflacioniste do të qëndrojnë të ulëta, do të mbështesin konsumin privat po ashtu edhe investimet.

Qeveria ka futur tashmë një paketë fiskale që prek kryesisht të ardhurat tatimore dhe administrimin tatimor. Autoritetet janë angazhuar fort për të paguar borxhet e akumuluara gjatë viteve të fundit, duke injektuar likuiditet të freskët në ekonomi. Njëkohësisht, po merren masat e duhura për të parandaluar akumulimin e detyrimeve në të ardhmen. Shqipëria ka nënshkruar me FMN-në një marrëveshje trevjeçare huaje, që pritet ta ndihmojë vendin të plotësojë nevojat financiare, ndërkohë që siguron mbështetjen e duhur për zbatimin me sukses të reformave strukturore. Në këtë aspekt, reformat e planifikuara dhe masat fiskale synojnë të përmirësojnë klimën e investimeve në vend. Të ardhurat pritet të rriten për shkak të ndryshimeve të politikës tatimore dhe përpjekjeve për të përmirësuar performancën e mbledhjes së taksave. Të ardhurat fiskale për gjysmën e parë të vitit 2015 ishin 182,972 milionë Lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014, të ardhurat fiskale shënuan rritje me 4.4%

2.1.10 Borxhi publik

Në qershor të vitit 2015 niveli i borxhit në terma nominal vlerësohet në 1,015.3 miliardë lekë, duke pësuar një rritje prej 38.2 miliardë lekë krahasuar me vitin 2014. Në këtë rritje 12.4 miliardë lekë i atribuohen efektit të kursit të këmbimit dhe 12.6 miliardë lekë likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Ecuria e borxhit të brendshëm gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 ka qenë pozitive pasi ka arritur të përmbush nevojën për financim me rreth 13.4 miliardë lekë. Financimi i brendshëm është arritur të realizohet plotësisht nëpërmjet instrumenteve afatgjata dhe njëkohësisht është shoqëruar me maturim të instrumenteve afatshkurtra, duke bërë që portofoli i borxhit të brendshëm të përmirësohet ndjeshëm në kuadër të riskut të ri-financimit *(jetgjatësia mesatare është rritur nga 630 ditë në fund të vitit 2014 në 673 ditë në qershor 2015)* dhe riskut të normave të interesit.

Gjatë vitit 2015, ka vazhduar diversifikimi i portofolit duke vlejtur për tu përmendur shtimi i financimit nëpërmjet instrumentave 7 dhe 10 vjeçare, përkatësisht në shumat 7.2 dhe 6.1 miliardë lekë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015 normat e interesit kanë qëndruar pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e vitit 2014 duke pasur ulje dhe ngritje të moderuara në segmente të caktuara.Gjithsesi dhe pavarësisht alternimeve të normave të interesit, portofoli i borxhit të brendshëm është shoqëruar me një rënie të kostos mesatare me rreth 9 pikë bazë krahasuar me fundin e vitit të kaluar.

Borxhi i jashtëm paraqitet i qëndrueshëm duke pësuar disa ndryshime relativisht të vogla në kuadër të diversifikimit të mëtejshëm të monedhave që e kompozojnë këtë portofol, si edhe në kuadër të rritjes së peshës së stokut me norma interesi koncesionale, kryesisht për shkak të disbursimeve të mbështetjes buxhetore.

Zhvlerësimi i monedhës vendase kundrejt monedhave që kompozojnë portofolin e borxhit të jashtëm dhe kryesisht kundrejt USD, ka bërë që efektet e shtesës së borxhit gjatë raportimit në monedhë vendase të jenë të konsiderueshme.

Gjashtëmujori i parë të vitit 2015 është karakterizuar nga një rënie e disbursimit të fondeve për projektet me financim të huaj duke u vlerësuar rreth 46% më i ulët se gjashtëmujori i vitit të kaluar. Ndërkohë, disbursimet për mbështetjen buxhetore në kuadër të likuidimit të detyrimeve të prapambetura kanë avancuar në përputhje të marrëveshjes me partnerët ndërkombëtarë (FMN).

Republika e Shqipërisë vazhdon të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme me kreditorët e projekteve me financim të huaj duke paraqitur një nivel bashkëpunimi të lartë dhe duke përcjellë konfidencë tek kreditorët nëpërmjet likuidimit të detyrimeve të saj në kohë.

2.1.11 Privatizimi

Procesi i *privatizimit* mbetet prioritet, sidomos në sektorë strategjikë që synojnë tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendas që do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik. Gjatë vitit 2015 është rishikuar politika e privatizimit të kompanive të vogla e të mesme me 100% kapital shtetëror në sektorin jostrategjik. 2 kompani me performancë të dobët ekonomiko-financiare kanë kaluar në proces likuidimi. 7 kompani të tjera janë ristrukturuar e bashkuar.

Asetet e papërdorura të kompanive të tjera me performancë të dobët janë vënë në dispozicion të investitorëve vendas apo të huaj për tu dhënë me qira 1 Euro.

Gjatë vitit 2015 janë përgatitur dosjet e privatizimit të 45 aseteve dhe 1 kompanie dhe janë dërguar për shitje në Ministri të Financave. Informacion më të zgjeruar për to mund të gjendet në uebsite http://www.ekonomia.gov.al, për të bërë procesin e privatizimit më transparent. Shitja e aseteve bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë shitur 17 asete dhe aksionet shtetërore në 1 kompani me një vlerë prej 655 milion leke ose 4,6 milion Euro.

Procesi i privatizimit të kompanisë INSIG sha ka filluar gjatë vitit 2015 dhe është përzgjedhur kompania që do të bëjë vlerësimin e aksioneve të INSIG sha. Procesi i vlerësimit të aksioneve të INSIG sha pritet të përfundojë në fund të muajit dhjetor 2015. Plani i veprimeve për privatizimet në sektorin strategjik për periudhën 2015-2020 është miratuar nga Ministri i MZHETTS me shkresë nr. 7476, date 30.09.2015, e cila parashikon privatizimin e kompanisë Albpetrol sha, si dhe paketat shtetërore të mbetura në Albtelekom sha dhe Armo sha.

2.1.12 Sektori bankar

Prioritetet

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian në Raport Progresin 2015 për Bankën e Shqipërinë prioritet në fushën e kriterit ekonomik:

Rekomandimi nr. 4 i PRE-ve: *"Të merren masa të mëtejshme për të zgjidhur çështjen e kredive me probleme, me përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë, dhe po qe e nevojshme edhe të Bankës së Shqipërisë, me qëllim uljen e qëndrueshme të nivelit të tyre. Në këtë drejtim, do të ishte e udhës, të jepet zgjidhje për pengesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore".*

Sektori bankar shqiptar ka ruajtur strukturën[1]*dhe qëndrueshmërinë e tij gjatë vitit 2015.*

Vëllimi i aktivitetit shfaqi rritje dhe performanca financiare, përmirësim. Treguesit prudencialë të sektorit bankar për aftësinë paguese, likuiditetin dhe provigjonimin e mëtejshëm u shfaqën në nivelet të përshtatshme, duke qëndruar brenda niveleve rregullatore, edhe kur supozohet materializimi i skenarëve të rënduar makroekonomikë. Sfidat kryesore të sektorit bankar shqiptar gjatë periudhës në vijim janë: të sigurojë një rekuperim të qëndrueshëm të huadhënies dhe të përmirësojë treguesit e cilësisë së aktiveve bankare nëpërmjet masave pastruese, që synojnë fshirjen e huave me probleme nga bilancet, me një impakt pozitiv tek efiçenca operative dhe kapaciteti ndërmjetësues i bankave. Përsa i përket rreziqeve të tregut, sektori bankar shfaqet relativisht i mbrojtur nga rreziku i drejtpërdrejtë nga kurset e pafavorshme të këmbimit dhe lëvizjeve të normës së interesit.

Mjedisi makrofinanciar ka qenë i qëndrueshëm, duke mbështetur kështu performancën e sistemit financiar. Veprimet e politikave fiskale dhe monetare u shoqëruan me një funksionim të përshtatshëm të tregjeve financiare dhe kosto financimi më të ulëta.

Në qershor 2015, ndërmjetësimi financiar në Shqipëri, i llogaritur si raporti i aktiveve financiare mbi PBB, ishte 102.6%. Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, duke përfaqësuar mbi 90.3% të aktiveve totale të sistemit financiar.

Në qershor 2015, aktivet e sektorit bankar shqiptar shënuan një rritje vjetore me 4.8% dhe 1.4%, që nga fundi i muajit dhjetor 2014. Zgjerimi i aktiveve u regjistrua në formën e investimeve ndërbankare (kryesisht në institucione financiare jo-rezidente), si edhe në rritje të portofolit të huave, ndërkohë që portofoli i letrave me vlerë ka rënë si rezultat i investimeve më të ulëta në letra me vlerë të huaja. Investimet e sektorit bankar në borxh qeveritar përbëri rreth 25% të totalit të aktiveve bankare. Rreziku potencial i ri-investimit të portofolit të bankave në letra me vlerë të qeverisë është vlerësuar në rënie, duke qenë se: **(i)** aftësia paguese e qeverisë u përmirësua si rezultat i politikave fiskale të konsoliduara dhe marrëveshjeve me FMN që mundësojnë të ardhura alternative në monedhë të huaj; **(ii)** bankat janë në kushte të mira likuiditeti dhe kapitali, dhe shfaqin preferencë ndaj këtyre formave të investimit; **(iii)** struktura e maturitetit të letrave me vlerë të qeverisë ka vazhduar të shfaqë rritje të maturitetit mesatar.

Aktiviteti i kredidhënies u rikuperua dukshëm gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, i shtyrë nga norma interesi të favorshme për monedhën vendase. Rritja e kreditimit[2] për

[1] Janë 16 banka, nga të cilat: 2 janë banka shqiptare dhe 14 janë banka me kapital të huaj. Asnjë nga bankat me kapital të huaj nuk funksionon si degë.

sektorin privat u ri-arriti në 5.3% në qershor 2015, pas një kontraktimi në 2.5% në qershor 2014. Në mënyrë specifike, huadhënia ndaj korporatave, që përbën 70% të huave totale, ishte burimi kryesor i aktivitetit të kredidhënies[3], duke u rritur me 6.3% në Qershor 2015, kundrejt një rënie me 3% një vit më parë, ndërkohë që huatë me pakicë *(retail)* u rritën me 2.8% në qershor 2015, pasi qëndruan të pandryshuara gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2014. Ky trend pozitiv kryesisht reflekton zbutjen e standardeve të kredidhënies nga bankat, të nxitur nga parashikimi i një përmirësimi të ndjeshëm në cilësinë e aktiveve të tyre, të mbështetur nga spastrimi i vonesave të akumuluara dhe fshirjet e detyruara të huave, të mbajtura në kategorinë "të humbura" për më shumë se 3 vjet, që nga data 1 janar 2015. Në të njëjtën kohë, një varg masash[4] nga BSH, të ndërmarra në 2013 dhe 2014, kanë mbështetur gjithashtu përmirësimin e aktivitetit të kredidhënies. Nga pikëpamja e monedhës, komponenti i monedhës vendase, megjithëse përfaqësonte vetëm 38% të totalit të huave, ishte shtysa kryesore e ringritjes së aktivitetit të huadhënies në 2015. Pati një rritje mesatare vjetore me 7.2% gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, kundrejt 3.3% gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014. Performanca e fortë e huadhënies në monedhë vendase u mbështet gjithashtu nga një rënie e ndjeshme e normave të interesit për Lek-un. Në fakt, që nga fillimi i ciklit të lehtësimit të politikës monetare në shtator 2011, norma mesatare e huadhënies për Lek-un ka rënë me 3 pikë përqindje dhe ka arritur një normë rekord të ulët, mesatarisht 8.3% gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2015.

Aktiviteti bankar vazhdoi të jetë përgjithësisht nga depozitat, të cilat përfaqësonin rreth 82% të totalit të aktiveve. Treguesi kredi/depozita është rreth 5%. Volumi i depozitave vendase pati një rritje vjetore me 4% në qershor 2015, pavarësisht rënies së normës mesatare të interesit. Të dyja, depozitat në Lek dhe depozitat në monedhë të huaj patën një ndikim pozitiv, i cili ishte më i fortë në rastin e pjesës në monedhë të huaj (4.8% në qershor 2015, ndryshim nominal vjetor, ndërkohë që pjesa në Lek pati një rritje vjetore 3.1%). Llogaritë e biznesit u rritën me një normë më të lartë se në 2014, të ndikuara nga shlyerjet e pagesave të vonuara nga qeveria. Varësia e sektorit bankar nga burimet e jashtme të fondeve është tepër e limituar. Pozicioni neto i sektorit bankar ndaj jo-rezidentëve qëndroi kryesisht në anën e kreditimit, dhe vazhdoi të rritej gjatë periudhës, megjithëse me një ritëm më të ulët.

Huamarrja nga grupet e bankave mëmë ra. Masat[5] kundër ciklike të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në maj 2013, ndikuan në rritje më të ngadaltë të investimeve të sektorit bankar në aktive të huaja *(jo-rezidente)*. Rritja e tyre vjetore ra në 10% (gjatë gjashtëmujorit të parë të 2015), nga 14% në 2014 dhe 24% në 2013. Pjesa më e madhe e detyrimeve konsistoi në detyrime ndaj grupeve bankare mëmë, kryesisht në formën e linjave të kredisë. Pjesa e përdorur e linjave të kredisë ra me 62% që nga fundi i muajit Dhjetor 2014 dhe me 55% në terma vjetorë.

---

[2] Kredia për sektorin privat përbën 95% të kredisë vendase.

[3] Huadhënia ndaj entiteteve të huaja ka qenë më e theksuar gjatë gjashtëmujorit të pare të vitit 2015.

[4] Në mars 2013, kërkesat për capital për bankat që shtojnë kredinë nga 4-10% u reduktuan dhe u dekurajua mbajtja e fondeve jashtë shtetit nga bankat. Për më tepër, në fund të 2013s dhe në fillim të 2014s, procesi i fshirjeve nga bilanci u lehtësua, dhe proçesi i ekzekutimit të kolateraleve u thjeshtua.

[5] Shiko futnotën 4.

Kapitalizimi vazhdimisht i mjaftueshëm i sektorit bankar vazhdon të mbetet një tipar dallues i sektorit bankar shqiptar. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin, 16% në qershor 2015, është konsiderueshëm mbi nivelin minimal të kërkuar, 12%. Fondet e veta afatshkurtra të sektorit bankar shqiptar, përbehen kryesisht nga kapital Tier-1, duke mundësuar kështu qëndrueshmëri ndaj goditjeve. Kapitalizimi i fitimeve ka çuar në një nivel të përmirësuar kapitalizimi, pamvarësisht rritjes së Aktiveve të Peshuara me Risk për shkak të ndryshimeve rregullatore[6].

Rrezultati financiar neto u përmirësua ndjeshëm në sajë të uljes së kostos së financimit dhe të uljes së shpenzimeve neto për provigjonet, midis ngadalësimit të akumulimit të huave me probleme. Në qershor 2015, treguesit e përfitueshmërisë RoA dhe RoE u rritën respektivisht në 1.3% dhe 14.2%, nga 0.9% dhe 10.4% një vit më parë.

Cilësia e portofolit të huave u përmirësua gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, kryesisht i shtyrë nga zhvillimet lidhur me fshirjet e huave problematikë (write-off), me treguesin hua me probleme mbi hua bruto total, në rënie në 21% në qershor 2015. Provigjonet për huatë me probleme arritën në 69%, megjithatë vlera e huave problematike neto, pas zbritjes së provigjoneve mbi kapitalin, qëndroi në rreth 36% në korrik 2015. Kështu, është ndjekur një monitorim i ecurisë së huave me probleme. Banka e Shqipërisë ka vazhduar implementimin e iniciativës për zgjidhjen e huave me probleme me mbështetjen e zyrës FinSAC të Bankës Botërore.

Për më tepër, në kuadrin e një inisiative kombëtare për reduktimin e huave me probleme, Banka e Shqipërisë ka qenë në diskutime me institucione të tjera mbi veprime potenciale, që mund të ndërmerren. U ngrit një Grup Pune i Nivelit të Lartë për të hartuar një strategji kombëtare tërësore. Në fund të muajit qershor 2015, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar organizoi një konferencë kombëtare për planin e veprimit për reduktimin e huave me probleme, për të cilën pritet një dokument në shtator 2015.

Sektori bankar duket se është i mirëmbrojtur nga rreziku direkt i kurseve të pafavorshme të këmbimit, por ndjeshmëria ndaj këtyre ndryshimeve është rritur. Pozicioni i limituar neto, i hapur në valutë, në bilanc kundrejt kapitalit rregullator (7.2%), dhe pozicioni "në blerje"nënkuptoi ekspozim të kufizuar ndaj rënies së kursit të këmbimit. Megjithatë, ekspozimi ndaj rrezikut indirekt të tregut nga huamarrja e pambrojtur në monedhë të huaj mbetet relativisht i lartë, me hua të tilla (të pambrojtura) në monedhë të huaj që përbëjnë rreth 1/3 e huave në total.

[6] Duke filluar nga janari 2015, bankat i janë nënshtruar një standardi të ri, përsa i përket përllogaritjes së kërkesave për kapital për të monitoruar rreziqet kryesore në përputhje me Bazel II. Në përputhje me rregulloren e re "Për treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit" që bën të mundur përshtatjen me këtë standard, bankat mund të reduktojnë kapital në disa klasa të aktiveve të kredisë të peshuar me rrezik, duke shtuar kështu kapital për kërkesat për rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional (ky i fundit, më parë i pakonsideruar në kërkesat rregullatore për kapital).

Gjendja e likuiditetit në sistemin bankar qëndroi e fortë. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit ishte i ulët. Treguesit e likuiditetit (aktive likuide mbi deyrime afat-shkurtra), si në Lek, edhe në valutë, janë mbi minimumin rregullator[7]. Në fund të muajit qershor 2015, aktivet likuide përfaqësonin 32.6% të totalit të aktiveve të sektorit bankar.

Sektori bankar në Shqipëri ka kapital prudencial dhe rezerva likuiditeti që mund të përballojnë goditje të forta të shkaktuara nga zhvillime makroekonomike të pafavorshme vendore dhe të huaja. Prova e rezistencës për aftësinë paguese të sektorit bankar shfaq një kapacitet të mirë për të mbuluar humbjet potenciale si pasojë e zhvillimeve të mundshme makroekonomike shumë të rënduara, pavarësisht rënies së fortë të raportit të kapitalit total.

Likuiditeti vazhdoi të shfaqte nivele të mira kundrejt një trendi ri ribalancimi të strukturimit të aktiveve dhe detyrimeve të bankave sipas monedhave. Provat e rezistencës së likuiditetit të sektorit bankar nga një pikëpamje makroprudenciale, janë tregues të një kapaciteti të mirë për të përballuar një goditje mesatarisht të fortë, të shkaktuar nga tërheqjet e financimit.

Efektet potenciale negative nga kriza greke kanë qenë në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë. Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar[8] u mblodh në maj, qershor dhe korrik 2015, dhe u përqendrua tek analizimi i aktivitetit të sektorëve bankar dhe financiar dhe tek vlerësimi – ndër të tjera – i efekteve potenciale nga kriza greke. Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjerë, anëtarë të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar intensifikuan aktivitetin e mbikëqyrjes, për shkak të mbylljes së bankave dhe fillimit të kontrolleve të kapitalit në Greqi.

Treguesit e shëndetit financiar për bankat shqiptare me kapital grek dhe të sektorit bankar në përgjithësi, janë testuar dhe vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe konservatore për skenarë të ndryshëm, ndërkohë që ekspozimi i tyre ndaj bankave mëmë dhe Greqisë është reduktuar deri në nivele të papërfillshme. Krahas kësaj, është rivlerësuar gatishmëria e kuadrit të instrumenteve për mbrojtjen e stabilitetit financiar.

Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar vuri në dukje se treguesit e mirë të likuiditetit dhe kapitalizimit për bankat shqiptare me kapital grek dhe ndërprerja e veprimeve të tyre me grupet bankare mëmë, kanë neutralizuar kanalet potenciale financiare, që mund të kenë efekt mbi bankat shqiptare me kapital grek. Të gjitha këto masa kanë ndikuar në zbutjen e çdo luhatshmërie të mundshme të depozitave, dhe kanë ndihmuar në ruajtjen e besimit të plotë të publikut tek bankat vendase.

Sistemi bankar vazhdoi të tregojë një trend të qëndrueshëm përsa i përket shpërndarjes dhe përdorimit të burimeve financiare. Kjo u reflektua gjithashtu në Indeksin Herfindahl, i cili mat nivelin e përqendrimit në sistemin bankar. Treguesit e përqendrimit, siç maten nga Indeksi Herfindahl, për totalin e aktiveve, depozitave dhe huave, dëshmuan se ka një

[7]Bankat duhet të mbajnë aktive likuide që mbulojnë 15 përqind të detyrimeve afatshkurtra në secilën monedhë, me një kërkesë për mbulesë totale në të tëra monedhat, 20 përqind. Disa banka duhet të konformojnë me një kërkesë për likuiditet 5 përqind më të lartë se bankat e tjera, për të zvogëluar risqe likuiditeti të perceptuara si më të larta.Këto banka përmbushën lehtësisht kërkesat më të larta në qershor 2015.

[8]Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar

përqendrim relativisht të lartë në sistemin bankar, përsa u përket aktiveve, depozitave dhe (më pak) huave. Megjithatë, duket se ka një shpërndarje disi më të mirë të pjesëmarrjes në treg me kalimin e kohës dhe, rrjedhimisht një konkurrencë të përmirësuar.

2.2 Aftësia për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së

2.2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Ekonomia e tregut funksionale kërkon që Shqipëria të ruajë stabilitetin e vet makroekonomik, përfshi qëndrueshmërinë e financave publike, të mbajë stabilitetin e çmimeve dhe të bilancit të pagesave, të ketë ekuilibër ndërmjet kërkesës dhe ofertës, të eliminojë barrierat ekzistuese dhe të sigurojë sundimin e ligjit dhe ekzekutimit të kontratave dhe të titujve të pronësisë.

Në vitet e fundit, Shqipëria e ruajti stabilitetin makroekonomik, por ngadalësimi ekonomik rezultoi në tkurrje të deficitit të llogarisë korrente, por disbalancat në sektorin e jashtëm janë ende të mëdha, duke pasqyruar bazën e ngushtë të prodhimit. Shqipëria ka marrë disa masa për të realizuar procesin e privatizimit dhe ka nisur reforma për të adresuar çështjen e të drejtave pronësore.

Kapitali njerëzor: Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe tregu i punës funksional janë faktorë kyçë që kontribuojnë në rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë dhe pozicionin e sistemit ekonomik shqiptar si pjesëmarrës në tregun evropian dhe global. Problemet kryesore me të cilat përballet Shqipëria dhe që pengojnë realizimin e plotë të kapitalit njerëzor janë: ndryshimet në sistemin e ekonomisë, "bjerrja e trurit" në vitet e fundit, informaliteti dhe mungesa e arsimit dhe sistemit të formimit profesional. Si rezultat, bizneset shpesh përballen me mungesë aftësish që kufizon rritjen e tyre.

Në fund të Tremujori II 2015, shkalla e papunësisë ishte 17.3%, siç është raportuar nga INSTAT.

Politikat e punësimit

Në lidhje me politikën e punësimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka vazhduar të zbatojë masat e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësi 2014-2020, në bashkëpunim me institucionet zbatuese, Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe institucionet e tjera të varësisë.

Përsa i përket të dhënave për punëkërkuesit e papunë, që janë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, për periudhën Janar – Gusht 2015 në të gjithë territorin e vendit (36 zyra rajonale/vendore), rezultojnë si më poshtë:

- Totali i punëkërkuesve të papunë është 151.926 persona, nga të cilët rreth 50% janë femra;
- Të rinj të moshës 15-30 vjeç janë 42.550 punëkërkues të papunë ose 28% e totalit;
- Punëkërkues të papunë në pagesë papunësie janë 5.902 ose 4% e totalit të punëkërkuesit e papunë;

- Punëkërkues të papunë në ndihmë ekonomike janë 65.626 ose rreth 43% e totalit të punëkërkuesit e papunë;
- Punëkërkues të papunë nga komuniteti rom dhe egjyptian janë 9.856 ose rreth 6% e totalit të punëkërkuesit e papunë.

Për vitin 2015 fondi për programet e nxitjes së punësimit është 450 milion leke dhe nga totali i këtyre 250 milion ka për qëllim të mbështesë industrinë fasone.

Gjatë vitit 2015 janë zbatuar 6 programe të nxitjes së punësimit dhe janë përfshirë 5631 punëkërkues të papunë, të regjistruar pranë zyrave të punësimit. Në këto programe kanë përfituar 582 subjekte dhe gjithashtu janë shpenzuar 97% e fondeve. Shumë përfitues janë nga Tirana e Durrësi, kryesisht në fushat e shërbimit spitalor, arsimit, shëndetësisë, tregtisë, ndërtimit, turizmit, prodhim mobilje, hoteleri-turizmit, telemarketing, bukëpjekës, autoservis, duralumin, prodhime pasticerie, qepje, konfeksione, prodhim tekstile, përpunimit të bimëve medicinale, prodhimit të ndërtimit metalike, etj.

5631punëkërkues të papunë, të cilët janë përfshirë në këto programe, janë të ndarë sipas kategorive:

- 72% femra, dominance që vihet re në të gjitha llojet e programeve te zbatuara, kjo lidhet me llojin e kompanive të perfshira në projekte, ku industria fason zë mbi 55 %.
- 57% të rinje deri në 29 vjeç dhe 22% të moshave mbi 40 vjeç
- 46% me nivel arsimor deri në 9 vjeçar (pjesëmarrje e cila ne VKM nr.47 dhe VKM nr.48 shkon deri në 60%.)
- 7% e pjesëmarrësve jane nga skemat e mbështetjes me të ardhura.
- 25% punëkërkues të papune afatgjatë, pra që kanë mbi nje vit të regjistruar në Zyrat e Punësimit.
- 180 punëkërkues të papunë nga komuniteti Rom dhe Egjyptian, pjesemarrës në programe sipas VKM nr.47 dhe VKM nr.48.
- 29 Persona me aftesi te kufizuar, pjesemarres ne programe sipas VKM 248 dhe 2 te tjere ne VKM nr.48 dhe VKM nr.873.
- 10 punëkërkues të papunë, emigrantë të kthyer, janë përfshirë në programe të subvensionimit në punë.

Në lidhje me zbatimin e Strategjisë së Punësimit në këtë periudhën deri në Gusht të vitit 2015, është duke u punuar për riorganizimin e zyrave të punësimit nëpërmjet modernizimit të infrastrukturës, ri-konceptimit dhe kompjuterizimit të shërbimeve të ofruara. Trembëdhjetë zyra të reja punësimi janë ngritur në nivel rajonal dhe vendor, sipas modelit të ri të shërbimeve, që është model unik i ofrimit të shërbimeve me tre nivele, informacion, shërbime punësimi dhe këshillim individual, të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme me institucionet homologe evropiane.

Tabela 3 : Treguesit e monitorueshëm

Nr.	Treguesit e monitorueshëm	Arritjet Gusht 2015
1.	Punësimi	17,826
2.	Ndërmjetësimet nga zyrat e punësimit	10.086
3.	Të trajnuar në kurse profesionesh në QFP	10.356

4.	Pjesëmarrës në programet e nxitjes së punësimit	5.631
5.	punëkërkues të papune, të punësuar pas mbarimit të një kursi	460

Kapitali fizik: Investimet në infrastrukturë dhe në kapital për NVM-të mbeten parakushtet kryesore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe rritjen afatgjatë. Për të arritur konkurrueshmërinë, vëmendje i është kushtuar zhvillimit të sektorit privat. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë masash për të promovuar zhvillimin dhe modernizimin e sektorit privat dhe zgjerimin e bizneseve të reja. Me kontribut prej 80% të PBB-së dhe rreth 82% të punësimit, sektori privat përbën lokomotivën kryesore të e rritjes ekonomike. Nisur nga struktura dhe përbërja industriale e sistemit ekonomik shqiptar, prioritet i është dhënë zhvillimit të NVM-ve, kryesisht në promovimin dhe zhvillimin e industrive nxjerrëse dhe përpunuese, si edhe industrisë joushqimore, duke u mbështetur në përdorimin më racional të burimeve vendore.

Raporti i Konkurrueshmërisë Globale (GCR) 2014-2015 i Forumit Ekonomik Botëror e rendit Shqipërinë në pozicionin e 97-të nga 144 vende / ekonomi, me një rënie prej 2 pozicionesh krahasuar me vitin pararendës.

Si faktorët më problematikë për të bërë biznes, ky raport identifikon aksesin në financim, normat e tatimit, korrupsionin dhe rregullimin fiskal.

Kapitali fizik: Rrjeti rrugor kombëtar i cili administrohet dhe investohet nga Autroiteti Rrugor Shqiptar, përbëhet nga 3740 km. Investimet infrastrukturore synojnë integrimin e rrjetit rrugor kombëtar në rrjetin rajonal dhe europian TEN-T, duke përfshirë arterie strategjike si, ndërtimi i Autostradës Adriatiko–Joniane (*në kuadër të procesit të Berlinit*); përfundimi i akseve rrugore kryesore, si segmenti Tiranë –Elbasan, dhe ndërtimi i Rrugës së Arbrit, etj.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është i përfshirë, në Rrjetin kryesor rajonal të transportit, me gjatësi rreth rreth 420 km. Infrastruktura portuale është përmirësuar, në vitin 2013 përfundoi ndërtimi i terminalit të pasagjereve në Portin e Durrësit, vijon puna për rehabilitimin e kalatave nr. 7 dhe nr. 8, të cilat përfundojnë brenda vitit 2017. Rehabilitimi i infrastrukturës vijon gjithashtu në Portin e Vlorës, ndërkohë që investime janë kryer edhe në portet e Shëngjinit dhe të Sarandës; (*Shih Kapitullin 21Rrjetet Trans – Europiane*).

Prioritetet në fushën e transportit janë:

i) Ndërtimi i korridoreve kryesore rrugore të transportit, duke përfshirë Korridorin 8 Pan-Evropian, Korridorin Durrës-Morinë, që bën të mundur lidhjen me Korridorin 10, Korridorin Rrugor Veri-Jug (pjesë e Autostradës Adriatiko – Joniane) , Rrugën e Arbrit, si një degë e Korridorit 8 dhe Aksin Qendror;

ii) Integrimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor shqiptar në rrjetin rajonal të Evropës Juglindore, si dhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Maqedoninë;Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës portuale në Shqipëri.

2.2.2 Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Investimet në infrastrukturë dhe në kapital për NVM-të mbeten parakushtet kryesore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe rritjen afatgjatë. Për të arritur konkurrueshmërinë, vëmendje i është kushtuar zhvillimit të sektorit privat. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë masash për të promovuar zhvillimin dhe modernizimin e sektorit privat dhe zgjerimin e bizneseve të reja.

Me kontribut prej 80% të PBB-së dhe rreth 82% të punësimit, sektori privat përbën lokomotivën kryesore të e rritjes ekonomike. Nisur nga struktura dhe përbërja industriale e sistemit ekonomik shqiptar, prioritet i është dhënë zhvillimit të NVM-ve, kryesisht në promovimin dhe zhvillimin e industrive nxjerrëse dhe përpunuese, si edhe industrisë joushqimore, duke u mbështetur në përdorimin më racional të burimeve vendore.

Raporti i Konkurrueshmërisë Globale (GCR) 2014-2015 i Forumit Ekonomik Botëror e rendit Shqipërinë në pozicionin e 97-të nga 144 vende/ekonomi, me një rënie prej 2 pozicionesh krahasuar me vitin pararendës.

Si faktorët më problematikë për të bërë biznes, ky raport identifikon aksesin në financim, normat e tatimit, korrupsionin dhe rregullimin fiskal.

Lehtësirat në kreditim dhe financim

Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri (PRODAPS)

Skema e kreditimit të NVM në kuadrin e Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Sektorit Privat në Shqipëri (PRODAPS) është duke u zbatuar pa probleme. Në 1 tetor 2014 – tetor 2015, gjashtë projekte të iniciuara nga SME shqiptare u mbështetën në sektorët e mëposhtëm: qumështi dhe produktet e përpunimit të ushqimit, prodhimi i aluminit dhe aksesorëve, prodhimin e elementeve të parafabrikuara të ndërtimit, prodhimin e mobilieve. Në total, mbështetja për këto projekte ishte 1.797.000 euro. Gjatë kësaj periudhe, SME-të që operojnë jashtë aksit Tiranë – Durrës kanë marrë rreth 77% të fondeve, ndërsa NVM të regjistruara në Tiranë dhe në Durrës morën pjesën e mbetur 33%. Tre projekte për një vlerë totale 200,000 euro janë në proces të lëvrimit.

Që nga themelimi i Fondit Shqiptar të Garantimit, nën të njëjtin Program, në vitin 2011, 51 kompani kanë shprehur interesin e tyre në garancitë e lëshuara nga ky fond.

Bazuar në Marrëveshjen e Programit të PRODAPS, kompanitë duhet të paraqesin kërkesat e tyre për bankat partnere, të cilat bëjnë seleksionimin fillestar. Nga 51 aplikime, Bankat kanë dorëzuar tek bordi i Fondit të Garancisë shtatë (7) prej tyre. Në vitin 2015, Bordi i Fondit të Garancisë ka miratuar një aplikim, 3 janë refuzuar, ndërsa tre aplikime janë në një proces të vlerësimit nga ana e Bordit të Fondit të Garancisë.

Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE)

Banka Kombëtare Tregtare (BKT) vepron si ndërmjetës për zbatimin e EFSE në Shqipëri. BKT, në janar – shtator 2015, disbursoi 3,376,227 Euro. Që nga fillimi i zbatimit të këtij Fondi, bazuar në informacionin e dhënë nga BKT, në total 380 subjekte kanë përfituar nga ky

fond dhe janë disbursuar 29,512,877 Euro. Të dhënat për numrin e klientëve dhe pagesat janë paraqitur më poshtë.

Tabela 4: Informacion mbi zbatimin e Fondit Evropian për Evropën Juglindore në Shqipëri

Në Euro

Viti	Nr. i kredive (klientëve)	Shuma e kredisë së disbursuar	%
2010 (Tre mujori i 4)	9	436,794	1.48%
2011	98	6,973,398	23.63%
2012	101	6,505,898	22.04%
2013	95	6,711,107	22.74%
2014	53	5,509,453	18.67%
2015 (Janar – Shtator)	24	3,376,227	11.44%
TOTAL	**380**	**29,512,877**	**100.00%**

Burimi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit ,Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Projekti EDIF: Në kuadrin e projektit EDIF, në vitin 2014 u ngrit EDIF për Ballkanin Perëndimor, me qëllim që të shërbejë si mekanizëm gjithëpërfshirës që promovon NVM-të novatore me potencial rritjeje në rajon, të lehtësojë aksesin në financim dhe të nxisë mobilizimin e investimeve kapitale. Projekti ka katër komponentë:

- Fondi i Novacionit (ENIF) që fokusohet te NVM-të novatore në fazën fillestare të krijimit të tyre;
- Fondi i Zgjerimit (ENEF) që fokusohet në zgjerimin e kapitalit për NVM-të me potencial për rritje dhe zhvillim;
- Instrumenti i Garancisë (GF) në mbështetje të aksesit në kreditim bankar për NVM-të vendore me akses të kufizuar në financim;
- Asistencë Teknike për të mbështetur NVM-të novatore me potencial për rritje dhe për të promovuar krijimin e kapitalit investues (kapitalit të përbashkët).

Në kuader të zbatimit të projektit EDIF, është hartuar draft VKM për miratimin në parim nga qeveria te dy marrveshjeve: Marreveshja e partneritetit me përgjegjësi të kufizuar si dhe Marrëveshja per kontributin e qeverise ne Fondin ENIF, ne vlere prej 400 Mije EUR, qe do te paguhet e ndare ne 10 vite, 2015-2024.

Në kuadër të komponentes se asistencës teknike të projektit WBEDIF, me suportin e OECD po zbatohet projekti 2 vjeçar, 2014-2015 “Triple helix “ një instrument i rëndësishëm në forcimin e parteneritetit trepalësh “qeveri-akademia-sektori privat” në fushën e nxitjes së inovacionit dhe konkurueshmërisë.Ky projekt është duke u implementuar dhe deri më tani, është paraqitur nga OECD një dokument mbi "Korniza e Politikave për Inovacionin" dhe konkursi 'Triple Helix'.

2.2.3 Integrimi ekonomik me BE-në

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë dominohen gjerësisht me tregtinë me vendet BE28. Gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2015, eksportet e mallrave në vendet BE28 shkuan në 1067.3

milionë euro, ose 71.8% të totalit të eksporteve, me një rënie prej 11.1% në krahasim me një vit më parë. Importet e mallrave nga vendet BE28 shkuan në 2194.1 milionë euro, ose 62.5% të totalit të importeve, me një rritje vjetore prej 3.7%.

Italia ishte destinacioni kryesor për eksportet shqiptare (48.9% të totalit të eksporteve). Gjithashtu, përsa i përket tregtisë me vendet BE28, eksportet janë rritur në terma vjetorë me Austrinë (133.23%), Greqinë (3.9%), Gjermaninë (24.3%). Eksportet në Spanjë, Itali dhe Maltë kanë rënë në terma vjetorë. Gjatë 7 muajve të parë të vitit 2015, importet nga vendet BE28 kanë origjinë kryesisht nga Italia (30.9%), Greqia (8.4%), Gjermania (6.5%) dhe Franca (1.9%).

Që me futjen në CEFTA, aktiviteti tregtar i Shqipërisë me vendet anëtare është intensifikuar nga rreth 3% e totalit para vitit 2007, në 8.7% në vitin 2013.

Kategoria "Minerale, naftë dhe energji elektrike" përbën 40.35% të totalit të eksporteve, me rritje rreth 12.9% krahasuar me vitin pararendës. *"Tekstilet dhe veshjet për këmbën"* mbetennjë kategori e rëndësishme që zë 28.15% të totalit të eksporteve, me rritje rreth 3.4% kundrejt vitit pararendës. "*Materialet e ndërtimit dhe metalet"* përbëjnë rreth 14.7% të totalit të eksporteve, me rënie rreth 22.2%, dhe *Artikujt ushqimorë, pijet dhe duhani* që përbëjnë 5.9% të totalit të eksporteve, kanë pësuar një rënie të lehtë me 1% krahasuar me vitin 2012.

Eksportet e mallrave drejt BE-28 vendeve arritën vlerën 188.716 milion Lek, ose 76.6% të totalit të eksporteve, me rritje prej 17.3% në krahasim me vitin pararendës. Importet e mallrave nga BE-28 vendet arritën vlerën prej 330.753 milion Lek, ose 64.2% të totalit të importeve, me rënie prej 1.0 krahasuar me vitin pararendës. Sipas Bankës Botërore, eksportet e Shqipërisë drejt BE-së llogariten të jenë 40% nën potencial. Importet prej BE-së vlerësohet të jenë 33% nën potencial.

Gjatë 3 muajve të parë të 2014, eksportet kanë pasur destinacion kryesisht Italinë (50.14% e totalit të eksporteve). Vihet re rritje e konsiderueshme e eksporteve drejt Rusisë (rritje me 206 herë), Ukrainës (400%), Kroacisë (140%), Kosovës (rreth 54%) dhe Spanjës (45.67%).

Eksportet drejt Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar kanë pësuar rënie përkatësisht me 84.66% dhe 50%.

Gjatë 3 muajve të parë të 2014, importet kanë origjinar kryesisht nga Italia (28.63%), ndjekur nga Greqia (10.79%), Turqia (7.08%) dhe Gjermania (5.76%).

Eksportet e mallrave drejt vendeve CEFTA kapën vlerën 26.113 milion Lek ose 10.7% të totalit të eksporteve, me rritje 4.6%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës.

Importet e mallrave prej vendeve CEFTA arritën vlerën 31.674 milion Lek, ose 6.8% të totalit të importeve, me rënie 16.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit pararendës.

PJESA 3 - Aftësia për të marrë përsipër detyrimet që burojnë nga anëtarësimi

KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

- Direktiva e Këshillit 93/109/KE e datës 6 dhjetor 1993 që përcakton modalitete të hollësishme për ushtrimin e të drejtës për të votuar si dhe për t'u zgjedhur në Parlamentin Evropian për qytetarët e BE-së që banojnë në një Shtet Anëtar pa qenë shtetas të këtij shteti;
- Vendimi 95/553/KE i Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare në mbledhjen e Këshillit të datës 10 dhjetor 1995 në lidhje me mbrojtjen e qytetarëve të Bashkimit Evropian nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;
- Vendimi 96/409/*CSFP* Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare në mbledhjen e Këshillit të datës 25 qershor 1996 për krijimin e një dokumenti udhëtimi emergjent.

Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian ka rëndësi madhore.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore normative

Akti ligjor kryesor që rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë është Ligji Nr. 108/2013, datë 28.03.2013 "Për të huajt". Ky ligj përafron legjislacionin shqiptar me disa akte ligjore të BE-së në fushën e imigrimit. Në zbatim të Ligjit "Për të huajt", janë miratuar 18 VKM që përcaktojnë rregulla për lëshimin, refuzimin apo anulimin e lejeve të punës.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje me vende të treta për mbrojtjen shoqërore, si p.sh. me Turqinë.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional që rregullon lirinë e lëvizjes së punëtorëve përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (institucion kryesor);
- Këshilli i Ministrave;
- Ministria e Shëndetësisë (ISSh);
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Integrimit Evropian;
- Avokati i Popullit;
- INSTAT.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2016	2017	2018
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	3,030,000	2,504,000	0
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	0	0	0
Buxheti total i Kapitullit	3,030,000	2,504,000	0

III. Prioritetet

Një nga prioritetet kryesore të Shqipërisë në këtë fushë është vijimi i negociatave për të lidhur marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, sidomos me Shtetet Anëtare të BE-së. Kuadri ligjor në fushën e sigurimeve shoqërore, për sa i përket lëvizjes së lirë të personave, konsiston në marrëveshje dypalëshe që bashkërendojnë sistemet e sigurimeve shoqërore të vendeve nënshkruese.

Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Belgjikës është nënshkruar në Bruksel nga ministrat e të dy vendeve, në 9.12.2013 dhe është ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë, me ligjin Nr.35/2014, datë 3.4.2014. Në Tiranë, në 24 Shtator 2015, u nënshkrua Rregullorja Administrative, në zbatim të marrëveshjes bazë.

Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore me Luksemburgun, pas nënshkrimit në 27 Tetor 2014, nga ministrat e dy vendeve, është ratifikuar me ligjin nr. 42/2015, date 16.04.2015. Do të vazhdojnë bisedimet në nivele teknike ne Luksemburg, ne muajin Tetor 2015, për të diskutuar e miratuar formularët zbatues te marrëveshjes.

Marrëveshjet e mbrojtjes shoqërore me Hungarinë dhe Rumaninë janë miratuar në Këshillin e Ministrave, janë nënshkruar përkatësisht në Tiranë, datë 10.12.2014 dhe në Bukuresht, në datë27.02.2015. Po bashkëpunohet me MPJ për të vazhduar me procedurën e ratifikimit në Kuvendin e Shqipërisë.

Negociatat për marrëveshjen e mbrojtjes shoqërore me Kanadanë, janë finalizuar me negociatat e zhvilluara në Tirane , në datat 1 – 4 dhjetor 2014, ku u diskutua dhe u miratua edhe marrëveshja administrative. Marreveshja eshte miratuar me VKM nr. 336, date 22.04.2015. Pritet nenshkrimi i saj deri ne fund te vitit 2015.

Negociatat me Maqedoninë janë finalizuar për marrëveshjen baze, në Tirane me 14 nëntor 2014. Eshtë miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr. 228, date 11.03.2015 dhe është nënshkruar, në Shkup, në muajin Mars 2015. Më tej do vazhdohet me negociatat për miratimin e marrëveshjes administrative .

Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore me Çekinë është parafimuar në Maj 2015 së bashku me rregulloren administrative, është miratuar në Këshillin e Ministrave, me VKM nr. 728, date 02.09.2015 dhe do të nënshkruhet nga palët në date 13 Tetor 2015, në Pragë.

Ne muajin janar 2015 filluan negociatat për marrëveshje dypalëshe te mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Gjermanisë, te cilat u mbajtën ne Tirane. ne negociatat e zhvilluara ne Berlin, ne Prill 2015, u diskutuan dhe u miratuan nga delegacionet e te dy vendeve tekstet e marreveshjes se mbrojtjes shoqerore dhe shtojces administrative ne zbatim te saj. Marreveshja eshte miratuar me VKM nr. 727, date 02.09.2015 dhe eshte nenshkruar nga minsitrta pergjegjes te mbrojtjes shoqerore te dy vendeve , ne Tirane , me 23.09.2015.

Gjithashtu, ne kuadrin e zgjerimit te procesit te koordinimit te skemave te mbrojtjes shoqërore , ne Janar te këtij viti , u zhvilluan ne Vjenë, bisedimet e para për marrëveshje dypalëshe ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Austrisë. Ne negociatat e zhvilluara ne Shkurt dhe ne Qershor te ketij viti, u diskutua dhe u miratua nga delegacionet respektive teksrti i marreveshjes per mbrotjen shoqerore. Ne nentor 2015, eshte rene dakort te zhvillohet ne Viene, raundi i rradhes per diskutimin e draft marreveshjes administrative.

Me Italinë ka filluar bashkëpunimi ne nivelin teknik për te analizuar dhe vlerësuar sistemet e sigurimeve shoqërore ne dy vendet respektive, për te vazhduar me pas me negociatat për marrëveshje dypalëshe.

MMSR ka shprehur interesin dhe po punon për të shtuar numrin e marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe misionet diplomatike, kryesisht në Itali dhe Greqi, ku jetojnë një numër i lartë emigrantësh shqiptarë.

Ka filluar bashkepunimi me qeverine e Kosoves per te patur nje marreveshje te mbrojtjes shoqerore ndermjet dy vendeve ne mbrojtje te shtetasve te dy vendeve me elemente te sigurimeve shoqerore e shendetsore. Jane shkembyer informacionet ne lidhje me funksionimin e skemave te mbrojtjes shoqerore ne te dy vendet, per te vazhduar me negociatat per diskutimin e draft marerveshjes baze.

Ka filluar bashkëpunimi edhe me Qeverinë spanjolle, Kroacinë, Danimarkën, Francën, te cilat kane shprehur interesin për të nisur negociatat për marrëveshje dypalëshe, propozim ky që është pritur pozitivisht nga Qeveria shqiptare dhe konkretisht kane filluar shkëmbimet e informacioneve te ndërsjellta për sistemet e mbrojtjes shoqërore. Shqipëria është e interesuar që të nisë bashkëpunimin edhe me Bullgarinë pasi janë vërejtur mjaft probleme te cilat do te gjejnë zgjidhje me hartimin e një marrëveshje te re te mbrojtjes shoqërore ndërmjet dy vendeve. Shqipëria po punon që të lidhë marrëveshje edhe me të tjera Shtete Anëtare të BE-së dhe vende evropiane jashtë BE-së, siç është Zvicra.

Janë bërë përparime të rëndësishme në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve, sidomos në lidhje me aksesin e qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës.

Në fushën e integrimit të të huajve në shoqërinë shqiptare, do të ketë ndryshime mjaft pozitive në të ardhmen duke qenë se Ligji "Për të huajt" Nr. 108/2013 parashikon hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Integrimit Social të të huajve nga Ministritë përgjegjëse.

Institucionet publike kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë, sipas kompetencave, me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin dhe zbatimin e programeve të integrimit të të huajve në shoqëri.

Shqipëria do të vazhdojë përpjekjet për të përafruar më tej legjislacionin me *acquis* dhe ta zbatojë plotësisht. Nismat që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe të bashkërendimit ndërinstitucional do të zbatohen më mënyrë konsistente.

IV. Plani i masave për periudhën 2016 – 2018

IV.1 Aksesi në tregun e punës

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 –2020	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2014 – 2020

Inventari i masave ligjore ekzistuese

***Acquis* e BE-së**	**Legjislacioni shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Shkalla e përafrimi**	**Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)**
Direktiva 2009/50/KE	Ligji nr. 108/2013 "Për të huajt"	Ministria e Punëve të Brendshme	E papërafruar	28.03.2013	20.4.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

***Acquis* e BE-së**	**Statusi i**	**Legjislacioni shqiptar**	**Statusi i**	**Institucioni**	**Shkalla e**	**Data e**	**Hyrja në fuqi**

	përkthimit në shqip (po/jo)	**(ligjet dhe aktet nënligjore)**	**përkthimit në anglisht (po/jo)**	**përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**synuar e përafrimit (e plotë/ e pjesshme)**	**planifikuar për miratim**	
AFAT SHKURTËR (2016)							
s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka
AFAT MESËM (2017– 2018)							
Traktatet e Bashkimit Evropian Karta e të Drejtave Themelore Programet e Këshillit të Evropës Strategjia- Evropa 2020	Jo	Projekt-VKM-Programi Kombëtar I Integrimit Social të të Huajve	Jo	MMSR MASH MZHETTS	E Plote	2017	2017 – 18

IV.2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

IV.2.1 Legjislacioni

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
s'ka	s'ka	s'ka

Inventari i masave ligjore ekzistuese

***Acquis* e BE-së**	**Legjislacioni shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Shkalla e përafrimit**	**Data e miratimit (Legjislacioni shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacion**

					shqiptar)
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	Miratimi i Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut.	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	VKM nr. 530, datë 6.8.2014,	2016
Rregullorja (KE) nr. 987/2009 Rregullorja (KE) nr. 883/2004	Ratifikimi i Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Belgjikës	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	Ligji nr. 35/2014, datë 3.4.2014.	2016
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	Miratimi i Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	VKM nr. 626, datë 24.9.2014	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	Miratimi i Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë.	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	VKM nr. 531, datë 6.8.2014	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	Miratimi iMarrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Cekisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	VKm nr. 728, date 02.09.2015	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	Miratimi i Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	VKM nr. 228, date 11.03.2015	2017
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	Miratimi i Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë.	Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E pjesshme	VKM nr. 336, date 22.04.2015	2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

***Acquis* e BE-së**	**Statusi i**	**Legjislacioni shqiptar (ligjet**	**Statusi i**	**Institucioni**	**Shkalla e synuar**	**Data e**	**Hyrja në fuqi**

	përkthimit në shqip (po/jo)	**dhe aktet nënligjore)**	**përkthimi t në anglisht (po/jo)**	**përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**e përafrimit (e plotë/ e pjesshme)**	**planifikuar për miratim**	
AFAT SHKURTËR (2016)							
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	po	Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dheKosovës"	po	MMSR	E pjesshme	3 mujori i IV 2016	2018
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	po	Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë"	po	MMSR	E pjesshme	3 mujori i IV 2016	2018
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	po	Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Zvicrës"	po	MMSR	E pjesshme	3 mujori i IV 2016	2018
AFAT MESËM (2017– 2018)							
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr. 987/2009	po	Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Francës"	po	MMSR	E pjesshme	3 mujori i III 2017	2018
Rregullorja (KE) nr. 883/2004 Rregullorja (KE) nr.	po	Përgatitja deri në miratim e projektvendimit "Për miratimin e Marrëveshjes së	po	MMSR	E pjesshme	3 mujori i IV 2017	2018

987/2009		mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA“					

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela Fondeve të Planifikuara në Buxhetin e Shtetit

Kapitulli: 2 Aksesi në tregun e punës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Projekt-VKM-Programi Kombëtar I Integrimit Social të të Huajve	A) Paga –stafi ekzistues		24.000		24.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total		**24.000**		**24.000**
Kapitulli: 2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit “Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës“	A) Paga –stafi ekzistues	40.000			40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	900.000			900.000
	Aktiviteti total	**940.000**			**940.000**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit “Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore	A) Paga –stafi ekzistues	40.000			40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				

ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë“	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	900.000			900.000
	Aktiviteti total	**940.000**			**940.000**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit “Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Zvicrës“	A) Paga –stafi ekzistues	50.000			50.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	1.100.000			1.100.000
	Aktiviteti total	**1.150.000**			**1.150.000**
Kapitulli: 2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit “Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe .....“	A) Paga –stafi ekzistues		40.000		40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		1.200.000		1.200.000
	Aktiviteti total		**1.240.000**		**1.240.000**
Përgatitja deri në miratim e projektvendimit “Për miratimin e Marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe .....“	A) Paga –stafi ekzistues		40.000		40.000
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		1.200.000		1.200.000
	Aktiviteti total		**1.240.000**		**1.240.000**
Kapitulli total					**5,534,000**

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

Legjislacioni i BE-së për të drejtën e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime është i një natyre horizontale, i cili mbulon një larmi të madhe të fushave dhe profesioneve si edhe përfshirjen e shumë institucioneve dhe organeve publike. Legjislacioni kombëtar në përputhje me legjislacionin evropian, nuk duhet të cenojë të drejtat e përcaktuara të neneve 49 dhe 56 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, me përjashtim të atyre të përcaktuara në Traktat. Pjesa kryesore e *acquis* në këtë fushë është Direktiva 2006/123 (KE) datë 12.12.2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve)" e amenduar, e cila përbën masën më të madhe, dhe është e bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës të Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në fushën e shërbimeve postare, është Direktiva 97/67/KE datë 15.12.1997 "Mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit" e amenduar, dhe përcakton parimet për të siguruar ofrimin e një shërbimi universal postar, krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe të shërbimit postar me cilësi të lartë për përdoruesit fundorë.

Në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, është Direktiva 2005/36/KE datë 7.09.205 "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale" e amenduar, që përcakton rregullat në lidhje me njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të tjera midis vendeve anëtare. Direktiva gjithashtu lehtëson masat dhe shërbimet e rastit të profesionistëve për disa profesione të tjera të rregulluara

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve, Shqipëria garanton të drejtën e vendosjes për kompanitë e themeluara në BE duke u ofruar atyre trajtim të njëjtë si kompanive shqiptare. Në këtë drejtim, është hartuar projektligji "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë". Ky projektligj ka transpozuar pjesërisht Direktivën 2006/123/KEE "Për shërbimet në tregun e brendshëm". Ky draft është në fazën e konsultimeve teknike me grupin e punës.

Në fushën e shërbimeve postare legjislacioni përafrohet pjesërisht me Direktivën 97/67/KE.

Në fushën e *njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale*, Ministria e Arsimit dhe Sporteve është duke punuar për të zbatuar detyrimet e Direktivës 2013/55/KE, e cila ndryshon me Direktivën 2005/36/KE "Për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale". Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 952 datë 12.12.2012 "Për përjashtimin nga përgjegjësia profesionale për provimin shtetëror në profesionet", përcakton përjashtimin nga përgjegjësia për provimin e shtetit profesional, i cili ka fituar të drejtën për të ushtruar ndonjë nga profesionet e rregulluara në vendet si të BE-së, EFTA shtetet, si: Zvicra, Lihtenshtejni, Norvegjia dhe vendet me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje dypalëshe, si me SHBA-në, Kanada-në dhe Japoni-në. Ndërkohë, është duke u punuar për ofrimin e programeve të studimit cilësor sipas eksperiencave më të mira evropiane duke mundësuar njohjen e diplomave të arsimit të lartë të përfituara në Shqipëri në vendet e BE-së, si dhe njohjen e kualifikimeve në BE për të mundësuar punësimin e specialistëve shqiptarë në vendet e BE-së.

I.3 Struktura e kapitullit

1. E DREJTA E THEMELIMIT
2. LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËR KUFITARE
3. SHËRBIMI POSTAR
4. NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMET PROFESIONALE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE

Nenet e MSA-së me rëndësi për këtë kapitull janë nenet : 50, 57, 58, 70, 100.

Acquis të BE-së në këtë kapitull përfshijnë, *ndër të tjera*:

- Direktiva 2006/123/KE datë 12.12.2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për shërbimet në tregun e brendshëm";
- Vendimi i Komisionit 2009/767/KE i 16 tetor 2009 që "Përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me mjete elektronike përmes pikave të kontaktit të vetëm nën Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm";
- Vendimi i Komisionit 2010/425/BE të 28.07.2010 i cili ndryshon "Vendimin 2009/767/KE datë 16.12.2009 përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me anë të mjeteve elektronike përmes 'pikave të kontaktit të vetëm sipas Direktivës 2006/123/KE të

Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm, në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe publikimin e listave të besuara të ofruesve të shërbimeve të certifikimit të mbikëqyrur/akredituar nga Shtetet Anëtare";

- Direktiva 2013/55 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 nëntor 2013 që ndryshon Direktivën 2005/36/KE "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Rregulloren Nr. 1024/2012 mbi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm ("Rregullorja IMI") Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor1996 "Mbi zhvendosjen e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve";
- Direktiva 2014/67 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi zbatimin e Direktivën 96/71 / KE në lidhje me postimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe që ndryshon Rregulloren Nr. 1024/2012 mbi bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit të Tregut të Brendshëm Informacionit ("Rregullorja IMI");
- Direktiva 98/5/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shkurt 1998 "Për lehtësimin e praktikës së profesionit të avokatit në mënyrë të përhershme në një Shtet Anëtar tjetër nga ai në të cilin është marrë kualifikimi";
- Direktiva e Këshillit 77/249/KEE e 22 mars 1977 "Për të lehtësuar ushtrimin efektiv nga avokatët lidhur me lirinë për të ofruar shërbime";
- Direktiva e Këshillit 86/653/KEE e 18 dhjetor 1986 "Mbi koordinimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me agjentët e vetëpunësuar të nivelit të dytë";
- Direktiva 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 dhjetor 1997 "Mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit";
- Direktiva e Këshillit 63/474/KEE e 30 korrik 1963 "Për liberalizimin e transfertave në lidhje me transaksionet e padukshme që nuk janë të lidhura me lëvizjen e mallrave, shërbimeve, kapitalit ose personave".

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore legjislative

1&2 E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËRKUFITARE

Nënkapitujt 1 dhe 2 së bashku, për shkak të lehtësisë për t'u kuptuar, në veçanti në lidhje me shfaqjen e legjislacionit sektorial, që do të mbulojë monitorimin për të dy sektorët (1) të drejtën e vendosjes dhe (2) lirinë për të ofruar shërbime.

Shqipëria nuk ka pjesë horizontale të legjislacionit për të adresuar tërësisht lirinë e lëvizjes së shërbimeve. Progres është bërë në drejtim të krijimit të një kuadri institucional për këtë pjesë të *acquis*. Është ngritur një grup pune ndërministror me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 39 të 2013/04/02 "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e kuadrit institucional për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së në fushën

e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve”.Është hartuar një udhëzues për përshtatjen e legjislacionit të shërbimeve ndërkufitare me Direktivën e Shërbimeve. Për më tepër, VKM-ja Nr. 264 të 2013/04/03 "Për organizimin e punës për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve", i cili ka krijuar një metodologji për rishikimin e legjislacionit sektorial në fushën e të drejtës së themelimit dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve. Në këtë kuadër, është hartuar raporti për rishikimin e legjislacionit në sektorin minerar, shërbimet juridike, klinikat veterinare, shërbimet sociale dhe taksat.

3. SHËRBIMI POSTAR

Në zbatim të angazhimeve të marra të MSA-së dhe të programit qeveritar për shërbimet postare, me fokus në përafrimin e legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Evropian në këtë fushë, është përshtatur kuadri ligjor në fushën e shërbimeve postare. Dokumenti strategjik: Politika e Zhvillimit në Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë, e miratuar me vendimin Nr. 625, datë 24/07/2013, përcakton liberalizimin e mëtejshëm të tregut të shërbimeve postare nëpërmjet reduktimit të menjëhershëm të zonës së rezervuar nga 100 gram në 50 gram dhe heqjen e zonës së plotë të rezervuar në vitin 2014. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 711, datë 21/08/2013, zona e rezervuar është reduktuar nga 100 gram në 50 gram. Me Vendimin Nr. 11, datë 20/02/2014 Parlamenti miratoi një strukturë të re të AKEP-it, e cila është miratuar nga Parlamenti me datë 20.02.2014 dhe strukturat që përfshijnë rregullimin e sektorit postar.

4. NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Më datë 17.7.2014 u miratua me Ligjin Nr. 90/2014 “Për një shtesë në ligjin Nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i cili i shton listës aktuale me 10-të profesionet të rregulluara edhe 2 profesione të tjera, atë të punonjësit social dhe psikologut.Tashmë edhe aplikantët për ushtrimin e këtyre profesioneve ju nënshtrohen provimeve të shtetit pranë AKP-së.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është institucioni kryesor që drejton. Për ta përafruar legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së mbi të drejtën e vendosjes dhe të lëvizjes së lirë të shërbimeve, është ngritur një grup pune ndërinstitucional sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 39 datë 2013/02/04.

Ajo është e përbërë nga përfaqësues të këtyre institucioneve:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
3. Ministria e Integrimit Evropian
4. Ministria e Arsimit dhe e Sporteve;
5. Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike;
6. Ministria e Drejtësisë;
7. Ministria e Financave;
8. Ministria e Mbrojtjes;
9. Ministria e Brendshme;
10. Ministria e Shëndetësisë;
11. Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës;
12. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
13. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
14. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
15. Ministria e Mjedisit;
16. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
17. Autoriteti i Medias Audio-vizuale ;
18. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
19. Banka e Shqipërisë;
20. Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
21. Qendra Kombëtare e Licencimit;
22. Enti Rregullator i Energjisë;
23. Agjencia e Prokurimit Publik;
24. Njësia Monitorimi të Lojërave të Fatit;
25. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
26. Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
27. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Organizimi institucional në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve përfshin shumë institucione dhe ka tri fusha kryesore: (i) ekipet sektoriale në terren, (ii) ekipi bazë që vërteton çdo raport të sektorit, (iii) grupi ndër-ministror i punës

II.4 Ndarja buxhetore

Viti	2016	2017	2018
Buxheti total per kete kapitull I Institucionit lider	**14 960 000**	**0**	**0**
Buxheti total per kete kapitull I institucioneve te tjera	247 000	**0**	**0**
Buxheti total I Kapitullit	**15 207 000**	**0**	**0**

III. Prioritetet

Prioritetet kryesore të kapitullit përfshijnë:

- Miratimi i ligjit "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë" për të përafruar pjesërisht Direktivën 2006/123/KE dhe rishikimin e legjislacionit ekzistues sektorial;
- Ekzaminimi i legjislacionit sektorial në përputhje me *acquis* të BE në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime;
- Forcimi i kapaciteteve administrative për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave themelore në këtë fushë;
- Përshtatja dhe implementimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas përcaktimeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe direktivave të BE dhe përgatitja e kornizës sektoriale.
- Ofrimi i programeve të studimit cilësore sipas eksperiencave më të mira evropiane duke mundësuar njohjen e diplomave të arsimit të lartë të përfituara në Shqipëri në vendet e BE, si dhe njohjen e kualifikimeve në BE për të mundësuar punësimin e specialistëve shqiptarë në vendet e BE-së.

IV. Plani i veprimit për periudhën 2016 – 2018

IV.1E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
Strategjia e Zhvillimit të Investimeve dhe Biznesit 2014-2020	MZHETTS	2014 – 2020
Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së	MZHETTS	2014 – 2020

Inventari i masave ekzistuese ligjore

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e-përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2006/123/KE	Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara, I ndryshuar nga Ligji Nr. 90 / 2014"Për një shtesë në ligjin nr 10,171 datë 22.10.2009," Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë"	MAS	I pjesshëm	22.10.2009 17.7.2014	22.10.2009 17.7.2014
	Ligji Nr. 10081 datë 23.02.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet	MZHETTS	I pjesshëm	23.02.2009	23.02.2009
	Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit	MZHETTS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007

Kuadri i politikave të planifikuara në periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi

Masat ligjore e planifikuara në 2016– 2018

Acquis të BE	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në shqip	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (e plotë / përafrim i pjesshëm)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
Direktiva 2006/123/KE	PO	Ligji "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë"	JO	MZHETTS	I pjesshëm	Tremunori i I 2016	Tremujori i II 2016
		VKM "Për metodologjinë e		MZHETTS		Tremujori III	Tremujori i IV

		shqyrtimit të përputhshmërisë së kritereve të legjislacionit sektorial ekzistues”				2016	2016
		VKM “Për njoftimin dhe format e vlerësimit të përputhshëmrisë së legjislacionit të ri sektorial”		MZHETTS		Tremujori III 2016	Tremujori i IV 2016
AFAT MESME (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.2 Shërbimi postar

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha
Politika e Zhvillimit në Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë	MIAP	2013 – 2017

Korniza ligjore ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Niveli i përafrimit (i plotë/pjesor/ jo i përafruar)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 97/67/KE	Ligji Nr. 8530, datë 23.09.1999 "Në shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë"	MIAP	I pjesshëm	23.9.1999	5.10.1999
Direktiva 2008/6/KE	Ligji Nr 46/2015 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë	MIAP	I pjesshëm	7.05.2015	10.6.2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore për periudhën 2014 – 2016

Acquis të BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi

AFATSHKURTËR (2016)							
Direktiva 2008/6/KE	N n/a	VKM për rregullat e krijimit dhe administrimit të fondit të shërbimit universal	N	MIAP	I plotë	Tremujori I 2016	Tremujori I 2016
AFATMESME (2017 – 2018)							
N/A	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.3 Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	MAS	2009 – 2013

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2005/36/KE	Ligji Nr. 10171 datë 22.10.2009 " Për rregullimin e profesioneve, i ndryshuar".	MAS/ Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	22.10.2009	22.11.2009
Direktiva 2013/55/BE	Vendimi Nr. 952, datë 12.12.2012 "Për përjashtimin nga përgjegjësia profesionale për provimin e shtetit për profesionet".	MAS / Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	12.12.2012	12.12.2012

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli (strategji, AP, dokument)	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia e Zhvillimit	MAS	2015-2020	Tremujori I 2016	Tremujori i II 2016

të Arsimit Parauniversitar 2015-2020 dhe Plani i Veprimit				

Masat ligjore të planifikuara në 2015 – 2017

Acquis të BE	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Legjislacioni shqiptar	Statusi përkthimit në anglisht (y/n)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT MESME (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitull 3 : E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME					
Përfituesi: MIAP					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
VKM për rregullat e krijimit dhe administrimit të fondit të shërbimit universa	A) Pagat – stafi ekzistues	247,000	0	0	247,000
	B) Pagat – stafi I ri	0	0	0	0
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	0	0	0	0
	Totali për aktivitet				**247,000**

Buxheti total i përfituesit	**247,000**

Kapitull 3 : E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME					
Përfituesi: MZHETTS					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga donatorë**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
VKM "Për metodologjinë e shqyrtimit të përputhshmërisë së kritereve të legjislacionit sektorial ekzistues"	A) Pagat – stafi ekzistues	480,000	0	0	480,000
	B) Pagat – stafi I ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0			
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0			
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	0	0	0	0
	Totali për aktivitet				480,000
VKM "Për njoftimin dhe format e vlerësimit të për puthshëmrisë së legjislacionit të ri sektorial"	A) Pagat – stafi ekzistues	480,000	0	0	480,000
	B) Pagat – stafi I ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0			
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0			
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	0	0	0	0
	Totali për aktivitet				480,000
Buxheti total i përfituesit					**960,000**
Totali i kapitullit					**1,207,000**

Tabela B – Fondet e asistencës së huaj

Kapitulli:	

1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli I Programit/donatori**	**Shuma në €**	**Aktivitetet**
MZHETTS	Projekti GIZ: Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis të BE	Ministria Federale Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik	Buxheti total i projektit: 100.000 €	Fokusi i projektit është: a) Legjislacioni dhe interpretimi i acquis të BE - Rishikimi i legjislacionit sektorial per ne perputhje me Direktiven e Sherbimeve - Hartimi i VKM në përputhje ligji nper sherbimet
		Totali :	**100'000 €**	

KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet Anëtare pritet të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit dhe pagesave, si brenda BE-së, ashtu edhe mes Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. *Acquis* përfshin gjithashtu, edhe rregullat për pagesat ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon që bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë të identifikojnë klientët dhe të raportojnë disa transaksione, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë dhe për transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Një kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative dhe zbatuese, përfshi edhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) përcakton kalendarin për liberalizimin e kapitalit. Gjithashtu, parashikon lirinë dhe konvertueshmërinë e pagesave të llogarive korrente dhe të transfertave.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e lëvizjeve të kapitalit, Shqipëria ka bërë progres sa i përket, liberalizimit të transfertave dhe transaksioneve të llogarive korrente dhe kapitale, dhe transfertave unilaterale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve. Parashikohen flukse hyrëse dhe dalëse për kapitalin pa kufizime. Gjithashtu, ajo shfuqizoi të drejtat ekskluzive të Bankës së Shqipërisë për kontrollin e flukseve dalëse të kapitalit.

Aktet kryesore ligjore që rregullojnë parandalimin e pastrimit të parave janë Ligji 9917, datë 19.05.2008 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i ndryshuar dhe rregulloret e tij zbatuese.

Blerja e pasurive të paluajtshme nga të huajt është objekt kufizimesh: të huajt nuk lejohen të blejnë tokë bujqësore, pyje, lëndina dhe kullota.

MSA parashikon përshtatjen progresive të legjislacionit në këtë fushë, me synimin që deri në 1 prill 2016 të garantohet që trajtimi i shtetasve të BE-së të jetë jo më pak i favorshëm sesa trajtimi që u akordohet shtetasve shqiptarë. Kjo kërkon rritje të kapaciteteve administrative. Gjithashtu, Shqipëria duhet të zgjidhë pasiguritë aktuale për të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.

I.3 Struktura e kapitullit

1. REGJIMI I LËVIZJEVE TË KAPITALIT DHE PAGESAVE AKTUALE
2. SISTEMI I PAGESAVE
3. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE.

Detyrimet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fushën e liberalizimit të lëvizjeve të kapitalit rrjedhin nga nenet 70 dhe nenet 60-62 të MSA-së. Në fushën e pastrimit të parave rrjedhin nga neni 4 dhe neni 82 i MSA-së.

Siç duket qartë nga këto dispozita, Shqipëria ka jo vetëm detyrimin të përafrojë teknikisht legjislacion e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, por edhe të sigurojë zbatimin e duhur të tij. Në këtë etapë të procesit para-anëtarësimit, autoritete të ndryshme shtetërore duhet të përfshihen në ushtrimin për anëtarësimin. Për më tepër, meqenëse ligji i BE-së është subjekt zhvillimi të vazhdueshëm, përafrimi i ligjeve nuk përfundon me përshtatjen e ligjit shqiptar ndaj *acquis* aktualisht në fuqi. Është i domosdoshëm monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në BE, si për përpjekjen para anëtarësimit ashtu edhe për përgatitjen e Shqipërisë për realitetin e përditshëm të anëtarësimit të ardhshëm në BE. Duket qartë se përafrimi me *acquis* të BE-së mbi lëvizjen e lirë të kapitalit nuk është një ndër fushat e prioriteteve në nenin 70 të MSA-së. Arsyetimi vetëkuptohet, pasi ligji i BE-së në këtë fushë do të zbatohet vetëm në lidhje me Shqipërinë nga data e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Duhet të vihet në dukje se MSA nuk parashikon ndonjë dispozitë të posaçme për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

Acquis e BE-së në fushën e lëvizjes së kapitalit përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Nenet 63-66 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU);
- Direktiva 88/361/KEE, datë 24 qershor 1988 për zbatimin e Nenit 63 të Traktatit;
- Direktiva 2007/64/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 Nëntor 2007, mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm;

- Direktiva 2009/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 6 maj 2009 që ndryshon Direktivën98/26/EC mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë dhe Direktivën2002/47/KE mbi marrëveshjet për kolateralin financiar;
- Direktiva 2009/110/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009 "Për sipërmarrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë së institucioneve te parasë elektronike",qëndryshon Direktivën 2005/60/KE dhe 2006/48/KE dhe shfuqizon Direktivën 2000/46/KE;
- Rregullorja (KE), Nr. 924/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009 mbi pagesat ndërkufitare në Komunitet dhe shfuqizim i Rregullores (KE), Nr. 2560/2001;
- Rregullorja (KE) nr. 1781/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 nëntor 2006 mbi informacionin për paguesin, që shoqëron transfertat e fondeve;
- Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (Direktiva kundër Pastrimit të Parave);
- Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (Direktiva kundër Pastrimit të Parave);
- Direktiva e Komisionit 2006/70/KE, datë 1 gusht 2006 e cila parashtron zbatimin e masave për Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me përkufizimin e 'personave të ekspozuar politikisht' dhe kriteret teknike për procedurat e thjeshtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit (customer due diligence) dhe për përjashtimin në rastin e një aktiviteti financiar të kryer në bazë rastësore ose shumë të kufizuar.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion në Shqipëri

Në përgjithësi, Shqipëria ka vepruar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në këtë fushë:

- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Mbi taksën ndaj të ardhurave" është përafruar pjesërisht me Nenin 65 tëTraktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU);
- Ligji Nr. 7764, datë 02.11.1993 "Mbi investimet e huaja" është përafruar pjesërisht me nenin 63 të TFEU.

Ligjet dhe rregulloret e mëposhtme janë përafruar pjesërisht me Direktivën 2007/64/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2007 "Mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm":

- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”;
- Ligji nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave” është përafruar pjesërisht me Direktivën 98/26/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 maj 1998 “Mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të titujve”; Direktivën 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 qershor 2002, mbi marrëveshjet për kolateralin financiar;dokumentittë Bankës për Rregullimet Ndërkombëtare(BIS) “Mbi Parimet Themelore për Sistemet e Pagesave me Rëndësi Sistemike” dhe Protokollin nr. 4 “Mbi Statutin Evropian të Bankave Qendrore”;
- Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar dhe rregulloret në zbatim të tij, janëë në përputhje me Direktivën 2005/60 EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare për qëllime të pastrimit te parave dhe financimit të terrorizmit;
- Vendimi nr. 70, datë 14.10.2009 i Këshillit Mbikëqyrës (KM) të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për veprimtarinë valutore” është përafruar pjesërisht me Direktivën 88/361/KEE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 qershor 1988 mbi zbatimin e nenit 67 të Traktatit.

II.3 Përmbledhje e Institucionet përgjegjëse

Institucioni përgjegjës kryesor është Banka e Shqipërisë. Ajo mbikëqyr pagesat ndërkombëtare që rrjedhin nga veprimet tregtare, transaksionet jotregtare dhe angazhimet e bankave të tjera shqiptare, që kanë lidhur kontrata me shtete, banka apo shoqëri të huaja.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të objektivit të saj primar dhe tregut të brendshëm bankar, promovon dhe mbështet zhvillimin në bazë tregu të sistemit valutor, tregut të brendshëm financiar, sistemit të pagesave, dhe nxitjes së kushteve të favorshme monetare dhe të kreditimit për zhvillimin e rregullt, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Në cilësinë e autoritetit monetar e mbikëqyrës të vendit, Banka e Shqipërisë ushtron funksionet e mëposhtme:

- Harton, miraton dhe zbaton politikën monetare të vendit, për realizimin e objektivave të së cilës ajo përdor instrumentet e duhura monetare;
- Ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të kartëmonedhës dhe të monedhës kombëtare;
- Mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë;
- Harton, miraton e zbaton regjimin e këmbimit valutor si dhe politikën e kursit të këmbimit;
- Licencon ose revokon licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe mbikëqyr aktivitetin bankar me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar;

- Shërben si bankier, këshilltar e agjent fiskal i Republikës së Shqipërisë;
- Shërben si bankë e bankave të nivelit të dytë;
- Nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave.

*Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)*është Njësia e Inteligjencës Financiare shqiptare e fuqizuar nga legjislacioni kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (AML / CFT) për të mbledhur, administruar dhe analizuar raportet e dorëzuara nga detyruesit për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

DPPPP shpërndan informacionin drejt autoriteteve shqiptare të zbatimit të ligjit nëse ka bazë për të dyshuar se veprat e pastrimit te parave apo financimit të terrorizmit kanë qenë ose janë duke u kryer. Ajo gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Njësitë e tjera të Inteligjencës Financiare nëpër botë.

Për më tepër, DPPPP ka edhe rol mbikëqyrës ku ajo kontrollon përputhshmërinë e detyruesit me kërkesat e ligjit për PP/FT dhe në këtë drejtim ajo bashkëpunon me të gjitha autoritetet mbikëqyrëse, veçanërisht me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

DPPPP lidhet në mënyrë aktive me zbatuesit e ligjit vendor, rregullatorët dhe homologët ndërkombëtarë, qe në mënyrë efektive të ndihmojë në zbulimin, vlerësimin dhe zhdukjen e të gjitha kërcënimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në ekonominë kombëtare. Numri total i punonjësve të DPPPP-së është 28.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave zbaton programin e Qeverisë në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Objektivat e saj kryesore renditen si më poshtë vijon:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë rritjen e qëndrueshme të bujqësisë dhe prodhimit;
- Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit në përputhje me kërkesat e BE-së;
- Garantimi i informacionit mbi bujqësinë;
- Administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore;

Numri total i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave është 116.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian në kuadër të Kapitullit 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit" kryesohet nga Banka e Shqipërisë dhe përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministria e Bujqësisë. Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

II.4 Sqarim në lidhje me parashikimet financiare

Kapitulli 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit"	2016	2017	2018
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	1,651,500		
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	-		
Buxheti total i Kapitullit	1,651,500		

III. Prioritetet

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian në Raport 2015 për Shqipërinë prioritetet në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit janë:

- zbatimi me efektivitet i legjislacionit kundër pastrimit të parave në të gjitha nivelet dhe forcimi i mëtejshëm i sistemit kombëtar të luftës kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT);
- zbatimi i plan veprimit për blerjen e pronës nga të huajt.

Sa i përket adresimit të prioritetit të Partneritetit Evropian, ku kërkohet liberalizimi i plotë i lëvizjes kapitale përmes rregullores "Për veprimtarinë valutore", miratuar me Vendimin nr. 70, datë 30.09.2009 të Këshillit Mbikëqyrës u liberalizuan plotësisht transaksionet dhe transfertat korente, transaksionet dhe transfertat kapitale dhe tranfertat e njëanshme si dhe gëzojnë trajtim të barabartë qytetarët e BE-së dhe Shqipërisë për sa i përket investimeve në portofol dhe kredive dhe huadhënies financiare me maturim më pak se një vit.

Shqipëria do të forcojë luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, përfshirë pastrimin e parave dhe falsifikimin e kartëmonedhave, dhe të arrijë rezultate të dukshme në luftën kundër pastrimit të parave, si brenda ashtu edhe jashtë sektorit financiar.

Në përputhje me rekomandimet e Task Forcës për Ndërhyrjen Financiare (FATF), DPPPP, ka siguruar përputhshmërinë e ligjit ekzistues për parandalimin e pastrimit të parave në linjë me *acquis* për aq sa kërkohet në kuadër të rekomandimevetë FATF-së. Më tej, me anë të trajnimeve të subjekteve ka rritur ndërgjegjësimin e subjekteve të ligjit për raportim, e cila konkretizohet me rritjen e numrit të raporteve të aktivitetit të

dyshimtë (RAD). Paralelisht, është investuar në përmirësimin e sistemit të teknologjisë dhe informacionit. Gjithashtu lidhur me rritjen e numrit te stafit është bërë kërkesë për rritjen e kapaciteteve njerëzore në DPPPP.

Në kuadër të zbatimit të objektivitmbi reduktimin e mëtejshëm të përdorimit të parasë fizike në ekonomi me anë të zhvillimeve të mëtejshme ligjore dhe operacionale, të përcaktuara në dokumentin strategjik për Hetimin e Krimit Financiar, përmes Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 25.06.2015, u krijua Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP).

Kapitulli paraqet një vështrim të situatës aktuale të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri, duke përfshirë njohjen me legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet përkatëse por dhe rezultatet konkrete të punës të dy institucioneve përgjegjëse. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuar direkt me çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucionesh të tjera, të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale dhe sigurimi i një niveli mbrojtje të tyre në Shqipëri, të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e marra përsipër nga Qeveria Shqiptare në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, neni 73 i saj. Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e Pronësisë Intelektuale me *acquis*, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

I.2 Situata aktuale në Shqipëri

Në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura, objektivi kryesor i politikave për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në Shqipëri ka qenë garantimi i mbrojtjes se këtyre të drejtave, si dhe zbatimi efikas i tyre. Organizimi dhe struktura aktuale institucionale dhe ligjore kërkon reforma të mëtejshme në mënyrë që të jenë në përputhje me praktikat më të mira të vendeve të BE.Ligji i ri për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e lidhura me to është miratuar nga Këshilli i Ministrave në 22 Shtator të vitit 2015 dhe pritet të kalojë në Komisionet parlamentare për diskutim Përpos pjesës së kuadrit ligjor mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura, ZSHDA vazhdon të luajë rolin e saj promotor për ndërgjegjësimin dhe informimin ekategorive të ndryshme të subjekteve/përdorues të produktit artistik dhe jo vetëm por dhe me të gjitha isntitucionet shtetërore të cilat janë pjesë e zbatimit të legjislacionit në fuqi. Në kuadër të bashkëpunimit, ZSHDA ka qënë përfituese e mjaft aktiviteteve nga Komisioni Evropian, ku në qendër ka qënë trajnimi i institucioneve zbatuese të cilat janë pjesë e procesit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për të drejtat e autorit në RSH. Ky bashkëpunim me institucionet kyce ka konsistuar dhe në nënshkrimin e Memorandumeve të Bashkëpunimit për një koordinim më efikas me këto institucione. ZSHDA i ka kushtuar vemëndje dhe trajnimit të stafit të ri të rekrutuar në vitin 2014. Trajnimet janë mbështetur nga KE dhe nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale në fushën e të drejtës së autorit, të cilat do të vijojnë dhe më tej.

Vëmendje të vecantë i kushtohet monitorimit të tregut të PI ndërgjegjësimit të subjekteve për detyrimet që u burojnë nga Ligji në fuqi, si dhe aplikimit të masës ndëshkuese (gjobë) ndaj subjekteve cenues te LDA. Rritja e kapaciteteve administrative te ZSHDA sjell si rezultat dhe nje mbulim (inspektim) më të gjerë të të gjithë kategorive të subjekteve përdorues të pronësisë artistike nga inspektorët e kesaj zyre duke përfshirë dhe qytete të ndryshme të Shqipërisë.
Sa i takon sistemit të menaxhimit kolektiv, si një nga çështjet më të ndjeshme, nënvizojmë se në RSH funksionojnë që nga Prill 2015 katër (4) agjenci të menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhur, një agjenci për çdo degë të caktuar arti.
Në kuadër të rritjes së informimit dhe ndërgjegjësimit mbi çështjet e të drejtës së autorit, të shoqërisë shqiptare, ZSHDA ka ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi me nxënësit dhe studentët, duke e filluar këtë proces që nga bankat e shkollës, si një mënyrë efikase për ndërgjegjësimin dhe edukimin e shoqërisë shqiptare. ZSHDA ka filluar dhënien e leksioneve të hapura në auditorët e Universiteteve, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit janë bërë përpjekjet maksimale për futjen në kurikulën mësimore të modulit "Pronësia Intelektuale".

Në progres raportin e BE të vitit 2015 për të drejtën e autorit ndër të tjera thuhet:

- ZSHDA ka kryer inspektime dhe ka monitoruar përdoruesit e PI, si dhe ka lëshuar certifikata për të drejtat e autorit dhe transferimin e të drejtave ekonomnike dhe kontrata të regjistruara.
- Bashkëpunimi me autoritet lokale, policinë dhe disa Universitete është përmirësuar

Në fushën e Pronësisë Intelketuale, Shqipëria ka të përafruar plotësisht legjislacionin në fushën e Pronësisë Industriale me *acquis* e BE-së. Baza ligjore u plotësua me hyrjen në fuqi të Ligjit 55/2014 dhe Ligjit 66/2014 të cilat përafrojnë plotësisht legjislacionin në fushën e Pronësisë Industriale, me direktivat e BE.

Shqipëria është palë në shumë marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtare e Organizatës Europiane të Patentave dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

Dokumenti kryesor politik në fushën e Pronësisë Intelektuale është Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale (2010-2015). DPPM karealizuar objektivat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të PI, duke përmbushur të gjitha detyrimet në lidhje me zbatimin e saj.

DPPM, në rolin e Sekretariatit Teknik ka bashkëpunuar me institucionet e përfshira në strategji, ka organizuar takimet e grupit ndërinstitucional të punës për të vlerësuar implementinin e saj, ka hartuar raportet 6-mujore dhe vjetore për monitorimin e ecurisë së realizimit të objektivave të parashikuara në të.

Me Urdhërin e Kryeministrit, nr. 112, datë 26.08.2015 është ngritur grupi ndër-institucional për hartimin e një strategjie të re për pronësisë intelektuale (2016- 2020), e cila do të jetë vazhdim i strategjisë aktuale që përfundon në fund të vitit 2015.

Në progres raportin e fundit të KE theksohet:

- Për Pronësinë Industriale, kuadri ligjor dhe nënligjor është plotësuar;
- Në zbatim të detyrimeve të MSA-së është miratuar struktura e re e DPPM;
- DPPM ka forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional, bashkëpunimi me QKR është forcuar
- DPPM ka realizuar aktivitete promovuese dhe si rrjedhim ka patur një rritje të numrit të kompanive që regjistrojnë markat e tyre;

DPPM-ja ka punuar për të krijuar dhe forcuar kapacitetin e saj administrativ. Është forcuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e PI. Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut ka qenë një nga objektivat kryesorë në punën e saj. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe aneks marrëveshje ku janë parashikuar kalendarë trajnimesh me QKR dhe DPD. Marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar dhe me UPT. Në ambientet e UPT është hapur një qendër informacioni për patentat si dhe janë organizuar seminare me studentët. Në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë dhe QKR në rrethe janë organizuar seminare promovuese dhe ndërgjegjësuese për biznesin dhe mbajtësit e të drejtave. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit të DPPM, ka pësuar ndryshime, në përmirësimin e programeve kompjuterike që automatizojnë procedurat e regjistrimit të Objekteve të PI, si edhe përmirësojnë shërbimet elektronike që DPPM ofron si dhe ka përfunduar digjitalizimi i arkivës së patentave.

DPPM hartoi duke i konsultuar me grupet e interesit, projektaktet në zbatim të Ligjit, të cilat u miratuan gjatë këtij viti me Vendim të Këshilli të Ministrave. Përmirësimi i paketës ligjore ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë së egzaminimit.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 80, datë 12.06.2015, është miratuar struktura e DPPM me 24 punonjës, duke plotësuar një nga rekomandimet e KE dhe një objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të PI.

DPPM ka ofruar në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit shërbim cilësor, si elektronik në faqen zyrtare të saj ashtu edhe në ambjentet e saj, për tu ardhur sa më shumë në ndihmë aplikantëve dhe grupeve të interesit. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit në lidhje me PI, ka qenë në fokusin e aktiviteteve të realizuara nga DPPM. Aktivitet e shumta të organizuara më qëllim promovimin, përmirësimin e cilësisë dhe kryerja më shpejt e shërbimeve, ka çuar në rritjen e numrit të aplikimeve në DPPM.

DPPM ka organizuar tryeza të rrumbullakëta me bizneset, mbajtësit e të drejtave si ka marë pjesë në panaire për të promovuar PI dhe shërbimet e saj.

Regjistrat on line janë përditësuar çdo 10 ditë duke bërë të mundur ofrimin e informacionit sa më të saktë në lidhje me statusin e aplikimeve.DPPM ka shtuar numrin e publikimeve të buletineve të PI, duke ulur ndjeshëm afatin e procedurave të ekzaminimit.

Vendimet e marra nga Bordi i Apelimit në DPPM, gjatë këtij viti kanë qenë kryesisht të pa kontestuara në Gjykatë. Në shumicën e rasteve Gjykata ka lënë në fuqi vendimet e Bordit të Apelit të DPPM-së.

Në rolin e kordinatorit të kapitullit 7 "Pronësia Intelektuale", ka hartuar dhe ka koordinuar punën ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e Pronësisë Intelektuale, duke grumbulluar dhe përpunuar informacionin e tyre për të hartuar progres-raportet finale, hartuar dhe përditësuar Kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale" dhe PKIE-në, etj.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe EU *acquis*

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në fushën e Pronësisë Intelektuale me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 73 i MSA-së.

Acquis e BE-së mbi Pronësisë Intelektuale përbëhen nga disa direktiva të miratuara nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Kjo përfshin, ndër të tjera:

- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 22 Majit 2001 mbi "Harmonizimin e disa aspekteve te te drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të ne Shoqërinë e Informacionit;
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 27 Shtatorit 2001 mbi "Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti";
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale";
- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të";

- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi “Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave”;Direktiva 2009/24/ e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 23 Prill 2009 Mbi Mbrojtjen Ligjore të Programeve Kompjuterike.
- Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 “Mbi koordinimin e rregullave te caktuara lidhur me te drejtën e autorit dhe te drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore”;
- Direktiva 2012/28/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 “***Mbi përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor***”;
- Direktiva 2014/26/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 “Mbi administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura dhe licencimin e të drejtave multi-territoriale të veprave muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm”;
- Direktiva 2008/95/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 Tetor 2008 për të përafruar ligjet e Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare;
- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 6 korrik 1998 mbi “Mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike”;
- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 13 Tetor 1998 mbi “Mbrojtjen ligjore të disenjove industriale”;
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 29 prill 2004 mbi “Zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale”;
- Rregullorja e Këshillit (EEC) nr. 1768/92 të datës 18 qershor 1992 "Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve mjekësore";
- Rregullorja (KE) nr. 1610/96 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 korrik 1996 "Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve";
- Rregullorja e Këshillit (EEC) nr. 2081/92 të datës 14 korrik 1992 "Për mbrojtjen e të dhënave gjeografike dhe emërtimet e origjinës së produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore".

II.2 Përmbledhja e arritjeve në legjislacion

Legjislacioni Shqiptar ne fushën e të drejtës së autorit përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr. 9380, date 28.04.2005 Mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të (publikuar në fletoren Zyrtare nr. 42, datë 13.06.2006 fq-1493-1528) është pjesërisht i përputhur me Acquis e Bashkimit Evropian.
- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 22 Majit 2001 mbi “Harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shoqërinë e Informacionit;
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit ë 27 Shtatorit 2001 mbi “Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti”;
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi “Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave ë tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale”;

- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të";
- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi "Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave";
- Direktiva 2009/24 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Prill 2009 "Mbi Mbrojtjen Ligjore të Programeve Kompjuterike"Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 mbi "Koordinimin e rregullave te caktuara lidhur me te drejtën e autorit dhe te drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore".

Pjesë e kuadrit ligjor për funksionim e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë dhe:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 232, datë 19.4.2006 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit",
- VKM 343 datë 06.06.2007 "Për miratimin e tarifave që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit".

Legjislacioni Shqiptar në fushën e Pronësisë Industriale përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

Ligji 9947 datë 07.07.2008 i ndryshuar me ligjet:

- Ligji Nr. 10/2013 datë 01.03.2013,"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale".
- Ligji Nr. 55/2014 datë 24 Qershor 2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale".

Është plotësisht i përafruar me direktivat e mëposhtme:

- Direktiva 98/44/EC "Mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike";
- Direktiva 98/71/EC "Mbi mbrojtjen ligjore të disenjove industriale";
- Direktiva 2008/95/EC "Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare për markat tregtare dhe të shërbimit";
- Direktiva 2004/48/EC "Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale.

Ligji 8488 datë 13.05.1999, "Për mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara" i ndryshuar me ligjin:

- Ligji Nr. 66/2014 datë 24.07.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 8488 datë 13.05.1999 "Për mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara".

Është plotësisht i përafruar me direktivën e mëposhtme:

- Direktiva Nr. 87/54 "Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara".

Aktet e mëposhtme nënligjore dalë në zbatim të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" të ndryshuar janë:

- Vendimi nr.38, datë 21.01.2015, *Për "Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr.1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullores për Lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit", të ndryshuar.*
- Vendimi Nr. 37, datë 21.01.2015, *Për Disa Shtesa dhe Ndryshime Në Vendimin Rr.883, Datë 13.5.2009, Te Këshillit Te Ministrave, "Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale", të ndryshuar.*
- Vendimi Nr. 548, date 18.06.2015, *"Për disa ndryshime në Vendimin 381, datë 08.04.2009 "Për miratimin e rregullores "Për regjistrimin e disenjove industriale".*
- Vendimi Nr. 550 datë 18.06.2015, *"Për disa ndryshime dhe shtesa në vedimin Nr.1706 datë 29.12.2008, "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit".*
- Vendimi nr. 549 datë 18.06.2015, *"Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1705 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores "Për regjistrimin e treguesve gjeografikë".*

II.3 Institucionet përgjegjëse

II.3.1 Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të

Institucionet qendrore, përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Kulturës si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, konkretisht Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave. Institucione të tjera, të përfshira në procesin e zbatimit, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Inspektoriati i Tregut (pas krijimit të këtij organi);
- Policia e Shtetit – Drejtoria e Krimit Ekonomik;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit;/IZHA
- Shkolla e Magjistraturës;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

II.3.2 Të drejtat e pronësisë industriale

Institucionet kryesore për zbatimin e këtij kapitulli janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit.

Institucionet drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Prokuroria;
- Policia e Krimit Ekonomik;
- Sistemi gjyqësor që ka të bëjë kryesisht me Gjykatën e Tiranës;
- Ministria e Arsimit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Inspektoriati i Tregut (pas krijimit të tij);
- Shkolla e Magjistraturës.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian që merret me kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale", udhëhiqet dhe koordinohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe përbëhet nga:

- Ministria e Kulturës
- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
- Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit

II.4 Përcaktim i alokimeve financiare

	2016	2017	2018
Buxheti total per kete kapitull i institucionit lider	255,024		
Buxheti total per kete kapitull i institucioneve te tjera	1,410,130		
Buxheti total i Kapitullit	1,665,154		

III. Prioritetet

Rekomandimet e Komisionit Evropian (Raporti i Progresit 2015) janë si më poshtë:

- Ka pasur pwrgatitje tw rwndwsishme në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale;
- Progres është bërë vitin e fundit;
- Shqipëria nuk ka përmbushur angazhimet e saj në bazë të nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;
- Në vitet në vazhdim duhete miratohet një ligj i ri e për të Drejtën e Autorit në përputhje me standartet europiane;
- Të përmirësohet sistemi i funksionimit të agjensive të administrimit kolektiv si dhe pagesat e honorareve që mbajtësit e të drejtave

Prioritetet e ZSHDA-së janë:
Prioritete afat-shkurtra :

- Përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, trajnimi dhe rritja e ekpertizës së tyre;
- Krijimi i një mekanizmi të vazhdueshëm për të forcuar bashkëpunimin me agjencitë e administrimit kolektiv si dhe për të përmirësuar gjithë sistemin në tërësi;
- Trajnimi i vazhdueshëm i sistemit gjyqësor si një nga hallkat kryesore në gjithë këtë proces mbetet prioritet;
- Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit do të ofrojë mbështetje për AKEP-in, dhe AMA-n për të monitoruar zonat e tyre të tregut;
- Organizimi dhe zbatimi i mëtejshëm i fushatave të ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e pronësisë intelektuale;
- Aplikimi i regjistrimit on-line (e-registration) të të drejtave të autorit;
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020 dhe Planit të Veprimit.

Prioritetet Afat-mesme të ZSHDA:

- Krijimi i grupit të punës për shkeljet në internet me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), dhe Autoriteti i Medias Audiovizuale (AMA)
- Forcimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- Zbatimi i masave dhe i planit të punës që do të jenë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e Të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (2016-2020);
- Futja në kurikulën mësimore dhe në cikle të tjera të arsimimit para-universitar;
- Fushata të gjera ndërgjegjësimi për komunitetin e biznesit dhe shoqërisë në tërësi.

Prioritetet e DPPM-së në periudhë afatshkurtër:

- Forcimin e kapaciteteve administrative të saj dhe të infrastrukturës së TIK-ut;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;
- Fuqizimin e qendrës së informacionit teknik dhe shkencor;
- Zhvillimin e aktiviteteve promovuese dhe trajnuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe biznesit;
- Trajnimi i stafit të DPPM-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Fillimi i punës për krijimin e Arkivës on-line per marka, disenjo industriale dhe tregues gjeografikë.
- Kontrollimi dhe pastrimi i të dhënave të hedhura në bazën elektronike të të dhënave të DPPM.
- Klasifikimi i elementeve figurative të markave sipas klasifikimit ndërkombëtar të Vienës për këtë qëllim.
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale (2016-2020).
- Monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale (2010-2015).

Përgatitja e materialeve me qëllim përfshirjen e modulit të Pronësisë Indsutriale në shkollat e mesme.**Prioritetet e DPPM-se** në periudhe afat-mesme:

- Trajnimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në;
- Trajnimin e autoriteteve gjyqësore me çështjet e PI-së nëpërmjet projekte dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturëa.
- Implementimin e aplikimit on-line për objektet e Pronësisë Industriale;
- Lidhja e rregjistrave on line të DPPM-së me ata të EPO dhe OHIM.
- Trajnimi i stafit të DPPM-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Zhvillimin e aktiviteteve promovuese dhe trajnuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe biznesit;
- Përfundimi i arkivës on-line për marka tregtare dhe të shërbimit, disenjo industriale dhe tregues gjeografikë.

IV. Plani i veprimit për vitet 2016 – 2018

IV.1 E drejta e autorit dhe të drejta të lidhura me të

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni përgjegjës	Periudha e referencës
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, (Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave) në	2010 – 2015

	bashkëpunim të ngushtë me Zyrën shqiptare për të Drejtat e Autorit	

Inventari i masave ligjore ekzistuese

***Acquis* i BE**	**Legjislacioni shqiptar**	**Institucioni përgjegjës**	**Niveli i përshtatjes (i plotë/ i pjesshëm/ jo në përputhje)**	**Data e miratimit (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 93/83/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2001/84 EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2006/115 EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2006/116 EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 96/9/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2009/24/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2001/29/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të tjera të Lidhura me të"	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005

Korniza Politike e planifikuar në 2016 – 2018

Titulli	Institucioni përgjegjës	Periudha e referencës	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale2016-2020 dhe Plani i Veprimit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM, ZSHDA	2016 – 2020	3 mujori i dytë 2016	3 mujori i dyte 2016

Masat ligjore e planifikuara në 2016 – 2018

Acquis i BE	Statusi i përkthimit në shqip	Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i përshtatjes (i plotë/ i pjesshëm/ jo në përputhje)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
Direktiva2006/116/EC Direktiva 2006/115/EC Direktiva 2004/48/EC Direktiva 96/6/EC Direktiva 2001/84/EC Direktiva 2009/24/EC	Jo	Ligji "Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të"	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I plotë	3 mujori II /2016	3 Mujori i II i 2016

Direktiva 2001/29/EC Direktiva 2014/26 / BE							
Direktiva 2004/48/EC	Jo	Rishikim i Kodit Penal Kodit të Procedurës Penale	Jo	Ministria e Kulturës Ministria e Drejtësisë. Ministria e Punëve të Brendshme ZSHDA	E plotë	3 mujori i 1I / 2016	3 mujori i II /2016.
AFAT MESËM (2017 –)2018							
Direktiva 2012/28/EU	jo	Amendim i Ligjit te Ri per te Drejten e Autorit dhe te Drejtat e Lidhura me te	Jo	Ministria e Kultures ZSHDA	E Plote	3 mujori i I i 2018	3 mujori i I i 2018

IV.2 E drejta e pronësisë industriale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM	2010 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)

Direktiva 98/44/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	i plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 98/71/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 2008/95/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 2004/48/EC	Ligji Nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I plotë	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 87/54/EEC	Ligji Nr 8488 i 1999/05/13 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara", i ndryshuar	DPPM	I plotë	17.07.2008	31.10.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale 2016 – 2020 dhe Plani i Veprimit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; DPPM.	2016 – 2020	3 mujori II/ 2016	3 mujori i II/ 2016

Masat ligjore të planifikuara 2016– 2018

Acquis i BE	Statusi i përkthimit në shqip	Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							

N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
AFAT MESËM (2016 – 2018)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.3 Zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM	2010 – 2015

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2004/48/EC	Ligji nr. 23/2012, datë 01.03.2012 "Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon sanksione penale kundër atyre që shkelin të drejtat e pronësisë industriale".	Ministria e Drejtësisë	E plotë	01.03. 2012	11.04.2012
Rregullorja e BE Nr. 1383/203 KE	VKM 547 datë 01.05.2008 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 205 të 1999/04/13 për zbatimin e dispozitave të Kodit Doganor".	DPD	E plotë	01.05.2008	26.5.2008
Rregullorja e BE-së nr 608/2013	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1090, datë 28.12.2015 Për disa ndryshime në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të	DPD	E plotë	28.12.2015	12.01.2016

	Ministrave, "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar"				

Korniza Politikave të planifikuara në 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale 2016-2020 dhe Plani i Veprimit	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; DPPM. ZSHDA.	2016 – 2020	3 mujori i dytë 2016	3 mujori i dytë 2016

Masat ligjore të planifikuara 2016 – 2018

Acquis i BE	Statusi i përkthimit në shqip	Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
Direktiva 2004/48/EC	Po	Rishikimi I Kodit Penal	Jo	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Partial	T 2 2016	T 3 mujori i 2 i 2016
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve te buxhetit te shtetit te planifikuara

Kapitulli: 7
Përfituesi: MZHETTS

1	2	3	4	5	6
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Miratimi i Strategjisë për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale 2016-2020	A) Paga –stafi ekzistues	1,265,154			1,265,154
	DPMM	255,024			255,024
	Institucione te tjera	1,010,130			1,010,130
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim				
	Aktiviteti total	**1,265,154**			**1,265,154**
	Buxheti i Përfituesit total				**1,265,154**
Përfituesi: Ministra e Kultures					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Rishikimi i Kodit Penal dhe Kodin e Procedurës Penale	A) Paga –stafi ekzistues	400,000			400,000
	B) Paga –stafi i ri	0			
	C) Trajnimi	0			
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0			
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0			
	Aktiviteti total	**400,000**			**400,000**
	Buxheti i Përfituesit total				**400,000**
	Kapitulli total				**1,665,154**

KAPITULLI 8: POLITIKAT E KONKURRENCËS

I. Hyrje

1.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 8 "Politika e Konkurrencës" përfshin rregullat në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, rregullat lidhur me zbatueshmërinë e ndihmës shtetërore, si dhe pjesën e liberalizimit.

Mbrojtja e konkurrencës është një fushë e rëndësishme për zbatimin e parimeve të ekonomisë së lirë të tregut. Për të vendosur një konkurrencë të lirë dhe efektive në tregun shqiptar, Autoriteti i Konkurrencës është i angazhuar të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenet 71 dhe 72 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), të dokumenteve strategjikë, të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, si dhe të gjithë kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e një institucioni publik, të pavarur në vendimmarrje.

Kuadri ligjor i BE në fushën e konkurrencës përfshin rregullat e antitrust, përqendrimet si dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Ajo përfshin rregullat dhe procedurat për sjelljet anti konkurruese të ndërmarrjeve (marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimi me pozitën dominuese), kontrollin e përqendrimeve si dhe parandalimi i qeverive në dhënien e ndihmës shtetërore që shtrembëron konkurrencën në tregun e brendshëm. Rregullat e Konkurrencës janë direkt të zbatueshme në Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë me Komisionin për zbatueshmërinë e tyre.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është promovimi dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive nëpërmjet ruajtjes së mjedisit konkurrues dhe nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Ruajtja apo nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat, apo ai shtetëror, mund t'i bëjnë konkurrencës, prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, ndarjen e tregut, kufizimin apo kontrollin e prodhimit, të zhvillimit teknik, zbatimin e kushteve të ndryshme për transaksione të njëjta etj, abuzimin me pozitën dominuese, si dhe kontrollin e përqendrimeve që rrezikojnë të krijojnë, ose forcojnë një pozitë dominuese në treg.

I.2 Situata ne Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres për sa i përket konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Autoriteti i Konkurrencës ka ndërhyrë në shumë sektorë të ekonomisë, në të cilat janë evidentuar dhe zbuluar praktika anti-konkurrenciale, duke marrë masat e duhura për rikthimin e konkurrencës në treg. Gjithashtu, janë përdorur gjerësisht instrumentet e duhura për rritjen e kulturës dhe advokacisë së konkurrencës, në synim edhe të ndërgjegjësimit të aktorëve në treg për rregullat dhe parimet e konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me atë të *Acquis Communautaire* të BE-së, në synim të një kuadri të plotë ligjor në fushën e konkurrencës.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA E KONKURRENCËS
2. NDIHMA SHTETËRORE

II. Situata aktuale

Autoriteti i Konkurrencës ushtron veprimtarinë e tij në mbështetje të rregullave të konkurrencës së lirë dhe efektive, në respektim të të gjithë kuadrit ligjor në fuqi. Në fokus të veprimtarisë së tij janë të gjitha praktikat anti-konkurrenciale, të cilat shtrembërojnë, deformojnë, apo kufizojnë, konkurrencën në treg. Sektorë dhe tregje të ndryshme dhe të ndjeshme të ekonomisë kanë qenë nën vëmendjen e Autoritetit të Konkurrencës .

Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë përparësi krijimit të legjislacionit dytësor në fushën e konkurrencës. Ai ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore, të cilat janë të përafruara plotësisht me aktet e BE-së.

Në vijim të aktivitetit të tij Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë një rëndësi të veçantë advokacisë së konkurrencës. Puna e Autoritetit të Konkurrencës për rritjen e kulturës së konkurrencës është përqendruar kryesisht në transparencën e plotë të procedurave të ndjekura nga Autoriteti. Kjo transparencë është respektuar edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve të Komisionit, në kohë reale, si dhe dëgjimit të aktorëve të tjerë (institucioneve shtetërore) përpara dhënies së rekomandimeve. Gjithashtu kjo transparencë është realizuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes publike në media, e cila ka shërbyer dhe për rritjen e kulturës së konkurrencës në Shqipëri.

Sektorë të ndryshëm të ekonomisë janë monitoruar dhe janë kryer studime të ndryshme të tregut, gjetjet e të cilave janë reflektuar në rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës.

II.1 Përmbledhja e kërkesave te MSA dhe *Acquis Communautaire* të BE

Nenet 70, 71 dhe 72 të MSA parashikojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive nga veprimet dhe praktikat anti-konkurruese, që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", parashikon përgjegjësinë që ka Autoriteti i Konkurrencës dhe ndërhyrjen që duhet të bëjë në rastet e (1) të gjitha marrëveshjeve ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve, të cilat kanë si objektiv të tyre, ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; (2) Abuzimit me pozicionin dominues nga një ose më shumë ndërmarrje në territoret e BE, apo të Shqipërisë, si një e tërë, ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre. Referenca janë nenet e Traktatit të Funksionimit të bashkimit Evropian dhe konkretisht nenet 101, 102 dhe 106 të tij. Gjithashtu, në bazë të Nenit 72 "Sipërmarrjet publike", parashikohet se Shqipëria zbaton për sipërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, me referencë të veçantë tek Neni 86 (tani neni 106 I TFEU-së).

Neni 71 i MSA-së

Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Nuk janë të pajtueshme me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, në masën që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:
   (i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;
   (ii) abuzimi me pozicionin dominues nga një ose më shumë sipërmarrje në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;
   (iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara.
2. Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës që zbatohen në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretues të adoptuara nga institucionet e Komunitetit.

3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij Neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.
4. Shqipëria do të ngrejë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë, *inter alia*, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.
5. Secila prej Palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke i paraqitur, *inter alia*, Palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të Komunitet për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njërës Palë, Pala tjetër jep informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.
6. Shqipëria do të hartojë një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4 dhe të sigurojë pajtueshmërinë e këtyre skemave ndihme me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
7. (a) Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se Shqipëria konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian.

   (b) Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Evropiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Evropiane atëherë do t'i vlerësojnë bashkërisht nevojën e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetet maksimal të ndihmës në lidhje me to për hartimin e një harte ndihmash zonale në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.
8. Në lidhje me produktet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:
   - paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;
   - çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kritereve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve specifikë të Komunitetit të adoptuar mbi këtë bazë.
9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas këshillimeve me Këshillin e Stabilizim-Asociimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për këshillim.

   Asgjë në këtë Nen nuk cënon ose ndikon në ndonjë mënyrë marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose masave kundërbalancuese në përputhje me Nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

Kuadri ligjor i BE-së në fushën e konkurrencës përbëhet ndër të tjera nga aktet e mëposhtme:

- Nenet e Traktatit të Lisbonës , neni 101-102 i Traktatit të Funksionit të BE-së
- Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 "Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit;
- Rregullorja e Komisionit Evropian (EC) nr. 773/2004, e datës 7 Prill 2004 mbi kryerjen e procedurave nga ana e Komisionit në mbështetje të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE;
- Rregullorja e Komisionit nr. 330/2010 e datës 20 Prill 2010 mbi zbatimin e nenit 101/3 të traktatit të Funksionimit të BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikat e bashkërenduara;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1217/2010, e datës 14 dhjetor 2010 "Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1218/2010, e datës 14 dhjetor 2010 "Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 772/2004, e datës 27 prill 2004 "Për zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike;
- Rregullorja e Komisionit Nr 316/2014 e datës 21 Mars 2014 mbi zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike;
- Rregulloren e Komisionit Nr. 461/2010 e datës 27 Maj 2010 Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike;
- Rregullorja e Këshillit Evropian Nr 487/2009 e datës 25 Maj 2009, "Mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshjesh dhe praktika të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror;
- Rregullorja e BE-së: Rregullorja e Këshillit nr. 246/2009 e datës 26 shkurt 2009 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar;
- Rregullorja e Komisionit nr. 906/2009 e datës 28 Shtator 2009 mbi zbatimin e nenit 6 të ligjit për disa kategori të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar. (kosorcium)
- Direktiva 2014/104/EU e Parlamentit European dhe e Këshillit të 26 Nentorit 2014 mbi disa rregulla qe menaxhojne veprimet per demtimet sipas legjislacionit vendas per shkeljet e provizioneve te ligjit te konkurrences te vendeve anetare dhe te Bashkimit Europian.

Kuadri ligjor për kontrollin e përqendrimeve përbëhet nga aktet e mëposhtme:

- Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" (Rregullorja e Përqendrimit të KE);
- Rregullorja e Komisionit 802/2004 e datës 21 Prill 2004 që implementon Rregulloren e këshillit (EC) Nr 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore ne fushën e legjislacionit

Autoriteti i Konkurrencës e mbështet veprimtarinë e tij në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar) si dhe në një set të plotë aktesh nënligjore, përfshirë rregullore dhe udhëzime konkrete. Ligji dhe kuadri ligjor dytësor janë plotësisht të përfaruar me kuadrin ligjor të BE-së në fushën e konkurrencës , ndër te tjera me nenet e Traktatit të Lisbonës , neni 101-102-106 i Traktatit të Funksionit të BE-së; Rregulloren e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 "Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit; Rregulloren e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" (Rregullorja e Përqendrimit të KE); Njoftimin e Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës; Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve ; Udhëzimin për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis), etj, si dhe akte të tjera ligjore të BE-së.

Baza ligjore e miratuar e ndihmon Autoritetin e Konkurrencës në veprimtarinë e tij dhe realizimin e misionit dhe të objektit të ligjit, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në përgjithësi Shqipëria ka plotësuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në këtë fushë. Kuadri ligjor në fushën e ndihmë shtetërore është i përbërë nga ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore", i ndryshuar, si dhe 3 rregulloret përkatëse të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Legjislacioni shqiptar për ndihmën shtetërore është i përfaruar me direktivat e mëposhtme të BE-së: Rregullore Nr. 69/2001, (KE) e datës 12 Janar 2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën "de minimis"; Rregullore 70/2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 te Traktatit te BE-se lidhur me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; Rregullore Nr 2204/2002 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për punësimin" ; Rregullore Nr. 68/2001, "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën për trajnim"; Rregullore e Këshillit nr. 659/1999 "Për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së.

Aktualisht, ligji për ndihmën shtetërore po pëson disa ndryshime, si dhe janë në proces draftimi dy akte nënligjore që do të garantojnë përafrimin e mëtejshëm e të tij me *acquis communautaire.*

II.3 Institucionet Përgjegjëse

1. Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës;
2. Sektori i Kontrollit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
3. Komisioni i Ndihmës Shtetërore

Autoriteti i Konkurrencës është koordinator dhe përgjegjës për kapitullin e 8 "Politika e Konkurrencës". Anëtarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian janë përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë ashtu si dhe të Ministrisë së Integrimit Evropian.

II.4 Direktivat e parashikimeve financiare

Autoriteti i Konkurrencës është institucion buxhetor qe financohet 100% nga buxheti i shtetit.

Viti	2016	2017	2018	
Buxheti total për këtë kapitull iinstitucionit lider:Autoritetit të Konkurrencës	2 760 450	814 400	3 589 600	
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve te tjera: Ndihma Shtetërore,MZHETTS	3 525 000	-425 000	425 000	-
Buxheti total i kapitullit	6 285 450	1 239 400	4 014 600	
Buxheti total për këtë kapitull iinstitucionit lider:Autoritetit të Konkurrencës	2 760 450	814 400	3 589 600	

Shpenzimet për funksionimin e Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të Komisionit të Ndihmës Shtetërore janë të përfshira në planifikimin e shpenzimeve në kuadër të programit buxhetor afat-mesëm 2016-2018 në nën programin "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi" të Ministrisë.

III. Prioritetet

Në përparësitë e Autoritetit të Konkurrencës është ruajtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, nëpërmjet zbatimit të rregullave dhe parimeve të konkurrencës, duke zbatuar dispozitat e ligjit.

Në funksion të arritjes së synimeve të ligjit organik dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, aktivitetet zbatuese të institucionit do të shtrihet në këto fusha kryesore:

Rregullore e (EU) Nr 549/2013,datë 21 Maj 2013 “Mbi Sistemin Europian te llogarive Kombetare dhe Rajonale ne Bashkimin Europian”.	Vendim i KM të BSH, nr. 95, datë 24. 12.2008:“Për Miratimin e Metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	24.12.2008	24.12.2008
Rregullore e (EU) Nr 549/2013,datë 21 Maj 2013 “Mbi Sistemin Europian te llogarive Kombetare dhe Rajonale ne Bashkimin Europian”.	Vendim i KM të BSH nr. 75, date 06.09.2000, i ndryshuar, “Mbi miratimin e formularëve të sistemit të unifikuar të raportimit”, I ndryshuar.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	06.09.2000	06.09.2000
Rregullore e (EU) Nr 549/2013,datë 21 Maj 2013 “Mbi Sistemin Europian te llogarive Kombetare dhe Rajonale ne Bashkimin Europian”.	Rregullore nr. 45, date 10/06/2009 “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit të unifikuar të raportimit.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	10.06.2009	02.08.2009
Rregullore e (EU) Nr 549/2013,datë 21 Maj 2013 “Mbi Sistemin Europian te llogarive	Programi Kombëtar i statistikave zyrtare 2012-2016.	INSTAT	Pjesërisht	14.02.2013	14.02.2013

Kombetare dhe Rajonale ne Bashkimin Europian”.					
Rregullore e (EU) Nr 549/2013,datë 21 Maj 2013 “Mbi Sistemin Europian te llogarive Kombetare dhe Rajonale ne Bashkimin Europian”.	Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, Banka e Shqipërisë - Korrik 2003.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	Korrik 2003	Korrik 2003
Rregullore (BE) Nr 1071/2013 e Bankës Qendrore Europiane, date 24 shtator 2013, “Mbi bilancin e institucioneve monetare dhe financiare” (recast) (ECB/2013/33)	Vendim i KM të BSH nr. 75, date 06.09.2000, i ndryshuar, “Mbi miratimin e formularëve të sistemit të unifikuar të raportimit”, I ndryshuar.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	06.09.2000	06.09.2000
Rregullore (BE) Nr 1071/2013 e Bankës Qendrore Europiane, date 24 shtator 2013, “Mbi bilancin e institucioneve monetare dhe financiare” (recast) (ECB/2013/33)	Vendim i KM të BSH, nr. 95, datë 24. 12.2008:“Për Miratimin e Metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	24.12.2008	24.12.2008
Rregullore (BE) Nr 1071/2013 e Bankës Qendrore Europiane,	Rregullore nr. 45, date 10/06/2009 “Mbi raportimet në Bankën e	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	10.06.2009	02.08.2009

date 24 shtator 2013, “Mbi bilancin e institucioneve monetare dhe financiare” (recast) (ECB/2013/33)	Shqipërisë sipas sistemit të unifikuar të raportimit.				
Rregullore (BE) Nr 1071/2013 e Bankës Qendrore Europiane, date 24 shtator 2013, “Mbi bilancin e institucioneve monetare dhe financiare” (recast) (ECB/2013/33)	Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, Banka e Shqipërisë - Korrik 2003.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	Korrik 2003	Korrik 2003
Rregullore (BE) Nr 1071/2013 e Bankës Qendrore Europiane, date 24 shtator 2013, “Mbi bilancin e institucioneve monetare dhe financiare” (recast) (ECB/2013/33)	Programi Kombëtar i statistikave zyrtare 2012-2016.	INSTAT	Pjesërisht	14.02.2013	14.02.2013
Rregullore (EU) Nr 63/2002 e Bankes Qendrore Europiane, date 20 dhjetor 2001 Mbi statistikat e	Rregullore nr. 45, date 10/06/2009 “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit të unifikuar të raportimit.	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	10.06.2009	02.08.2009

normave te interesit te aplikuara nga institucionet monetare dhe financiare mbi depozitat dhe huate e individëve dhe korporatave jo-financiare.					
Rregullore (EU) Nr 63/2002 e Bankes Qendrore Europiane, date 20 dhjetor 2001 Mbi statistikat e normave te interesit te aplikuara nga institucionet monetare dhe financiare mbi depozitat dhe huate e individëve dhe korporatave jo-financiare.	Vendim nr. 102, datë 27.12. 2006 Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 06.09.2000 i ndryshuar ,"Për miratimin e formularëve të Sistemit Raportues të Unifikuar"	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	27.12.2006	Janar 2007

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016- 2018

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e përshtatjes**	**Hyrja në fuqi**
Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare	INSTAT	2017 – 2021	T4 2016	T1 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

Paketa Ligjore e BE -së (EU *acquis*)	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe nën ligjet)**	**Statusi i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (Plotë/Pjesërisht)**	**Data e planifikuar e adoptimit**	**Hyrja ne fuqi**
AFAT – SHKURTER (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT – MESEM (2016 – 2017)							
Rregullore (EU) Nr 63/2002 e Bankes Qendrore Europiane, date 20 dhjetor 2001 Mbi statistikat e normave te interesit te aplikuara nga institucionet monetare dhe financiare mbi depozitat dhe huate e individëve dhe korporatave jo-financiare.	Ne proces	Rregullore per normat e interesit te depozitave dhe huave te raportuara nga bankat.	Jo	Banka e Shqipërisë (Vendim KM)	Pjesërisht	T 4 2016	T 4 2016
UDhëzues i ECB/2013/24, korrik 2013 “Mbi kerkesat per raportim te ECB per llogarite	Jo	Metodika e llogarive financiare për korporatat financiare (Miratim nga Administratori)	Jo	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	T 4 2016	T 4 2016

fianciare tremujore”							
Rregullorja 184/2005 EU e amenduar me rregulloren nr555/2012 EU	Jo	Bilanci i pagesave, Pozicioni i e Investimeve Ndërkombëtare, Shërbimet ndërkombëtare të tregtisë dhe Investimet e Huaja Direkte , vendim i këshillit mbikëqyrës së bankës	Jo	Banka e Shqipërisë	Pjesërisht	T 4 2016	T 4 2016

IV.6 Statistikat e bujqësisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Programi Kombëtar I Statistikave Zyrtare	INSTAT	2012 - 2016

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Rregullorja (EU) Nr 617/2008 datë 27	Ligji 9180 datë 05/02/2004 “Për	INSTAT	I pjesshëm		05/02/2004

Qershor 2008 Statistikat blegtorale dhe mishit	Statistikat Zyrtare”				
Rregullorja (EU) Nr 1165/2008	Ligji 9180 datë 05/02/2004 “Për Statistikat Zyrtare	INSTAT	I pjesshëm		05/02/2004
Direktiva 96/16/EU	Ligji 9180 datë 05/02/2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	I pjesshëm		05/02/2004
Rregullorja (EU) Nr 543/2009 e	Ligji 9180 datë 05/02/2004 “Për Statistikat Zyrtare”	INSTAT	I pjesshëm		05/02/2004
Rregullorja e (EU) Nr 1337/2011	Programi i Statistikave Zyrtare 2012 - 2016	INSTAT	I pjesshëm		05/02/2004

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016-2018

Titulli (Strategji ose ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Programi Zyrtar i Statistikave Zyrtare 2017 - 2021	INSTAT	2017-2021	T 4 2016	T 1 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016-2018

Ligjet	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.7 Regjistrat

Kuadri i politikave të planifikuara

Titulli (Strategji ose ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Programi Zyrtar i Statistikave Zyrtare 2017 - 2021	INSTAT	2017-2021	T 4 2016	T 1 2017

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Paketa Ligjore e BE -së (EU *acquis*)	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni Kryesor**	**Niveli i përafrimit (Plotë/Pjesërisht/ Jo në përputhje)**	**Data e përshtatjes(Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Rregullorja 177/2008/EEC	Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 " Për Statistikat Zyrtare" i ndryshuar	INSTAT	Pjesërisht	5.2.2004	27.03.2004
	Ligji Nr. 8957 datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, SME", ndryshuar me Ligjin Nr 10042 datë 22.12.2008.	MZHETTS	Pjesërisht	17.10.2002	2.12.2002

Rregullorja 1893/2006 /EC	VKM nr. 327, datë 1994/07/18 të klasifikimit statistikor të aktiviteteve ekonomike në Shqipëri.	INSTAT	Plotë	28.05.2014	03.06. 2014
	Ligji Nr.115/2015 Për ndarjen administrivo territoriale të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërise	Ministri i Shtetit për çështjet vendore	Plotë	31.07.2014	01.02.2015

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

Paketa Ligjore e BE -së (EU *acquis*)	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe nën ligjet)**	**Statusi i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (Plotë/Pjesërisht)**	**Data e planifikuar e adoptimit**	**Hyrja ne fuqi**
AFAT - SHKURTËR(2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT - MESËM(2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.8 Klasifikimet

6.01.02 (kodi 2012) Klasifikimet e përfshira në (kodin 2013 – 11.1.52)

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i synuar i përafrimit (Plotë/Pjesërisht)	Data e adoptimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja 3037/90/EU	VKM nr. 327 datë 1994/07/18 të klasifikimit statistikor të aktiviteteve ekonomike në Shqipëri	INSTAT	Plotë	18.07.1994	18.08.1994
Rregullorja 29/2002/EU	VKM nr. 363 date 20.05.1996, disa shtesa në klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike në Shqipëri	INSTAT	Plotë	20.05.1996	20.06. 1996
Rregullorja 1106/2012/EU	Ligji Nr. 9461, datë 21.12.2005	INSTAT	Pjesërisht	21.12.2005	21.12.2005
	VKM Nr 1067, datë 2013/12/14 "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të produkteve të Kombinuara të Klasifikuara", i ndryshuar me Vendim Qeverie Nr. 1100 datë 27.12.2013	INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Plotë	14.12.2013	14.12.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli (Strategji ose ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Programi Zyrtar i Statistikave Zyrtare 2017 - 2021	INSTAT	2017-2021	T 4 2016	T 1 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

Paketa Ligjore e BE -së (EU *acquis*)	**Status i përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe nën ligjet)**	**Statusi i përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit (Plotë/Pjesërisht)**	**Data e planifikuar e adoptimit**	**Hyrja ne fuqi**
AFAT - SHKURTËR(2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT - MESËM(2016 – 2017)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis mbi politikën sociale dhe punësimin përfshinë standardet minimale në fushën e së drejtës së punës, mundësive të barabarta, shëndetin dhe sigurinë, dhe anti - diskriminimit. "Në mënyrë të veçantë mbi Sigurinë dhe Shëndetin në punë ajo është e përfaqësuar nga Direktiva Kuadër 89/391 / EEC dhe 19 direktivat individuale mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për zonat specifike teknike, të cilat janë në përputhje me Direktivën Kuadër.

Fokusi kryesor i Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë është drejtuar në përmirësimin e skemave aktuale nëpërmjet reformimit të shtyllës publike të pensioneve. Reforma sistemike do konsistojë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës, forcimin e lidhjes midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, krijimin e llogarive personale të çdo kontribuuesi dhe përfituesi për arritjen e transparencës maksimale, duke përgatitur skemën dhe sistemin për integrimin në Bashkimin Evropian.

Parimi i mosdiskriminimit është parashikuar në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe në direktiva që rregullojnë zbatimin dhe respektimin e parimit të trajtimit të barabartë. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian është bërë e detyrueshme për zbatim për shtetet anëtare duke e bërë atë burim parësor të legjislacionit të BE-së. Parimi i mosdiskriminimit parashikohet edhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 14 dhe Protokolli 12) dhe në shumë instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në Shqipëri, me miratimin e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabartë në aspektin e kuadrit ligjor njohën një stad të ri të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Miratimi i këtij ligji dhe emërimi i Komisionerit është konsideruar si një arritje për Shqipërinë si në aspektin institucional ashtu dhe në atë të politikave anti-diskriminim.

Duke qenë se ligji për mbrojtjen nga diskriminimi është miratuar sipas standardeve evropiane, ka nevojë për ndryshime legjislative në legjislacionin kombëtar që ky i fundit të harmonizohet. KMD ka rekomanduar ndryshime legjislative në Kodin e Punës,Kodin e Procedurave Administrative, Kodin Penal, Kodin e Familjes, Kodin Zgjedhor, Ligjin 22/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Ligjin 9355/2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, Kodin e Transmetimit dhe Kodin e Procedurës Civile.

I.2 Situata në Shqipëri

Skema e detyrueshme e pensioneve dhe sistemi i sigurimeve shoqërore sipas konkluzioneve te arritura nga studimet per skemën e sigurimeve shoqërore nga ISSH, Qeveria Shqiptare, Organizmat Ndërkombëtarë si BB e FMN dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të Raport-Progresit, Komiteteve dhe Nenkomiteteve, ishte ne nje pike kyce te zhvillimit dhe kerkonte domosdoshmerisht nje reforme te thelle.

Për të rritur qëndrueshmërinë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, në fillim të vitit 2014 qeveria ndërmori reformën e pensioneve. Kjo reformë u krye nga një grup ndërministror me pjesëmarrje të gjerë të palëve të interesuara dhe partnerëve socialë, me konsultim të gjerë publik dhe iu nënshtrua të gjitha procedurat e vendimmarrjes në bashkëpunim me partnerët social. Ky proces është realizuar me asistencën teknike të Bankës Botërore.

Gjatë këtij procesi janë konsultuar praktikat më të mira ndërkombëtare dhe janë përgatitur disa skenarë, nga të cilët është përzgjedhur skenari më i përshtatshëm që forcon lidhjen midis kontributeve individuale dhe shumës së pensionit. Ky opsion parashikon ndryshimin e formulës së llogaritjes së pensionit, që reflekton thjeshtësinë dhe transparencën, duke e lidhur masën e përfitimit me kontributin e paguar.

Gjithashtu garanton përfitime te nivelit normal duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm të normës së zëvendësimit në krahasim me skemën aktuale. Zbatimi i reformës do të çojë në një reduktim më të shpejtë të deficitit të skemës pensioneve, përmirësimin e situates financiare të skemës dhe subvencione reduktuar nga buxheti i shtetit. Dokumenti i Politikave të Pensioneve u prezantua nga Kryeministri, më 29/04/2014.

Reforma e pensioneve, u materializua në përgatitjen eDokumentit të Politikave të Pensioneve dhe të ligjit nr. 104/2014, datë 31/07/2014, me përmirësimet e ligjit ekzistues të sigurimeve shoqërore, të cilat u miratuan gjatë vitit 2014.Reforma u shoqërua nga një fushatë e gjerë informuese dhe sensibilizuese për popullsinë, për prezantimin e përmirësimeve dhe inovacioneve të ligjit, nëpërmjet organizimit të takimeve me grupet e interesit, shoqërisë civile, prezantimeve të shumta mediatike dhe fushatës publicitare në rrjetet sociale.

Procesi i reformës ka vazhduar me përmirësime të ligjeve dhe vendimeve të ndryshme, të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar në përputhje me ligjin e përmirësuar të sigurimeve shoqërore si:

Është miratuar Ligji nr. 27/2015, datë 26.03.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8097, datë 21.03.1996" Për pensionet suplementare shtetërore për personat që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësit të shtetit "Është miratuar Ligjin nr 108, datë 15.10. 2015 "për disa

shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10139, datë 15.05.2009 " Për pensionet suplementare shtetërore të punonjësve të universiteteve, të shkollave të mesme, Qendra Albanologjike studimi, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucionet e tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencore ", Indeksimin e pensioneve për vitet 2014, 2015,. indeksimit të shumës së kompensimit të veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Ligji për faljen e gjobave , për mosapagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqë rore dhe shëndetsore, nga subjektet juridike dhe fizikë, duke nxitur bizneset në pagesën e kontributeve të prapambetura.

Për të inkurajuar dhe lehtësuar procedurat e pjesëmarrjes për personat e vetëpunësuar në bujqësi, në skemën e sigurimeve shoqërore është përgatitur dhe miratuar Ligji No. 153/2014 "Për faljen e gjobave për kontribute te detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi".

Udhëzimi i Ministrit “Për llogaritjen e të ardhurave individuale për efekt të llogaritjes së masës së pensionit social”.

Përmirësimi i VKM “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”
VKM “Për kriteret dhe procedurat për pension social”.

VKM “Për koeficientët e indeksimit të pagave për qëllime të llogaritjes së bazës së vlerësimit për pension të pleqërisë”.

Në përgjigje të kërkesave të vazhdueshme të sindikatave në lidhje me uljen e moshës së pensionit për punonjësit e nëntokës, është përgatitur dhe miratuar Ligji nr. 150 / 2014 “Për pensionet e punonjësve të cilët kanë punuar në miniera, nëntokë”, i cili ofron ulje të moshës e daljes në pension për punonjësit që kanë punuar në miniera nëntokësore, në 55 vite nga 60 vite, në bazë të nenit 92, të ligjit Nr. 7703 dhe periudhën e sigurimit që do të jetë 30 vjet në total, nga të cilat 12 vjet e 6 muaj punë nënëntokë. Në bazë të ligjit të sipërpërmendur është përgatitur dhe miratuar VKM "Mbi marrëveshjet e financimit të pensioneve të punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokësore".

Për të mbrojtur njerëzit në nevojë, duke hequr efektet e fashës mbi konsumin e energjisë elektrike, është përgatitur dhe miratuar VKM për mbrojtjen e kategorive të caktuara të përfituesve, si: ata të ndihmës ekonomike, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, etj.
Udhëzim nr 1 datë 02.02.2015 “Mbi zbatimin e Vendimit nr 8, datë 14.01.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga heqja e fashës deri në 300 këh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Pjesë e reformës janë edhe skemat profesionale për profesionet e vështira të cilat janë kthyer në detyrim ligjor dhe do të përfshijnë disa kategori punonjësish si ata te industrisë minerare, punonjësit e industrive të tjera si nafta dhe metalurgjia, punonjësit e artit dhe kulturës etj. Këto skema do të kenë si synim garantimin e të ardhurave për individët që dalin në pension më herët sesa mosha zyrtare e daljes në pension. Ato do të jenë kontributive, ku masa e kontributit do të ndahet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe do të krijohen mbi bazën e marreveshjeve kolektive. Mbikqyrja e këtyre skemave do të bëhet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Qëllimi i ligjit është të vendosë skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, parimet dhe procedurat e funksionimit të saj, si dhe menaxhimin e saj nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. E një rëndësie të veçantë është hapi i ndërmarrë në këtë ligj për shndërrimin e ISKSH-së në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësorë. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një ndryshim të emrit, por me krijimin e një Fondi që do të sigurojë fleksibilitet në financimin e shërbimeve shëndetësore, transparencë në administrim dhe besueshmëri maksimale të të siguruarit që kanë derdhur kontribute pranë tij.

Skema e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore, bazohet në kontribute dhe në parimin e solidaritetit dhe synon në mbulimin e popullsisë në përfitimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor duke synuar realizimin e një mbulimi universal të popullatës.

Në fushën e punësimit dhe aftësive qeveria miratoi, Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020, e cila fokusohet në çështjet kritike të punësimit dhe aftësive. Kjo strategji është një axhendë shumë e rëndësishme e zhvillimit të burimeve njerëzore në Shqipëri dhe si e tillë do të shqyrtohet nga strategjitë e tjera sektoriale, që kanë të bëjnë me politikat makro - zhvillimin ekonomik, fiskal dhe ekonomik.

Në fushën e mbrojtjes sociale janë ndërmarrë tri reformat kryesore, Reformat janë deklaruar me ligj nr. 84/2012 per ratifikimin e marreveshes se huase ndërmjet Shqiperise dhe bankës Nderkombetare per Rindertim dhe Zhvillim per financimin e Projektit te Modernizimit te Asistences Sociale. Gjithashtu mjane shpallur ne Strategjine Kombetar per Zhvillim dhe Integr si dhe ne Strategjine Kombetare per Mbrojtjen Sociale 2015/2020:
(i) Reforma e ndihmës ekonomike nga thjeshtimi i kritereve të përshtatshmërisë, krijimi i një regjistri kombëtar të integruar elektronik dhe përdorimi i formulës së pikëve në përzgjedhjen e përfituesve. Ai siguron transparencën e skemës, shmang abuzivitetin , garanton barazisnë dhe efikasitetit, përdorimin më të mirë të fondeve të buxhetit të shtetit dhe targetimin më të mirë të familjeve të varfra. Vitin e ardhshëm ne kemi për synim hapjen e skemës.Eshte duke u hartuar Plani per Ri-integrimin social dhe Ekonomik te grave dhe viktimave. (ii) Reforma e aftësisë së kufizuar synon kalimin e proçesit të vlerësimit nga një modeli mjekësor në një model social. Kjo reformë përfshin ngritjen e Regjistrit elektonik kombëtarë të integruar.Eshte hartuar dhe pritet miratimi i dokumentit politik per Aftesine e Kufizuar. (iii) Reforma e shërbimeve sociale është fokusuar në procesin e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të siguruar tipologji të reja të

shërbimeve komunitare dhe krijimin e strukturave sociale të shërbimeve të kujdesit në nivel lokal, për të ofruar shërbime cilësore për komunitetin nga stafet profesionale.

Po punohet për adresimin e çështjeve specifike për mosdiskriminimin e personave LGBTI në Shqipëri për periudhën 2016 – 2020, në përputhje me Rekomandimin i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010) 5 dhe dokumente të tjera të rëndësishme si: Raporti Universal i Rishikimit Periodik, i Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë i vitit 2014; dhe Raporti i 2015 i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë.
Ky dokument do të referojë përmirësime në legjislacion, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe ngritjen e kapaciteteve të administratës publike dhe të ofruesve të shërbimeve të ndryshme për publikun

Në kuadër të politikave rinore në Shqipëri është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 383 datë 06.05.2015"Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 – 2020" . Qëllimi i këtij Plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe forcimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse. Ministria e Mirëqenies sociale dhe e Rinisë është Institucioni përgjegjës për koordinimin e zbatimit dhe Monitorimit të PKVR 2015 – 2020.

Ka një ndërgjegjësim më të madh të publikut të gjerë dhe grupeve të veçanta mbi mjetet juridike për mbrojtjen nga diskriminimi. Kjo vërtetohet nga rritja e numrit të ankesave të regjistruara në KMD, dhe zbatimin e Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në gjykata. Disa ndryshime legjislative janë bërë në Kodin Penal. Qëndron ende një domosdoshmëri për të miratuar një legjislacion të ri, ose për të rishikuar legjislacionin ekzistues dhe masat e duhura për të siguruar respektimin e të drejtave të individëve që mund të jenë viktima të sjelljeve diskriminuese si romët dhe egjiptianët (rishikimi i kritereve për ndihmë ekonomike, për tu regjistruar apo për të përfituar strehim social), gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar.

Në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut është draftuar Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale i cili përcakton një kuadër politikash dhe monitorimi për përfshirjen sociale dhe integrimin për grupet vulnerabël.

Në zbatim të Ligjit Nr. 93/2014, datë 24.7.2014, janë miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 48, Datë 21.01.2015 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar" Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 708, datë 26.8.2015Përllojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor.; është finalizuar VKM Nr. 1074, Datë 23.12.2015, "Për masat e mënjanimit të pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike për Personat me Aftësi të Kufizuar"

Shqipëria ka dorëzuar në vitin 2015 Raportin e Parë Kombëtar për Konventën e të Drejtave e Personave me Aftësi të Kufizuar në dy-vjecarin e ratifikimit të Konventës". Riorganizimi i Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar si organ këshillimor dhe politikëbërës hap rrugën për përqasjen ndërsektorale në punën për të drejtat e PAK.Në kuadër të zbatimit të Konventës dhe në përgjigje të rekomandimeve të dhëna nga ky Këshill, po punohet për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, i cili do të adresojë ndërmjet të tjerash edhe konkluzionet e dala nga vlerësimi i Strategjisë Kombëtare të PAK 2005-2015.

Në kuadër të integrimit të komunitetit Rom dhe Egjyptian, Plani Kombëtar i Veprimit për Romët dhe Egjiptianët për periudhën 2016 – 2020 u miratua nga Qeveria shqiptare në Dhjetor 2015.

Përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mekanizmat për mbrojtjen dhe monitorimin e të drejtave të fëmijëve, janë përmirësuar dhe është kryer vlerësimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijët, 2012-2015. Ky vlerësim paracakton drejtimet për aktivitetet dhe masat kryesore që do të ndërmerren me hartimin e Axhendës së veprimit.Plani i ardhshëm do të përmirësojë bashëpunimin e ministrive të linjës dhe gjithë aktorëve përgjegjës për të përmirësuar kuadrin ligjor, të politikave në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës së fëmijve.

Plani do të ketë fokus në arsim, shëndetësi, politika sociale, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, drejtësi për fëmijët, ndërgjegjësimi, promovimi i të drejtave. Synojnë të adresojnë nevojat e fëmijëve më vulnerabël 2016-2020. Janë miratuar me VKM Nr. 573, 24.06. 2015 "Standardet mbi punën e NJMF" për përmirësimin e cilësinë e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal dhe për të krijuar bazën për inspektim të tyre nga strukturat në nivel qendror,dhe për të siguruar inspektimin e këtij shërbimi nga niveli qendror.

Prioritetet aktuale janë duke hartuar Agjendën e re Kombëtare për Fëmijët 2016-2020 dhe rishikimin e ligjit ekzistues Nr 10347 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", me qëllim të forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve duke krijuar mekanizma të rregullta monitorimi dhe të kontrolli për NJMF-të në nivel lokal , dhe duke siguruar alokimin adekuat të buxhetit për funksionimin e NJMF-ve.

Një protokoll për mbrojtjen e fëmijëve është miratuar dhe nënshkruar nga katër ministrat. Ky dokument përcakton procedurat që duhet të ndiqetnga profesionistët në fushën e arsimit, shëndetësisë, policisë, shërbimeve sociale, në mënyrë që të ofrojë mbrojtjen e duhur për fëmijët në nevojë.

Është miratuar Protokolli i ri për mbrojtjen e fëmijës si një Udhëzim i katër ministrave. Ky dokument specifikon në detaje mënyrën e ndjekjes së proçedurave për menaxhimin e fëmijës në rrezik nga strukturat e arsimit, shëndetësisë, policisë, shërbimeve sociale etj, dhe unifikon mënyrën e punës së të gjithë Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) në vend.

Është miratuar marrëveshja e bashkëpunimit për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Arsimit dhe Sportit. Plani i Veprimit për Fëmijët në situatë rruge 2015- 2017 është zhvilluar dhe i është bashkangjitur Marrëveshjes. Kjo synon ndërmarrjen e veprime të koordinuara sistemike për adresimin e situatës aktuale të fëmijëve që jetojnë, punojnë, lypin dhe shfrytëzohen në rrugë.

Aktualisht po punohet për hartimin e Planit të Veprimit për Fëmijë 2016 – 2020 dhe përmirësimin e ligjit Nr 10347 datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve".

Barazia gjinore, lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje janë prioritete të Qeverisë Shqiptare, prioritete të cilat përputhen edhe me hapat që po ndiqen për integrimin e vendit në Bashkimin Europian. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje, 2011-2015 ka kontribuar në:

- Përmirësim të ndjeshëm të kuadrit ligjor për nxitjen e përparimit të barazisë gjinore;
- Fuqizimin e grave dhe vajzave nëpërmjet pjesmarrjes së tyre në vendim-marrje, politike dhe ekzekutive – reflektuar edhe me ndryshimet në Kodin Zgjedhor në kuadër të zgjedhjeve vendore 2015, ku u vendos kuota prej 50% e përfaqësimit të secilës gjini në listat e kandidatëve për antare/ë në Këshillat Bashkiakë. Zbatimi i kësaj mase në praktikë tregoi se përfaqësimi i grave dhe vajzave në Këshillat Bashkiakë arriti 34% (nga 12% që ishte në zgjedhjet vendore 2011);
- Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave ka sjellë rritj*en e numrit të grave*, si në përgjithësi ashtu edhe brenda grupeve vulnerabël, të mbështetura me programme të punësimit dhe formimit profesional. Po kështu, kuadri ligjor në këtë drejtim *është përmirësuar* duke adresuar mbështetjen e gruas sipërmarrëse, shoqëruar kjo dhe me krijimin e një fondi të vecantë për gruan sipërmarrëse;
- Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, kanë zënë tashmë një vend të rëndësishëm në kuadrin ligjor dhe të politikave. Është rritur ndjeshëm numri i denoncimeve por edhe proçedimi i rasteve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe është punuar në drejtim të përmirësimit të mbrojtjes dhe ri-integrimit të viktimave/të mbijetuarave.

Ka filluar procesi ihartimit të Strategjisë së re të Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në familje 2016 – 2020 e cila do të synojë në veprime konkrete për të përmirësuar dhe fuqizuar mekanizmat institucionalë që sigurojnë monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor; veprime të mëtejshme për zbatimin në mënyrën e duhur në praktikë të përmirësimeve ligjore, si dhe për adresimin e çështjeve që ndikojnë në rritjen e aksesit dhe fuqizimin ekonomiko-shoqëror të grave në zonat rurale; ndërhyrje e mëtejshme, e mirëkoordinuar dhe shoqëruar me burime të mjaftueshme për: fuqizimin e mekanizmave ekzistues në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave të formave të ndryshme të dhunës dhe shtrirjen e tyre në mbarë vendin; ngritjen e shërbimeve të nevojshme, në numër të mjaftueshëm, të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme nga viktimat/të mbijetuarat, si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese me burime njerëzore e financiare (sipas standarteve dhe në përputhje edhe me instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar); harmonizimin e legjislacionit ekzistues me detyrimet ndërkombëtare si dhe përmirësimin e tij me qëllim, që të adresohen të gjitha format e dhunës.

Në dhjetor 2015, Parlamenti miratoi Ligjin No.136, datë 2015/05/12, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" Kodi i Punës është në përputhje me *acquis-in* për shëndetin dhe sigurinë në punë, mosdiskriminimit, marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe ofrimin e sigurimeve shoqërore në një sërë profesionesh të pambrojtura.

Për sa i përket *shëndetit dhe sigurisë në punë*, janë miratuar katër rregullore të reja, të cilat mbulojnë risqet që vijnë nga fushat elektromagnetike, rrezatimi optik artificial, zhurmat dhe vibracionet, duke synuar përafrimin e legjislacionit me *acquis*. Qeveria miratoi legjislacionin dytësor lidhur me masat e sigurisë për gratë shtatëzane, mbrojtjen e të miturve në vendin e punës dhe industrinë e peshkimit. U bënë përpjekje për të përmirësuar inspektimet e punës duke trajnuar inspektorët për zbatimin e legjislacionit tëri për sigurinë dhe shëndetin dhe duke zgjeruar raportimin elektronik tek Inspektoriatet Rajonale të Punës. Raportimi i aksidenteve dhe inspektimet e punës për zbulimin e punonjësve të padeklaruar u përmirësua. Numri i aksidenteve të raportuara në punë është rritur nga 86 në 2013, në 111 raste në vitin 2014.

Gjithashtu në tetor 2015 u ratifikuan Konventa për Punën Detare (MLC 2006).

Në lidhje me *dialogun social*, Këshilli Kombëtar i Punës (KKP) po funksionon plotësisht; megjithatë nevojiten më shumë përpjekje për marrëveshjet kolektive në të gjitha nivelet dhe për rritjen e kapaciteteve të partnerëve socialë për të negociuar marrëveshje kolektive. Disa partnerë social shprehën shqetësim për përjashtimin e tyre nga 6 Këshillat (KKP) tripalësh.Dialogu social dypalësh duhet të përmirësohet dhe autonomia e partnerëve socialë ka nevojë të rritet.Mbetet shumë për t'u bërë për zhvillimin e dialogut social në nivel vendor dhe ndërmarrjesh.

I.3 Struktura e kapitullit

1. LEGJISLACIONI I PUNËS
2. KËRKESAT E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË
3. DIALOGU SOCIAL
4. PUNËSIMI DHE FONDI SOCIAL EUROPIAN
   4.1. POLITIKAT E PUNËSIMIT TË TË RINJVE
5. PËRJASHTIMI SOCIAL
   5.1. ROMËT
   5.2. PERSONAT NE AFTESI TËKUFIZUAR
   5.3. FËMIJËT
6. SIGURIA SOCIALE
   6.1. MBROJTJA SOCIALE
   6.2. SIGURIMI SHOQËROR
   6.3. SIGURIMI SHËNDETËSOR
7. ANTIDISKRIMINIMI DHE SHANSET E BARABARTA
   7.1. TRAJTIMI I BARABARTË I PUNËTORËVE TË HUAJ TË PUNËSUAR
   7.2. SHANSET E BARABARTA
   7.3. ANTIDISKRIMINIMI

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimet në fushën e politikave sociale dhe punësimit rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, dhe më saktësisht nga neni 99 mbi "Zhvillimin, përmirësimin e sistemit të sigurimeve shoqërore", neni 48 mbi "Koordinimin e sistemeve të mbrojtjes shoqërore, për shtetasit komunitare punonjës në territorin shqiptar dhe për shtetasit shqiptar, punonjës në vendet e Bashkimit Evropian".

Nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimit si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave në fushën e tregut të punës dhe formimit profesional me rregullat dhe standardet komunitare.

Gjithashtu, neni 70 bashkë me nenin 99 “Bashkëpunimi social” janë të rëndësishëm në këtë fushë.

Direktivat Europiane mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Punë që janë pjesë e Kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC

1. Direktiva e Këshillit 89/654/EEC datë 30 nëntor 1989 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës (Direktiva e parë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
2. Direktiva e Këshillit 89/655/EEC datë 30 nëntor 1989 mbi kërkesat minimale për përdorimin e pajisjeve të punës prej punëtorëve në vendin e punës (Direktiva e dytë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
3. Direktiva e Këshillit 89/656/EEC datë 30 nëntor 1989 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin nga ana e punonjësve të pajisjeve individuale të punës, në vendin e punës (Direktiva e tretë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
4. Direktiva e Këshillit 90/269/EEC datë 29 Maj 1990 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për ngritjen manuale të peshave ku ka rrezik të veçantë për dëmtim të shpinës për punonjësit (Direktiva e katërt brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
5. Direktiva e Këshillit 90/270/EEC datë 29 maj 1990 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje që kanë ekran/monitor demonstrimi (Direktiva e pestë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
6. Direktiva e Këshillit 90/394/EEC datë 28 Qershor 1990 mbi mbrojtjen e punonjësve prej ekspozimit me lëndë kancerogjene, në punë (Direktiva e gjashtë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
7. Direktiva e Këshillit 90/679/EEC datë 26 nëntor 1990 mbi mbrojtjen e punonjësve prej rreziqeve të lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë (Direktiva e shtatë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
8. Direktiva 2000/54/EC mbi mbrojtjen e punonjësve prej rreziqeve të lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë (Direktiva e shtatë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC), i ndryshuar
9. Direktiva e Këshillit 92/57/EEC datë 24 qershor 1992 mbi zbatimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit në kantieret e ndërtimit të përkohshme ose portative (Direktiva e tetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
10. Direktiva e Këshillit 92/58/EEC datë 24 qershor 1992 mbi kërkesat minimale për sigurimin e shenjave (tabelave) të sigurisë dhe/ose shëndetit në vendin e punës (Direktiva e nëntë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
11. Direktiva e Këshillit 92/85/EEC datë 19 tetor 1992 mbi vendosjen e masave për të nxitur përmirësimet për shëndetin dhe sigurinë në punë të punonjëseve shtatëzëna dhe punonjësve që kanë lindur në një kohë të afër apo janë në fazën e ushqyerjes së fëmijës me gji (Direktiva e dhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)

12. Direktiva e Këshillit 92/91/EEC datë 3 nëntor 1992 mbi kërkesat minimale për përmirësimin mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në industritë e nxjerrjes (përmes shpimeve) të mineraleve (Direktiva e njëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
13. Direktiva e Këshillit 92/104/EEC datë 3 Dhjetor 1992 mbi kërkesat minimale për përmirësimin mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punonjësve në industritë e nxjerrjes së mineraleve nëntokë apo në sipërfaqe (Direktiva e dymbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
14. Direktiva e Këshillit 93/103/EC të 23 nëntor 1993 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën në mjetet detare të peshkimit (Direktiva e trembëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
15. Direktiva e Këshillit 98/24/EC të 7 Prill1998 mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të lidhura me agjentët kimikë në punë (Direktiva e katërmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
16. Direktiva 1999/92/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 1999 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punonjësve që janë nën rrezikun e atmosferave shperthyese (Direktiva e pesëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
17. Direktiva 2002/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin prej agjentëve fizikë (vibrimi) (Direktiva e gjashtëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
18. Direktiva 2003/10/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 shkurt 2003 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin prej agjentëve fizikë (zhurma) (Direktiva e shtatëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
19. Direktive 2004/40/EC mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin prej agjentëve fizikë (fushat elektromagnetike) (Direktiva e tetëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
20. Direktive 2006/25/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2006 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin prej agjentëve fizikë (rrezatimi optik artificial) - (Direktiva e nëntëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)
21. Direktiva 94/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 mars mbi përafrimin e Ligjit të Shteteve Anëtare të lidhur me pajisjet dhe sistemet mbrojtës të synuar për t'u përdorur në atmosfera (presion ajri) me rrezik shpërthimi (ATEX).
22. Direktiva e Komisionit 2000/39/EC e datës 8 qershor 2000 që formulon një listë fillestare të kufirit të vlerave treguese në lidhje me ekspozimin në zbatim të Direktivës së Këshillit 98/24/EC mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të agjentëve kimikë në punë.
23. Direktiva 2003/670 EEC e datës 19 shtator 2003 "Për miratimin e listës së sëmundjeve profesionale"

24. Harmonizimi i rregullave kombëtare në lidhje me parandalimin e rreziqeve të mëdha për aksidente në bazë të Direktivës Seveso II. Nr 96/82/EC mbi kontrollin e rreziqeve të mëdha për aksidente që përfshijnë substancat e rrezikshme.
25. Direktiva 2003/88/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 nëntor 2003 "Mbi disa aspekte të rregullimit të kohëds së punës"
26. Direktiva 91/383 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për punëmarrësit me kontratë punë me afat të caktuar dhe kohë të pjesshme"

Rregullorja 883/2004
Direktiva 79/7/EEC
Direktiva 86/378/EEC
Direktiva 2000/43/EC
Direktiva 2000/78/EC
Direktiva 2004/113/EC
Direktiva 2006/54/EC
Direktiva 96/71/EC
Direktiva 2002/14/EC
Direktiva 97/81/EC
Direktiva 2000/43/EC
Direktiva 2006/54/EC
Direktiva 2003/88/EC
Direktiva 91/533/EEC
Direktiva 1999/70/EC

Direktiva 2008/104/EC
Direktiva 98/59/EC
Direktiva 2001/23/EC
Direktiva 2010/18/ EC
Direktiva 92/85/EEC
Direktiva 94/33 EC
Direktiva 98/59/ EC
Direktiva 2001/23/EC
Direktiva 89/391/EEC
Direktiva 2009/104/EC
Direktiva 2009/104/EC
Direktiva 89/656/EEC
Direktiva 90/269/EEC
Direktiva 90/270/EEC
Direktiva 2004/37/E
Direktiva 2000/54/EC

Direktiva 92/57/EEC
Direktiva 92/58/EEC
Direktiva 93/103/ EC
Direktiva 98/24/EC
Direktiva 1999/92/EC
Direktiva 2002/44/ EC
Direktiva 2003/10/ EC
Direktiva 2013/35/ EEC
Direktiva 2006/25/EC
Direktiva 2000/39/ EC
Direktiva 90/641/ EC
Direktiva 94/33EC
Direktiva 92/29/EEC
Direktiva 2009/148/EC
Direktiva 89/654 EEC
Direktiva 92/91 EEC
Direktiva 92/104 EEC
Direktiva 2009/50/EC
Direktiva2003/86/EC
Direktiva 2004/114/EC

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e thotë qartë se të huajt në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë, të

cilat rrisin hapësirat dhe heq kufizimet për të drejtat e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë.

- Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar me ligjin no. 9602, datë 28.07.2006, Ligjin Nr.10 137, datë 2009/05/11, ligji nr. 10 252, datë 2010/03/11, Ligji Nr.10 399, datë 2011/03/17, ligji nr. 25/2013, datë 14.02.2013 Ligji nr. 47/2014, datë 24.04.2014;
- Në dhjetor 2015, Parlamenti miratoi Ligjin No.136, datë 2015/05/12, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"
- Ligji Nr. 108/2013, datë 28.03.2013 “Për të Huajt”;
- VKM. Nr. 265, date 7.5.2014, për “Përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare”.
- Ligji Nr. 7703, date 11.05.1993 “Për Sigurimin Shoqëror ne RSH”;
- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore"; i ndryshuar;
- Ligji nr. 7995 datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 8444, date 21.0.1.1999, me ligjin Nr. 8862 date 7.03.2002, me ligjin 9570 date 3.7.2006, dhe me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009;
- VKM Nr. 818 datë 26.11.2014 “Për Strategjinë e Punësimit dhe Aftësive 2014 - 2020”
- VKM nr 47, datë 16.01.2008 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë", i ndryshuar VKM nr 683, datë 5.10.2011; VKM nr 193, datë 2.4.2014; VKM nr 458, datë 9.7. 2014.
- VKM nr 48, 16.01.2008 "Për masën dhe përfitimet nga kriteret e programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi", ndryshuar me VKM Nr 991, datë 2.07.2008; VKM nr 923, datë 10.11.2010 , VKM Nr.192, datë 2014/02/04, VKM nr 461, datë 2014/07/09.
- VKM nr 27, datë 1012/01/11 "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta" ndryshuar me VKM Nr 189, datë 2014/02/04, VKM nr 459, datë 2014/07/09.
- VKM Nr 873, datë 27.12.2006 "Për shumën e financimit, kriteret dhe procedurat për zbatimin e programeve të stazhit për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, në shtëpi ose jashtë vendit", ndryshuar me VKM Nr 187, datë 2014/02/04.

- VKM nr 199, datë 11.01.2012 "Për shumën e financimit, kriteret dhe procedurat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, të rinj", ndryshuar me VKM nr 188, datë 2014/02/04, VKM Nr 464, datë 9.07.2014.
- VKM Nr.248, datë 30.04.2014 "Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar", të ndryshuar me VKM nr 460, datë 2014/07/09.
- Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2020 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin Nr. 10011, datë 30.10.2008 dhe Ligjin Nr. 10434, datë 23.06.2011;
- Ligji nr. 10347, dt 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve";
- Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 126/2013, datë 04.25.2013, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10383, datë 24.02.2011, 'Për sigurimet e detyruara të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 184/2013, datë 28.12.2013, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10383, datë 24.02.2011, 'Për sigurimet e detyruara të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- VKM Nr. 124, datë 03.05.2014, "Për miratimin e statutit të Fondit të sigurimevetë detyruara të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- VKM Nr. 135, datë 03.12.2014, "Për miratimin e listës së ilaçeve të rimbursuara dhe vlera e shumës që mbulohet nga Fondii sigurimeve të detyruara të Kujdesit Shëndetësor";
- VKM Nr. 1, datë 01.08.2014, "Për financimin e shërbimeve primare të kujdesit shëndetësor nga skema e sigurimeve të detyruara të kujdesit shëndetësor";
- Ligji Nr. 144/2013 " Për disa ndryshime në Kodin Penal të RSH";
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri";
- Ligji Nr. 9690 , datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare";
- Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për disa

ndryshime në Ligjin Nr. 7952, datë 21.06.1995 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”;

- Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH-së”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22. 08. 1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 5.8.1996 “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994 “Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve”;
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, të miratuar me V.K.M nr. 538, datë 12.08.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013);
- Udhëzim nr. 14, datë 09.03.1994 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999,“Për Avokatin e Popullit” i plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000;
- Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
- V.K.M nr. 633, datë 18.09.2003 për miratimin e Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”;
- V.K.M nr. 127, datë 11.03.2004 “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet”;
- VKM nr. 508, datë 8.08.2007 “Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr. 632, datë 18.09.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, femra”;
- VKM nr. 437, datë 8.04.2008 “Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të RSH-së në Deklaratën “Dekada e Përfshirjes së Romëve”;
- VKM nr. 366, datë 15.04.2009 “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”;
- VKM nr. 1087 datë 28 .10.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015”;
- Ligji nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune”;
- Ligji Nr.93/2014 date 25.07.2014 “ Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar”;

- Ligji Nr. 7995, datë 20.09.1995, “Për Nxitjen e Punësimit”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8444, datë 21.0.1.1999, Ligjin Nr. 8862, datë 7.03.2002, Ligjin Nr. 9570, datë 3.7.2006, dhe Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009;
- Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2002, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10011, datë 30.10.2008, dhe Ligjin Nr. 10434, datë 23.06.2011;
- Ligji Nr. 10383, dated 24.2.2011, “‘Për sigurimet e detyruara të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili hyri në fuqi në 25 Mars 2013.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Në Portin e Shëngjinit, ka përfunduar zbatimi i dy projekteve. I pari është IPA 2008 "Përmirësimi i Sektorit Detar Shqiptar, Rehabilitimi i Portit të Shëngjinit", me financim në vlerën e përafërt 3,6 milion Euro. Projekti tjetër është "Thellimi i Basenit", një financim i Qeverisë Shqiptare, në vlerën e përafërt 1 milion Euro. Aktualisht në port përpunohen tragete dhe anije deri në 8 000 ton.

Shqipëria ka marrë pjesë aktive në Observatorin e Transportit të Evropës Jug-Lindore (SEETO), dhe synon të vazhdojë bashkëpunimin me vendet fqinje, me qëllim përcaktimin e përbashkët të projekteve me interes rajonal, shkëmbimin e informacionit mbi projektet aktuale infrastrukturore dhe projekteve prioritare për të ardhmen.

Për sa i përket rrjeteve të energjisë elektrike, sistemi energjetik shqiptar deri në fund të vitit 2011, ka qenë i lidhur me vendet fqinje nëpërmjet linjës 400 kV me Greqinë, linjës 220 kV me Kosovën, dhe linjës 220 kV me Malin e Zi. Si rrjedhojë rrjeti energjetik shqiptar është pjesë e rrjeteve Trans - energjetike evropiane.

Në vitin 2011 është vënë në punë linja e interkonjeksionit 400 kV Elbasan-Tiranë-Podgoricë (Mali i Zi). Ka filluar puna në terren për ndërtimin e linjës së re të interkonjeksionit 400 kV Tiranë - Kosovë, e cila parashikohet të vihet në punë brenda vitit 2016. Qendra e re Kombëtare Dispeçer është në ndërtim.

Në lidhje me sistemin e transmisionit të energjisë elektrike në Shqipëri, profili i tensionit në rrjetin kryesor të 400 kV dhe 220 kV është në përputhje me kriteret e UCTE, në pjesën më të madhe të tij. Rrjeti 220 kV është i integruar plotësisht në rrjet unazor, duke lidhur hidrocentralet kryesore në veri të Shqipërisë me qendrat e ngarkesës në rajonet e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Rrjeti 110 kV është përdorur për furnizimin e sistemit të shpërndarjes.

Shqipëria nuk është e lidhur me rrjetet rajonale dhe evropiane të gazit natyror. Rrjeti ekzistues i tubacionit të gazit (që administrohet nga Albpetrol Sh.A.) është i amortizuar, për shkak dhe të mospërdorimit në 20 vitet e fundit.

Shqipëria ka marrë pjesë aktive në iniciativën e vendeve të Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore (CESEC), për ndërlidhjen e burimeve të furnizimit me gaz dhe sigurinë e tij. Në samitin e CESEC mbajtur në Dubrovnik, Kroaci, më 10 korrik 2015, Ministrat e Energjisë dhe përfaqësuesit e nivelit të lartë të sektorit të energjisë nga 15 vendet e Evropës Juglindore e Qendrore dhe BE-së (DG Energy), nënshkruan "Memorandumin e Mirëkuptimit mbi një qasje të përbashkët për të adresuar diversifikimin dhe sfidat e sigurisë së furnizimit me gazit natyror si pjesë e nismës së ndërlidhshmërisë së Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore Gas Lidhshmëria (CESEC)". Pjesë e këtij MoM është edhe Shtojca me "Planin e Veprimit", ku janë renditur projektet prioritare të gazit duke përfshirë projektin e gazsjellësit TAP. Me kërkesën e përfaqësuesit shqiptar, në këtë dokument projekti IAP është përfshirë si një projekt i mundshëm rajonal i gazit.

Shqipëria po garanton një zbatim të sigurt dhe në kohën e duhur të projektit TAP. Shqipëria është duke bashkëpunuar me Kroacinë, Malin e Zi dhe Bosnjë e Hercegovinën në eksplorimin e mundësive për realizimin e projektit IAP.

Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) është përzgjedhur fitues në 28.06.2013 për të transportuar gazin nga fushat gazmbajtëse Shah Deniz II, Azerbajxhan, në Itali, përmes Turqisë dhe Greqisë. Në kuadër të këtij projekti është miratuar "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin Trans Adriatik Pipeline (projekti TAP)", ratifikuar me Ligjin Nr. 104/2013 të 25.03.2014, si dhe "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Gazsjellësit Trans Adriatik AG, në lidhje me projektin e Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP)", ratifikuar me Ligjin Nr. 116/2013 të 15.04.2013. Në 8.04.2014, TAP ka marrë lejen zhvillimore komplekse nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 1081, datë 18.12.2013, ka ngritur një komision ndërinstitucional për të koordinuar institucionet shqiptare, në lidhje me zbatimin e projektit TAP.

Pas miratimit të Autorizimit të Ndihmës Shtetërore, me Vendimin nr. 49, datë 29.9.2014 të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe konfirmimit nga kompania TAP AG, deklarohet se HGA ka hyrë në fuqi efektivisht në datën 11 Nëntor 2014.

Aktualisht projekti TAP është në fazën e implementimit. Në datën 3 korrik 2015 u zhvillua ceremonia inaguruese e fillimit të punimeve të ndërtimit për rrugët ndihmëse të projektit TAP, si dhe janë miratuar lejet përkatëse për punimet e ndërtimit për 17 rrugë hyrëse dhe për rehabilitimin apo ndërtimin e 52 urave në rruget që do të përdoren nga shoqëria TAP AG.

Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri, me Vendimin e tij Nr. 100, datë 05.08.2015, ka miratuar "Rregulloren për certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Gazit". Ndërsa me Vendimin Nr. 101, datë 05.08.2015, ERE ka nisur procedurat për "Për nisjen e procedurave për pranimin e dokumenteve për licencimin e TAP si operator i sistemit të transmetimit".

Me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të Ligjit të ri "Për sektorin e gazit natyror" (ligji nr.102, datë 23.09.2015), i cili implementon Paketën e Tretë të Energjisë së BE-së për sektorin e gazit, krijohet i gjithë kuadri i nevojshëm ligjor për zbatimin e procedurave përkatëse nga ana e ERE.

Ndërkohë, për sa i përket projektit të gazsjellësit Ionian Adriatik (Projekti IAP), në 5 qershor 2015 u nënshkrua në Budva, Mali i Zi, "Deklarata e Përbashkët për projektin e Gazsjellësit Ionian Adriatik", nga ana e Ministrave të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnjës e Hercegovinës, si dhe Kroacisë.

Në kuadër të Rrjeteve Trans Evropiane të Energjisë Shqipëria është duke realizuar Master Planin e Gazifikimit të Shqipërisë, me një financim prej 1,1 milionë Euro nga WBIF, Ky Master Plan, që parashikohet të mbarojë në tetor të vitit 2016, do të kontribuojë direkt në diversifikimin e rrugëve të furnizimit me gaz si dhe në rritjen e sigurisë së furnizimit edhe të Rajonit, por edhe më gjerë në kuadër të Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore. Aktualisht është dorëzuar nga ana e konsulentit COWI IPF dokumenti final i "Raportit fillestar" në kuadër të Master Planit të Gazit.

Për prioritizimin e projekteve në transport, energjetikë dhe rrjetet e transportit, energjisë, mjedisit, etj, është kompetencë e Komitetit Kombëtar të Investimeve (KKI), rolin e të cili e luan Komiteti Ndërministror për Planifikimin Strategjik sikurse përcaktuar nga Urdhri i Kryeministrit Nr. 113, datë 26.8.2015 "Për disa shtesa në Urdhrin Nr. 18, datë 22.1.2014 të Kryeministrit, "Për krijimin e Komitetit Ndërministror të Planifikimit Strategjik". Sikurse përcaktuar në Urdhër, KKI do të të bëjë planifikimin, prioritizimin, parashikimet për mbështetjen financiare dhe miratimin e investimeve me përmasa dhe për projekte rajonale, me rëndësi të veçantë për Shqipërinë dhe bashkëpunimin në rajon.

Ngritja e KKI ishte realizim i një rekomandimi të Komisionit Evropian dhënë për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. KKI zbaton një metodologji të re pune si bazë për dhënien e menaxhimin e asistencës së BE-së për investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të kësaj metodologjie, çdo shtet do të hartojë paketat kombëtare të projekteve të përbërë nga paketat kombëtare sektoriale. Në këtë

mënyrë, këto projekte do të kenë akses më të madh në burimet e financimit dhe fondet e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare financiare.

I.3 Struktura e kapitullit

1. Rrjetet Evropiane të Transportit
2. Rrjetet Evropiane të Energjisë
3. Rrjetet Trans-Evropiane të Transportit

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Në fushën e Transportit, përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian është një detyrim në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Protokollit 5, më konkretisht neni 70, neni 106 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe neneve 4 dhe 5 të protokollit 5, "Mbi transportin tokësor". *Në fushën e rrjeteve të energjisë* përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, parashikohet në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Legjislacioni i BE-së në këtë kapitull përfshin, ndër të tjera:

- Rregullore (BE) Nr 1315/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 Mbi udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjetit të transportit trans-evropian,që shfuqizon Vendimin Nr 661/2010/BE;
- Rregullore (BE) Nr 1316/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetor 2013 për krijimin e "Connecting Europe Facility", që ndryshon Rregulloren (BE) Nr 913/2010, që shfuqizon Rregulloret (EC) Nr 680/2007 dhe (EC) Nr 67/2010;
- Rregullore (BE) Nr 347/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 prill 2013 Mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane, që shfuqizon Vendimin Nr 1364/2006/EC dhe ndryshon Rregulloret (EC) Nr 713/2009, (EC) Nr 714/2009 dhe (EC) Nr 715/2009;
- Rregullore (KE) Nr 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrik 2009 Mbi kushtet për qasjen në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike, që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr 1228/2003;
- Rregullorja (KE) Nr 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrik 2009 Mbi kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror, që shfuqizon Rregulloren (EC) Nr 1775/2005.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, është i harmonizuar me Direktivën e Këshillit 96/53/EC të 25 Korrikut 1996, "Përcaktimi, për disa mjete rrugore që qarkullojnë në Komunitetin Evropian, i përmasave maksimale të autorizuara, në trafikun kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe peshave maksimale të autorizuara në trafikun ndërkombëtar";
- Ligji nr. 9501, datë 3.04.2006 "Për ratifikimin e Traktatit të themelimit të Komunitetit të Energjisë";
- Ligj nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror".

II.3 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Portet detare, sha;
- Autoriteti Portual Durrës;
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Enti Rregullator i Energjisë.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Viti	2016	2017	2018
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	5	155	5
Buxheti total për këtë kapitull i institucioneve të tjera	0	0	0
Buxheti total i Kapitullit	5	155	5

III. Prioritetet

Prioritetet në kapitullin 21 janë:

- Ndërtimi i korridoreve kryesore rrugore të transportit me parametrat teknike të autostradave interurbane, duke përfshirë Korridorin 8 Pan-Evropian, Korridorin Durrës-Morinë, që bën të mundur lidhjen me Korridorin 10, Korridorin Rrugor Veri-Jug (pjesë e Autostradës Adriatiko – Joniane) , Rrugën e Arbrit, si një degë e Korridorit 8 dhe Aksin Qendror Jugor;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe eliminimi i pikave të zeza;
- Më shumë vëmendje i duhet kushtuar Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor për projektet rrugore që janë zbatuar;
- Integrimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor shqiptar në rrjetin rajonal të Evropës Juglindore, si dhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Maqedoninë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës portuale në Shqipëri;
- Pjesëmarrje aktive në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe bashkëpunimi i mirë me fqinjët në rajon, duke synuar përcaktimin e projekteve prioritare me interes rajonal;
- Rritja e sigurisë energjetike nëpërmjet diversifikimit të furnizimit dhe integrimit të mëtejshëm të rrjetit shqiptar të energjisë elektrike në rrjetet rajonale dhe evropiane, energjia e rinovueshme;
- Kuadri ligjor i përmirësuar, i përafruar me *acquis* përkatëse të BE-së në këtë fushë, sidomos përputhja me Paketën e Tretë të Energjisë të BE-së nga 1 janari 2015;
- Rritja e investimeve në sektorin e energjisë;
- Gazifikimi i Shqipërisë, duke përfituar nga realizimi i projektit Trans Adriatik Pipeline – (Projekti TAP).

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2015 – 2017

IV.1 Rrjetet Trans-Evropiane të Transportit

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Plani Kombëtari Transportit	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2016– 2030

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 96/53/BE	Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998,	Ministria e Transportit dhe	I pjesshëm	22.07.1998	21.7.1999

	"Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.	Infrastrukturës			

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Kuadri i Politikave të Planifikuara	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Sektoriale e Transportit 2016 – 2020	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2016– 2020	Tremujori IV 2016	Tremujori IV 2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

Acquis e BE	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFATSHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFATMESËM (2017– 2018)							
Rregullore (BE) Nr. 1315/2013	Jo	VKM "Mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rrjetin Trans evropian TEN-T"	Jo	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Autoriteti Rrugor Shqiptar	I pjesshëm	Tremujori II 2017	Tremujori III 2017

IV.2 Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor përgjegjës	Periudha kryesore e referencës
Strategjia Kombëtare e Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2006 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e rregullimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2009/73/(KE)	Ligj nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.9.2015	30.10.2015
Rregullorja (KE) Nr 715/2009	Ligji nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për sektorin e gazit natyror".	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	23.9.2015	

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Kuadri i Politikave të Planifikuara	Institucioni kryesor	Periudha e referencës	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia e Energjisë e Republikës së Shqipërisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015 – 2030	Tremujori II 2016	Tremujori II 2016

Masat ligjore për periudhën 2016 – 2018

Acquis e BE	Statusi përkthimi anglisht (po / jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi përkthimi anglisht (po / jo)	Pika Përgjegjëse dhe kontaktet	Shkalla e përafrimit	Data e planifikuar për adaptim	Hyrja në fuqi
AFATSHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFATMESËM (2017 - 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve të buxhetit të shtetit

Kapitulli 21					000/ lekë
Përfituesi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kostot që do të financohen nga Buxheti i Shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
VKM "Mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rrjetin Trans evropian TEN-T"	A) Pagat - Stafi ekzistues		150		150
	B) Pagat - Stafi ri	0	0	0	0
	C) Trajnime	0	0	0	0
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet e vazhdueshme	5	5	5	15
	Aktiviteti i përgjithshëm	**5**	**155**	**5**	**165**

Tabela B – Fonde të planifikuara nga ndihma e huaj

Kapitulli: 21				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i projektit**	**Titulli i Programit /dhuruesi**	**Vlera në €**	**Aktivitetet**
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i By-Pass-it të Rrogozhinës	Delegacioni Evropian.	5,689,856 EUR	By-pass-i i Rrogozhinës mbetet segmenti më i rëndësishëm i korridorit kryesor Perëndim-Lindje, i cili lidhet me korridorin rrugor Veri-Jug. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i By-Pass-it të Vlorës.	32% DKE & 34%BERZH & 34%BEI	BERZH 18 milionë Euro (kredi) BEI 18 milionë Euro (kredi) Delegacioni Evropian (17 milionë Euro Grant) i administruar nga BERZH (IPA 2011- Ndërtimi i	Ndërtimi i By Pass-it të Vlorës është projekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë. Aktivitetet kryesore të projektit

			Bypass-it të Vlorës).	lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	ByPass Shkozet dhe Nyja Vorë.	Fondi Kuvajtjan për Zhvillim.	Nyja Vore: Financimi i Huaj 4,361,858 Euro By Pass Shkozet, Financimi i Huaj: 9,006,560 Euro.	Ky projekt do të lehtësojë trafikun në të dy zonat. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i segmentit rrugor Damës-Tepelenë Loti.2 i Seksionit Levan-Tepelenë, pjesë e Korridorit Veri-Jug".	BEI/BERZH	45,486,200 EUR	Ky projekt i rëndësishëm është pjesë e korridorit rrugor Veri-Jug dhe vazhdim i segmentit Levan-Tepelenë, i cili do të ketë një impakt pozitiv në uljen e kohës së udhëtimit dhe në zhvillimin e zonës. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i By Pass-it të Fierit.	BEI/BERZH	BERZH 35 milionë Euro (kredi) BEI 35 milionë Euro (kredi)	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Veri-Jug Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Aksit Rrugor, Tiranë – Elbasan: Segmenti 1, (Sauk – Tuneli i Kërrabës).	IDB & Abu Dhabi	90,449,491 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Aksit Rrugor, Tiranë – Elbasan: Segmenti 3, (Tuneli i Kërrabës - Elbasan).	IDB, Abu Dhabi&OPEC Fund.	92,303,305 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.

Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Segmentit Rrugor Qukës-Qafë Plloçë, Seksioni Nr.1 dhe 2.	IDB	Lot-1: 38,199,652.84 USD Lot-2: 63,098,543.45 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtimi i Segmentit Rrugor Qukës-Qafë Plloçë, Seksioni Nr.3	Fondi Saudit per Zhvillim	33,396,000 USD	Ky është një projekt i rëndësishëm i korridorit rrugor Lindje-Perëndim. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me vepra ndërtimore.
Autoriteti Portual Vlorë	Rehabilitimi i Portit të Vlorës.	Qeveria Italiane	15,000,000 EUR (kredi) 300,000 EUR (grant)	Ndërtimi i dy kalatave lindore dhe perëndimore. Ndërtimi i një kalate për mallrat cargo. Thellimi i basenit të Portit. Rehabilitimi i sheshit të trageteve. Lehtësimi i akomodimit të udhëtarëve. Rikonstruksioni i ambienteve ekzistuese të Autoritetit Portual.
Autoriteti Portual Durrës	Ndërtimi i Terminalit të Pasagjerëve dhe Shesheve përreth tij (faza1) dhe Rehabilitimi i Kalatave 7&8 (faza 2) në Portin e Durrësit.	BEI/BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim 14 milion Euro (Kredi) Banka Evropiane e Investimeve 18 milion Euro (Kredi).	Projekti konsiston në ndërtimin e veprave civile të një terminali të ri pasagjerësh dhe rehabilitimin e kalatave 7&8 në portin e Durrësit).

KAPITULLI 22: POLITIKA RAJONALE DHE BASHKËRENDIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 22 "Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumenteve strukturore" fokusohet në zhvillimin e politikave rajonale, zhvillimin vendor dhe asistencën financiare që BE-ja i jep Shqipërisë. *Acquis* i këtij kapitull konsiston kryesisht në akte normative kuadër dhe zbatuese, që përcaktojnë rregullat për përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e kësaj asistence financiare në kuadrin e programit IPA. Këto programe negociohen dhe miratohen me Komisionin Evropian, por programimi dhe zbatimi janë përgjegjësi e Shqipërisë dhe Delegacionit të BE-së në Shqipëri. Shqipëria ka ngritur kuadrin institucional dhe kapacitetet administrative adekuate për programim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të shëndoshë dhe kosto-efikas nga pikëpamja e menaxhimit dhe kontrollit financiar. Neni 110 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) përcakton që palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Asistenca financiare e ofruar nga BE parashikohet nga nenet 112-115 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Bazuar në ligjin 115/2014 “Mbi ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes lokale në Republikën e Shqipërisë”, Shqipëria ndahet në 12 qarqe dhe 61 bashki.Ndërsa, për qëllime të raportimit NUTS II, Shqipëria organizohet në 3 rajone territoriale-statistikore (veriu, qendra dhe jugu).

Objektivi i Qeverisë shqiptare në këtë fushë është eliminimi i pabarazive ekonomike, krijimi i rajoneve konkurruese, me një zhvillim të qendrueshëm ekonomik, social e mjedisor, dhe rrjedhimisht, zhvillimi ekonomik dhe social i vendit në përputhje me standardet e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Në janar 2015 u prezantua në Qeveri, koncepti i ri i Menaxhimit Rajonal, në Shqipëri, i konsideruar si një "veprim për zhvillim", për vitin 2015. Koncepti iu përgjigj domosdoshmërisë, për të patur një politikë koherente rajonale, në përputhje me orientimet e politikës së kohezionit të BE-së, duke siguruar krijimin e rajoneve konkurruese, me një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm për të gjitha rajonet e vendit.

Qasja e re fokusohet në hartimin e politikave zhvillimore, që sjellin perspektivën horizontale (territoriale), koordinuar me instrumentat sektorial (vertikale) dhe vendim-marrës. Arsyeja pas kësaj qasjeje, i ka rrënjët në nevojën për ndërhyrje të integruara për zhvillimin e territoreve dhe fuqizimin e potencialeve ekonomike të rajoneve, inkurajimin e modeleve të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe partneriteteve, reduktimin e diferencave socio-ekonomike midis rajoneve/territoreve dhe promovimin e fuqizimin e ekonomive lokale, rajonale e ndër-rajonale.

Për të të arritur këtë, lindi nevoja e vendosjes së objektivave të rinj të zhvillimit dhe e ngritjes së instrumentave politikë dhe financiar zhvillimor, me një fokus të rëndësishëm në krijimin e lidhjes së planifikimit hapësinor/territorial me zhvillimin edhe qeverisjen. Për të siguruar qëndrueshmëri dhe efikasitet, Qeveria Shqiptare ka vendosur kontekstin e duhur që kjo ndërthurje të ndodhë gradualisht, përmes përcaktimit të zonave të zhvillimit rajonal, ngritjes së strukturave zhvillimore, agjencive zbatuese të politikës rajonale, aplikimit të instrumentave financiar, si elementët kyç të Mekanizmit për Zhvillimin Rajonal.

Përsa më sipër, në Shtator të vitit 2015, u miratuan Zonat e Zhvillimit Rajonal (4 zona të zhvillimit rajonal), të cilat nuk janë zona/rajone administrative por janë zona/rajone zhvillimi. Për përcaktimin e këtyre zonave janë ndjekur 3 qasje zhvillimi, përkatësisht, i) qasje e pabarazisë: bazuar në mitigimin e problemeve përmes barazisë në akses, në burime dhe shërbime; ii) qasja mikse: bazuar në ekonominë, aksesin në infrastrukturë, burime, kufij administrativ dhe traditë historike bashkëpunimi; iii) qasje ekonomike: bazuar në grupimin e potencialeve të zhvillimit ekonomik, drejt interesit të përbashkët për zhvillim. Për seicilën nga qasjet janë vlerësuar treguesit e zonave, përkatësisht të ndarë në tre kategori, i) treguesit e zhvillimit ekonomik, konkurrencës dhe elasticitetit; ii) treguesit e qëndrueshmërisë mjedisore dhe ekonomia e gjelbër, iii) treguesit e aksesueshmërisë së rajoneve. Pas analizës së bërë dhe kryerjes së vlerësimit të treguesve u arrit në propozimin e 1 (një) opsioni të zonave të zhvillimit rajonal, për secilën qasje.

Opsionet e propozuara, kaluan në një fazë të dytë vlerësimi të treguesve, të karakteristikave respektive për seicilën zonë, si dhe të prespektivës së zhvillimit ekonomik dhe rajonal të zonës, duke mbërritur në propozimin e një opsioni të vetëm për Zonat e Zhvillimit Rajonal.

Për zbatimin e politikës kombëtare, rajonale u ngritën strukturat: i) Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), 4 Agjensitë e Zhvillimit Rajonal (AZZHR) dhe Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER).Agjencitë do të kenë rolin e një institucioni ekspert për implementimin dhe arritjen e objektivave për politikën e zhvillimit rajonal dhe të zhvillimit rural, me mision promovimin e një politike të përbashkët investimesh, të integruara, për zhvillimin e rajoneve dhe potencialeve të tyre, inkurajimin e një modeli sa më të gjërë bashkëpunimi, krijimin e partneriteteve publik-privat me interes të përbashkët zhvillimi, ngritjen e rrjetëzimeve rajonale dhe ndër-rajonale, zvogëlimin e dallimit hendekut mes ndërmjet zonave të zhvilluara dhe të pazhvilluara. si dhe hartimin e zbatimin e projekteve publike e private. Këto struktura u miratuan me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.961 dtaë 2 Dhjetor 2015.

Në lidhje me reformimin e mekanizmit ekzistues, të financimit për zhvillimin e rajoneve, Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, Shqipëria po të përgatitet, për të qenë në të jetë në një linjë me politikat e zhvillimit rajonal të BE-së, si edhe mundësuar përthithjen e fondeve strukturore.
Për vitin buxhetor 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është konsideruar si një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. Eshtë organizuar në 3 (tre) programe financimi, përkatësisht, i) Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale; ii) Programi i Mbështetjes për Ekonominë, dhe iii) Programi "Shqipëria dixhitale". Kjo qasje ndryshon nga ajo e plotësimit të nevojave bazë për infrastrukturë, si edhe e copëzimit në projekte të vogla dhe pa impakt zhvillimi, që është aplikuar më përpara, dhe do të orientohet drejt mbështetjes për projekte që gjenerojnë zhvillimin ekonomik të rajoneve, duke marr në konsideratë burimet dhe potencialet e komuniteteve rajonale, si dhe planet e programet zhvillimore në nivel vendor, rajonal e kombëtar; që ofrojnë asistencë për agjentët zhvillimor të interesuar për të hartuar e zbatuar projekte që mbështeten nga burime komplementare financimi (publike dhe/ose private); që mbështeten mbi partneritete ndërvendore e ndër-rajonale me natyrë komerciale, që i japin vlerë financimit dhe sigurojnë kthim të investimit.
Për vitin 2015, (Janar – Tetor 2015), Fondi për Zhvillimin e Rajoneve ka shpërndarë një portofol në vlerën e 86.8 mln Euro, duke financuar rreth 166 projekte te reja (59.3 mln Euro), dhe shlyer financimin për 184 projekte (27.5 mln Euro)

Aktualisht, Shqipëria përfiton prej BE-së fonde para-anëtarësimi (Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit - IPA) të programit të kaluar financiar 2007-2013 dhe ka filluar një perspektivë e re financiare perspektivën e re financiare 2014-2020. Prioritetet e vendit në perspektivën e re janë përcaktuar në Dokumentin Strategjik të vendit, që përcakton prioritetet në sektorët e përzgjedhur për asistencë të IPA-s. Sektorët dhe fushat prioritare për financim brenda sektorëve janë identifikuar bashkërisht nga BE dhe Shqipërisë, në përputhje me prioritetet politike të përcaktuara në Strategjinë e Zgjerimit dhe Progres-Raportin Vjetor të Komisionit. Janë marrë parasysh edhe strategjitë dhe politikat kyçe kombëtare të Shqipërisë.

1. Një tjetër dokument strategjik është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI), e cila së bashku me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, masterplanet, si dhe planet e veprimit formojnë kuadrin e plotë strategjik të zhvillimit të vendit. Ato përcaktojnë vizionin për prioritetet dhe objektivat e përgjithshme dhe specifike sipas afateve kohore afatmesme dhe afatgjata. Këto dokumente shërbejnë njëkohësisht si udhërrëfyes për monitorimin e zbatimit të reformave të Qeverisë, duke përcaktuar piketat e arritjes së qëllimeve.
2. Në kontekstin e politikave të qeverisë, SKZHI 2015-2020 përbën instrumentin kryesor për drejtimin e zhvillimit të vendit dhe në të njëjtën kohë reflekton lidhjen logjike midis zhvillimit të vendit dhe proçesit të integrimit Evropian
3. Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 merr edhe një rëndësi më të madhe tani që Shqipëria ka marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Aktualisht, në shtator të vitit 2015 është pergatitur drafti i konsoliduar i SKZHI-së, i

cili është konsultuar gjatë periudhës shtator - nëntor 2015 dhe janë të përfshirë në të sugjerimet dhe rekomandimet nga palët e interesuara, aktorët dhe partnerët e zhvillimit. Gjithashtu, drafti do t'i nënshtrohet konsultimit publik gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2015 dhe miratimi i SKZHI 2015-2020 do të përfundojë brenda vitit 2015.

4. Komiteti Kombëtar i Investimeve - Procesi per ngritjen e një pakete projektesh kombëtare është inicuar nga Komisioni Evropian (KE) përmes një Shënimi/Notes për anëtarët e Komitetit Drejtues të WBIF, e cila nënvizon "Mbështetjen ndaj Ballkanit Perëndimor për investime për projekte infrastrukturore për periudhën 2014-2020". Ai parashtron një metodologji të re pune që nevojitet të zbatohet nga të gjitha vendet e rajonit, si bazë për mbështetjen e BE-së për investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor.

5. Paketa Kombëtare e Projekteve (Single Project Pipeline), forcon identifikimin, përgatitjen dhe selektimin e projekteve në sektorët e energjisë, transportit, mjedisit dhe sektorit socialdhe është parakusht për marrjen e mbështetjes së IPA II për bashkë-financim. Në këtë kontekst, janë hartuar Paketat Sektoriale të Projekteve (Single Sector Project Pipeline) për këto sektorë, të cilat më pas shkrihen në një Paketë të vetme Kombëtare. Në këtë mënyrë do të kenë akses më të madh në burimet e financimit dhe fondet e Bashkimit Evropian dhe institucione të tjera ndërkombëtare financiare.Ekspertete IFICOkane dhënë mbeshtetjen për këtë proçes.

6. Mbështetja e Qeveria Shqiptare për ngritjen e NIC dhe nevojën për të krijuar një Paketë të vetme Kombëtare Projektesh, u konfirmua gjatë takimit të Ministerialit për Qeverisje Ekonomike dhe Ndërlidhje(Economic Governance & Connectivity Ministerial Meeting) për Ballkanin Perëndimor, të mbajtur në Beograd në 23 tetor 2014. Kjo mbështetje u ripohua në konferencën mbi "Përmirësimin ndërlidhjes dhe një rrjet të forte bazë " të Ministerialit WB6 mbajtur në Prishtinë 25 Mars 2015.

7. Rolin e NIK për Shqipërinë do ta luajë Komiteti Ndërministror për Planifikimin e Strategjik (KPS), si një mekanizëm i vetëm për planifikimin strategjik të investimeve kapitale. Sekretariat teknik për këtë proces është sekretariati teknik i KPS, pra Departamenti I Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

8. Ka filluar procesi per te zhvilluar procesin, për 4 sektorët transport, energji, mjedis (ujësjellës-kanalizime; mbrojtja nga përmbytja; ndotja e ajrit) dhe sektori social(arsim & sport,; shëndetësi; art-kulturë; mbështetja për burgjet; strehimi).

9. Janë plotesuar 112 fisha projektesh dhe është duke u përmbyllur faza e parë e vleresimit për cdo sektor (Paketat sektoriale), që kryhet nga ministritë e linjës. Gjatë muajit nëntor po kryhen takime me donatorët, për të paraqitur projektet për cdo sector. Procesi do të përmbajë edhe konsultimin me donatorët në nivelin e përgatitjes së Paketës Kombëtare. Miratimi final i PKP do të kryhet në KPS dhe afati i vendosur nga BE është brenda datës 15 Dhjetor (qëështë edhe data e Konferencës së Nivelit të lartë në Paris).

Programimi i Instrumenit financiar të mëparshëm të BE-së për periudhën 2007-2013 ka përfunduar dhe ka filluar një perspektivë e re financiare IPA II për periudhën 2014– 2020.Qasja aktuale e BE-së për alokimin e asistencës financiare ka ndryshuar plotësisht në perspektivën e IPA II, duke prezantuar risinë e *Mbështetjes Buxhetore*. Prioritetet e vendit për perspektivën e re janë përcaktuar në Dokumentin Strategjik të vendit

2014-2020. Sektorët dhe fushat prioritare për financim brenda sektorëve janë identifikuar bashkërisht nga BE dhe Shqipëria, në përputhje me prioritetet politike të përcaktuara në Strategjinë e Zgjerimit dhe Progres-Raportin Vjetor të Komisionit.

Programi IPA 2014 ishte viti i parë i programimit nën perspektivën e re financiare, kur u prezantua instrumenti i mbështetjes buxhetore (në sektorin e menaxhimit të Financave Publike). Ndërkohë, programi vjetor IPA 2015 në Shqipëri po finalizohet dhe ka filluar programimi i IPA 2016.

Nën perspektivën financiare IPA I (2007-2013), Komisioni Europian miratoi në 25 Mars 2014 vendimin për akreditimin e sistemit të menaxhimit të decentralizuar për komponentin e parë të IPAs me kontroll ex-ante dhe si rrjedhim 8 projekte nga IPA 2012 dhe IPA 2013 po implementohen nën përgjegjësinë e Qeverisë Shqiptare.

Në kuadrin e IPA II, të gjitha vendet duhet të aplikojnë për transferimin e përgjegjësive për menaxhimin e buxhetit. Shqipëria ka dërguar kërkesën për menaxhimin e IPA 2014 dhe ka filluar përgatitjet për IPA 2015. Plotësimi i disa kushteve të mbetura për IPA 2014 janë përfshirë në Marrëveshjen Financiare 2014 dhe do të jenë subjekt verifikimi. Vendimi i KE lidhur me IPA 2015 pritet nga fundi i Marsit 2016.

Gjithashtu, edhe në drejtim të programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar, Ministria e Integrimit Evropian ka koordinuar procesin për hartimin dhe finalizimin e tyre në kuadër të perspektivës së re 2014-2020. Puna e Ministrisë së Integrimit Evropian është fokusuar në ngritjen e grupeve të punës (Task Forcat) e përbashkëta, organizimin e konsultimeve publike, me qëllimin përfundimtar të miratimit nga KE të 8 (tetë) Programeve ku Shqipëria merr pjesë.

Draftet finale të programeve IPA CBC Shqipëri-Mal i Zi, Shqipëri-Kosovë dhe Maqedoni-Shqipëri, janë dorëzuar në Shtator të vitit 2014, dhe u miratuan nga KE në Dhjetor të vitit 2014. Aktualisht MIE është në proces të nënshkrimit të Marrëveshjeve të Financimit për tre Programet për sa i përket alokimeve financiare të viteve 2014 dhe 2015.

Në lidhje me programet e tjera me vendet anëtare është koordinuar procesi i ngritjes së Task Forcave të përbashkëta dhe u përfundua puna për hartimin e Programeve të reja Greqi-Shqipëri, Adriatiko-Jonian (Adrion), Ballkan-Mediterran, MED dhe Programi Trilateral Itali-Shqipëri-Mali i Zi, programe të cilat janë dorëzuar Komisionit Evropian në kohën e duhur. Përveç programit të fundit, të gjitha programet e tjera janë miratuar nga KE-ja gjatë vitit 2015, ndërsa Programi Trilateral me Italinë dhe Malin e Zi është në fazën përfundimtare të miratimit. Deri në Nëntor 2015 vetëm Programi MED ka lancuar thirrjen e parë për Propozime, ndërsa për Programet Greqi-Shqipëri dhe Adrion, vendet pjesëmarrëse e kanë

hartuar tashmë Manualin e Thirrjes së Parë, por ende nuk kanë shpallur Thirrjet. Programet e tjera do të shpallin Thirrjet e para për projekte gjatë gjysmës së parë të vitit 2016.

Lidhur me Bashkëpunimin Territorial, nevojiten ende përpjekje dhe procesi i decentralizimit do të kërkojë më shumë kohë.

Institucionet shqiptare do të vazhdojnë të marrin pjesë në disa Programe të BE-së (ish-komunitare).

Lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin, po ndiqen projektet problematike që implementohen në mënyrë të decentralizuar nga DBE, ndërkohë që MEI/sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit ka filluar implementimin e projekteve nën menaxhimin e decentralizuar (IPA I dhe IPA II).

Krahas Komitetit të Monitorimit të IPAs që po ndjek progresin e projekteve IPA cdo vit, do të ngrihen Komitetet Sektoriale të Monitorimit gjatë vitit 2016, sipas fushave kryesore të mbështetjes IPA II, për të implementuar projektet e asistencës së BE-së në sektorin përkatës.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE-së

Neni 110 i MSA-së parashikon se palët do të forcojnë bashkëpunimin për zhvillimin rajonal dhe vendor, me objektivin për të kontribuuar në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale.Konkretisht palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe interrajonal.Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.

Asistenca financiare që jep BE-ja përcaktohet në nenet 112-115 të MSA-së. Këto nene shprehen qartë se Shqipëria mund të përfitojë nga BE-ja asistence financiare në formën e granteve dhe huave, por së pari, Shqipëria duhet të përcaktojë prioritetet dhe të garantojë kapacitetet e duhura për përthithjen e kësaj asistence. MSA-ja kërkon që kontributet e Komunitetit të jepen në bashkërendim të ngushtë me kontributet prej burimeve të tjera si Shtetet Anëtare, vende të tjera dhe institucione financiare ndërkombëtare. Konkretisht, në përputhje me Nenin 112 të MSA, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Evropiane e Investimeve, BERZH etj. Ndihma e BE varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 29 prill 1997, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim Asociimit, Partneriteteve Evropiane, dhe të

konkluzioneve të tjera të Këshillit, të cilat i përkasin në mënyrë të veçantë respektimit të programeve rregulluese. Sipas MSA, ndihma që i jepet Shqipërisë do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.Përsa i përket Nenit 113 të MSA, Asistenca financiare, në formën e granteve, duhet të trajtohet nga masat operacionale të parashikuara në Rregulloren përkatëse të Këshillit brenda kuadrit indikativ shumëvjeçar të caktuar nga Unioni pas konsultimeve me Shqipërinë. Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik.Neni 114 i MSA sanksionon se, me kërkesë të Palës shqiptare dhe në rastet e nevojës së veçantë, Unioni, duke u koordinuar me institucionet ndërkombëtare financiare, mund të shqyrtojë mundësinë, duke bërë përjashtim, e dhënies së asistencës makro-financiare, e cila varet nga kushte të caktuara dhe duke marrë parasysh disponimin e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet vetëm kur përmbushen kushtet që do të vendosin në kontekstin e një programi për të cilin është rënë dakord mes Shqipërisë dhe FMN-së.Sa i përket nenit 115 të MSA BE dhe Shqipëria garantojnë që kontributet e BE të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me ato kontribute të ardhura nga burime të tjera si prej Shteteve Anëtare, vendeve të tjera dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.
Në këtë drejtim, informacioni për çdo burim të asistencës shkëmbehet rregullisht ndërmjet Palëve.

E drejta e BE-së në fushën e bashkëpunimit financiar konsiston, ndër të tjera, nga këto akte ligjore:

1. Rregullorja Zbatuese (BE) e Komisionit nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014 për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II);
2. Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Mars 2014 që përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II);

- Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që përcakton rregulla dhe procedura të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme;
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 e datës 17 korrik 2006 që përcakton instrumentin për asistencën e para-anëtarësimit (IPA);
- Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 718/2007 e datës 12 qershor 2007 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 që përcakton instrumentin për asistencën e para-anëtarësimit (IPA).
- Vendimi i Komisionit i datës 25.03.2014 mbi transferimin e menaxhimit të komponentit I – TAIB, të IPAs për Shqipërinë.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore normative

Në kuadër të perspektivës së re financiare IPA II (2014-2020), Marrëveshja Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të BE në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit, u nënshkrua në 9 Prill 2015 dhe u ratifikua me Ligjin Nr.37/2015.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 18.06.2015 "Mbi përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të IPA II (2014-2020)" u miratua dhe ka hyrë në fuqi.Ky vendim përcakton funksionet dhe përgjegjësitë dhe vendos marrëdhënie reciproke ndërmjet autoriteteve dhe strukturave për t'u akredituar me detyrën e implementimit të buxhetit (nga këtu e poshtë: menaxhimi indirekt/IM) për zbatimin e Instrumentve të BE-së për Asistencën në Programin e Para-Anëtarësimit IPA II (2014- 2020).
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1020, datë 14.10.2009, "Për krijimin e Agjencisë për auditimin e sistemit të zbatimit të Programit të BE-së" (i ndryshuar me VKM nr. 328 datë 13.05.2011, dhe VKM nr 235, datë 04.04.2012), në bazë të cilit autoriteti i auditimit funksionon, është ndryshuar përsëri me VKM Nr.539 datë 18.06.2015, duke pasqyruar të gjitha kërkesat e reja të Marrëveshjes Kuadër të IPA dhe VKM 856 të datës 21.10.2015, duke përfshirë kriteret e rekomanduara nga misioni i IPA IIlidhur me menaxhimin indirekt për IPA 2014.

Në mënyrë që të sigurojë autonomi të plotë buxhetore dhe për të ofruar siguri si një organ i pavarur, Qeveria ka hartuar një ligj i cili është dërguar për mendim për palët e interesuara përkatëse dhe KE.Ky ligj parashikohet të miratohet brenda vitit 2016.

Në vijim të rekomandimeve të auditorëve të KE mbi forcimin e rolit të KKIPA në programimin dhe monitorimin e IPA II, Kryeministri miratoi Urdhërin nr.22 datë 20.02.2015 "Mbi miratimin e strukturës dhe organizimit të Ministrisë së Integrimit Europian". Nëpërmjet këtij Urdhëri, Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të projekteve të BE-sëështë ngritur në Ministrinë e Integrimit Europian. Kjo drejtori përbëhet nga 4 sektorë (tre sektorë programimi dhe një monitorimi) me 17 punonjës në total.

Më 28 maj 2015, është miratuar Programi për Zhvillimin Rural për periudhën 2014-2020 dhe më 20 korrik 2015, Komisioni Evropian miratoi vendimin zbatues për miratimin e programit IPARD për RSH nën instrumentin IPA II për vitet 2014-2020.

Më tej, më 24 Shtator 2015 u nënshkrua Marrëveshja Sektoriale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për Zbatimin e Asistencës për Zhvillimin në Sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (IPARD II).

Në 22 Shtator 2015, NAO miratoi Planin Kombëtar për akreditimin e zbatimit të buxhetit për IPARD. Kjo masë i është transmetuar DP-Bujqësisë në KE.

VKM nr.966“Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPARD II (2014–2020), Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, u miratua në 02.12.2015.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional përgjegjës për bashkërendimin e instrumenteve financiarë të BE-së në Shqipëri përbëhet nga këto institucione:

1. Ministria e Integrimit Evropian
2. Ministria e Financave
3. Struktura Operuese
4. Kryeministria (DZhPFNH)
5. Ministria e Buqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujrave (MBZHRAU)
6. INSTAT

Ministria e Integrimit Evropian (MIE) është institucioni qendror përgjegjës për programimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës financiare të BE-së. Ky institucion është ngarkuar me koordinimin e pjesëmarjes së Shqipërisë në programet e BE-së, si dhe koordinimin e aplikimeve të Shqipërisë në raundet e WBIF dhe programeve me shumë vende. MEI, e përfaqësuar nga Ministri, është përcaktuar Koordinator Kombëtar i IPA (KKIPA). KKIPA është kundërpala kryesore e Komisionit për procesin e përgjithshëm të planifikimit strategjik, koordinimit të programimit, monitorimit dhe implementimit, vlerësimit dhe raportimit të asistencës IPA II. Zyra e KKIPA drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të projekteve të asistencës së BE-së, i cili është Drejtues i Zyrës së KKIPA.

Zv.ministri i Integrimit Europian kryen funksionin e Zëvendës KKIPA për veprimtarinë e përditshme të zyrës së KKIPA.

MIE është gjithashtu përgjegjëse edhe për koordinimin e pjesëamrrjes së Shqipërisë në programet e Bashkëpunimit Territorial dhe mban rolin e Strukturës Operative për këto programe. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë vepron ex-officio si Drejtues i Strukturës Operative për këto programe.

Në Ministrinë e Integirmit Evropian ka dy drejtori që janë përgjegjëse për asistencën financiare të BE-së:

(i) Drejtoria e Programit dhe Monitorimit të projekteve të Asistencës së BE-së, që përbëhet nga 4 sektorë (i) sektori i programeve të BE-së në fushat e Demokracisë, Qeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe të drejtave Themelore (ii) sektori për programet e BE-së në Bujqësi, Ekonomi, dhe Kohezionin Social (iii) sektori për koordinimin e programeve horizontale, dhe (iv) sektori për monitorimin dhe vlerësimin e Asistencës së BE-së.

(ii) Drejtoria për Bashkëpunimin ndërkufitar dhe transnacional, që përbëhet nga 2 njësi: njësia për bashkëpunimin ndërkufitar dhe transnacional dhe njësia për monitorimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe transnacional.

Ministria e Financave: Zv.Ministri i Financave, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO), mbart përgjegjësinë kryesore për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në Republikën e Shqipërisë dhe për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e shpenzimeve nën IPA I dhe II.

ZKA në kryerjen e detyrave të tij mbështetet nga strukturat e menaxhimit të cilat përbëhen nga Fondi Kombëtar dhe Zyra e Mbështetëse e ZKA-se. Të dyja janë struktura të veçanta të Ministrisë së Financave, mbështetëse të ZKA-së për zbatimin e programeve IPA.

***Komiteti Kombëtar i Investimeve*:** Procesi per ngritjen e një pakete projektesh kombëtare është inicuar nga Komisioni Evropian (KE) përmes një Shënimi/Notes për anëtarët e Komitetit Drejtues të WBIF, e cila nënvizon "Mbështetjen ndaj Ballkanit Perëndimor për investime për projekte infrastrukturore për periudhën 2014-2020". Ai parashtron një metodologji të re pune që nevojitet të zbatohet nga të gjitha vendet e rajonit, si bazë për mbështetjen e BE-së për investimet në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor.

10. Paketa Kombëtare e Projekteve (Single Project Pipeline), forcon identifikimin, përgatitjen dhe selektimin e projekteve në sektorët e energjisë, transportit, mjedisit dhe sektorit social dhe është parakusht për marrjen e mbështetjes së IPA II për bashkë-financim. Në këtë kontekst, janë hartuar Paketat Sektoriale të Projekteve (Single Sector Project Pipeline) për këto sektorë, të cilat më pas shkrihen në një Paketë të vetme Kombëtare. Në këtë mënyrë do të kenë akses më të madh në burimet e financimit dhe fondet e Bashkimit Evropian dhe institucione të tjera ndërkombëtare financiare.Ekspertete IFICOkane dhënë mbeshtetjen për këtë proçes.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) është përgjegjëse për ngritjen e një Autoriteti Menaxhues dhe Agjencisë së IPARD si organe implementuese për programin e Zhvillimit Rural 2014-2020. Të dyja strukturat kanë përgatitur e trainuar stafin mbi procedurat kryesore për implementimin e IPARD. Autoriteti Menaxhues është një strukturë e pavarur në MBZHRAU i cili merret me

programimin, monitorimin, komunikimin dhe vizibilitetin e programit operacional IPARD. Agjencia e pagesave është një agjenci e pavarur dhe organi zbatues për IPARD, në vecanti përgjegjëse për pranimin, para-seleksionimin, përzgjedhjen dhe ekzekutimin e pagesave.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian përgjegjës për Kapitullin 22 (Politika Rajonale dhe Bashkërendimi i Instrumenteve Strukturorë) kryesohet nga Ministria e Integrimit Evropian me këtë përbërje:

i) Ministria e Financave
ii) Kryeministria (Departamenti për Zhvillim, Programin, Financim dhe Ndihmën e Huaj)
iii) Ministria e Buqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujrave (MBZHRAU)
iv) INSTAT
v) Përfaqësuesit e zyrës së Kryeministrit.

II.4 Parashikimet financiare indikative (ALL)

Alokimet Financiare (mln Euro) sipas sektorëve dhe fushave të politikave (Dokumenti Strategjik për vendin – Shqipëria)

Shqipëria	2014	2015	2016	2017	2018-2020	Total 2014-2020 (*)	Nga të cilat, të lidhura me ndryshimet klimatike (%) (**)
a. Reformat për përgatitjen për anëtarësimin në BE	**78.7**	**59.9**	**12.7**	**74.9**	**94.3**	**320.5**	
Demokracia dhe Qeverisja	157.2				66.3	223.5	
Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore	69.0				28.0	97.0	
b. Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal	**0**	**18.0**	**50.0**	**0**	**100.0**	**168.0**	
Mjedisi	34.0				34.0	68.0	66%
Transporti	18.0				38.0	56.0	27%
Energjia	0.0				0.0	0.0	

Konkurueshmëria dhe Inovacioni	16.0				28.0	44.0	9%
c. Punësimi, politikat sociale, arsimi, promovimi i barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	**5.0**	**0**	**14.0**	**0**	**50.0**	**69.0**	
Arsimi, punësimi dhe politikat sociale	19.0				50.0	69.0	
d. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	**0**	**9.0**	**13.0**	**18.0**	**52.0**	**92.0**	
Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	40.0				52.0	92.0	26%
TOTAL	**83.7**	**86.9**	**89.7**	**92.9**	**296.3**	**649.4**	

Lidhur me programin IPA shumë-vende 2015, me vendimin implementues te Komisionit C(2015) 5242 të datës 22 Korrik 2015 nën IPA II, programi i veprimit i miratuar për vitin 2015, ka alokuar 122,500,000 Euro për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa ky program për vitin 2016 është në procesin e programimit.

Shqipëria është përfitues i programit IPA të fushës së 5-të, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. Nën IPA II, dokumenti strategjik indikativ përcakton prioritetet për asistencën financiare për periudhën 2014-2020. Në këtë kontekst, alokimi indikativ për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural parashikohet 92 milion Euro. Në 20 Korrik 2015, Komisioni Europian miratoi vendimin implementues që miraton programin shumë-vjecar për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural për RSH nën IPA II për vitet 2014-2020. Buxheti total i alokuar për këtë fushë është 71 milion Euro,i ndarë në 4 vjet.

III. Prioritetet

Objektivi i Shqipërisë është të arrijë gradualisht transferimin e përgjegjësisë për menaxhimin e buxhetit lidhur me alokimet IPA në mënyrë që Qeveria Shqiptare të ketë më tepër pronësi mbi këtë proces. Për më tepër, prioritetet e mëposhtme duhet të arrihen:

3. Përditësimi dhe përafrimi i bazës ligjore dhe i procedurave në përputhje me IPA II në mënyrë aplikimin për transferimin e përgjegjësisë për menaxhimin e buxhetit për IPA II, sic kërkohet nga KE, vit pas viti;

- Forcimi i mëtejshëm i kuadrit institucional, strukturave kombëtare dhe autoriteteve të ngarkuara me menaxhimin indirekt (IPA II) dhe/ose menaxhimin e decentralizuar (IPA I);
- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor, për të siguruar programim sektorial shumëvjeçar, fleksibilitet buxheti dhe kapacitet bashkëfinancimi për projektet e BE-së në nivel kombëtar dhe vendor;
- Në lidhje me bashkëpunimin territorial, procesi i decentralizimit do të përparojë dhe dokumentet e nevojshme, të tilla si marrëveshjet implementuese dhe operacionale ndërmjet zyrtarit kombëtar autorizues, kreut te Strukturës Operative dhe zyrtarit autorizues te Programit, do të miratohen;
- MIE do të udhëzojë Njësitë e Qeverisjes Vendore për të ngritur një sektor të dedikuar brenda strukturës së tyre e cila do të merret me projekte të financuara nga BE apo donatorët. Rritja e kapaciteteve absorbuese dhe pjesëmarrja e NjQV-ve në Programet e bashkëpunimit territorial është një prioritet i MIE-së në mënyrë që t'i përgatisë ato për fondet ERDF;
- Rritja e pjesëmarrjes së suksesshme të Shqipërisë në Strategjinë e BE-së për rajonin e Adriatik dhe Jonit (EUSAIR) si dhe lehtësimin e hartimit të projekteve rajonale në mbështetje të Strategjisë;
- Përgatitjet për menaxhimin indirekt në fushën e zhvillimit bujqësor e rural;
- Në lidhje me procesin e programimit, kapacitetet administrative duhet të rriten ndjeshëm, me qëllim që të hartohen dhe të zbatohen politika dhe strategji sektoriale realiste. Përgatitja e një liste projektesh prioritare mbetet një çështje e rëndësishme që duhet adresuar, sidomos në lidhje me perspektivën financiare në kuadrin e IPA2;
- Grupet sektoriale,ekzistuese të Punës nevojitet të fuksionojnë si një sistem efektiv për të monitoruar zhvillimet e politikave dhe ofrojnë këshilla strategjike;
- Rritja e kapaciteteve programuese per politikat sektoriale dhe përmirësimi i hartimit të listave të projekteve prioritare në nivel kombëtar e lokal;
- Forcimi i menaxhimit të projekteve nën programin IPA 2013 për të minimizuar vonesat në përdorimin e fondeve të BE-së.

IV. Plani për periudhën 2016-18

IV.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Kryeministria	2007-2013
	Ministria e Integrimit Evropian	2014-2020

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian		
Plani i Veprimit i MIE-s për sensibilizimin mbi procesin e integrimit evropian	Ministria e Integrimit Evropian	2012-2013
Dokumenti Strategjik Kombëtar	Komisioni Evropian Ministria e Integrimit Evropian	2014 - 2020
Plan Veprimi i MIE për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me procesin e integrimit Europian	Ministria e Integrimit Evropian	2012-2013
Strategjia e BE-së për rajonin Adriatik Jonian – Plan Veprimi	Ministria e Integrimit Evropian Ministria e Punëve të Jashtme	2014-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

***Acquis* e BE-së**	**Legjislacioni shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Shkalla e përafrimit (e plotë/e pjesshme/ mospërputhje)**	**Data e miratimit (legjislacion shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (legjislacion shqiptar**
E paaplikueshme	Ligji 115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në RSH"	Minister Shteti per Cështjet Vendore	E paaplikueshme	31.07.2014	Gusht 2014
	VKM nr 1037 date 15.12.2010 "Për zbatimin e nomenklaturës Shqipëria në 3 rajone NUTS II, sipas nomenklaturës së njësive teritoriale për statistikat NUTS të BE	INSTAT, Ministria e Integrimit Evropian		15.12.2010	2011
E paaplikueshme	Ligji nr. 37/2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të	Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e	E paaplikueshme	09.04.2015	16.05.2015

	Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit financiar për asistencën e BE për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të para-anëtarësimit (IPA II)"	Financave			
E paaplikueshme	VKM nr. 541/2015 "Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe mardhenieve midis autoriteteve dhe strukturave për menaxhimin indirekt të IPA II (2014-2020)	Ministria e Integrimit Evropian, MF	E paaplikueshme	18.06.2015	26.06.2015
E paaplikueshme	VKM nr.684/2015 "Për miratimin e Marrëveshjes Sektoriale midis KM RSH dhe KE lidhur me programin IPARD (2014-2020)	Ministria e Integrimit Evropian, MBZHRAU	E paaplikueshme	29.07.2015	24.09.2015
E paaplikueshme	Ligji nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të para-	Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Financave	E paaplikueshme	10.12.2007	27. 12.2007

	anëtarësimit (IPA)"				
E paaplikueshme	VKM nr. 23, datë 12.01.2011 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I”	Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	12.01.2011	12.01.2011
E paaplikueshme	VKM nr. 850, datë 14.12.2011"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 23, datë 12.01.2011 ' Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I”	Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	14.12.2011	14.12.2011
E paaplikueshme	VKM nr. 707, datë 21.08.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 23, datë 12.01.2011 'Për përcaktimin e	Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	21.08.2013	21.08.2013

	funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I", i ndryshuar				
E paaplikueshme	VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së"	Ministria e Financave	E paaplikueshme	14.10.2009	14.10.2009
E paaplikueshme	VKM nr. 328, datë 13.05.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së"	Ministria e Financave	E paaplikueshme	13.05.2011	13.05.2011
E paaplikueshme	VKM nr. 235, datë 04.04.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së", i ndryshuar	Ministria e Financave	E paaplikueshme	04.04.2012	04.04.2012
E paaplikueshme	VKM nr. 525, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive e të	Ministria e Financave dhe Ministria e	E paaplikueshme	16.08.2012	16.08.2012

	marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të para-anëtarësimit (IPA), Komponenti II - "Bashkëpunimi ndërkufitar".	Integrimit Evropian			
E paaplikueshme	VKM për miratimin e Marrëveshjes Financiare mbi programin e veprimit IPA 2014 për Shqipërinë midis KM RSH dhe KE	Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	Dhjetor 2015	3m I, 2016
E paaplikueshme	VKM për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrdhenieve midis autoriteteve të menaxhimit indirekt të asistencës së BE-së për IPARD 2014-2020	Ministria e Integrimit Evropian , Ministria e Financave MBZHRAU	N/a	02.12.2015	3m I, 2016
E paaplikueshme	VKM nr.525/2012 “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe marrdhenieve midis autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së BE, në kuadrin e IPA, komponenti II, Bashkëpunimi Ndër-kufitar	Ministria e Financave Ministria e Integrimit Europian	E paaplikueshme	16.08.2012	16.08.2012

E paaplikueshme	VKM për miratimin e Marrëveshjes Financiare për programin e bashkëpunimit ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës (alokimet e viteve 2014-2015)	Ministria e Integrimit Europian	E paaplikueshme	11.11.2015	11.11.2015
E paaplikueshme	VKM për miratimin e Marrëveshjes Financiare për programin e bashkëpunimit ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (alokimet e viteve 2014-2015)	Ministria e Integrimit Europian	E paaplikueshme	Dhjetor 2015	Dhjetor 2015
E paaplikueshme	VKM për miratimin e Marrëveshjes Financiare për programin e bashkëpunimit ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Maqedonisë (alokimet e viteve 2014-2015)	Ministria e Integrimit Europian	E paaplikueshme	Dhjetor 2015	Dhjetor 2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e referuar**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI)	Kryeministria/ Departamenti i Zhvillimit, Programimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj	2014-2020	Dhjetor 2015 (parashikohet)	2016
Plani Kombëtar për Integrimin Evropian	Kryeministria/Ministria e Integrimit Evropian	2016-2018	Dhjetor 2015 (parashikohet)	2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)	EU acquis	Legjislacioni Shqiptar
AFATSHKURTËR (2016)							
E paaplikueshme	E paaplikueshme	VKM për miratimin e Marrëveshjes Financiare për programin e Aksioneve IPA 2015 midis KM të RSH dhe KE	Jo	E paaplikueshme	3m IV, 2015		
E paaplikueshme	E paaplikueshme	VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri	Jo	E paaplikueshme	3m II, 2016		3m II, 2016
E paaplikueshme	E paaplikueshme	VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Adriatik Jonian	Jo	E paaplikueshme	3m II, 2016		3m II, 2016
E paaplikueshme	E paaplikueshme	VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Mediterranean	Jo	E paaplikueshme	3m II, 2016		3m II, 2016
E paaplikueshme	E paaplikueshme	VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Balkan-Mediterranean	Jo	E paaplikueshme	3m II, 2016		3m II, 2016
E paaplikueshme	E paaplikueshme	VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Itali-	Jo	E paaplikueshme	3m III, 2016		3m III, 2016

		Shqipëri-Mali i Zi					
AFATMESME (2017 – 2018)							

V.Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e planifikuar e fondeve

Kapitulli 22: Zhvillimi rajonal dhe koordinimi i instrumentave strukturore					
Përfituesi: MIE					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
VKM për miratimin e Marrëveshjes Financiare për programin e Aksioneve IPA 2015 midis KM të RSH dhe KE	A) Paga –stafi ekzistues	100,000 ALL	0		100,000 ALL
	B) Paga –stafi i ri	0	0		
	C) Trajnimi	0	0		
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0	0		
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0	0		
	Aktiviteti total	100,000 ALL			**100,000 ALL**
VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA CBC Greqi-Shqipëri	A) Paga –stafi ekzistues	100.000 ALL	0	0	100.000 ALL
	B) Paga –stafi i ri	0	0	0	0
	C) Trajnimi	0	0	0	0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0	0	0	0
	Aktiviteti total	100.000 ALL			**100.000 ALL**
VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Adriatik Jonian	A) Paga –stafi ekzistues	100.000 ALL	0	0	100.000 ALL
	B) Paga –stafi i ri	0	0	0	0
	C) Trajnimi	0	0	0	0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0	0	0	0

	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0	0	0	0
	Aktiviteti total	100.000 ALL			**100.000 ALL**
VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Mediterranean	A) Paga –stafi ekzistues	100.000	0	0	100.000 ALL
	B) Paga –stafi i ri	0	0	0	0
	C) Trajnimi	0	0	0	0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	0	0	0	0
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	0	0	0	0
	Aktiviteti total	100.000	0		**100.000 ALL**
VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Balkan-Mediterranean	A) Paga –stafi ekzistues	100.000	0	0	100.000 ALL
	B) Paga –stafi i ri		0	0	0
	C) Trajnimi		0	0	0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme		0	0	0
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		0	0	0
	Aktiviteti total	100.000	0		**100.000 ALL**
VKM për miratimin e MF për programin Interreg IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi	A) Paga –stafi ekzistues	100.000	0	0	100.000 ALL
	B) Paga –stafi i ri		0	0	0
	C) Trajnimi		0	0	0
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme		0	0	0
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim		0	0	0
	Aktiviteti total	100.000	0		**100.000 ALL**
	Totali i Kapitullit				**600,000 ALL**

KAPITULLI 23: BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E GJYQËSORIT DHE TË DREJTAVE THEMELORE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 23 mbulon disa fusha të cilat janë në ombrellën e përgjithshme të Gjyqësorit dhe të Drejtave Themelore. Është një kapitull thelbësor për përpjekjet e para aderimit dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, ku vendosen kushtëzime strikte dhe etapa të caktuara së bashku me monitorimin nga Bashkimi Evropian.

I.2 Situata në Shqipëri

Sistemi gjyqësor

Me vendimin nr. 96/2014 Parlamenti Shqiptar miratoi krijimin e një komisioni të posaçëm (Komiteti ad hoc) "Për reformimin e sistemit të drejtësisë." Mandati i Komisionit është të analizojë situatën aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë; të identifikojë problemet dhe nevojat për përmirësim; të hartojë një dokument strategjik mbi objektivat në reformën e sistemit të drejtësisë; të propozojë një paketë të plotë të projektligjeve që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë edhe ato kushtetuese. Ministria e Drejtësisë merr pjesë aktive përmes përfaqësuesve të saj në grupet e punës të ngritura në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për reformën në drejtësi.

Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar një dokument analitik mbi gjendjen aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë e cila ka shërbyer si bazë për punën e Grupit të Punës të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, i ndihmuar nga Sekretariati Teknik në Komisionin e Posacëm Parlamentar Ad hoc për të identifikuar problemet dhe nevojat për përmirësim.

Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i tij i Veprimit për zhvillimin e një strategjie për reformën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, janë hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë me ndihmën e Sekretariatit Teknik, në përmbushjen e fazës së dytë të funksionimit të Komisionit të Posacëm Parlamentar të Reformës së Sistemit të Drejtësisë. Bazuar në çështjet dhe shqetësimet e identifikuara në Analizë, Strategjia përcakton objektivat e përgjithshme dhe specifike të reformës në sistemin e drejtësisë dhe ndërhyrjet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore për realizimin e këtyre objektivave. Dokumenti analitikë të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, si dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit

për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", janë miratuar në parim me vendimin nr. 15, datë 30.07.2015 të Komisionit të Posaçëm për Reformën e Sistemit të Drejtësisë shërben si dokument udhëzues për fazën e tretë, e cila është një fazë që përkon me hartimin e një paketë ndryshimesh ligjore dhe kushtetuese.

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë do të vazhdojë organizimin e procesit të konsultimit publik dhe konsultimet me ekspertizë ndërkombëtare dhe gjithashtu do të vlerësojë dhe do të reflektojë përfshirjen e tyre në këto dokumente. Më 28.09.2015 Komisioni Parlamentar Ad Hoc i ka kërkuar Komisionit të Venecias opinionin e tij mbi projekt-ndryshimet dhe çështjet kushtetuese të hartuara nga Grupi i Punës së Ekspertëve të Nivelit të Lartë.

Në përmbushjen objektivin e tretë (faza), grupi i ekspertëve të nivelit të lartë bazuar në gjetjet e Dokumentit analitikë të Sistemit (të përgatitur gjatë fazës së parë) dhe në zbatimin e objektivave të Dokumentit Strategjik (përgatitur gjatë fazës së dytë), do të hartojë një paketë të projekt-ligjit të nevojshme për reformimin e sistemit të drejtësisë. Reforma në sistemin e drejtësisë është hartuar në bazë të 7 shtyllave kryesore, të cilat plotësojnë ndërtimin e sistemit të drejtësisë në vend. Plani i Veprimit përmban një listë të detajuar të masave ligjore për t'u miratuar në vitin 2016.Qëllimi i përgjithshëm i procesit të reformës është krijimi i një sistemi drejtësisë të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional drejt një shërbimi të orientuar, i hapur, i përgjegjshëm dhe efikas, që gëzon besimin e publikut , mbështet zhvillimin e qëndrueshëm , zhvillimin social-ekonomik të vendit dhe mundëson integrimin e saj në BE.

Qëllimi i amendimeve kushtetuese është rivendosja e ekuilibrave kushtetues për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrimit reciprok të pushteteve.

Shtylla e parë e reformës në drejtësi: "***Sistemi i drejtësisë sipas Kushtetutës dhe Gjykata Kushtetuese***", mbështetur në gjetjet dhe problematikat e konstatuara nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë dhe në konkretizim të objektivave dhe masave përkatëse të parashtruara në këtë strategji, në këtë fushë parashikohen:

- Amendime në Kushtetutë, pjesa e katërt (*Presidenti i Republikës*), pjesa e tetë (*Gjykata Kushtetuese*), pjesa e nëntë (*Gjykatat*), pjesa e dhjetë (*Prokuroria*), pjesa e njëmbëdhjetë (*Referendumi*);
- Pershtja e një ligji organik për Presidentin e Republikës;
- Amendime në Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë";
- Amendime në Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë";
- Amendime në Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë";
- Amendime nëLigjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

- Amendime nëLigjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Amendime nëLigjin “Për referendumet” etj.

Normat kushtetuese që rregullojnë përbërjen, mënyrën e emërimit të anëtarëve, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të KLD-së do të rishikohen, në mënyrë që të garantohet pavarësia, përgjegjshmëria, cilësia e përbërjes dhe efiçienca e këtij organi të rëndësishëm kushtetues dhe përmes tij mirëqeverisja dhe pavarësia e gjyqësorit, si dhe statusi dhe paanësia e gjyqtarëve.

Reforma kushtetuese do të synojë forcimin e garancive për pavarësinë, integritetin dhe efiçiencën e sistemit të prokurorisë përmes rishikimit të formulës kushtetuese të emërimit, shkarkimit apo kufizimit të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe përmes rishikimit të mënyrës së organizimit të sistemit të prokurorisë.

Reforma kushtetuese do të synojë krijimin e një organi të posaçëm kushtetues me përgjegjësi të qarta dhe mjete të përshtatshme për shqyrtimin dhe ndëshkimin e shkeljeve disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

Ndryshimet kushtetuese e ligjore lidhur me Gjykatën e Lartë do të synojnë:

- Shqyrtimin e mundësisë për ta bërë GJL-në pjesë integrale të sistemit gjyqësor dhe rrjedhimisht shtrirjen e kompetencave të KLD-së mbi të.
- Parashikimin e kritereve kushtetuese që duhet të plotësojnë kandidatët për t’u emëruar anëtarë të GJL-së, me qëllim garantimin e një përbërjeje cilësore të GJL-së.
- Konsolidimin e Gjykatës së Lartë si një *gjykatë karriere*, ku shumica e anëtarëve të saj do të jenë gjyqtarë të promovuar nga shkallët më të ulëta të sistemit.
- Parashikimin e detajuar në ligj dhe forcimin e kritereve dhe procedurave për promovimin në GJL të gjyqtarëve.
- Parashikimin e detajuar në ligj të kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin në GJL të kandidatëve të jashtëm, në mënyrë që të zvogëlohet diskrecioni i organeve të emërtesës dhe të sigurohet zgjedhja e kandidatëve më të mirë.
- Rishikimin e formulës së emërimit të anëtarëve të GJL-së që nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke parashikuar një rol ekskluziv të KLD-së në këtë proces ose një bashkëpunim midis KLD-së dhe Presidentit për të mundësuar transparencën dhe objektivitetin e procesit dhe, ç’është më e rëndësishme, zgjedhjen e kandidaturave më të mira.

Në kuadër të forcimit të trasparencës dhe llogaridhënies në qevrisjen e gjyqësorit, Reforma në Drejtësi synon rishikimin e ligjit për Këshillin e Lartë të Drejtësisë në mënyrë që të parashikojë:

- ngushtimin e diferencës së tanishme midis numrit të anëtarëve nga radhët e gjyqësorit dhe atyre të jashtëm, ku anëtarët e gjyqësorit do të ruajnë shumicën e vendeve në KLD.
- parashikimin që anëtarët e KLD-së të ushtrojnë me kohë të plotë funksionin e tyre dhe të kthehen në pozicionin e mëparshëm pas përfundimit të mandatit.
- parashikimin që ministri i Drejtësisë dhe Presidenti të mos jenë në përbërje të KLD-së.

Reforma në Drejtësi synon ngritjen e një inspektorati të pavarur të ngarkuar me përgjegjësinë për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi mbi gjykatat duke hequr në këtë mënyrë komptencën e Ministrit të Drejtësisë dhe KLD-së për inspektimin e gjyqtarëve.

Reforma Drejtësisë ka për qëllim të ndryshojë Kushtetutën për të forcuar garancitë për pavarësinë, integritetin dhe efikasitetin e sistemit të prokurorisë përmes rishikimit t formulës kushtetuese të emërimit, heqjes apo kufizimin e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe shqyrtimit të rrugës së organizimit të sistemit të prokurorisë.

Statusi dhe përgjegjësitë e Këshillit të Prokurorisë do të ndryshojnë, duke e transformuar atë në një institucion kushtetues të pavarur ose si një nga dhomat e Këshillit të Lartë tëDrejtësisë (nëse modeli i prokurorisë brenda pushtetit gjyqësor zgjidhet), duke synuar në të dyja rastet forcimin e pozitave të Këshillit dhe ushtrimi e funksioneve të saj të vendimmarrjes.

Projektligji për sistemin e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve u aprovua në Këshillin e Ministrave më datë 13.5.2015 dhe pritet të miratohet në Kuvend.

Pushteti gjyqësor

Në shtyllën e dytë të reformës në drejtësi: Pushteti gjyqësor, janë parashikuar këto aktivitete:

- Amendime në Kushtetutë, pjesa e nëntë (Gjykatat).
- Miratimi i një ligji organik për pushtetin gjyqësor, i cili do të përfshijë ndryshime:
    - Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”;
    - Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;
    - Ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
    - Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

- Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”;
- Ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”;
- Ligjin “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”;
- Ligj të ri për statusin e gjyqtarit;
- Ligj të ri për administratën gjyqësore;
- Kodin e Procedurës Civile;
- Kodin e Procedurës Penale;
- Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

Për më tepër është planifikuar miratimi i këtyre ligjevetë reja:

- Ligji per statusin e gjyqtarit;
- Ligji përadministratën gjyqësore;
- Ligji për arbitrazhin;
- Ligji ekzistues"Përorganizimin dhe funksionimin eKonferencës Gjyqësore Kombëtarepritet tëshfuqizohen".

Drejtësia penale

Në shtyllën III të reformës në drejtësi: “Drejtësia Penale”, janë parashikuar ndryshime nëaktet ligjore të mëposhtme:

- Kushtetuta e Shqipërisë, pjesa e dhjetë (Prokuroria).
- Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”.
- Kodin e Procedurës Penale.
- Kodin Penal.
- Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.
- Ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- Ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.
- Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.
- Ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”.

Kodi i Procedurës Penale është duke u rishikuar nga një grup pune i ngritur nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi do të sigurohet pwr tw realizuar forcimin e garancive procedurale në fazën e hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, për marrjen e masave të mëposhtme:

- Forcimi i rolit dhe pozitës së prokurorit në drejtimin, kontrollin dhe kryerjen e hetimeve paraprake;
- Garantimi i instrumenteve procedurale dhe afateve të arsyeshme për kryerjen e veprimeve hetimore në përputhje me kompleksitetin e çështjes.

Edukimi ligjor dhe arsimi juridik

Në shtyllën IV të reformës në drejtësi: Edukimi ligjor dhe Arsimi juridik, janë parashikuar ndryshime nëaktet ligjore të mëposhtme:

- Ligjin për arsimin e lartë;
- Ligjin për Shkollën e Magjistraturës;
- Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar;
- Hartimin e legjislacionit për provimin e shtetit në drejtësi;
- Ligjin për profesionin e avokatit;
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor";
- Ligjin "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat";
- Ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH";
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH";
- Ligjin për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Ligjin për noterinë;
- Ligjin për Avokaturën e Shtetit;
- Miratimi i një ligji të ri përprovimin shtetëror është parashikuar.

Shërbimet ligjore dhe profesionet e lira

Në shtyllën V të reformës në drejtësi, *Shërbimet ligjore dhe profesionet e lira*, janë parashikuar ndryshime nëaktet ligjore të mëposhtme:

- Kodin e Procedurës Civile
- Kodin e Procedurës Penale;
- Ligjin për profesionin e avokatit;

- Ligjin për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor;
- Ligjin për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat;
- Ligjin për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Ligjin për noterinë;
- Ligjin për Avokaturën e Shtetit;
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë";
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

Masat në luftën kundër korrupsionit

Në shtyllën VI të reformës në drejtësi, *Masat antikorrupsion*, janë parashikuar ndryshime nëaktet ligjore të mëposhtme:

- Kushtetutë, pjesa e nëntë (*Gjykatat*) dhe pjesa e dhjetë (*Prokuroria*);
- Ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë";
- Kodin e Procedurës Civile;
- Kodin e Procedurës Penale;
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore";
- Ligjin "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"
- Ligjin "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike";
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Ligjin "Për Shkollën e Magjistraturës";
- Ligjin "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin për arsimin e lartë;
- Ligjin mbi Avokatinë në Republikën e Shqipërisë;
- Ligjin mbi noterinë;
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimin Gjyqësor";
- Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë";
- Ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit";

- Ligjin “Mbi bankat apo dhe rregulloreve të lidhura me bankat;
- Ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.
- Miratimi i një ligji të ri për sigurimin emasave anti-korrupsion dhe krijimin e mekanizmave të specializuara për hetimin e veprave korruptive është parashikuar

Politika anti-korrupsion

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore është caktuar si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit (KKKK) me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1012, datë 22.11.2013 për qëllim koordinimin e përpjekjeve dhe politikat anti-korrupsion mes të gjitha palëve të interesuara në nivel kombëtar dhe vendor. Në mars 2015, Shqipëria kaloi dokumentet më të rëndësishme të politikave anti-korrupsion: Strategjia Ndër-sektoriale kundër Korrupsionit 2015 – 2020 dhe Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015 – 2017, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.03.2015. Këto akte janë të bazuara në një analizë të detajuar të zbatimit të dokumenteve të mëparshme të politikave, si dhe një rishikim të rekomandimeve nga projektet e mëparshme. Kjo Strategji Kundër Korrupsionit ka një qasje të trefishtë për luftimin e korrupsionit: parandalimin, shtypjen dhe edukimin (ndërgjegjësimi).

Si rezultat i mësipërm, ndryshimet legjislative janë prezantuar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. Ndryshimet në vitin 2014 nëKodin e Procedurës Penale dhe ndryshimet nëligjin “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (ligji antimafie) klasifikuan korrupsionin e zyrtarëve të lartë si një vepër të rëndë penale. Në krahasim me procedurat e mëparshme penale për rastet e korrupsionit, ndryshime të tilla forcuan regjimin e ndjekjes së çështjeve të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve të lartë të shtetit duke emëruar Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda si autoritetet kompetente për ndjekjenpenale dhe gjykimin. Nga ana tjetër, ndryshimet e ligjit anti-mafia zgjerojnë fushëveprimin e ligjit të këtyre zyrtarëve të lartë shtetërorë. Ligji i ri "Për të drejtën e informimit"garanton transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve në raport me publikun. Ky ligj i jep kompetenca të plota Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për monitorimin e zbatimit të tij nga institucionet publike. Për më tepër, ligji i ri nr.146/2014 “Mbi njoftimeve dhe konsultimeve publike”parashikon rregullat procedurale që duhen zbatuar për pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike me synim nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

Në maj 2014, KKKK dhe Ministria e Drejtësisë, me ndihmën e qeverisë hollandeze, filloi hartimin e ligjit përmbrojtjen esinjalizuesve të veprave penale të korrupsionit. Projektligji u diskutua gjatë vitit 2014 dhe 2015 me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe institucioneve të pavarura, aktorëve ndërkombëtarë dhe palët e interesuara. Ky projektligj, i zbatueshëm në sektorin publik dhe atë privat, do të shërbejë për rritjen e

transparencës së institucioneve publike dhe private duke ofruar mbrojtje për bilbilfryrësit për të rritur dhe raportuar rastet e korrupsionit në vendin e punës së sinjalizuesve. Projektligji është miratuar nga Këshilli i Ministrave në16 dhjetor 2015 dhe pritet të miratohet nga Parlamenti gjatë tremujorit të parë të vititi 2016.

Një nga objektivat në kuadër të reformës në drejtësi është parandalimi i korrupsionit përmes rritjes së përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe forcimin e hetimit administrativ dhe penal për pasuritë e tyre. Në këtë kuadër, objektivi i reformës është përmirësimi i sistemit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktin e interesit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personave të lidhur me synim identifikimin e rasteve të pasurimit të paligjshëm nga veprat penale korruptive. Në këtë drejtim, është propozuar për të parashikuar në dështimin e ligjit për deklarim, deklarimin përtej afateve kohore ose deklarimin jo të plotë të pasurisë dhe konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës si bazë për fillimin e procedurës disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për më tepër ajo është propozuar për të forcuar strukturën aktuale të hetimit të korrupsionit brenda shërbimit policor dhe të prokurorisë.

Së fundmi, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm nr 141, datë 19.6.2014 janë miratuar"Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve".

Forcimi i kodit të rregullave dhe etikës së prokurorëve përmbush një nga dhjetë Rekomandimet e përcaktuara nga VlerësimiiRaundit të Katërt të GRECO-s për Shqipërinë lidhur me parandalimin e korrupsionit në radhët e deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve. Bazuar në Strategjinë Kundër Korrupsionit, të gjitha rekomandimetparashikohen të përmbushen në mënyrë të kënaqshme deri në vitin 2017.

Të drejtat themelore

Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj Opsional, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me një procedurë të komunikimit.Gjykata ka dorëzuar gjykimet për 6 kërkesa duke gjetur se Shqipëria kishte shkelur të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shteti i së drejtës

Qeveria Shqiptare është e angazhuar plotësisht në zbatimin në gjerësi dhe thellësi të reformave në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara dhe të mbështetura nga partneret ndërkombëtare, ne bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese që përfshihen në çështjet e reformave dhe

performancës së sistemit të drejtësisë si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Neni 1, 2, 13, 70 dhe 78 i MSA-së).

Çdo veprim që do të ndërmarrë Qeveria shqiptare në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë dhe forcimit të shtetit të së drejtës, ka si qëllim dhe objektiv final krijimin e një sistemi drejtësie bashkëkohor, të aftë të sigurojë garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit të drejtësisë shqiptare, të respektojë parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, të kontribuojë në administrimin e drejtësisë penale, të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive dhe të drejtë si dhe të implementojë legjislacionin e BE dhe të pasqyrojë standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Në kuadër të krijimit të një sistemi drejtësie bashkëkohor, Qeveria shqiptare synon rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike. Ky objektiv përcakton si prioritet rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes një programi trajnimi të niveleve bashkëkohore dhe standardeve evropiane dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë shqiptare duke siguruar një trajnim profesional pas universitar për gjyqtarë dhe prokurorë.

I.3 Struktura e kapitullit

1. SISTEMI GJYQËSOR
2. POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT
3. TE DREJTAT E NJERIUT

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së janë me rëndësi të veçantë për këtë kapitull. Sipas Nenit 78 të MSA-së rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të imponimit të ligjeve duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Instrumentet e BE dhe Ndërkombëtarë në fushën e gjyqësorit përfshijnë, ndër të tjera:

- Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, veçanërisht neni 47 e cila ofron të drejtën për një zgjidhje efektive.
- Tabela e Pikëzimit të Drejtësisë së BE: një mjet për të promovuar drejtësinë efektive dhe rritjen.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, veçanërisht neni 6 i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë).
- Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit te Ministrave për shtetet anëtare mbi gjyqtarët: pavarësia, eficienca dhe përgjegjësitë.
- Raporti i Komisionit të Venecias mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor (2010) – Pjesa I: pavarësia e gjyqtarëve.
- Opinioni Konsultativ Nr 1 (2001) i Këshillit të Gjyqtarëve Evropian mbi standardet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe pandërrueshmërinë e gjyqtarëve.
- Karta Evropiane dhe statute për gjyqtarët, 1998,
- Rekomandimi R(94) 12 i Komitetit te Ministrave mbi pavarësinë, eficiencën dhe rolin e gjyqtarit, 1994.
- Rekomandimi Nr R(86) i Këshillit të Evropës mbi Masat për të Parandaluar dhe të Zvogëluar Ngarkesën e Tepërt të Punës në Gjykata.
- Principet e Bangalore mbi Sjelljen në Gjyqësor ("Principet e Bangalore"), miratuar nga Kombet e Bashkuara, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në 23 Prill 2003.
- Principet Bazike të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, 29 Nëntor 1985, A/RES/40/32.

II.2 Institucionet përgjegjëse

Institucionet Shqiptare përgjegjëse për kapitullin 23 janë:

- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë
- Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor
- Gjykata Kushtetuese
- Gjykata e Lartë
- Konferenca Gjyqësore Kombëtare
- Prokuroria
- Avokati i Popullit
- Shkolla e Magjistraturës
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
- Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për Kapitullin 23, Nr. 770, datë 10.12.2013.

II.3 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Shiko tabelën buxhetore më poshtë

III. Prioritetet

Në përputhje me Raportin 2015 të Komisionit Evropian prioritetet janë:

- Përditësimi i Strategjisë sëreformës gjyqësore dhe rritjes së pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhëniessëinstitucioneve gjyqësore.
- Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale, sidomos në lidhje me miratimin e dispozitave që synojnë racionalizimin e kompetencave dhe procedurave të Gjykatës së Lartë si edhe reduktimin e ngarkesës së punës.
- Nevojitet të miratohen akte ligjore të rëndësishme për reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- Roli i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të shqyrtohet.
- Pavarësia dhe paanësia e Gjykatës së Lartë dhe të anëtarëve të saj duhet garantuar plotësisht.
- Vlerësimi i gjyqtarëve si kriter vendimtar për të pasur proces emërimesh, transferimesh dhe ngritjesh në detyrë të bazuar në merita dhe transparencë duhet të përfundohet.
- Procedura për emërimin e gjyqtarëve administrative duhet finalizuar.
- Buxheti i Shkollës së Magjistraturës duhet të rritet.
- Publikimi i vendimeve gjyqësore, duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet të ndiqen rekomandimet përkatëse të Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale
- Ndryshimi i Ligjit për Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale që mundësojnë arrestimin e gjyqtarëve si edhe kontrollin e tyre personal dhe shtëpiak, duhet të miratohen.
- Prokuroria e Përgjithshme duhet të ketë me shumë llogaridhënie. Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç të Prokurorisë duhet të jenë transparence dhe të paanshme, ndërsa roli i Këshillit të Prokurorëve duhet të përforcohet.

- Pavarësia e kancelarëve të gjykatës dhe njohja e tyre si nëpunës civil duhet të garantohet. Duhet të hartohen dhe të miratohen aktet nënligjore.
- Buxheti i akorduar për gjykatat dhe stafin e gjykatave duhet të rritet.
- Një Plan Veprimi duhet të miratohet për ngritjen e një mekanizimi efektiv kompensimi, në mënyrë që vendimet në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave të shtetëzuara gjatë regjimit komunist të mund të ekzekutohen.Per periudhën 2016-2018 – prioritet është implementimi i ligjit te ri për trajtimin e pronës dhe mekanizmit efektiv te kompensimit brenda afateve te arsyeshme me qellim përfundimin e procesit.

Rekomandimet e KSA- së dhe Nënkomitete janë në vazhdim:

Reforma Gjyqësore

- Shqipëria është e inkurajuar të vazhdojë me zbatimin e Strategjisë Ndër Sektorale për Reformën në Drejtësi, në kuadër të forcimit të sundimit të ligjit duke marrë masa konkrete për të promovuar një gjyqësor të paanshëm, të pavarur, transparent, llogaridhënës dhe efektiv. Për këtë, zhvillimi i një analize për të evidentuar mangësitë e kuadrit ligjor të sistemit gjyqësor, duhet marrë në konsideratë.
- Shqipëria do të zbatojë masat e planifikuara për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së gjyqtarëve (si rritja e pagës), dhe do të përfundojë procesin e vlerësimit në kontekstin e zhvillimit të karrierës së tyre.
- Një trak-rekord mbi inspektimet gjyqësore, gjykimet dhe masat disiplinore duhet të hartohet, ashtu sikurse dhe një trak-rekord mbi ankesat.
- Regjistrimi audio i seancave gjyqësore do të shtrihet në të gjitha gjykatat, dhe botimi i vendimeve do të sigurohet në zbatim të plotë të legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale.
- Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike do të konsolidojë një trak-rekord mbi zbatimin e Ligjit Për Ndihmën Juridike dhe do të përmirësojë aksesin në ndihmën juridike për kategoritë e aplikantëve vulnerabël.
- Menaxhimi i çështjeve duhet të përmirësohet duke zhvilluar një sistem të vetëm dhe të harmonizuar për menaxhimin e çështjeve që të mbulojë të gjitha gjykatat e vendit.
- Ligji për Profesionin e Avokatit duhet të zbatohet në mënyrë rigoroze, që të sigurojë, veçanërisht, punën në mënyrë efektive të komitetit disiplinor të sapo krijuar dhe të rrisë llogaridhënien e avokatëve.

Politikat Kundër Korrupsionit

- Shqipëria duhet të vazhdojë në zhvillimin e një track rekordi të hetimeve, gjykimeve dhe dënimeve në çështjet e korrupsionit në të gjitha nivelet, përfshirë dhe çështje me profil të lartë.

- Autoritetet duhet te ekzaminojnë funksionimin e kuadrit të përgjithshëm ligjor duke përfshirë dhe politikat eficiente për parandalimin dhe goditjen e korrupsionit.
- Agjencitë ligj zbatuese shqiptare inkurajohen të ndjekin hetimet në mënyrë pro-aktive, duke përdorur analizën e riskut, burimet e inteligjencës dhe metodat speciale të hetimit. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar financimeve të partive politike, PEPs, dhe në fusha ku ka perceptim publik për korrupsion.

Të Drejtat e Njeriut

Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë do të krijojë një sistem të dedikuar të drejtësisë për të mitur, duke përfshirë legjislacionin përkatës dhe të përmirësuar të ndër-shërbimit të bashkëpunimit(dmth në mes të policisë, oficerëtgjyqësorë/prokurorët, gjykatësit, kujdestarisë), si dhe procedurat e drejtësisë miqësore për fëmijët edhe për fëmijët e viktimave,dëshmitarët apo palët e interesuara në krime dhe procedurat administrative.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2016 – 2018

IV.1 Sistemi gjyqësor

Kuadri i politikave ekzistuese

Strategji ose PV ose dokument politikash	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyesi)	Institucioni Përgjegjës	Periudha e referuar
Plani i masave të Udhërrëfyesit për Prioritetin nr. 2 "Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore"	Prioriteti 2: "Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore"	MD, KLD, GJL, GJK, AP, SHM, ZABGJ, KGJK, PP, ILDKP, KUVENDI, Avokatura e Shtetit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, KSHNJ, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore,	2016 – 2017 – 2018

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyesi)	Institucioni Përgjegjës	Hyrja në fuqi
Ligji nr. 8577 datë 10.02.2000 "Për	Prioriteti 2: "Të merren masa të mëtejshme për të	Ministria e Drejtësisë	10.02.2000

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”	përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore		
Ligji nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë Flet.Zyrtare Nr.7, Faqe:274 Ndryshuar me Ligjin, Nr.177/2014, Dt.Aktit:18.12.2014, Flet.Zyrtare Nr.217, Faqe:12909 Ligji Nr.151/2013, datë 30.05.2013, Flet.Zyrtare Nr.95, Faqe:3949	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore	Ministria e Drejtësisë	15.03.2000, i ndryshuar
Ligji nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ndryshuar Flet.Zyrtare Nr.9, Faqe:205 Ndryshuar me ligjin , nr.101/2014, Datë 31.07.2014, , Flet.Zyrtare Nr.137, Faqe:6285	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Këshilli i Lartë i Drejtësisë , Ministria e Drejtësisë	17.5.2001 , i ndryshuar
Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.Flet.Zyrtare Nr.27, Faqe:1288 Ndryshuar me Ligjin, nr.114/2013,Date 11.04.2013, Flet.Zyrtare Nr.59, Faqe:2556 Vendim i GJK, Nr.20, Dt.Aktit:09.07.2009, Dt.Miratimit:09.07.2009, Flet.Zyrtare Nr.117, Faqe:5617	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	18.02.2008, i ndryshuar

Ligji nr. 9110 datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave per krimet e renda.Flet.Zyrtare Nr.78, Faqe:3487	Prioriteti 2: "Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, eficencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore"	Ministria e Drejtësisë	24.07.2003
Ligj, Nr.49/2012, Dt.Aktit:03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", Flet.Zyrtare Nr.53, Faqe:2701		Ministria e Drejtësisë	03.05.2012
Regullore (BE) Nr. 1292/2013	Vendimi Nr 798, datë 2014/11/19 Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Evropiane për Kërkime Bërthamore (CERN), në lidhje me bashkëpunimin shkencor dhe teknik në fizikë të lartë të energjisë	MAS	I plotë	19.11.2014	17.12.2014
Rregullore e BE-së nr. 1296/2013	Ligj Nr 75/2015 datë 09.07.2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë e Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Unionit për punësim e inovacion social –EASI”	MAS	I plotë	9.7.2015	27.7.2015
Deklaratë për bashkëpunim të përbashkët në Shkencë dhe Inovacion, firmosur në Sarajevë në vitin 2013; Deklaratë për Strategjinë Rajonale të Kërkimit dhe Zhvillimit për inovacion firmosur në Zagreb në vitin 2013	VKM Nr 785 datë 22.09.2015 “Për miratimin në parim të marrëveshjes për themelimin e qendrës së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të Ballkanit Perëndimor (WISE)	MES	I plotë	22.09.2015	22.09.2015

Kuadri politik i planifikuar

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Dokumenti i Politikave për Kërkim dhe Zhvillim 2016 – 2020	MAS	2015 – 2020	T1 2016	T1 2016

Masat ligjore të Planifikuara 2016 – 2018

Legjislacioni i BE-SË	I përkthyer Po/Jo	Legjislacioni (aktet nënligjore) shqiptare	Institucion përgjegjës	Niveli i përafrimit	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
Afatshkurtër (2016)						
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr 58/2003 i 19 dhjetorit 2002 hedhjen poshtë statutin për agjencitë ekzekutive që t'i besohet me detyra të caktuara në menaxhimin e programeve të Komunitetit	Jo	Vendim "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit nga A.K.K.SH.I."	MAS	I pjesshëm	T2 2016	T2 2016
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr 58/2003 i 19 dhjetorit 2002 hedhjen poshtë statutin për agjencitë ekzekutive që t'i besohet me detyra të caktuara në menaxhimin e programeve të Komunitetit	Jo	Vendim "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimi i A.K.K.SH.I.".	MAS	I pjesshëm	T2 2016	T2 2016
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr 58/2003 i 19 dhjetorit 2002 hedhjen poshtë statutin për agjencitë ekzekutive që t'i besohet me detyra të caktuara në	Jo	Vendim "Për strukturat dhe organizimin e qendrave ndërinstitucionale"	MAS	I pjesshëm	T2 2016	T2 2016

menaxhimin e programeve të Komunitetit						
Afatmesëm (2017– 2018)						
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitulli: Kapitulli : Shkenca dhe Kërkimi Shkencor					
Përfituesi: Ministria e Arsimit dhe Sportit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Fonde për t'u financuar nga Buxheti i Shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Mbështetje për studentët e shkëlqyer	A) Paga –stafi aktual	120,000	120.000	120,000	360,000
	B) Paga–staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative				
	Aktivitet total	**120,000**	**120.000**	**120,000**	**360,000**
Pjesëmarrje në Horizont 2020	A) Paga –stafi aktual	120,000	120.000	120,000	360,000
	B) Paga–staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative				
	Aktivitet total	**120,000**	**120.000**	**120,000**	**360,000**
Mbështetje për kërkuesit e rinj shkencorë	A) Paga –stafi aktual	60,800	60800	60800	182,400
	B) Paga–staf i ri				
	C) Trajnim				

	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative				
	Aktivitet total	**60800**	**60800**	**60800**	**182,400**
Buxheti i përfituesit total		**902,400**			
Përfituesi: Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktivitet	**Fonde për t'u financuar nga Buxheti i Shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Fonde për Kërkim dhe Zhvillim, Teknologji dhe Inovacion, dhe Programe Dypalëshe	A) Paga – Stafi aktual	52,200	65,000	105,000	222,200
	B) Paga – staf i ri				
	C) Trajnim				
	D) Shërbime të ndryshme këshillimi				
	E) Infrastrukturëdhe shpenzime operative				
	Aktivitet total	**52,200**	**65,000**	**105,000**	**222,200**
Buxheti i përfituesit total		**222,200**			
Kapitull total		**1,124,600**			

KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli *Arsimi dhe Kultura* synon të japë një panoramë të qartë të situatës aktuale në fushën e arsimit, formimit profesional dhe kulturës, duke nxjerrë në pah nismat e ndërmarra për ngritjen e cilësisë së arsimit në përputhje me standardet evropiane. Ky kapitull përmban masat ligjore të planifikuara dhe prioritetet për reformat në funksion të Integrimit Evropian të vendit.

Acquis për arsimin dhe kulturën konsiston kryesisht në kuadrin e bashkëpunimit të përbërë nga programe dhe metoda të koordinimit të hapur (OMC), që synojnë konvergjencën e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit dhe kulturës shtetet anëtare duhet të sigurojnë menaxhimin e mirë të programeve të decentralizuara të Bashkimit Evropian. *Acquis* kërkon gjithashtu, që shtetet anëtare të lehtësojnë arsimin për fëmijët e punëtorëve emigrantë në Bashkimin Evropian dhe që ata të mos diskriminohen kundrejt shtetasve të BE-së. Në fushën e kulturës, Konventa e UNESCO-s e vitit 2005, "Mbi mbrojtjen dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore" e cila është ratifikuar nga Bashkimi Evropian, është një komponent kryesor i *acquis*. BE kontribuon gjithashtu, në promovimin e çështjeve sportive evropiane.

Acquis i BE për kulturën bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga "Traktati për Bashkimin Evropian" dhe "Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian". Qëllimi i politikave të BE-së për kulturën është për të inkurajuar bashkëpunimin në mbështetje dhe për plotësimin e veprimeve që lidhen me rritjen e dijes dhe përhapjen e kulturës, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shkëmbimet kulturore dhe krijimet letrare dhe artistike duke përfshirë dhe sektorin audiovizual. BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen në programet e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Gjatë vitit 2014-2015, janë ndërmarrë një sërë përmirësimesh thelbësore në legjislacion dhe në procedura në fushat e arsimit dhe kulturës.

Në lidhje me fushën e arsimit në kuadër të reformës në arsimin parauniversitar, në maj 2014 u hartua "Raporti paraprak për reformën në Sistemin Arsimor parauniversitar", pas një konsultimi të gjerë me mësues, pedagogë, menaxherë arsimorë dhe studiues. Reforma në sistemin

arsimor parauniversitar synon krijimin e një sistemi të orientuar nga nevojat dhe interesat e nxënësve, zhvillimin e të menduarit kritik dhe pajisjen e nxënësve me aftësitë e nevojshme për t'u përballur me sfidat e jetës.

Në datë 28 maj 2015 u miratua Ligji Nr. 56/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë". Ndryshimet e ligjit të sipërpërmendur prekin këto fusha: kornizën kurrikulare, përzgjedhjen e teksteve shkollorë dhe emërimin e mësuesve.

Për sa i përket kurrikulës, Ligji Nr. 56/2015 parashikon përshtatjen e kornizën kurrikulare kombëtare me kompetencat themelore.

Është rikonceptuar procedura e përzgjedhjes së teksteve shkollorë duke kufizuar altertekstin deri në tri alternativa për çdo lëndë, pa cenuar parimin e konkurrencës.Për të zbatuar sa më sipër është hartuar baza ligjore përkatëse e cila konsiston në Udhëzimin Nr. 11/1 datë 15.04.2015 "Për botimin e teksteve shkollorë të reja për vitin shkollor 2014-2015"; Udhëzimin Nr. 13, datë 11.05.2015 dhe Udhëzimin Nr. 18, datë 12.06.2015. Baza ligjore e sipërpërmendur përcakton se, tekstet shkollorë për lëndët shkencore për klasat I dhe VI, hartuar në përputhje me kurrikulën e re, do të jenë përkthim i teksteve shkollorë të shtëpive botuese prestigjioze ndërkombëtare.

Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit u ngrit grupi i punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2015-2020. Aktualisht ka përfunduar drafti final i kësaj strategjie i cili është diskutuar në takime konsultative me grupe të interesit dhe është dërguar për miratim ne Këshillin e Ministrave.

Më 15 maj 2015 u prezantua portofoli i mësuesit dhe nxënësit, bazuar në kurrikulën e re me bazë kompetencat. Gjatë periudhës nëntor 2014 – maj 2015, 78 mësues, përfaqësues të tri cikleve nga 26 shkolla në të cilat po pilotohet kurrikula e re bazuar në kompetenca, janë përfshirë në procesin e hartimit të portofolit të të nxënit. Portofoli i të nxënit bazohet në kriteret e cilësisë dhe dokumenton kontributin e nxënësve në veprimtari mësimore të orientuara drejt kompetencave. Ky proces udhëhiqet dhe realizohet nga mësuesi, i cili harton dhe dokumenton veprimtaritë e realizuara nga ai vetë (portofoli i mësuesit) si dhe udhëheq veprimtaritë e të nxënit (portofoli i nxënësit). Gjatë veprimtarive për hartimin e portofolit janë bërë përpjekje edhe për rritjen e pjesëmarrjes së prindërve në procesin mësimor.

Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) zhvilloi procesin e trajnimit të mësuesve të klasave I dhe VI për zbatimin e kurrikulës se re me bazë kompetencat e cila do të zbatohet në nivel kombëtar në të gjitha klasat I dhe VI të arsimit bazë, gjatë vitit shkollor 2015-2016.

Në kuadër të projektit “Digjitalizimi i shkollave shqiptare nëpërmjet integrimit të teknologjisë në arsimin e mesëm” ka përfunduar pajisja me infrastrukturën e nevojshme për 60 shkolla të mesme të përgjithshme, në të cilat 120 klasa janë pjesë e procesit të digjitalizimit. Në zbatim të prioritetit për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit pedagogjik, gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 400 mësues mbi përdorimin e pajisjeve digjitale në mësimdhënie.

Pas një diskutimi të gjerë dhe gjithëpërfshirës me aktorët e interesit, si dhe pas diskutimesh në komisionet e përhershme përkatëse parlamentare, projektligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 17.09.2015. Në zbatim të këtij ligji po përgatitet paketa e plotë e akteve nënligjore për fillimin e vitit akademik 2015-2016

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 638, datë 22.07.2015, "Për kuotat e pranimit në IAL-të publike, ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015¬ - 2016", u miratuan 20 211 kuota, pra 485 më shumë se vitin e kaluar. Lidhur me sigurimin e cilësisë, kuotat e akorduara në asnjë rast nuk tejkalojnë kapacitetet pritëse të deklaruara nga vetë IAL-të publike. Për akordimin e tyre janë marrë parasysh kërkesat e vetë IAL-ve publike (21 730), nevojat e tregut të punës dhe prioritetet e zhvillimit të vendit, rezultatet e inspektimeve dhe verifikimeve lidhur me standardet dhe kapacitetet e mësimdhënies dhe kushteve infrastrukturore në IAL-të publike.

Është miratuar gjatë kësaj periudhe Ligji Nr 63/2014 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8872, datë 29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nëpërmjet të cilit kemi rregulluar aspektin ligjor të kalimit të varësisë së arsimit të mesëm profesional nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nën varësinë e Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë. Kemi miratuar VKM Nr. 297, datë 08.04.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional (KKAFP)”, nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, i cili është një organ këshillimor i qeverisë për politikat dhe strategjitë në fushën e AFP-së. Gjithashtu po gjatë kësaj periudhe (2014-2015) janë miratuar një sërë aktesh nënligjore (Udhëzime, Udhëzime të përbashkëta me MAS, etj), nëpërmjet të cilave kemi rregulluar aktivitetin dhe funksionimin e ofruesve të AFP-së.

Ndërkohë për t’iu përgjigjur reformës në AFP si dhe për përmirësuar elementë shumë të rëndësishëm si menaxhimi, financimi, decentralizimi, etj., po punojmë për hartimin e një drafti të ri të Ligjit të AFP-së.

Në drejtim të regjistrimeve të nxënësve në shkollat e mesme profesionale si gjatë vitit shkollor 2014-2015 ashtu edhe gjatë këtij viti është rritur numri i te riregjistruarve. Konkretisht vjet numri i të regjistruarve ishte rreth 5.400 nxënës në vitet e para, këtë vit ky numër është mbi 5.800 nxënës.

Ndërkohë në qendrat publike të formimit profesional publik, është rritur në mënyrë të ndjeshme numri i kursantëve të trajnuar. Konkretisht vjet ku numër ishte mbi 13.000 persona të certifikuar në këto qendra, ndërsa këtë vit, për periudhën Janar – Gusht 2015, numri i të trajnuarve është mbi 11.000 persona. Në rritjen e numrit të pjesëmarrësve në kurset e formimit profesional ka ndikuar edhe zbatimi i Urdhrit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 286, Datë 16.12.2013, me anë të të cilit tarifat për punëkërkuesit e papunë të regjistruar pranë zyrave përkatëse të punësimit janë falas.

Duke konsideruar artin dhe trashëgiminë kulturore si një faktor të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, *Ministria e Kulturës gjatë vitit 2015*,ka intensifikuar investimet në infrastrukturë për rehabilitimin, ruajtjen dhe promovimin e artit dhe trashëgimisë kulturore, të cilat kanë pësuar një rritje prej 40% krahasuar me vitin 2014. Është përmirësuar infrastruktura e muzeve, është në proces ngritja e muzeve të rinj si Muzeu i Përgjimeve, Pavioni Etnografik në Muzeun Historik Kombëtar, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë. Është punuar intensivisht për krijimin e një Sistemi Informatik Kombëtar të Administrimit të Trashëgimisë Kulturore si dhe është përmirësuar kuadri ligjor për menaxhimin e qendrave historike Berat Gjirokastër, Pogradec, Korçë etj, ndërsa është intensifikuar bashkëpunimi me autoritetet lokale në kuadrin e këtyre rregulloreve.

Gjithashtu, gjatë vitit 2015, janë hartuar projektet e restaurimit për investime në infrastrukturën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Teatrit Kombëtar, Kapanoni (Skena e re), Teatri "Andon Zako Çajupi" në Korçë dhe Teatri "Migjeni" në Shkodër. Platforma kombëtare "Edukimi përmes Artit" po implementohet me sukses nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë. Gjatë vitit 2015, janë rritur programet specifike që mbështesin krijimtarinë letrare dhe përkthimin nëpërmjet thirrjeve për aplikime për projekte mbështetur nga Ministria e Kulturës si dhe u realizua portali i autorëve shqiptarë (në shqip dhe anglisht) si dhe katalogu përfaqësues i tyre. Është intensifikuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë, është realizuar pjesëmarrja e suksesshme e Shqipërisë në Programin e Bashkimit Evropian "Evropa Krijuese"; e pavionit shqiptar në Bienalen e Artit 2015 në Venecia; kalendari i përbashkët kulturor më Kosovën.

Me urdhrin e Ministres nr. 278, datë 21.07.2015 është ngritur grupi i punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2016-2021", strategji e cila pritet të miratohet në Këshillin e Ministrave brenda vitit 2016.

I.3 Struktura e kapitullit

1. ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL
2. KULTURA

II Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në arsim me *Acquis* të BE-së buron nga neni 70 MSA për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe trajnim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA thekson se 'palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor. Ky bashkëpunim do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e mirëkuptimit të përbashkët dhe të respektit reciprok ndërmjet individëve, komunitetit dhe njerëzve. Palët gjithashtu zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore."

Në përputhje me Partneritetin Evropian prioritetet afatgjatë dhe afatshkurtër në fushën e arsimit dhe trajnimeve, përshkruhen si më poshtë:

Prioritete afatshkurtër:

- Përmirësimi i administrimit të sistemit arsimor, të trajnimi i mësuesve dhe infrastrukturës arsimore.
- Zbatimi i ligjit të ri të arsimit të lartë.
- Pjesëmarrje me aktive në programet komunitare të BE-së si Horizont 2020, 2020 Erasmus + me synim përfitimin maksimal prej tyre.

Prioritete afatmesme:

- Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe krijimi i një sistemi bashkëkohor të arsimit dhe formimit profesional , inkurajimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e arsimit të lartë.

Kërkesa të cilat rrjedhin nga akte/direktiva të tjera në fuqi që kanë lidhje me përafrimin janë:

- Rezoluta e Këshillit 16 Nëntor 2007 mbi Agjendën Evropiane;
- Komunikata e Komisionit, Këshillit, Parlamentit, ECSC dhe Komitetit të Rajoneve mbi një Agjendë Evropiane mbi Kulturën (2007);
- Raporti i Komisionit mbi zbatimin e Agjendës për Kulturën (2010);
- Komunikata e Komisionit mbi promovimin e kulturës dhe sektorëve krijues për rritje dhe punësim në BE (2012);
- Konkluzione të Këshillit mbi Qeverisjen Kulturore;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 1295/2013 për lancimin e Programit "Creative Europe";

- Direktiva 2014/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Maj 2014 për kthimin e objekteve kulturore të lëvizura kundër ligjit nga territori i një Shteti Anëtar.
- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 116/2009 e 18 Dhjetorit 2008 mbi eksportimin e mallrave kulturore.
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 1081/2012 e 9 Nëntorit 2012 për qëllimet e Rregullores së Këshillit (BE) nr. 116/2009 mbi eksportimin e mallrave kulturore

II.2 Përmbledhje e arritjeve legjislative kryesore

Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" synon:

- Fuqizimin e kompetencave të institucioneve që realizojnë drejtpërdrejt shërbimin arsimor nëpërmjet decentralizimit, dekoncentrimit e autonomisë shkollore dhe saktësimi i rolit të nivelit qendror në politika bërje e vendosjen e standardeve të cilësisë së shërbimit arsimor.
- Përmirësimin e ndjeshëm të aftësive menaxhuese në sistemin arsimor nëpërmjet përcaktimit më të qartë të përgjegjësive të institucioneve e individëve, vlerësimit të jashtëm, vetëvlerësimit e raportimit periodik të punonjësve arsimorë e institucioneve dhe shtimit të transparencës së performancës së tyre. Vendosjen e baraspeshës ndërmjet përgjegjësive dhe hapësirës vendimmarrëse.
- Shtimin e larmisë së kurrikulës që t'i shkojë më përshtat larmisë së prirjeve, mundësive dhe aspiratave të karrierës së nxënësve.

Ligji Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
Risitë kryesore të këtij ligji janë si vijon:

- Rrit lirinë akademike, autonominë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit;
- Garanton arsimimin e lartë jo vetëm për ata që kanë mundësi financiare, por dhe për individët që plotësojnë kriteret e pranimit, por që nuk kanë mundësi financiare për të studiuar .
- Krijon kushtet për një arsim të lartë që t'i përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit;
- Unifikon dhe standardizon sistemin e arsimit të lartë;
- Heq maturën shtetërore, përcakton notën mesatare si kriter bazë dhe u jep IAL-ve të drejtën të përcaktojnë kritere shtesë për pranimin e studentëve dhe të përzgjedhin ata fitues;
- Krijon mekanizma të qëndrueshme të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të IAL-ve, në mënyrë që të sigurohen standarde evropiane për arsimin e lartë;
- Krijon baza financiare të qëndrueshme dhe mundësi për të shfrytëzuar burime të ligjshme financimi;
- Ligji sanksionon raportin që duhet të ekzistojë midis pranimeve në IAL dhe aftësive të këtyre të fundit për të përthithur fluksin e studentëve;

- Mundëson konkurrencën e lirë mes IAL-ve, personelit akademik dhe studentëve;
- Përcakton detyrimin për të mbështetur vetëm institucionet publike të arsimit të lartë me infrastrukturë të nevojshme kërkimore-shkencore;
- Krijon fondin për mbështetjen studentore (studentë të shkëlqyer, studentë në programet e studimit që janë prioritet kombëtar, studentë të shtresave në nevojë) për studentë të institucioneve publike të arsimit të lartë;
- Mundëson dhënien e kredive studentëve për të përballuar kostot e studimeve dhe kreditë për institucionet publike me qëllim zhvillimin e tyre institucional dhe infrastrukturor;
- Krijon dy qendra të reja: Qendra për Shërbimet Arsimore që ofron shërbime për qytetarët dhe akses publik në të dhënat për arsimin e lartë; dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të lartë;
- Ristrukturon institucionet ekzistues si Agjencia e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia e Akreditimit Publik të Arsimit të Lartë dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar synon:

- Përgatitjen e të rinjve me njohuri e shprehi të përshtatshme me kërkesat dinamike të tregut të punës përmes modernizimit të AFP, duke u bazuar në kërkesat e niveleve të kualifikimit sipas KSHK.
- Ofrimin e mundësive për përditësim të dijeve e aftësive të të rriturve në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Ligji Nr. 10 247, datë 04.03.2010 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve",përafrohet plotësisht me "Kornizën e Kualifikimeve në Sistemin e Arsimit të Lartë Evropian", miratuar nga Ministrat përgjegjës të arsimit të lartë evropian në Konferencën e Bergen, datë 20.05.2005;Ky akt është hartuar dhe ndryshuar në përafrim plotë të Kornizën Evropianë të Kualifikimeve

Projekt – ligji për Trashëgiminë Kulturore

Ka përfunduar përgatitja e draftit të ri të ligjit pas një konsultimi të kujdesshëm me grupet e interesit/palët e interesuara. Hartimi i këtij ligji ka qenë një proces kompleks, sepse përveç analizës së mangësive të ligjit aktual, ka qenë i nevojshëm studimi i legjislacionit në fuqi që rregullon pjesë të caktuara që janë objekt i ligjit të trashëgimisë kulturore si dhe krijimi i një modeli të qartë veprimi duke marrë parasysh jo vetëm ruajtjen e trashëgimisë kulturore të vendit, por edhe administrimin e tyre në bashkëpunim me biznesin. Ky projektligj përafron legjislacionin shqiptar me Direktivën 2014/60/EU për " Kthimin e objekteve kulturore të trafikuara në mënyrë të paligjshme nga territori i një vendi anëtar ", si dhe me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr.1081/2012 mbi "Eksportin e mallrave kulturorë". Gjithashtu projektligji mbi trashëgiminë kulturore është fokusuar në përmirësimin dhe riorganizimin e mbrojtjes së siteve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë rishtazi dhe peizazhin dhe do të

përmirësojë sistemin e administrimit të siteve të trashëgimisë kulturore duke prezantuar forma të tilla administrimi dhe mbikëqyrjeje të trashëgimisë kulturore që do të mundësojnë nga njëra anë, një situatë të përmirësuar inputesh në to, dhe nga ana tjetër një mbikëqyrje rigoroze të vlerave kulturore që administrohen nga institucionet e trashëgimisë kulturore dhe një promovim më të mirë të tyre. Projekt-ligji parashikon sanksione ligjore të një forme të plotë dhe të diversifikuar për ashpërsimin e masave administrative për personat fizikë dhe juridikë që shkelin rëndë dispozitat e këtij projektligji.

Projektligji i ri "Për trashëgiminë kulturore", është parashikuar të miratohet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në Dhjetor 2016.

Projekt –Ligji "Për Muzetë"

Grupi i punës që po punon për draft-Ligjin "për Trashëgiminë Kulturore" ka vendosur që në këtë draft ligj të përfshijë edhe nenet që rregullojnë sistemin e muzeve në Shqipëri si një komponent i rëndësishëm i mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore. Për pasojë, amendimet në Ligjin Nr. 9387, datë 04.05.2005 "Për muzetë", të parashikuar brenda vitit 2015, nuk do të realizohen, dhe ky ligj do të shfuqizohet. Kjo do të mundësojë realizimin e objektivit për të pasur një ligj plotësisht të integruar në rendin juridik shqiptar për Trashëgiminë Kulturore, si në rastin e praktikave ligjore më të mira të vendeve evropiane dhe më gjerë.

II.3 Përmbledhje e institucioneve përgjegjëse kryesore

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
- Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP),
- Agjencia e Arsimit dhe Zhvillimit (AAZh) ,
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit (IShA),
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve,
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL),
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZhA),
- Inspektorati Kombëtar i Arsimit Para-universitar (IKAP),
- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK),
- Ministria e Kulturës
- INSTAT
- Ministria e Shëndetësisë

II.4 Përcaktimi i Alokimeve Financiare

në 000/Lek

	2016	2017	2018
Buxheti total për këtë kapitull i Institucionit lider	58.221.910	59.369.600	60.541.402
Buxheti total për ketë kapitull i institucioneve të tjera	23.323.000	23.323.000	23.323.000
Buxheti total i Kapitullit	81.544.910	82.692.600	83.864.402

III. Prioritetet

Prioritetet janë si më poshtë:

1. Rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor
    - Zhvillimi i kapitalit njerëzor duke investuar në fëmijërinë e hershme
    - Mundësi hyrjeje dhe përfshirje masive e të gjithë fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor
    - Rritja e cilësisë së shërbimit të mësimdhënies dhe të të nxënit.
2. Reforma në sistemin parauniversitar
    - Reforma në sistemin parauniversitar do të përqendrohet në radhë të parë në rritjen e cilësisë së sistemit arsimor, duke hartuar dhe zbatuar një sistem drejtimi dhe kontrolli vendor dhe kombëtar më të besueshëm. (reformë strukturore 5+4+3 vjet, rishikimi i altertekstit, kurrikula të reja bazuar në kompetenca dhe jo objektiva, karta e performancës/arritjeve për çdo shkollë, vlerësim kombëtar të nxënësve, përmirësimi i procesit të Maturës Shtetërore). Krijimi i një baze të dhënash për menaxhimin efikas administrativ dhe digjitalizimin e çdo procesi të administrimit arsimor, si mjet i domosdoshëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.
    - Përmirësimi i infrastrukturës shkollore: sistemi EMIS të jetë tërësisht funksional, planifikim shkollash të reja, shkolla si qendra komunitare.
    - Proces më të mirë vendimmarrjeje duke krijuar një komunikim të ri shkollë-prindër-qeveri, duke e bërë prindin pjesë të komunikimit dhe arsimimit, do të realizohet llogaridhënia e ndërsjellë dhe do të garantohet cilësia në rekrutimin e mësuesve.

Procedura e re e rekrutimit të mësuesve, ku shkolla bashkë me bordin e senatin e saj, komitetin e prindërve, komunitetin e qeverisjes vendore dhe nxënësit, vendos bashkërisht për zgjedhjen e mësuesve, do të institucionalizohet më tej.

- Gjithëpërfshirje sasiore dhe cilësore e grupeve të margjinalizuara (uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën, pakësimi i dukurisë së korrupsionit: zbatimi i rreptë i masave ndëshkuese për të gjitha praktikat korruptive të denoncuara dhe evidentuara).

3. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë
    - Ofrimi i një cilësie shumë të mirë në arsimin e lartë: ngritja e cilësisë në standardet evropiane dhe qëndrueshmëri, për të fituar besimin e shoqërisë dhe të institucioneve kombëtare; reformë thelbësore në kuadrin ligjor si në drejtim të programeve të studimit (zhvillimi i panevojshëm i disa profesioneve dhe i mangët i disa profesioneve të tjera më të kërkuara në tregun e punës, e deri në cilësinë e diplomave)
    - Efiçencë financiare nëpërmjet menaxhimit dhe alokimit efikas
    - Njohje ndërkombëtare dhe emër/përfaqësim më të mirë
    - Hartimin e një skeme të re financiare për universitet publike, bazuar në arritje dhe rezultate të institucioneve arsimore, vendosjen e një mekanizmi të ri për dhënie llogari ndaj shtetit dhe aktorëve të tjerë publikë.
    - Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2016-2021, përparësitë strategjike të së cilës, në përputhje dhe me programin e qeverisë shqiptare si dhe me planifikimin buxhetor afatmesëm do të jenë: 1) Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore; 2) Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza ; 3) Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve; 4) Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare (materiale dhe shpirtërore) në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare; 5) Hartimi dhe zbatimi i platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore dhe në sistemin parauniversitar.
    - Zbatimi me sukses i Platformës kombëtare “Edukimi përmes Artit” nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë;
    - Forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetezuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare;
    - Rishikimi i ligjit “për Artin dhe Kulturës” Nr. 10352, datë 18.11.2010,me fokus përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të menaxhimit të sistemit kulturor institucional e më gjerë brenda vitit 2016;
    - Rishikimi i Ligjit për Librin, Nr. 9616, datë 27.09.2006 për hartimin e bazës ligjore për krijimin e Qendrës Kombëtare të Librit, brenda vitit 2016;

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2016 – 2018

IV.1 Arsimi dhe formimi profesional

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e Referuar
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)	2009 – 2013
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë(MMSR)	2014 – 2020

Kuadri i masave ligjore ekzistuese

Acquis i BE-së s	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Kryesor	Niveli i përafrimit	Data e miratimit të legjislacionit Shqiptar	Data e Hyrjes në Fuqi të legjislacionit shqiptar
Direktiva Nr.(2000/c, 364/01) c 364/1 (celex no. 12010p001); (2006/962/ec (celex no. 32006h0962)OJ C 115 date 9.5.2008, p 120-1; ROJ(2009/C 155/02); ('ET 2020') OJ(2009/C 119/02; 16459/08 EDUC 278 SOC 736 MI 499; OJ (2006/C 298/05 date 8.12.2006);	Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë "Ligj Nr. 56/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".	MAS	I pjesshëm	22.7.2015	21.9.2015
Deklarata e Bolonjës datë 19 korrik 1999	Ligji Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"	MAS	I plotë	12.9.2015	27.9.2015

Direktiva 2005/36 EC	Ligj Nr. 8872 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me Ligjin 63/2014	MMRS/MAS	I pjesshëm	26.6.2014	18.07.2014
Vendimi i Këshillit 2005/517/KE, datë 22 Nëntor 2004 "Mbi firmosjen e një Marrëveshje Kuadër ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Bashkimit Europian" CELEX 32005L0517, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 192, dt. 22. 07. 2005. Rregullorja (BE) Nr. 1288/2013 e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 "Mbi krijimin e 'Erasmus +': Programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin" (shfuqizon Vendimet Nr. 1719/2006/KE, Nr. 1720/2006/KE dhe Nr. 1298/2008/KE), CELEX	Ligji nr. 117/2014, datë 11.09.2014 "Për Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Erasmus +, programi i BE-së për Rininë dhe Sportin	MAS	I plote	11.09.2014	26.9.2014.

32013L1288,					

Kuadri i politikave të planifikuara

Titulli (Strategji, PV, AP, Dokument Politikash)	**Institucioni kryesor**	**Periudha referencë**	**Data e miratimit**	**Hyrja në fuqi**
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	MAS	2015 – 2020	T1 2016	T1 2016
Program Kombëtar për Sportin	MAS	2015 – 2020	T1 2016	T12016
Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	MAS	2015 – 2020	T1 2016	T12016
Plan Veprimi për zbatimin e Kornizes shqiptare të Kualifikimit	MMRS/MAS	2015 – 2016	T2 2016	T2 2016
Plani i Punës për pilotimin e kurrikulës së re në institucionet arsimore të arsimit bazë në sistemin arsimor parauniversitar" 2015-2019	MAS IZHA	2015 – 2019	T2 2016	T3 2016

Masat e Planifikuara Ligjore 2014 – 2016

***Acquis* i BE-së**	**Statusi i përkthimi në Shqip (Po/Jo)**	**Legjislacioni Shqiptar;**	**Statusi i përkthimit në anglisht (Po/Jo)**	**Institucioni Përgjegjës/Pika e kontaktit**	**Niveli i synuar i përafrimit**	**Data e Planifikuar e Miratimit**	**Data e Hyrjes në fuqi**
AFAT SHKURTRA (2016)							
CEEPUS II Agreement	Po	Projektligj për miratimin e "Marrëveshjes në lidhje me Programin e Shkëmbimit të Studimeve Universitare të Europës Qëndrore"	Jo	MAS	I plotë	T1 2016	T1 2016

		(Central European Exchange Program for University Studies CEEPUS III)					
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e agjencive dhe strukturave të tjera sipas ligjit "Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".	Jo	MAS	I plotë	T1 2016	T1 2016
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Vendim "Për modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor."	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për percaktimin e tarifave kundrejt Q.SH.A"	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për organizimi dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë"	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016

Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për organizimin dhe funksionimi i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për Hartimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë "	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim "Për përcaktimin e tarifave për vlerësimin e jashtëm të cilësisë."	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projekt-vendim "Për Skemat e kreditimit studentor"	Jo	MAS	I Plotë	T2 2016	T2 2016
Direktiva 200/78/KE	Jo	Projektligji për AFP	Jo	MMSR	I pjesshëm	T4 2016	T4 2016
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
Deklarata e Bolonjës e vitit 1999	Po	Projektvendim per ngritjen e sistemit antiplagjiaturë të Doktoratave	Jo	MAS	I pjesshëm	T2 2017	T2 2017

IV.2 Kultura

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e Referuar**
Programi i Qeverisë Shqiptare 2013-2017. Seksioni Shërbimet Publike /	Ministria e Kulturës	2013 – 2017

Kultura dhe Trashëgimia Kulturore		

Kuadri i masave ligjore ekzistuese

***Acquis* i BE-së s**	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni Kryesor**	**Niveli i përafrimit**	**Data e miratimit të legjislacionit Shqiptar**	**Data e Hyrjes në Fuqi të legjislacionit shqiptar**
Direktiva 2014/60/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e dt. 15.05.2014 mbi kthimin e objekteve kulturore te hequra ne mënyre te jashtëligjshme nga territori i një Shteti Anëtar dhe që amendon Rregulloren (KE) Nr 1024/2012	Ligji nr. 9386, dt. 4.5.2005 "Për muzetë "	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	4.05.2005	26.06.2005
	Ligji nr. 9048 dt. 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore "	Ministria e Kulturës	I pa–përafruar	7.04.2003	02.06.2003
Rregullore (EU) Nr 1081/2012 mbi eksportin e mallrave kulturore	Ligji nr. 9386, dt. 4.5.2005 "Për muzetë"	Ministria e Kulturës	I Pa-përafruar	4.05.2005	26.06.2005
	Ligji nr. 9048 dt. 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore "	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	7.04.2003	02.06.2003

Kuadri i Planifikuar i Politikave 2015 – 2017

Titulli	**Institucioni kryesor**	**Periudha e Referimit**	**Data e Miratimit**	**Data e hyrjes në Fuqi**
Strategjia Kombëtare e Kulturës 2016-2021	Ministria e Kulturës	2016 – 2021	Dhjetor 2016	

Masat e Planifikuara Ligjore 2016 – 2018

***Acquis* i BE-së**	**Statusi i**	**Legjislacioni**	**Statusi i**	**Institucioni**	**Niveli i**	**Data e**	**Data e Hyrjes**

	përkthimi në Shqip (Po/Jo)	**Shqiptar;**	**përkthimit në anglisht (Po/Jo)**	**Përgjegjës/Pika e kontaktit**	**synuar i përafrimit**	**Planifikuar e Miratimit**	**në fuqi**
AFAT SHKURTRA (2016)							
Direktiva 2014/60/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 15 Maj 2014 që amendon rregulloren (EU) Nr. 1024/2012.	Jo	Ligji i ri "Për trashëgiminë kulturore"	Jo	Ministria e Kulturës	I Plotë	T4 2016	T4 2016
Rregullore (BE) Nr. 1081/2012 mbi eksportin e mallrave kulturore	Jo	Ligji i ri "Për trashëgiminë kulturore"	Jo	Ministria e Kulturës	I Plotë	T4 2016	T4 2016
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura					
Përfituesi: Ministria e Arsimit dhe Sportit					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Kontributi per procesin e Integrimit	A) Pagat – stafi ekzistues	104,000	83,520	69,600	257,120
	B) Pagat – stafi I ri				

	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet	**104.000**	**83520**	**69600**	**257.120**
Stretegjia e Arsimit Parauniversitar	A) Pagat – stafi ekzistues	29.058.955	29.643.040	30.235.901	
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet	**29.058.955**	**29.643.040**	**30.235.901**	**88.937.896**
Hartimi I Akteve Ligjore ne Zbatim te Ligjit te Arsimit te Larte	A) Pagat – stafi ekzistues	29.058.955	29.643.040	30.235.901	88.937896
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet	**29.058.955**	**29.643.040**	**30.235.901**	**88.937.896**
	Buxheti i përfituesit total	**58.221.910**	**59.369.600**	**60.541.402**	**178.132.912**

Kapitulli : 26					
Përfituesi: Ministria e Kulturës					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**

	buxheti i shtetit				
Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2016-2021 dhe hartimi i kuadrit ligjor për realizmin e kësaj strategjie	A) Pagat – stafi ekzistues	11,748,667 Lekë	11,748,667 lekë	11,748,667 Lekë	35,246,001 Lekë
	B) Pagat – stafi I ri	-	-	-	-
	C) Trajnime	-	-	-	-
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	1,200,000 Lekë	1,200,000 Lekë	1,200,000 Lekë	3,600,000 Lekë
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	3,000,000 Lekë	3,000,000 Lekë	3,000,000 Lekë	6,000,000 Lekë
	Totali për aktivitet	**15,948,667 Lekë**	**15,948,667 Lekë**	**15,948,667 Lekë**	**47,846,001Lekë**
Hartimi i ligjit të ri '' Për trashëgiminë kulturore '' dhe hartimi i kuadrit ligjor per adoptimin e ligjit të ri	A) Pagat – stafi ekzistues	5,874,333 Lekë	5,874,333 Lekë	5,874,333 Lekë	17,622,999 Lekë
	B) Pagat – stafi I ri	-	-	-	-
	C) Trajnime	-	-	-	-
	D) Shërbime të ndryshme konsulence	-	-	-	-
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative	1,500,000 Lekë	1,500,000 Lekë	1,500,000 Lekë	4,500,000 Lekë
	Totali për aktivitet	**7,374,333 Lekë**	**7,374,333 Lekë**	**7,374,333 Lekë**	**22,122,999 Lekë**
	Total kapitulli				69,969,000 All

Tabela B – Fondet e asistencës së huaj

Kapitulli 26: Arsimi dhe	

Kultura				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
Ministria e Kulturës	ArtVision (“Adriatic Live Art Channel”)	IPA Adriatik	198.713 Euro	Objektivi i përgjithshëm i projektit ArtVision është ngritja e sasisë dhe cilësisë së komunikimit ndër-kulturor ndërmjet popullsive të ndryshme të vendeve të Adriatikut që synojnë të përdorin strategji këtë tematik të komunikimit televiziv e satelitore dhe për të aktivizuar metodologji inovative të planifikimit pjesë e politikave kulturore në nivel institucional, përfshirë direkt vendimmarrësit Adriatik. Aktivitetet: 1 Future Kërko Konferenca dhe politikave bashkëkohore kulturore – krahasim krijues; 5 Art në Port - Adriatikut Art Ngjarje; 125 artet audiovizuale produkteve të prodhuara; Një Plan Qëndrueshmëria ndërkufitar në mënyrë që të transmetojë dhe promovimin e produkteve të krijuara në kuadër

				të projektit
Ministria e Kultures	Adrifort (Adrifort-Adriatic fortresses and military areas)	IPA Adriatik	138.183 Euro	Projekti synon ide efektive dhe zgjidhje të aplikueshme që mund të transferohen në kontekste të tjera dhe trashëgimive kulturore ekzistuese në të gjithë zonën e Adriatikut. Rrjeti ADRIFORT përfshin një seri të mjeteve të punës të hapura për të gjithë për një të vërtetë njohuri evropian të përbashkët: një hartë e fortesave të Adriatikut, një laborator vizuale, një qendër kryq dokumentacionit kufitar, shumë punëtorive territoriale, investimet mbi kështjella, pjesë e projektit; web site dhe gazetat periodike.
Ministria e Kultures	Rehabilitim i manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe peizazhit të vendit arkeologjik të Apolonisë, Fier Shqipëri	IPA Multibeneficiary	780.000 Euro	Restaurimi dhe Konservimi i Manastirit të Shën Mërisë në parkun arkeologjik të Apollonisë; Përmirësimi i peizazhit të parkut
		Totali për Kapitullin:	**1.116,896 Euro**	

KAPITULLI 27: MJEDISI

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

Politikat e BE-së për mjedisin kanë si qëllim që të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjësive. Legjislacioni mjedisor i BE-sëpërfshin dispozita që trajtojnëlegjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuara gjenetikisht, kimikatet, zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme, por sjell edhe përfitime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal është e domosdoshme për aplikimin dhe zbatimin e *acquis*.

I.2 Situata Aktuale në Shqipëri

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar cilësinë e ujit dhe atë te ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, etj. Megjithëse, Shqipëria është në një fazë të hershme të përgatitjeve në këtë fushë, ka pasur disa përparime në fushën e mjedisit dhe atë të ndryshimeve klimatike. Përafrimi me *acquis* ka përparuar, por përsëri nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një përafrim të plotë me *acquis* mjedisor të BE-së, në veçanti me Direktivën mbi Krimin Mjedisor. Në këtë kuadër, si dhe me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, Shqipëria ka vijuar me hartimin dhe amendimin e disa ligjeve kryesore, si dhe hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e mjedisit dhe atë të ndryshimeve klimatike.

Hapat e ndërmarrë për të forcuar zbatimin e ligjit duhet të vazhdojnë. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përmirësuar ndjeshem, por duhet të forcohet edhe më shume, veçanërisht në sektorin e hidrocentraleve dhe ate te minierave. Nderkohe qe jane zgjidhur problemet per sa i perket ndarjes se pergjegjesive ndermjet Agjencise Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe organeve zbatuese, lidhur me monitorimin e cilesise se ajrit. Ndalimi i pirjes së duhanit në ambjente të mbyllura ka rezultuar efektiv.

Që nga shkurti 2015, fusha e menaxhimit të ujërave është përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), ndërkohë qëështë krijuar edhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), me rol kryesor në koordinimin e punës për çështjet dhe problematikat e sektorit të ujit në vend, si dhe Inspektoriati Shtetëror i Ujit (ISHU), i cili është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat.

Me qëllim përmirësimin e situatës në këtë fushë, janë miratuar një sërë rregulloresh të rëndësishme lidhur me shfrytëzimin e ujit. Në përgjithësi është përmirësuar cilësia e ujërave për larje, por mbetet e pakënaqshme situata në lumenj, ku ujërat e zeza të patrajtuara mbeten burimi kryesor i ndotjes së tyre.

Për tu theksuar është fakti se disa Vendime të Qeverisë kanë përmirësuar ndjeshëm partneritetin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile. Miratimi i VKM-së nr. 247, date 30.04.2014 “Për miratimin e rregullave, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", miratimi i VKM nr. 419, date 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, rritja e numrit të stafit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit i përfshirë drejtpërdrejt në shqyrtimin e aplikimeve për lejet mjedisore, kryerja rregullisht e konsultimeve me publikun për planet e mjedisit, programet dhe legjislacionin, organizimi i takimeve të rregullta me OJQ-të mjedisore, si dhe shpërndarja e Buletineve Mjedisore Javore dhe Mujore, kanë përmirësuar ndjeshëm situatën lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen mjedisore, si dhe aksesin e publikut për informacion mjedisor. Një progres i tillë është shkrehur edhe nga stafi i KE-së në Progres Raportin 2015.

Gjithashtu, progres ka pasur edhe për sa i përket kuadrit institucional dhe administrativ. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është riorganizuar ku përveç ndryshimit të emrit në Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe shtimit të përgjegjësive, është rritur edhe numri i punonjësve, nga 42 në 62 punonjës. Në varësi të AKM-së kanë kaluar edhe 12 Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, të cilatoperojnë dhe koordinojnë punën dhe funksionet e tyre me ato të AKM-së si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar.

Me organizimin e ri të AKM-së dhe në përputhje të plotë me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, vëmendje e veçantë i është dhënë edhe forcimit të Laboratorit të AKM-së. Laboratori është zhvendosur në një vend të ri, plotësisht të rinovuar dhe në përputhje me standardet e kërkuara *ISO 170 25* të manualit të cilësisë. Përveç rinovimit të ndërtesës së Laboratorit të AKM-së është realizuar edhe blerja e pajisjeve teknike për analizimin dhe monitorimin e parametrave themelor të cilësisë së ujit, si dhe është rritur numri i stacioneve të monitorimit të ajrit. Gjithashtu, tashmë AKM

realizon edhe monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor, lumenjve, liqeneve dhe ujërave bregdetar, si dhe përcaktimin e metaleve të rënda në lumenj. Numri i stacioneve të monitorimi në lumenj, liqene dhe në pjesët bregdetare eshte rritur ndjeshëm, krahasuar me vitin 2013 ku Shqipëria kishte vetëm gjysmën e numrit të këtyre stacioneve të monitorimit. Megjithatë, pavarësisht forcimit në mënyrë të konsiderueshme të kapacitetit administrativ të AKM-së, si dhe përmirësimit të sistemit të montorimit mjedisor, opinion ky i shprehur edhe nga stafi i KE-së në Progres Raportin 2015, përsëri ka nevojë për më shumë financime.

Në Shkurt 2014, është krijuar Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), i cili është një institucion publik, i financuar nga buxheti i shtetit, në varësi të Ministrit të Mjedisit. Misioni i tij është garantimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e mjedisit dhe pyjeve.

Ashtu si për AKM-në, një opinion pozitiv Komisioni ka shprehur edhe për sa i përket Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, duke cituar se ISHMP ka ndërmarrë hapat e parë për të forcuar zbatimin e ligjit, si dhe ka theksuar faktin se në tetor 2015, është krijuar një task forcë për të inspektuar dhe vlerësuar përputhshmërinë mjedisore të kompanive që operojnë në fushën e kërkimit të naftës.

Me qëllim përmirësimin e zbatimit të ligjit, Inspektorati i Mjedisit ka rritur ndjeshëm numrin e kontrolleve në zonat industriale, ku në kryerjen e kësaj detyre ka bashkëpunuar ngushtë me inspektoratet dhe institucionet e tjera shtetërore. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë masash administrative për sa i përket shkeljeve të kushteve të lejes mjedisore, si dhe detyrimeve të tjera që lindin nga legjislacioni mjedisor. Legjislacioni i paplotë lidhur me zbatimin, në veçanti në sektorin e ujit, si dhe burimet e kufizuara logjistike shpeshherë pengojnë funksionimin normal të këtij inspektorati.

Gjithashtu, me qëllim mbrojtjen e natyrës dhe ndalimin aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura, janë ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm siç janë **(i)** amendimi i ligjit për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës. Tashmë, Qendra Kërkimore për Florën dhe Faunën duhet të konsultohet përpara se të lëshohet një leje për tregtimin e tyre, **(ii)** miratimi i akteve ligjore që ndalojnë gjuetinë apo transportin e qymyrit të drurit, **(iii)** nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme "Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pyjeve", i cili krijon Task Forcën mbi Pyjet, **(iv)** rritja e numrit të kontrolleve nga ana e Policisë Pyjore, **(v)** vendosja e masave administrative për të gjithë shkelësit e legjislacionit mjedisor, etj. Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit, në Shkurt 2014 janë krijuar 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor.

Në kuadër të reformës për menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura, në Shkurt 2015, u krijua Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) si një institucion në varësi të Ministrit të Mjedisit, që siguron për herë të parë në vend krijimin e administratave të pavarura të zonave të mbrojtura, jashtë strukturave të shërbimit pyjor. Në këtë kontekst, është hartuar Programi Strategjik 2015-2020 për Zonat e

Mbrojtura që synon përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare dhe eksperiencës së vendeve evropiane, duke ruajtur dhe përdoruar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në to.

Ndryshimeka pesuar edhe struktura e Ministrisë së Mjedisit, ku ne perberje te saj tashme eshte edhe Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve, e cila është përgjegjëse për të lehtësuar zbatimin e prioriteteve të nivelit të lartë të Kryeministrit, të cilat janë gjithashtu edhe prioritetetë Ministrisë së Mjedisit, si dhe të sigurojë dorëzimin e produkteve brenda afateve kohore të përcaktuara. Prioritet të cilat pasqyrohen në programet e punës, monitorohen dhe raportohen në mënyrë periodike për realizueshmërinë dhe problematikën që përfshijnë.

Me qëllim evidentimin e zonave të ndotura, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) në vitin 2015, ka ndërtuar hartën dhe databazën e parë të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane për tëgjithë territorin e Shqipërisë. Harta është një platformë interaktive e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS), e cila është bërë e aksesueshme për tëgjithë publikun. Harta momentalisht paraqet 92 venddepozitime aktive, por në vazhdim informacioni do të përditësohet me zhvillimet të tjera në terren, si dhe krijimin e modelimeve për landfillet.

I.3 Struktura e Kapitullit

1. Legjislacioni Horizontal;
2. Cilësia e Ajrit dhe Ndryshimet Klimaterike;
3. Menaxhimi i Mbetjeve;
4. Menaxhimii Ujërave;
5. Mbrojtja e Natyrës;
6. Ndotja Industriale, Menaxhimii Risqeve dhe Aksidentet;
7. Organizmat e Modifikuara Gjenetikisht;
8. Kimikatet;
9. Mbrojtja nga Zhurmat;
10. Pyjet

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e Kërkesave të MSA-së dhe Legjislacionit të BE-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit Shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së, rrjedh nga Neni 108 i MSA-së, në të cilin citohet si më poshtë vijon:

- Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.
- Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për fushën e mjedisit.

Legjislacioni i BE-së në fushën e mjedisit është i përbërë nga aktet ligjore të më poshtme:

Për fushën e Legjislacionit Horizontal

- Direktiva 2004/35/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21.04.2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin";
- Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27.06.2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara";
- Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë13.12.2011"Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private", amenduar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16.04.2014;
- Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26.05.2003 mbi "Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve e programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi të Direktivave të Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC";
- Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, datë 28.01.2003 mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor dhe shfuqizim të Direktivës së Këshillit 90/313/EEC;
- Vendimi i Këshillit të BE-së 2005/370/EC, datë 17.02.2005 për miratimin në emër të Komunitetit Evropian të Konventës për të drejtën për informim, pjesëmarrjetë publikut në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatave për çështjet mjedisore.

Për fushën e Cilësisë së Ajrit

- Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën;
- Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 15 Dhjetor 2004, lidhur me arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit;

- Direktiva 2001/81/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Tetor 2001 mbi Tavanet Kombëtare të Shkarkimit për disa ndotës atmosferik e amenduar nga Direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja 219/2009/EC;
- Direktiva e Këshillit 1999/32/EC e datës 26 Prill 1999 në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme dhe amendon Direktivën 93/12/EC siç amendohet nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 219/2009 dhe Direktivat 2005/33/EC dhe 2009/30/EC;
- Direktiva 2012/33 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Nëntor 2012 që amendon Direktivën e Këshillit 1999/32/EC në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse në transportin detar;
- Direktiva e Këshillit 1999/13/EC e datës 11 Mars 1999 mbi kufizimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa aktivitete dhe instalime, e ndryshuar me Rregulloren1882/2003, Direktivën 2004/42/EC dhe Direktivën 2008/112/EC;
- Vendimi i Këshillit 2000/541/ECi datës 6 Shtator 2000 mbi kriteret për vlerësimin e planeve kombëtare në përputhje me Nenin 6, të Direktivës së Këshillit 1999/13/EC (njoftuar në kuadër të dokumentit numër C(2000) 2473);
- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 94/63/EC e datës 20 Dhjetor 1994 mbi kontrollin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme (VOC) që burojnë nga depozitimi i karburantit dhe nga shpërndarja e tij nga terminalet tek stacionet e shërbimit siç amendohet nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008;
- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2009/126/EC e datës 21 Tetor 2009 mbi rikuperimin e avujve të karburantit të Fazës së II, gjatë rimbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shërbimit;
- Direktiva 2004/42/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Prill 2004 mbi limitimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa bojëra dhe llaqe të caktuara dhe produkteve për rilyerjen e automjeteve që amendon Direktivën 1999/13/EC dhe 2009/112/EC dhe Rregulloren (EC) 1137/2008;
- Direktiva e Këshillit 70/220/EEC e datës 20 Mars 1970 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të merren kundër ndotjes së ajrit nga gazet e çliruara nga mjetet motorike me motor me ndezje pozitive;
- Direktiva 97/68/EC e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 16 Dhjetor 1997 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore, amenduar nga Direktiva 2002/88/EC dhe Direktiva 2004/26/EC, dhe amendimi i fundit i Direktivës 2006/105/EC;
- Direktiva 2005/55/EC e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 28 Shtator 2005 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete;

- Rregullorja (EC) 715/2007 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e datës 20 Qershor 2007 mbi aprovimin e tipit të motorëve të automjeteve në lidhje me shkarkimet nga automjetet për pasagjer dhe tregëtar (Euro 5 dhe Euro 6) dhe mbi aksesin për riparimin e automjeteve dhe mirëmbajtjen e informacionit. Që prej Janarit 2013 kjo Rregullore shfuqizon Direktivat: 70/220/EEC, 72/306/EEC, 77/102/EEC, 74/290/EEC, 78/665/EEC, 80/1268/EEC, 83/351/EEC, 88/76/EEC, 88/436/EEC, 89/458/EEC, 91/441/EEC, 93/59/EEC, 93/116/EC, 94/12/EC, 96/44/EC, 96/69/EC, 98/69/EC, 98/77/EC, 1999/100/EC, 1999/102/EC, 2001/1/EC, 2001/100/EC, 2002/80/EC, 2003/76/EC, 2004/3/EC.

Për fushën e Ndryshimeve Klimatike

Mekanizmi Monitorues

- Vendimi i Këshillit 2002/358/ECi datës 25 Prill 2002 në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve;
- Vendimi i Komisionit 2005/166/EC e datës 10 Shkurt 2005 që parashtron rregullat e zbatimit të Vendimit 280/2004/EC te Parlamentit dhe te Këshillit Evropian lidhur me mekanizmin për monitorimin e emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit dhe për zbatimin e Protokollit të Kiotos;
- Vendimi i Komisionit i datës 14 Dhjetor 2006 që përcakton nivelet përkatëse të emisioneve të akorduara për Komunitetin dhe për secilin nga Shtetet Anëtare të tij sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Vendimit të Këshillit 2002/358/EC (njoftuar nën numrin e dokumentit C (2006) 6468) (2006/944 /EC);
- Vendimi i Komisionit 2010/778/EC, datë 15 Dhjetor 2010 i cili amendon Vendimin 2006/944/EC për përcaktimin e niveleve përkatëse të emetimeve të akorduara Komunitetit dhe secilit prej Shteteve Anëtare të tij sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Vendimit të Këshillit 2002/358/EC;
- Rregullorja (EU) 525/2013 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2013 e mekanizmit për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe për raportimin e informacioneve të tjera në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian në lidhje me Ndryshimet Klimatike dhe shfuqizimin e Vendimit 280 /2004/EC.

Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të BE

- Direktiva 2003/87/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Tetor 2003 për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit e cila amendon Direktivën e Këshillit 96/61/EC;

- Direktiva 2004/101/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 27 Tetor 2004 e cila amendon Direktivën 2003/87/EC për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e Protokollit të Kiotos-s;
- Vendimi i Komisionit 2006/780/EC i datës 13 Nëntor 2006 mbi shmangien nga llogaritja e dyfishtë e reduktimit të emisioneve të gazeve me efekt serrë sipas skemës për tregtimin e emisioneve të Komunitetit për projektet e aktiviteteve sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe te Këshillit Evropian;
- Direktiva 2009/29/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Prill 2009 e cila amendon Direktivën 2003/87/EC në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit;
- Vendimi i Komisionit 2010/2/EC i cili përcakton një listë të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes se karbonit;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 389/2013 e datës 2 Maj 2013 për krijimin e një Regjistri të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, Vendimet 280/2004/EC dhe 406/2009/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, e cila shfuqizon Rregulloret e Komisionit (EU) 920/2010 dhe 1193/2011;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 1031/2010 datë 12 Nëntor 2010 mbi afatin kohor, administrimin dhe aspekte të tjera të ankandit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për krijimin e një skeme për tregtimin e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 550/2011 datë 7 Qershor 2011 mbi përcaktimin e disa kufizimeve të zbatueshme për përdorimin e krediteve ndërkombëtare nga projektet që përfshijnë gazet industriale në përputhje edhe me kërkesat e Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 1123/2013 e datës 8 Nëntor 2013 për përcaktimin e të drejtave ndërkombëtare të krediteve në zbatim të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe Tekstit të Këshillit Evropian në përputhje me Agjencinë Evropiane të Mjedisit;
- Vendimi i Komisionit 2011/278/EU për përcaktimin e rregullave transitore të Bashkimit Evropian të zgjeruar për harmonizimin e shpërndarjes së lirë të njësive të lejuara të emisioneve në përputhje me Nenin 10a të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian (të njoftuar në dokumentin C (2011) 2772);
- Vendimi i Komisionit 2013/447/EU datë 5 Shtator 2013 për faktorin standard të përdorimit të kapaciteteve në përputhje me nenin 18 (2) të Vendimit 2011/278/EU Tekst me rëndësi nga Agjencia Evropiane e Mjedisit;
- Vendimi i Komisionit 2011/745/EU i cili amendon Vendimet 2010/2/EU dhe 2011/278/EU sa i përket sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohen të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit;

- Rregullorja e Komisionit 600/2012 për verifikimin e raporteve të emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe raportet ton-kilometër dhe akreditimin e verifikuesve sipas Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian. Tekst me rëndësi nga Agjencia Evropiane e Mjedisit;
- Rregullorja e Komisionit 601/2012 mbi monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit dhe te Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EU)176/2014 e datës 25 Shkurt 2014 e cila amendon Rregulloren (EU) 1031/2010 në veçanti për të përcaktuar vëllimin e njësive të lejuara të emetimeve të gazeve me efekt serrë që do te dalin në ankand në 2013-2020.

Sistemi i Tregtimit të Emisioneve: Aktivitetet e Aviacionit

- Direktiva 2008/101/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 19 Nëntor 2008 e cila amendon Direktivën 2003/87/EC në mënyrë që të përfshijë aktivitetet e aviacionit në skemën e tregtisë së njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit;
- Vendimi i Komisionit 2009/450/EC i datës 8 Qershor 2009 mbi interpretimin e detajuar të aktiviteteve të aviacionit të listuara në Aneksin I të Direktivës 2003/87/EC;
- Vendimi 377/2013/EU i Parlamentit Evropian dhe e Këshillit i datës 24 Prill 2013 për shmangien përkohësisht nga Direktiva 2003/87/EC për krijimin e një skeme të tregtisë për njësitë e lejuara të emetimeve të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit.

Vendimi për Shpërndarjen e Përpjekjeve

- Vendimi 406/2009/EC i Parlamentit dhe i Këshillit Evropian i datës 23 Prill 2009 mbi përpjekjet e Shteteve Anëtare për të reduktuar emetimet e tyre të gazeve me efekt serrë për të përmbushur angazhimet e Komunitetit Evropian për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë deri në vitin 2020.

Substancat Ozonholluese

- Rregullorja (EC) 1005/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Shtator 2009 mbi substancat që hollojnë shtresën e ozonit;
- Vendimi i Komisionit 2010/372/EC i datës 18 Qershor 2010 mbi përdorimin e substancave të kontrolluara si agjentë të procesit sipas nenit 8 (4) të Rregullores (EC) Nr. 1005/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 744/2010 e datës 18 Gusht 2010 e cila amendon Rregulloren (EC) 1005/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit, në lidhje me përdorimet kritike të haloneve;
- Rregullorja e Komisionit (EU)291/2011 e datës 24 Mars 2011 për përdorimin thelbësor të substancave të kontrolluara përveç hydroklorofluorokarboneve për laboratorët dhe për qëllime analitike në Bashkimin Evropian sipas Rregullores (EC) 1005/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit;

- Rregullorja e Komisionit (EU) 537/2011 e datës 1 Qershor 2011 e mekanizmit për alokimin e sasive të kontrolluara të substancave të lejuara për përdorime laboratorike dhe analitike në Bashkimin Evropian nën Rregulloren (EC) 1005/2009 e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit.

Gazet e Florinuara

- Rregullorja (EC) 517/2014 "Mbi gazet serrë të florinuara" që shfuqizon Rregulloren 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Maj 2006, mbi krijimin e formatit për raportimin që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa gazeve serrë të florinuara;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 1493/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin e formatit për raportimin që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa gazeve serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 842/2006,;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 1494/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin e formatit të etiketave dhe kërkesave shtesë të etiketimit për sa i përket produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë disa gazeve serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 842/2006;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 1516/2007 e datës 19 Dhjetor 2007 mbi përcaktimin e kërkesave standarde të kontrollit të rrjedhjeve për stacionet fikse ftohëse, kondicionimin e ajrit dhe pompat e nxehtësisë që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 303/2008 e datës 2 Prill 2008 mbi përcaktimin e kërkesave dhe kushteve minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit sa i përket stacioneve fikse ftohëse, kondicionimitte ajrit dhe pompat e nxehtësisë që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 304/2008 e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin e kërkesave dhe kushteve minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit sa i përket sistemeve të palëvizshme të mbrojtjes nga zjarri dhe shuarësve të zjarrit që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 305/2008 e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin e kërkesave dhe kushteve minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit për rikuperimin e disa gazeve serrë të florinuara nga kutia e shpejtësisë së tensionit të lartë, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 306/2008, e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin e kërkesave dhe kushteve minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit për rikuperimin nga pajisjet, të disa tretësve me bazë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;

- Rregullorja e Komisionit (EC) 307/2008, e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin e kërkesave për programet e trajnimit dhe kushtet për njohje të përbashkët të certifikimit të trajnimit për personelin përsa i përket sistemeve të kondicionimit të ajrit, në disa mjete motorike që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EC) 308/2008, e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin e formatit të njoftimit për trajnimet dhe programet e certifikimit të Vendeve Anëtare, në përputhje edhe me Rregulloren (EC) 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian.

Cilësia e Lëndës Djegëse

- Direktiva 98/70/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Tetor 1998 në lidhje më cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe naftë dhe që amendon Direktivën e Këshillit 93/12/EEC;
- Direktiva e Komisionit 2002/159/EC e datës 18 Shkurt 2002 mbi një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të të dhënave kombëtare mbi cilësinë e lëndës djegëse (të njoftuara në kuadër të dokumentit me numër C(2002) 508);
- Direktiva 2009/30/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian që amendon Direktivën 98/70/EC përsa i përket specifikimeve të benzinës, naftës dhe gas-nafte dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe amendimin e Direktivës së Këshillit 1999/32/EC për sa i përket specifikimit të lëndës djegëse të përdorur nga mjetet në brendësi të rrugëve ujore dhe shfuqizimin e Direktivës 93/12/EC.

Emetimet e CO2 nga Makinat dhe Furgonat

- Direktiva 1999/94/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Dhjetor 1999 në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO2 në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve;
- Rregullore (EC) 443/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Prill 2009, që vendos standardet e performancës së emetimeve për makinat e reja të pasagjerëve si pjesë e përqasjes së integruar të Komunitetit për të reduktuar emetimet e CO2 nga makinat e lehta;
- Rregullore e Komisionit (EU) 1014/2010 e datës 10 Nëntor 2010 mbi monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi regjistrimin e makinave të reja të pasagjerëve në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Rregullore e Komisionit (EU) 63/2011 e datës 26 Janar 2011, mbi përcaktimin e masave të detajuara për aplikimin për shmangien nga objektivat specifike të emetimeve të CO2 në përputhje me Nenin 11të Rregulloressë Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Rregullore (EU) 510/2011 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 11 Maj 2011, që vendos standardet e performancës së emetimeve për makinat e reja tregtare të lehta si pjesë e përqasjes së integruar e Bashkimit Europian për të reduktuar emetimet e CO2 nga makinat e lehta;

- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (EU) 725/2011 e datës 25 Korrik 2011, që vendos një procedurë për miratimin dhe certifikimin e teknologjive novatore për reduktimin e emetimeve të CO2 nga makinat e pasagjerëve, në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Vendimi i Komisionit 2012/100/EU i datës 17 Shkurt 2012 mbi metodën për grumbullimin e shpërblimeve për emisionet e tepërta të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (EU) 293/2012 e datës 3 Prill 2012 mbi monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi regjistrimin e makinave të reja të lehta tregtare në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 510/2011;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit 2012/99/EU e datës 17 Shkurt 2012 mbi marrëveshjet e detajuara për grumbullimin e shpërblimeve për emisionet e tepërta të CO2 nga makinat e reja të lehta tregtare në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EU) 510/2011. Teksti përkatës me EEA;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 397/2013 e datës 30 Prill 2013 që amendon Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (EC) 443/2009 përsa i përket monitorimit të emetimeve të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (EU) 396/2013 e datës 30 Prill 2013 që amendon Rregulloren (EU) 1014/2010 për sa i përket disa kërkesave për monitorimin e emetimeve të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve.

Pyjet dhe Bujqësia

- Vendimi i Parlamentit dhe i Këshillit Evropian 529/2013/EU, e datës 21 Maj 2013 mbi rregullat e llogaritjes së emetimeve të gazeve serrë dhe heqjeve që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës dhe pyjet dhe mbi masat që lidhen me këto aktivitete.

Kapja dhe Depozitimi i Karbonit

- Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2009/31/EC e datës 23 Prill 2009 mbi depozitimin gjeologjik të dyoksidit të karbonit, që amendon Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 85/337/EEC, Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2000/60/EC, 2001/80/EC, 2004/35/EC, 2006/12/EC, 2008/1/EC dhe Rregulloren (EC) 1013/2006;
- Direktiva e Komisionit 2010/670/EU e datës 3 Nëntor 2010 që përcakton kriteret dhe masat për financimin dhe projektet treguese tregtare që synojnë kapjen dhe depozitimin gjeologjik të sigurt nga ana mjedisore të dyoksidit të karbonit si dhe projektet që tregojnë teknologjitë e reja të energjisë së rinovueshme në kuadër të skemës për tregtimin e emetimeve të lejuara të gazeve serrë brenda Komunitetit të përcaktuar nga Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2003/87 (njoftuar në kuadër të dokumentit K(2010) 7499).

Për Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve

- Direktiva 2008/98/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 19 Nëntor 2008 mbi Mbetjet;
- Direktiva 86/278/EEC "Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës, kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi, ndryshuar nga Direktiva 91/692/EEC, Rregullorja (EC) 807/2003 dhe Rregullorja (EC) 219/2009;
- Direktiva 2006/66/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 6 Shtator 2006 "Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët", e amenduar nga Direktiva 2008/12/EC, nga Direktiva 2008/103/EC dhe Direktiva 2013/56/EU dhe Vendimet e Komisionit 2008/763/EC, 2009/603/EC, 2009/851/EC;
- Direktiva 94/62/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 Dhjetor 1994 "Për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet", e amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 219/2009 dhe Direktivat 2004/12/EC, 2005/20/EC dhe 2013/2/EU;
- Direktiva 96/59/EC e datës 16 Shtator 1996 "Për asgjësimin e bifenileve të poliklorinuara dhe trifenileve të poliklorinuara (PCB/PCT)", e amenduar nga Rregullorja (EC) 596/2009;
- Direktiva 2000/53/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 18 Shtator 2000 "Për automjetet në fund të jetës";
- Direktiva 2002/96/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 27 Janar 2003 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)", e amenduar nga Direktiva 2003/108/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 8 Dhjetor 2003;
- Direktiva e Këshillit 1999/31/EC e 26 Prillit 1999 "Mbi landfillin e mbetjeve", e amenduar nga Rregullorja (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008 dhe Direktiva 2011/97/EU;
- Direktiva 2006/21/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 15 Mars 2006 "Për menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse" që amendon Direktivën 2004/35/EC dhe Rregulloren 596/2009/EC, e amenduar nga Vendimet e Komisionit 2009/335/EC, 2009/337/EC, 2009/358/EC, 2009/359/EC dhe 2009/360/EC;
- Rregullorja 1257/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 20 Nëntor 2013 "Për riciklimin e anijeve" që amendon rregulloren 1013/2006 dhe Direktivën 2009/16/EC;
- Rregullorja 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 14 Qershor 2006 "Për transferimin e mbetjeve", e amenduar nga Rregullorja 1379/2007/EC, 669/2008/EC, 219/2009/EC, 255/2013/EU dhe 308/2009/EC, 664/2011/EU dhe 135/2012/EC;
- Direktiva 2012/19/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 4 Korrik 2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)";
- Direktiva 2011/65/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 8 Qershor 2011 "Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike", e amenduar nga Direktivat 2012/50/EU, 2012/51/EU, 2014/1/EU dhe 2014/16/EU;
- Rregullorja 1069/2009/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 21 Tetor 2009 që përcakton rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produktet e përftuara prej tyre jo të destinuara për konsum njerëzor dhe duke shfuqizuar Rregulloren (EC) 1774/2002 (Rregullore për nënproduktet shtazore) .

Për Fushën e Cilësisë së Ujërave

- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave të ujit, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC dhe 2013/39/EU;
- Direktiva e Këshillit 91/271/EEC e 21 Maj 1991 për trajtimin e ujërave të ndotur urban, amenduar nga Direktiva 98/15/EC dhe Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008;
- Direktiva 2008/56/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 Qershorit 2008 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare (Direktiva për kuadrin e strategjisë detare);
- Direktiva eKëshillit 98/83/EC e 3 Nëntorit 1998 për cilësinë e ujit të pijshëm, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009;
- Direktiva e Këshillit 91/676/EEC e 12 Dhjetorit 1991 për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet e përdorura në bujqësi, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008;
- Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Shkurtit 2006 për menaxhimin e cilësisë sëujërave të larjes që shfuqizon Direktivën 76/160/EEC te amenduar me Rregulloren (EC) 596/2009;
- Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 Dhjetorit 2006 për mbrojtjen e ujërave nëntokësornga ndotja dhe degradimi;
- Direktiva 2013/39/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 Gushtit 2013, e cila amendon Direktivën 2000/60/EC dhe 2008/105/EC për sa i përket substancave prioritare në fushën e politikave të ujit;
- Direktiva 2009/90/EC e 31 Korrikut 2009 që parashtron, në ndjekje të Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dheKëshillit, specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujit;
- Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Tetor 2007 për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet.

Për Fushën e Mbrojtjes së Natyrës

- Direktiva 2009/147/EC e 30 Nëntorit 2009 “Për ruajtjen e shpendëve të egër” (versioni i konsoliduar);
- Direktiva 92/43/EEC e 21 Majit 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër, të ndryshuar nga Direktiva 97/62/EC, Direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja (EC) 1882/2003;
- Direktiva 1999/22/EC e 29 Marsit 1999 lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike;

- Rregullore EC/338/97 e 9 Dhjetorit 1996 për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre, ndryshuar me Rregulloren EC/865/2006;
- Rregullore EEC/3254/91 e 4 Nëntorit 1991 që ndalon përdorimin e leqeve (kurtheve) në Komunitet dhe hyrjen në Komunitet të gëzofit dhe prodhimeve të disa llojesh të faunës së egër me origjinë nga vendet që i kapin ato duke përdorur metodat e kurtheve (leqeve) që nuk plotësojnë standardet njerëzore ndërkombëtare të zënies me kurthe (leqe);
- Direktiva 83/129/EEC e 28 Marsit 1983 lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre;
- Rregullore e Këshillit 348/81/EEC e 20 Janarit 1981 për rregullat e përbashkëta për importin e balenave dhe produkteve të tjera të cetaceve dhe amendimet.

Për fushën e Kontrollit të Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Riskut

- Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për shkarkimet industriale;
- Rregullore e EC/166/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi Regjistrin Evropian të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
- Rregullore (EC) 66/2010 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 17 korrikut 2000 mbi EU ECOLABEL;
- Rregullore (EC) 1221/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 25 nëntorit 2009 mbi Pjesëmarrjen Vullnetare të Organizatave në Komunitetin e Eko-Menaxhimit dhe Skemat e Auditit (EMAS);
- Direktiva 2012/18/EC e datës 4 korrik 2012 “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme, ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/KE.

Për fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht

- Direktiva 2001/18/EC e 12 marsit 2001 për lëshimin e kontrolluar në mjedis të Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht;
- Vendim 2002/811/EC i 3 tetorit 2002 që vendos udhëzues për Aneksin shtesë VII të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për lëshimin e kontrolluar në mjedis të Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 90/220/EEC;
- Vendim i Komisionit 2002/813/EC i 3 Tetorit 2002, që vendos sipas Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, formatin për informacionin përmbledhës të lajmërimit, për lajmërimet që lidhen me lëshimin e kontrolluar në mjedis të OMGJ-ve për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg;

- Vendim i Komisionit 2003/701/EC i 29 shtatorit 2003 që vendos në vijim të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit një format për paraqitjen e rezultateve të hedhjes së kontrolluar në mjedis të bimëve të larta të Modifikuara Gjenetikisht për qëllime përveç hedhjes së tyre në treg;
- Rregullore 1830/2003 e 22 shtatorit 2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me gjurmueshmërinë dhe etiketimin e OMGJ-ve dhe gjurmueshmërinë e ushqimeve dhe produkteve ushqimore të prodhuara nga OMGJ-te dhe që amendon Direktivën 2001/18/EC.

Për fushën e Kimikateve

- Rregullorja (EC) 1907/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 18 dhjetor 2006 në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve ECHA, që amendon Direktivën 1999/45/EC dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) 793/93, si dhe Direktivën e Këshillit 76/769/EEC dhe Direktivat e Komisionit 91/155/EEC, 93/67/EEC, 93/105/EC dhe 2000/21/EC;
- Rregullorja (EC) 1272/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 dhjetor 2008 mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve, që amendon dhe shfuqizon Direktivat 67/548/EEC dhe 1999/45/EC, dhe amendon Rregulloren (EC) 1907/2006;
- Rregullorja (EC) 1102/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 tetor 2008 mbi ndalimin e eksportit të mërkurit metalik dhe të disa komponimeve dhe përzierjeve dhe depozitimin e sigurt të mërkurit metalik;
- Direktiva e Këshillit 87/217/EEC e datës 19 Mars 1987 mbi parandalimin dhe reduktimin e ndotjes mjedisore nga asbesti siç amendohet nga Direktiva 91/692/EEC dhe Rregullorja (EC) 807/2003;
- Direktiva 98/8/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 shkurt 1998 në lidhje me hedhjen në treg të produkteve biocide siç është amenduar nga Rregullorja (EC) 1882/2003 dhe Direktivat 2006/50/EC, 2006/140/EC dhe 2009/151/EC;
- Rregullorja (EU) 528/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Maj 2012 në lidhje me përdorimin dhe disponueshmërinë në treg të produkteve biocide;
- Rregullorja (EC) 850/2004 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 29 prill 2004 mbi ndotësit organik të qëndrueshëm dhe që amendon Direktivën 79/117/EEC dhe Rregulloret (EC) 1195/2006, (EC) 172/2007, (EC) 323/2007, (EC) 219/2009 dhe (EC) 304/2009, amenduar nga Rregullorja 519/2012;
- Rregullore (EC) 649/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 4 korrik 2012, në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme;
- Direktiva 2010/63/EU e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 shtator 2010 mbi mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore.

Për fushën e Zhurmave

- Direktiva 2002/49/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropiandatë 25 qershor 2002 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”;
- Direktiva e Këshillit 70/157/EEC e datës 6 Shkurt 1970 mbi përafrimin e legjislacionit te Shteteve Anëtare ne lidhje me nivelin e lejueshëm te zhurmave dhe sistemin e shkarkimit të mjeteve motorike, siç është amenduar nga Direktivat 73/350/EEC, 77/212/EEC, 81/33/EEC, 84/372/EEC, 84/424/EEC, 87/354/EEC, 89/491/ EEC, 92/97/EEC, 96/20/EC, 1999/101/EC dhe 2007/34/EC;
- Direktiva 97/24/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 17 qershor 1997 ne lidhje me disa komponente dhe karakteristika te mjeteve motorrike me dy ose 3-rrota, siç është amenduar nga Direktivat 2002/51/EC, 2003/77/EC, 2005/30/EC, 2006/27/EC, 2006/72/EC dhe 2006/120/EC;
- Direktiva 2001/43/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Europian e datës 27 qershor 2001 qe amendon Direktivën e Këshillit 92/23/EEC ne lidhje me gomat për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre te përshtatshme me to;
- Direktiva 2009/40 EC e Parlamentit Europian dhe këshillit e datë 6 maj 2009 "Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”;
- Rregullore (EU) 598/2014 e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 16 prill 2014 mbi vendosjen e rregullave dhe procedurave në lidhje me prezantimin e masave kufizuese që lidhen me zhurmat, në aeroportet e Komunitetit brenda një qasje të balancuar dhe që shfuqizon Direktivën 2002/30 /EC.

Për fushën e Pyjeve

- Rregullorja (EC) 2152/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës e 17 nëntorit 2003 për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimit mjedisor në vendet Komunitare (Fokus Pyjet);
- Rregullorja e Komisionit (EC) 1737/2006 e 7 nëntorit 2006 “Për heqjen e disa rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimin mjedisor në vendet e Komunitetit”;
- Rregullorja (EC) 2152/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 nëntor 2003, lidhur me monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimeve mjedisore në Komunitet (Kuadri Pyjor);
- Rregullorja e Këshillit (EEC) 1615/89, 29 maj 1989 për krijimin e Sistemit Evropian të Informacionit Pyjor dhe të Komunikimit (Efics);

- Rregullorja e Këshillit (EC) 2173/2005, 20 Dhjetor 2005, mbi krijimin e një skeme lejesh FLEGT për importet e lëndës drusore në Komunitetin Evropian, ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (EC) 1024/2008, 17 tetor 2008, që përcakton masat e detajuara për zbatimin e Rregullores së mësipërme;
- Rregullorja 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 20 Tetor 2010, që formulon detyrimet e operatorëve, të cilët vendosin lëndën drusore dhe prodhimet e drurit në treg.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në fushën e *legjislacionit horizontal* është shënuar progres për sa i përket transpozimit te Direktivave te VNM-se dhe VSM-se, por nuk ka ndonjë progres për sa i përket direktivave te tjera. Transpozimi i Direktivës së VNM-se (2011/92/EU) ka përparuar se tepërmi duke arritur ne masen 100 % nepermjet amendimit te ligjit per VNM–ne ne shkurt 2015 dhe akteve nenligjore qe rrjedhin nga ky ligj, te cilat jane miratuar gjate vitit 2015, ndërkohë do te punohet me transpozimin e Direktivës 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014, e cila ka amenduar Direktiven (2011/92/EU), amendim ky qe parashikohet te te transpozohet brenda vitit 2017. Gjithashtu, progres i rëndësishëm shënohet edhe për sa i përket transpozimit te Direktivës se VSM-se, duke arritur në masen 100 %.Pjesa me e madhe e dispozitave te kësaj Direktive janë transpozuar me miratimin e Ligjit nr. 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, në Shkurt 2013 dhe pjesa e mbetur eshte transpozuar nepermjet akteve nenligjore qe rrjedhin nga ky ligj, te cilat jane miratuar gjate vitit 2015, duke arritur transpozimin e plote te kesaj Direktive. Ky ligj, transpozon Anekset dhe shumicën e dispozitave, si dhe siguron bazën ligjore për miratimin e legjislacionit dytësor. Transpozimi i plote i Direktivës mbi Aksesin ne Informacion dhe asaj mbi Pjesëmarrjen e Publikut është arritur qe në vitin 2012.

Ne fushën e *cilësisë se ajrit*, Ligji i ri nr. 162, date 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit" dhe VKM nr. 352, date 29.04.2015 "Mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat në lidhje me disa ndotës" transpozojne 99% dispozitat e Direktivës 2008/50/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën, si dhe të Direktivës 2004/107/EC.Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit është miratuar me VKM nr. 594, date 10.09.2014 “Per miratimin e Strategjise Kombetare per Cilesine e Ajrit te Mjedisit”.

Progres është arritur edhe në transpozimin e *acquis* në fushën e *menaxhimit te mbetjeve*. Transpozimi Direktivës Kuadër te Mbetjeve ka arritur ne masën rreth 95%.

Ne këtë fushe progres shënohet edhe në transpozimin e Direktivës mbi Llumrat e Ujerave te Ndotura nga e cila është përgatitur dhe miratuar VKM nr.127, datë 11.02.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujerave të ndotura. Kjo VKM transpozon pjesën me te madhe te dispozitave te kësaj direktive.

Transpozimi i Direktivës së Baterive ka përparuar për shkak të miratimit te VKM nr. 866, date 4.12.2012 "Mbi bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre". Niveli i transpozimit është i larte duke arritur afërsisht 90 %. Megjithatë, legjislacioni kombëtar nuk ka transpozuar ende gjashtë dispozitat e mbetura te kësaj Direktive.

Transpozimi i Direktivës mbi Mbeturinat e Paketimeve ka përfunduar në vitin 2012, me miratimin e Ligjit për Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve, ne Shtator 2011, si dhe VKM 177/2012 "Për paketimin dhe mbeturinat e tyre", ne Mars 2012.

Miratimi i VKM 705/2012 "Për menaxhimin e automjeteve ne fund te jetës", ne Tetor 2012, ka përmirësuar dukshëm transpozimin Direktivës përkatëse. Niveli i transpozimit ka arritur në 83%.

Niveli i transpozimit te Direktivës se re WEEE (2012/19/EU) është në fazë të hershme dhe shkalla e transpozimit prej 8% është rezultat i përputhshmërisë me Direktivën 2002/96/EC, i cili është përafruar me VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Mbi mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike.”

Transpozimi i Direktivës se Landfilleve është ne shkallen 98 %. Vetëm dy dispozita te Direktivës (neni 2 dhe 14 (d)), mbeten për tu transpozuar në legjislacionin kombëtar. Progresi në transpozim është arritur nëpërmjet miratimit të VKM "Për landfillet e mbetjeve", në Korrik 2012.

Nëpërmjet miratimit të VKM 178/2012 “Për incenerimin e mbetjeve”, është arritur progres edhe ne transpozimin e Direktivës 2000/76/EC për incinerimin e mbetjeve.

Në zbatim të Ligjit 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” janë miratuar 17 aktet nënligjore duke bërë më të plotë kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

MZHU është duke hartuar gjithashtu VKM-në“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, hartës dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane”, e cila do të miratojë hartën GIS, të krijuar me informacione që reflektojnë situatën aktuale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane, si dhe zhvillime të tjera në terren

MZHU është duke hartuar gjithashtu VKM “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, hartës dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane”, e cila do të miratojë hartën GIS, të krijuar me informacione që reflektojnë situatën aktuale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane, si dhe zhvillime të tjera në terren.

Gjithashtu, MZHU është duke hartuar draft VKM-ne per miratimin e marrëveshjes financiare midis KfW dhe MZHU si përfaqësuese e shtetit Shqiptar për hartimin e Studimit Sektorial për Nevojat për Investime për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri. Ky studim do të përcaktojë investimet në fushën e mbetjeve të ngurta në Shqipëri, do të ndërtojë një sistem prioritizimi për investimet, si dhe do të përcaktojë teknologjinë e përshtatshme për çdo rajon, shoqëruar me kostot respektive.

Ne fushën e *cilësisëse ujerave* progres është bërë në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit memiratimin e Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", në Nëntor 2012, VKM nr. 267, datë 07.05.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore’’dhe VKM nr. 246, datë 30.04.2014 ‘’Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë’’, si dhe te Vendimit te KKU-se nr. 1, date 17.02.2015 “Per propozim per miratim ne Keshillin e Ministrave te projektvendimit per “Permbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjise Kombetare te Menaxhimit te Burimeve Ujore, Planeve te Menaxhimit te Baseneve Ujore dhe Planeve te Menaxhimit te Rrezikut nga Permbytjet. Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ka transpozuar edhe disa prej dispozitave të Direktivës së Ujërave të Ndotur Urban.

Transpozimi i Direktivës së Ujit të Pijshëm është në fazë të avancuar, në shkallën 80%. Ndërsa transpozimi i Direktivës së Nitrateve është në fazën fillestare, ku vetëm 4 dispozita të Direktivës janë transpozuar në legjislacionin kombëtar.Aktualisht, është përgatitur draft VKM për miratimin e Rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, në përafrim të pjesshëm me Direktivën 98/83/EC të Këshillit të Bashkimit Europian “Mbi cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit” dhe është në proces miratimi në Këshillin e Ministrave.

Direktiva e Ujërave të Larjes është transpozuar plotësisht me VKM-në "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes", të miratuar në vitin 2010.

Ne fushën e *mbrojtjes se natyrës*, ka vazhduar progresi në transpozimin e legjislacioniut për këtë fushë. Transpozimi i Direktivës së Shpendëve të egër është pothuajse i plotë, aktualisht në masën 92 %, pas miratimit të VKM nr. 866,datë10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian”. Legjislacioni që transpozon Direktivën e Shpendëve të Egër janë Ligji për Mbrojtjen e Faunës së Egër, Ligji për Gjuetinë, Ligji për Zonat e Mbrojtura, i amenduar dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Gjithashtu, ka vijuar harmonizimi i legjislacionit kombëtar me kërkesat e Direktivës së Habitateve, e cilavlerësohet pothuajse e plotë, në masën 98%. Progresi ka ndodhur pas miratimit te Ligjit nr. 68/2014, date 3.07.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen e biodiversitetit" nr. 9587, date 20/07/2006" dhe të VKM nr. 866,datë10.12.2014 "Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian".

Në fushën e *kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut*, transpozimi i Direktivës së Emetimeve Industriale mendohet te jetë rreth 44%, ku progresi kryesor është arritur në vitin 2011 nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore. Shumica e përkufizimeve te kësaj Direktive, te përcaktuara në Kapitullin I, janë transpozuar nga Ligji nr. 10448, date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Lidhur me Kapitullin II, III, IV dhe V të kësaj Direktive, me rëndësi për transpozim është Ligji "Për Lejet e Mjedisit". Përveç ligjit "Për Lejet e Mjedisit", një akt tjetër i rëndësishëm për transpozimin e dispozitave te kësaj direktive eshte miratimi i VKM nr. 419, date 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", si dhe aktet qe kane te bëjnë me impiantet e incenerimit te mbetjeve dhe impiantet e co-incenerimit te mbetjeve, është VKM nr. 178, date 06.03.2012 "Për djegien e mbetjeve".

Transpozimi i plote i *acquis* në fushën e *kimikateve* është planifikuar për vitin 2016.

Progres është shënuar edhe për sa i përket transpozimit të *Direktivës se Zhurmave Mjedisore.* Progres ky i arritur në Janar 2013 për shkak të miratimit të Udhëzimit nr. 2, date 7.01.2013 "Për treguesit, metodat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike të metodologjisë për vlerësimin e nivelit të zhurmës, dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për të zgjidhur dhe për të përmirësuar situatën". Megjithatë, ka ende disa dispozita që ende duhen transpozuar.

Ne fushën e *ndryshimeve klimatike*, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, ne Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër te Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCC), që nga Janari 1995. Gjithashtu, Shqipëria ka përgatitur dy Komunikime Kombëtare në 2002 dhe 2009, si dhe përfundon në Prill 2016 përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC.

Në dhjetor 2004, Qeveria Shqiptare ka ratifikuar Protokollin e Kiotos. Deri ne vitin 2016, Qeveria Shqiptare ka planifikuar zbatimin e një sere aktivitetesh për adresimin e çështjes se ndryshimeve klimatike. Shqipëria miratoi dokumentin e INDC-se me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 16.09.2015si kontributin tonë kombëtar të pikesynuar dhee dorëzoi dokumentin e INDC-se në Sekretariatin e Konventes Kuader te

Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike, në datën 24 Shtator 2015. Angazhimet për reduktimin e emisioneve të Gazeve me Efekt Serre (GES) janë përfshirë në dokumentin e miratuar te INDC-se dhe synohet nje reduktim prej 11.5% te gazeve me efekt serre deri ne vitin 2030. Ky objektiv kombetar eshte reflektuar gjithashtu ne draft Strategjine Kombetare per Zhvillim dhe Integrim, si dhe draft Strategjine Ndersektoriale te Mjedisit 2015-2020, te cilat jane ne proces miratimi. Per te adresuar çeshtjet ndersektoriale qe lidhen me ndryshimet klimatike, eshte krijuar Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike, me Urdhërin e Kryeministrit nr.155, datë 25.04.2014.

Në Janar 2015, ka filluar puna për hartimin e Planit Kombëtar për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike (PKA) dhe integrimin e ndryshimeve klimatike në politikat dhe strategjitë sektoriale përkatëse

Strategjia per Ndryshimet Klimatike, ne linje me kuadrin politik te parashikuar per Klimen dhe Energjine EU 2030, është në proces draftimi dhe parashikohet te miratohet brenda Dhjetorit 2017.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Për fushën e Legjislacionit Horizontal

Ministria e Mjedisit (MM), është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e mjedisit, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe në fushën e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje mjedisore.

MM dhe institucionet e saj të varësisë, konkretisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM),Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura (AKZM), Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), si dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP) kanë angazhimin për të garantuar zbatimin e tyre.

Përveç MM-së dhe institucioneve të varësisë, edhe ministritë e linjës dhe institucionet ne varesi te tyre janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve mjedisore, sigurimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje me ndikim në mjedis si:

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI),
- Ministria e Shëndetësisë (MSH),

- Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU),
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI),
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS),
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU).

Autoritetet vendore, kanë një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe në përmbushjen e detyrimeve për informim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje mjedisore, veçanërisht për sa i përket proceseve që kërkojnë Vlerësim Strategjik Mjedisor për projekte të mëdha publike.

Për fushën e Cilësisë së Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike

MM është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nga ndotja.

AKMështë organi qendror për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, nëpërmjet institucioneve të kontraktuara nga MM. AKM grumbullon, përpunon të dhënat e monitorimit dhe bën publike raportin e gjendjes së cilësisë së ajrit.

ISHMPështë autoriteti kompetent që kontrollon kushtet e lejes së mjedisit të aktiviteteve industriale dhe të ndërtimit lidhur me shkarkimet në ajër.

Gjithashtu, MM është institucioni që harton politikat kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe koordinon integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale të bujqësisë, turizmit, shëndetësisë, energjisë, transportit, pyjeve, ujërave, etj. MM është përcaktuar si Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP) në kuadër të detyrimeve të vendit ndaj Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos, si dhe për ndjekjen e projekteve të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër.

Përveç Ministrisë së Mjedisit, përgjegjëse për fushën e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike janë:
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë,
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,
- Ministria e Shëndetësisë,
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave,

- Ministria e Integrimit Evropian.

Për Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve

MMështë institucioni kryesor i përfshirë në menaxhimin dhe hartimin e politikave në fushën e mbetjeve. MM **(i)** Harton rregullat/ligjet për menaxhimin e mbetjeve për të gjitha fazat (ndarja, ripërdorimi, riciklimi, kompostimi, hedhja dhe djegia), **(ii)** Vlerëson dhe jep lejet për transitimin dhe për eksportin e mbetjeve, **(iii)** Vendos rregullat për monitorimin dhe inspektimin/kontrollin për zbatimin e akteve lidhur me mbetjet, si dhe **(iv)** Organizon dhe menaxhon regjistrat lidhur me çështje të ndryshme të mbetjeve.

MZHUbazuar në VKM nr. 159, datë 25.02.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 944, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit", ushtron në përputhje me legjislacionin përkatës, veprimtarinë e saj në fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial, si dhe fushën e menaxhimit të projekteve të zhvillimit urban. Pra MZHU ushtron, në përputhje me legjislacionin përkatës, veprimtarinë e saj në fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial, si dhe fushën e menaxhimit të projekteve të zhvillimit urban.

MTI në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i landfilleve rajonal dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane, duke përcaktuar rregullat, teknikat dhe metodat e trajtimit të tyre, në çdo fazë, duke përfshirë krijimin, ndarjen, grumbullimin, ruajtjen, transportin, riciklimin, trajtimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe në zvogëlimin e ndikimit të tyre.

MTIka gjithashtu përgjegjësi për:

- *Planifikimi dhe ndjekja e investimeve*, bazuar në prioritetet e përfshira në PBA duke siguruar realizimin e studimeve, projektimeve dhe implementimin e tyre për mbylljen e vend depozitimeve ekzistuese dhe ndërtimin e impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve;
- *Sensibilizimi, koordinimi dhe bashkëpunimi* me strukturat dhe institucionet përkatëse, donatorët dhe NjQV-të për të vënë në jetë parimet më të rëndësishme të metodave bashkëkohore të cituara në Planin Kombëtar "Parandalimi, pakësimi, riciklimi dhe me pas asgjësimi i mbeturinave".
- *Hartimi* i regjistrit vjetor të mbetjeve në rang bashkie, qarku apo vendi, me qëllim njohjen dhe vlerësimin e situatës mjedisore të shkaktuar nga mbetjet në vend. Përgatitja e raporteve të nevojshme për evidentimin e problemeve dhe rrugët e zgjidhjes.

- *Identifikimi* i metodave të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve të ngurta, duke bërë të mundur reduktimin e rreziqeve ndaj shëndetit të banorëve.

MSH së bashku me MM kanë përgjegjësi për të hartuar rregulloret për menaxhimin e mbetjeve spitalore. Spitalet dhe të gjithë gjeneruesit e mbetjeve shëndetësore kanë përgjegjësi të hartojnë dhe azhornojnë planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me planet kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme.

MEIsë bashku me MM ka përgjegjësi për të hartuar rregulloret për mbetjet industriale dhe mbetjet minerare, si dhe në rehabilitimin e vendeve të hedhjes sipas specifikave të përmbajtjes së mbetjeve.

Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë rregulloret lidhur me mbetjet ushtarake.

Ministria e Financave (MF), në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë legjislacionin për taksat e ndryshme mjedisore.

MF harton rregullat mbi garancitë financiare për lejet mjedisore të vendeve të mbetjeve të rrezikshme, të cilat miratohen më vonë nga Këshilli i Ministrave.

MBZHRAUnë bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë rregulloret për mbetjet bujqësore dhe të kafshëve.

Për Fushën e Menaxhimit të Ujerave

Në zbatim të VKM nr. 92,datë04.02.2015 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Mjedisit, të ndryshuar”, Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore, e cila ka qenë struktura përkatëse në MM për përgatitjen e politikave lidhur me burimetujore, ka kaluar nën administrimin institucional tëMBZHRAU,së bashku me autoritetet lokale (6 ABU) dhe Inspektoratin Shtetëror përgjegjës për inspektimin e ujit. Aktualisht, MM është përgjegjëse vetëm për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësor të brendshëm, ujërave të përkohshëm, ujërave bregdetar, si dhe atyre nëntokësor.

Gjithashtu, në Prill 2014 është krijuar Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), i cili është miratuar nëpërmjet VKM nr. 230, datë 23.04.2014 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit”.

Me VKM nr. 386, datë 6.05.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Ujit” është krijuar Struktura e Inspektoriatit Shtetëror të Ujit.ISHU është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën e ujërave në përputhje me përgjegjësitë e ministrisë përgjegjëse për ujërat.

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore. KKU është organ ndërministror që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore. KKU përbëhet nga MM, MBZHRAU, MTI, MEI, MSH, MPB, MZHU, MZHETTS, si dhe MF. KKU ofron kështu një forum të nivelit shumë të lartë brenda të cilit çështjet e planifikimit dhe administrimit të rezervave ujore mund të diskutohen nëmënyrë të integruar.

MBZHRAUështë ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë, e cila në bashkëpunon me ministritë e linjës, harton dhe zbaton politika, strategji, programe dhe projekte që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre.MBZHRAU përveç administrimit tëinfrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, administron edhe burimet ujore në RSH, si dhe është përgjegjëse për menaxhimin e tyre nëkontekst ndërkufitar.

Komisioni i Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare, me Vendimin nr. 177, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit të Posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare”, i ndryshuar me VKM nr. 223, date 11.3.2015, Kryetar i ketij Komisioni eshte Zevendesministri i MBZHRAU, i cili mbulon fushen e ujerave.

STKKUka si objektiv koordinimin e punës në nivel ndërinstitucional për të gjitha çështjet e menaxhimittëintegruar të burimeve ujore.

Këshillat e Baseneve Ujore (KBU**)** janë autoritetet lokale përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenet përkatëse. KBU-të drejtohen nga Prefekti.

Agjencitë e Baseneve Ujore (ABU)janë struktura në varësi të MBZHRAU, të cilat funksionojnë në çdo basen ujor të krijuara nga KKU-ja. Në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë gjithsej 6 ABU, të cilat janë përgjegjëse për**(i)** hartimin e inventarit të burimeve ujore në sasi dhe cilësi, si dhe përditësimin periodik të tij, **(ii)** përgatitjen e raporteve, dhëniene opinioneve për burimet ujore brenda kufijve të basenit që administrojnë dhe paraqitjen e tyre për ndjekje të mëtejshme në mbledhjet e KBU-se, si dhe **(iii)** përgatitjen e materialeve për mbledhjet e KBU-së.

Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikavepër Ujin, i cili është i kryesuar nga Kryeministridhe anëtarë të tij janë ministrat përgjegjës për një fushë të caktuar të sektorit tëujit, si dhe përfaqësues të donatorëve që operojnë në vend. Ky organ ka si qëllim kryesor koordinimin dhe drejtimine punës për zhvillimin dhe monitorimin e reformave në sektorin e ujit, nëpërmjet hartimit të një programi kombëtar sektorial.

MMështë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujërave, nëpërmjet zbatimit të politikave për mbrojtjen e cilësisë së mjedisit ujor.

MTI harton politika për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, por jo rezerven ujore.

MTI eshte lider i Grupit te Menaxhimit të Integruar të Politikave të Ujit për Njerëz.

MSHpërcakton kërkesat higjieno-sanitare që duhet të plotësojë uji i pijshëm dhe pajisjet e furnizimit nga pellgu ujëmbledhës deri tek përdorues, si dhe kryen monitorimin, inspektimin dhe ekspertizën e cilësisë së ujit të pijshëmnëpërmjet institucioneve në varësi të saj, përkatësisht Strukturave Rajonale të Shëndetit Publik (SRShP), Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (IShSh) dhe Institutit të Shëndetit Publik (IShP).

MEIeshte autoriteti pergjegjesper hidrocentralet, ku aktualisht ne vend zene rreth 90% te kapaciteteve te instaluara. Ndersa, percaktimi i skemes se perdorimit, kapaciteti i shfrytezimit te burimeve ujore per prodhim hidroenergjie, si dhe monitorimi i ketyre veprave kryhet nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore.

MZHU menaxhon infrastrukturën urbane. MZHU është anëtare në grupet tematike: “Uji për njerëz”, “Uji për mjedis” dhe “Uji për industri dhe përdorime të tjera”.

MZHETTS është përgjegjëse për analizat ekonomike dhe investimet ne fushën e burimeve ujore.

MFështë përgjegjëse për shpërndarjen e financimeve për sektorin e ujerave.

Për fushën e Mbrojtjes së Natyrës

MMnëpërmjet Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, mbulon çështjet e lidhura me hartimin e politikave për mbrojtjen e natyrës, si dhe hartimin e dokumenteve strategjik në këtë fushë.

Bashkëpunimi shtrihet dhe me Drejtoritë e tjera të Ministrisë dhe me institucionet zbatuese:

- Agjencine Kombëtare te Zonave të Mbrojtura;
- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor;
- Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, MM bashkëpunon me MBZHRAU për biodiversitetin bujqësor, MZHU për bashkëpunimin në vendim-marrjen për përdorimin e territorit, Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) për bashkërendimin e punës për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë sportive dhe turistike, ministrine Shtetit për Çështjet Vendore për menaxhimin e burimeve natyrore lokale në pronësi komunale, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për kontrollin doganor të tregtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër.

Për fushën e Kontrollit të Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Riskut

MMështë institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për parandalimin e ndotjes industriale dhe minimizimin e saj. Përkatësisht AKM, ARM-te dhe ISHMP janë institucionet e varësisë së MM që janë përgjegjëse për procedurën e lëshimit të lejeve të mjedisit për instalimet industriale, si dhe për monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve të mjedisit.

Përveç MM-së dhe institucioneve të varësisë, edhe ministritë e linjës dhe institucionet ne varesi te tyre janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes industriale, sigurimin e procesit të lëshimit të lejeve të mjedisit, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje për lejet e mjedisit. Këtu mund të përmendim MEI, MSH, MZHU, MTI, MZHETTS, si dhe MBZHRAU.

MM është përgjegjëse edhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, rregulloreve dhe strategjive për fushën e aksidenteve industriale. Gjithashtu, MM bën edhe vlerësimin e efekteve të aksidenteve mbi mjedisin. Ministritë e linjës të cilat trajtojnë kimikatet apo substanca të rrezikshme janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit.

Për fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht

Si një fushë ndërtematike, nuk ka struktura të përcaktuara me ligj për OMGJ-të. Ndërkohë, në kuadër të zbatimit të Protokollit të Kartagjenes për Biosigurinë të Konventës së Biodiversitetit (CBD) janë identifikuar aktorët kryesorë. Në këtë kontekst kjo fushë kërkon kontributin e të gjithë aktorëve kryesorë të përcaktuar dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre.

Institucionet kryesore janë MBZHRAU për mbjelljet, ushqimet dhe tregtimin, si dhe MM për introduktimin e kontrolluar në mjedis, duke përfshirë vendosjen dhe mënyrat e sistemit të lajmërimit(notifikimit) midis shteteve Palë të Protokollit të Biosigurisë.

Në nivel kombëtar në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", u krijua Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në varësi të MBZHRAU me VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 "Për organizmin dhe funksionimin e AKU-së". Ndërmjet detyrave të AKU-së përcaktohet se "Drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e ushqimit dhe ushqimeve për kafshë".

Aktorë të tjerë për politikat janë MSH për mikroorganizmat në gjendje të mbyllur dhe ndikimet në shëndetin e njeriut dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) për zhvillimin e bioteknologjisë. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e Protokollit të Biosigurisë lidhur me lëvizjet ndërkufitare të OMGJ-ve.

Në kuadër të reformës së institucioneve kërkimore shkencore është krijuar Departamenti i Bioteknologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, i cili në bashkëpunim me institucione të tjera në varësi të Ministrive të përmendura më lart dhe me Akademinë e Shkencave janë të rëndësishëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit të rrezikut të OMGJ -së.

Për fushën e Kimikateve

Çështjet e menaxhimit të kimikateve janë detyrë e disa institucioneve, përkatësisht e MM, MSH, MEI, MBZHRAU, Ministrisë së Mbrojtjes, MTI, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), si dhe MF.

Në varësi të llojit të substancave dhe preparateve kimike, Ministria përkatëse licencon aktivitetet e menaxhimit, importit dhe eksportit të substancave dhe preparateve të rrezikshme.

MMështë përgjegjëse për hartimin e legjislacionit të kimikateve dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të riskut në mjedis, krijimin e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve, dhe inspektimin e aktiviteteve që menaxhojnë kimikatet. ISHMPkontrollon administrimin e kimikateve në aktivitetet e pajisura me leje mjedisore.

MSHështë përgjegjëse për hartimin e legjislacionit të biocideve, përcaktimin e procedurave të vlerësimit të riskut në shëndet, autorizimin e importit dhe përdorimit të biocideve. Kontrolli i menaxhimit të biocideve kryhet nga Inspektorati Sanitar Shtetëror.

MEI është përgjegjëse për kimikatet si lëndë e parë për industrinë, import-eksportin dhe kontrollin e kimikateve të konsumit.

MBZHRAU është përgjegjëse për lejet e prodhimit dhe të importimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe plehrave kimike, vlerësimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre. Importi dhe eksporti i tyre kontrollohen nga kjo ministri, përmes AKU-se. Në kontrollin e PMB-ve janë të angazhuar institutet kërkimore në varësi të MBZHRAU, si Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), si dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në Fushë Krujë. Gjithashtu, ministria mbulon Direktivat që lidhen me produktet e mbrojtjes se bimëve dhe përdorimet në bujqësi, si dhe për mbrojtjen e kafshëve të laboratorit.

MMSRka përcaktuar punët e vështira ose të rrezikshme, si dhe listën e substancave të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë nga përdorimi i tyre. Inspektorati Shtetëror i Punës në vartësi të kësaj ministrie, në bashkëpunim me inspektoratet e tjera të shtetit koordinojnë punën për të siguruar zbatimin e legjislacionit të punës nga punëdhënësit dhe personat e siguruar prej tyre.

MTI përgjigjet për transportin e mallrave të rrezikshme. Ajo lëshon lejen për automjetet që transportojnë mallrat e rrezikshme, bën kontrollin teknik dhe bashkërisht me MPB i shoqëron këto mallra deri në destinacion brenda vendit.

Ministria e Mbrojtjesjep lejet dhe ka përgjegjësinë kryesore për importin, eksportin, testimin e lëndëve eksplozive. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksportit (AKSHE) pajis me licencë importi, eksporti, transiti, me autorizim, me certifikatë ndërkombëtare importi, certifikatën e përdoruesit të fundit, certifikatë shpërndarjeje dhe certifikatë doganore, të mbërritjes së mallit në destinacion, subjekte fizike ose juridike, që kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre.

Autoritetet doganore regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe preparate të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror, si dhe kontrollojnë dokumentacionin shoqërues sipas legjislacionit në fuqi.

Për fushën e Pyjeve

MMdhe institucionet e varësisë, janë institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e pyjeve.

Njësitë e Qeverisjes Vendore janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në territorin administrativ te tyre.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fondin pyjor kullosor.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2016	**2017**	**2018**
Buxheti Total për Këtë Kapitull i Institucionit Lider	18.500.000	10.040.000	1.850.000
Buxheti Total për Ketë Kapitull i Institucioneve të Tjera	54.966.220	22.293.220	4.930.000
Buxheti Total i Kapitullit	73.466.220	32.333.220	6.780.000

III. Prioritetet

Për sa i përket mjedisit, në fushën e *legjislacionit horizontal*, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me (i) implementimin e legjislacionit kombëtar qe ka transpozuarDirektivën 2001/42/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara" dhe Direktivën e VNM-se (2011/92/EU) amenduar me Direktivën 2014/52/EU, si dhe transpozimi i plote i Direktives 2014/52/EU, (ii) forcimin e zbatimit te legjislacionit mjedisor, si dhe (iii) garantimin siç duhet te informimit dhe pjesëmarrjes se publikut në vendimmarrje duke përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Aarhusit.

Miratimi i projektligjit për *cilësinë e ajrit* dhe aktet nënligjore për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe kriteret për disa ndotës të caktuar, si dhe përafrimi i plote i legjislacionit te BE-se, janë disa nga prioritetet kryesore ne këtë fushe. Gjithashtu, me qellim përmirësimin e cilësisë se ajrit, si prioritete te Ministrisë se Mjedisit janë gjithashtu (i) hartimi i planit kombëtar dhe planeve lokale te veprimit për përmirësimin e cilësisë se ajrit te mjedisit, (ii) forcimi i sistemit kombëtar te monitorimit te ajrit urban dhe shkarkimeve ne ajër sipas standardeve evropiane, (iii) forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave te cilësisë se ajrit ne strategjitë sektoriale te tyre.

Megjithëse, janë miratuar aktet nënligjore për *menaxhimin e mbetjeve*, si dhe janë përgatitur draftplanet rajonale tëmenaxhimit të mbetjeve për 12 rajonet, përmirësimi i menaxhimit te integruar te mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore te punës se Ministrisë se Mjedisit. Disa nga prioritet në këtë fushë jane ndarja e mbetjeve ne burim, rritja e nivelit te riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, mbyllja e venddepozitimeve ilegale që nuk plotësojnë asnjë kriter për depozitimin e mbetjeve, orientimi drejt ngritjes së impianteve të djegies se mbetjeve (inceneratorëve), ndërtimi i landfilleve sipas standardeve te BE-së, sigurimi i faciliteteve për mbetjet e rrezikshme mjekësore ose ndërtimore, nxitja e partneritetit publik privat (PPP), si dhe sigurimi i investimeve te reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit te mbetjeve.

Në fushën emenaxhimit te integruar te burimeve ujore dhe*cilësisë së ujërave*, MBZHRAU ka si prioritet te punës se saj (i) përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit dhe miratimit te akteve nënligjore ne zbatim te Ligjit per menaxhimin e integruar te burimeve ujore, (ii) vlerësimin e shkallës së dëmtimit të baseneve të lumenjve si rezultat i aktiviteteve të subjekteve që shfrytëzojnë inertet lumore dhe ndërmarrjen e masave ndëshkuese, (iii) krijimin e regjistrit kombëtar te burimeve ujore, si dhe (iv) përmirësimin e menaxhimit te burimeve ujore ne nivel baseni dhe kombëtar nëpërmjet hartimit te strategjisë kombëtare te menaxhimit te integruar te burimeve ujore, hartimit te 2 planeve te menaxhimit te baseneve te lumenjve Drin-Bune dhe Seman, si dhe krijimit te kadastrës elektronike kombëtare te burimeve ujore.

Nje nder gjashte prioritetet e qeverise shqiptare eshte edhe menaxhimi i integruar i ujit, per realizimin e te cilit eshte ngritur edhe GMIP per ujin, si dhe eshte ne proces ngritja e kater nengrupeve tematike per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar sektorial per menaxhimin e integruar te ujit. Programi parashikohet te elaboroje ne menyre specifike detyrimet per fushen e ujit qe rrjedhin nga kuadri ligjor i BE-se dhe legjislacioni kombetar ne fuqi, objektivat e perfshira ne SKZHI apo strategji sektoriale te hartuara apo ne proces. Programi do te shoqerohet nga nje plan masash i kostuar, si dhe do te percaktohen qarte autoritetet pergjegjese, indikatoret mates dhe afatet kohore per arritjen e tyre.

Gjithashtu, MTI është duke ndërmarrë një reformë të thellë në sektorin e ujësjelles kanalizimeve, e cila ka për qëllim sigurimin me ujë të pijshëm në cilësinë dhe sasinë e duhur 24 orë në ditë dhe shtrirjen e plotë në të gjithë zonat e banuara të shërbimeve të furnizimit me uje dhe kanalizimeve. Riorganizimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime, do të jetë në përputhje me ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Në fushën *e mbrojtjes së natyrës*, do të punohet për të garantuar (i) menaxhimin e integruar të zonave te mbrojtura, (ii) identifikimin e zonave potenciale Natura 2000 për Shqipërinë, (iii) marrjen e masave për ndalimin e veprimtarive të paligjshme si prerja e drurëve dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, si dhe (iv) forcimin e kapaciteteve administrative të Zonave të Mbrojtura (AKZM dhe AdZM-ve) për eliminimin e këtyre fenomeneve.

Për sa i përket fushës së *ndotjes industriale, menaxhimit të risqeve dhe aksidentet* disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me (i) përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2010/75/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), si dhe me Direktivën 2012/18/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 4 Korrik 2012 "Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme", ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/EC.

Për sa i përket *politikave për zhurmën në mjedis*, një nga prioritetet kryesore ne këtë fushe është forcimi i zbatimit te vendimeve të task forcës se ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare.

Në fushën e *kimikateve*, dy nga prioritetet e Ministrisë se Mjedisit janë përafrimi i plote legjislacionit te BE-se ne këtë fushe dhe zbatimi i këtij legjislacioni, si dhe ngritja e sistemit kombëtar te menaxhimit te integruar te kimikateve.

Për sa i përket *ndryshimeve klimatike*, përafrimi i plote me legjislacionin e BE-se, hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar te Veprimit për Ndryshimet Klimatike, ngritja e sistemit kombëtar te inventarëve te shkarkimeve ne ajër dhe te gazeve me efekt serre, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave te ndryshimeve klimatike ne strategjitë e tyre sektoriale, janë disa nga prioritetet ne këtë fushe.

Ne fushën e *pyjeve*, prioritetet e Ministrisë se Mjedisit kane te bëjnë me (i) përafrimin e plote te legjislacionit kombëtar me atë te BE-se ne këtë fushe, si dhe hartimine akteve nënligjore qe dalin nga Ligji i ri për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë (ii) hartimin i Strategjisë së Re 10-vjeçare për Pyjet dhe Kullotat, si dhe (iii)Regjistrimi i fondit pyjor dhe kullosor kombëtar në sistemin kadastral të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit tëInventarit Kombëtar të Pyjeve**.**

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2016 – 2018

IV.1 Legjislacioni Horizontal

Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	Institucioni Lider	Periudha e Referuar

Strategjia Ndersektorale e Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2007 – 2013
Metodologjia Kombëtare e Procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	Ministria e Mjedisit	1 Shtator 2016 – në vazhdim

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni Lider**	**Niveli i Përafrimit**	**Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 2004/35/EC	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	09.06.2011	30.12.2013
Direktiva 2001/42/EC	Ligji nr. 91, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)";	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	28.02.2013	04.04.2013
	VKM nr. 219, datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor";	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	11.03.2015	01.04.2015
	VKM nr. 620, datë 07.07.2015 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësive dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar";	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	07.07.2015	16.07.2015
Direktiva 2011/92/EU	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)", të ndryshuar	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	07.07.2011	01.02.2013
	Ligji nr. 12/2015 "Për disa				

	ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	26.02.2015	01.09.2015
	VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave dhe kërkesave te procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore;	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	30.04.2014	21.05.2014
	VKM nr. 598, datë 01.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar";	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	01.07.2015	01.09.2015
	VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore"	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	29.07.2015	01.09.2015
Direktiva 2003/35/EC	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit";	Ministria e Mjedisit	I plotë	09.06.2011	30.12.2013
	Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 "Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar	Ministria e Mjedisit	I plotë	26.10.2000	10.11.2000

	gjykatës për çështjet e mjedisit"; VKM nr. 994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e publikut në vendimmarrje për mjedisin"; Urdhri i Ministrit nr. 1, datë 03.03.2009 " Për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis"	Ministria e Mjedisit Ministria e Mjedisit	I plotë I plotë	02.07.2008 03.03.2009	24.07.2008 03.03.2009
Direktiva 2003/4/EC	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 "Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"; Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"; VKM nr.16, datë 04.01.2012 "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor"	Ministria e Mjedisit Ministria e Mjedisit Të gjitha institucionet publike Ministria e Mjedisit	I plotë I plotë I plotë I plotë	09.06.2011 26.10.2000 18.09.2014 04.01.2012	30.12.2013 10.11.2000 02.11.2014 03.02.2012

Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2016 – 2018

Titulli	**Institucioni Lider**	**Periudha e Referuar**	**Data e Miratimit**	**Hyrja në fuqi**
Strategjia Ndër - Sektoriale e Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2015 – 2020	Tremujori 4, 2016	Tremujori4, 2016
Metodika Kombëtare e Vlerësimit	Ministria e Mjedisit	2018– në vazhdim	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017

Strategjik Mjedisor				

Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2016 – 2018

Legjislacioni i BE-së	**Status i Përkthimit në Shqip (po/jo)**	**Legjislacioni Shqiptar**	**Status i Përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Institucioni Përgjegjës**	**Niveli i Synuar i Përafrimit**	**Data e Planifikuar për Miratim**	**Hyrja në Fuqi**
AFAT SHKURTER 2016							
n/a	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**	**n/a**
AFAT MESËM 2017 - 2018							
Direktiva 2014/52/EU e cila ka amenduar Direktivën 2011/92/EU	Jo	Amendim i Ligjit 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar ose Ligj i ri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	Tremujori 4, 2017	Tremujori 4, 2017

IV.2 Cilësia e Ajrit dhe Ndryshimet Klimaterike

Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	**Institucioni Lider**	**Periudha e Referuar**
Dokument Politikash për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike në Deltat e Lumenjve Drini-Mati dhe më tej	Ministria e Mjedisit	2013 – 2020
Dokument politikash për Përshtatjen e Sistemit Shëndetësor ndaj Ndryshimeve të Klimës	Ministria e Shëndetësisë	2011 – 2021
Plani i Administrimit për Heqjen nga Përdorimi të Hidroklorfluorokarboneve	Ministria e Mjedisit	2011 – 2040

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Lider	Niveli i Përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2008/50/EC	Ligji nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis";	Ministria e Mjedisit	I plotë	04.12.2014	04.12.2017
	VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit";	Ministria e Mjedisit	I Plotë	10.09.2014	25.09.2014
	VKM nr. 352, datë 29.04.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"	Ministria e Mjedisit	I Plotë	29.04.2015	01.07.2018
Direktiva 2004/107/EC	Ligji nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis";	Ministria e Mjedisit	I Plotë	04.12.2014	04.12.2017
	VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit";	Ministria e Mjedisit	I Plotë	10.09.2014	25.09.2014
	VKM nr. 352, datë 29.04.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të"	Ministria e Mjedisit	I Plotë	29.04.2015	01.07.2018
Rregullore 517/2014 Rregullore	VKM nr. 865, datë 10.12.2014 "Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	10.12.2014	01.01.2016

1493/2007 Rregullore 1494/2007	florinuara”				
Direktiva 96/62/EC	Ligji nr.10266, datë 15.04.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	15.04.2010	30.04.2010
Direktiva 1999/32/EC	VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim termik, civil dhe industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	14.11.2012	29.11.2012
Direktiva 98/70/EC	VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel”, e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet; Urdhër i Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Nr. 6, datë 09.10.2007 “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë I Plotë	21.03.2007 09.10.2007	05.04.2007 24.10.2007
Direktiva	VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për	Ministria e Energjisë dhe	I Plotë	21.03.2007	05.04.2007

2000/71/EC	cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel", e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet; Urdhër i Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Nr. 6, datë 09.10.2007 "Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse"	Industrisë Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	09.10.2007	24.10.2007
Direktiva 2003/17/EC	VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel", e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet; Urdhër i Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Nr. 6, datë 09.10.2007 "Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë I Plotë	21.03.2007 09.10.2007	05.04.2007 24.10.2007

Rregullore 1882/2003/EC	VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel", e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet;	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	21.03.2007	05.04.2007
	Urdhër i Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Nr. 6, datë 09.10.2007 "Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse"	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	09.10.2007	24.10.2007
Direktiva 94/63/EC	VKM nr.1075, date 23.12.2015 "Për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezulton nga magazinimi dhe shpërndarjae benzinës nga terminalet në stacionet e shitjes së karburanteve"	Ministria e Mjedisit	I Plotë	23.12.2015	1.01.2018

Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2016 –2018

Titulli	**Institucioni Lider**	**Periudha e Referuar**	**Data e Miratimit**	**Hyrja në fuqi**
Dokument Strategjik dhe dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike	Ministria e Mjedisit	2016 – 2030	Tremujori 2, 2017	Tremujori 3, 2017
Plani Kombëtar për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike	Ministria e Mjedisit	2016 – 2026	Tremujori 4, 2016	Tremujori 4, 2016

Plani Kombëtar i Cilësisë së Ajrit	Ministria e Mjedisit	2017 – 2022	Tremujori 4, 2017	Tremujori 4, 2017

Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2016 – 2018

Legjislacioni i BE-së	Status i Përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar	Status i Përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe Pika e Kontaktit	Niveli i Synuar i Përafrimit	Data e Planifikuar për Miratim	Hyrja në Fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
Direktiva 98/70/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit përgjegjës për Energjinë dhe Ministrit të Mjedisit "Për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse"	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Pjesshëm	Tremujori 2, 2016	Tremujori 2, 2016
Vendim 2002/159/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit përgjegjës për Energjinë dhe Ministrit të Mjedisit "Për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse"	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Pjesshëm	Tremujori 2, 2016	Tremujori 2, 2016
Direktiva 1999/13/EC, e ndryshuar	Jo	VKM "Mbi masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime"	Po	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2016	Tremujori 4, 2019
Vendimi 2000/541/EC	Jo	VKM "Mbi masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i	Po	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2016	Tremujori 4, 2019

		tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime”					
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
Direktiva 2004/42/EC	Jo	VKM “Mbi masat për kufizimin e përbërësve organik të avullueshëm nga përdorimi i përbërësve organik në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e automjeteve”	Po	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 2, 2017	Tremujori 2, 2020
Direktiva 2009/126/ EC	Jo	VKM “Mbi kapjen e avujve të benzinës në fazën II gjatë rimbushjes së automjeteve në pikat e shitjes”	Po	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 2, 2017	Tremujori 2, 2020
Rregullore 1005/2009/EC	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017
Vendimi 2010/372/EC	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017
Rregullore 744/2010/EC	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017
Rregullore 291/2011/EC	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017
Rregullore 537/2011/EC	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	Tremujori 3, 2017	Tremujori 4, 2017
Rregullore 525/2013/EC	Jo	VKM ”Mbi krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe raportimit të gazeve me efekt serrë”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2017	Tremujori 4, 2018
Rregullore 1497/2007/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2017	Tremujori 4, 2019

		përgjegjës për Ekonominë "Kërkesat dhe metodat standarte të kontrollit të rrjedhjeve të gazeve serrë të florinuara nga pajisjet"					
Rregullore 1516/2007/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit përgjegjës për Ekonominë "Kërkesat dhe metodat standarte të kontrollit të rrjedhjeve të gazeve serrë të florinuara nga pajisjet"	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2017	Tremujori 4, 2019
Rregullore 303/2008/EC	Jo	Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Ministrit përgjegjës për Tregtinë dhe Ministrit të Arsimit "Mbi kërkesat minimale për programet e trajnimit,dëshmive të trajnimeve për përsonat fizik, çertifikimit për personat fizik dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre"	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2020
Rregullore 304/2008/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Ministrit përgjegjës për Tregtinë dhe Ministrit të Arsimit "Mbi kërkesat minimale për programet e trajnimit,dëshmive të trajnimeve për përsonat fizik, çertifikimit për	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2020

		personat fizik dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre”					
Rregullore 305/2008/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Ministrit përgjegjës për Tregtinë dhe Ministrit të Arsimit “Mbi kërkesat minimale për programet e trajnimit,dëshmive të trajnimeve për personat fizik, çertifikimit për përsonat fizik dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2020
Rregullore 306/2008/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Ministrit përgjegjës për Tregtinë dhe Ministrit të Arsimit “Mbi kërkesat minimale për programet e trajnimit,dëshmive të trajnimeve për personat fizik, çertifikimit për përsonat fizik dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2020
Rregullore 307/2008/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Ministrit përgjegjës për Tregtinë dhe Ministrit të Arsimit “Mbi kërkesat minimale për programet e trajnimit,dëshmive të trajnimeve	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2020

		për personat fizik, çertifikimit për përsonat fizik dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre”					
Rregullore 308/2008/EC	Jo	Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Mjedisit, Ministrit përgjegjës për Tregtinë dhe Ministrit të Arsimit “Mbi kërkesat minimale për programet e trajnimit,dëshmive të trajnimeve për personat fizik, çertifikimit për përsonat fizik dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre”	Jo	Ministria e Mjedisit	I Plotë	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2020
Direktiva 2009/30/EC	Jo	Projektvendim “Mbi specifikimet për lëndët djegëse, benzinë dhe diesel, lëndëve djegëse të lëngëta të mesme, të rënda (gas oil), lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim në mjetet e transportit ujor, si dhe mekanizmat e monitorimit dhe reduktimit të gazeve me efekt serrë”	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Pjesshëm	Tremujori 4, 2018	Tremujori 4, 2021

IV.3 Menaxhimi i Mbetjeve

Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	Institucioni Lider	Periudha e Referuar

Buxheti total iperfituesit		**2.615.000**			
Totali i Kapitullit		**2.615.000**			

Tabela B: - Fondet e planifikuara nga asistenca e huaj

Kapitulli 28 : MbrojtjaeKonsumatoritdheShëndetit				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli I Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU &GoA**	**Aktivitetet**
MZHET	Projekti GIZ:	Federal German Ministry for Economic	Buxhetinë	Projektikanëfokus:

TS	HarmonizimiiLegjislacionitEkonomikdheTregtar me atëtë BE-së	Development and Cooperation MinistriaFederalepërZhvilliminEkonomikdheBashkëpunim	total: 1'000'000	a) Legislacionindheinterpretimin e acquissë BE-së RIA përdirektiven ADR, amendimin e CPL 2011 b) Zbatimin e legjislacionittëharmonizuar me *Acquis* e BE-së. Rritja e transparencësnëpunën e KMK, rritja e ndërgjegjësimitdhe e pjesëmarrjessëpublikut c) Përgatitja per negociatat e anëtarësimitnë BE-zhvillimiiproceduravedheinstrumentevetënevojshëmpër përditësimit e analizëssëmangësiveligjore identifikimiiaktorëvekryesorëdheroliityrenëprocesin e anëtarësimitnë BE. Forcimiibashkëpunimitndërinstitucional
Totali për Kapitull:			**170'000**	

KAPITULLI 29: SISTEMI DOGANOR

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis e BE-së në fushën e doganave mbështeten kryesisht në Kodin Doganor të Bashkimit Evropian dhe Dispozitat Zbatuese të tij, në Tarifën Doganore, Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, Aktet ne lidhje me Akcizën, Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare në fushën doganore. Këto dispozita synojnë garantimin e sigurisë dhe të mbrojtjes, mbrojtjen e interesave financiarë dhe ekonomike të Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e vendit nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, lehtësimin e tregtisë, krijimin e një klime të favorshme konkurrence për biznesin, ndalimin e kontrabandës, korrupsionit, zbatimin e njëkohshëm të tarifave doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të tjera që lidhen me mallrat dhe lëvizjen e tyre, bashkëpunimin ndërmjet administrative doganore të vendeve të ndryshme, etj.

I.2. Situata në Shqipëri

Administrata Doganore Shqiptare ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit doganor me atë të BE-së. Ligji Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" është miratuar më 31.07.2014. Ky ligj përafron pjesësisht Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Nr. 952/2013 "Kodi Doganor i Bashkimit" dhe përafron pjesërisht disa akte të tjera të BE-së. Kodi i Ri Doganor ka hyrë pjesërisht në fuqi dhe aplikohet njëkohësisht me ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Pjesa që nuk ka hyrë në fuqi e Kodit të ri Doganor do të jetë e aplikueshme duke filluar nga data 1 qershor 2017, datë në të cilën do të shfuqizohen dispozitat e mbetura të Kodit Doganor të mëparshëm.

Administrata doganore përditëson nomenklaturën e mallrave në linjë me versionin 2015 të Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së. Tarifat preferenciale të vitit 2015 janë përfshirë në sistemin Asycuda World. Ka një sërë aktesh lidhur me shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, ndalimin e importit të mbetjeve, politika të brendshme dhe sigurie në Sistemin e Teknologjisë së Informacionit të Doganave.

Shkëmbimi elektronik i të dhënave me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi është operacional. Ka një bashkëpunim të mirë me vendet e tjera në kuadër të marrëveshjeve për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore (bazuar në Protokollin 6 të MSA), me qendrën SELEC, OLAF Mari-Info SUD, intensifikimi i bashkepunimit ne fushen e inteligjences me Atshe doganor te akredituar ne ambasada te ndryshme ne Shqiperi apo dhe jashte saj, por qe mbulojne Shqiperine, etj. Shqipëria dhe Kosova zbatojnë një marrëveshje të përbashkët për lehtësimin e transitit. DPD

mbështetet, në Strategjinë doganore të Biznesit dhe miraton çdo vit planin e veprimit në zbatim të saj; në Strategjinë e Teknologjisë së Informacionit dhe dokumentin e politikës së sigurisë, Strategjinë e Brendshme për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim – Asocimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe Protokolli 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafruar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh Acquis Communitaire në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

Legjislacioni doganor mbështetet kryesisht në aktet e BE-së të përmendura më poshtë:

- Rregullore e Këshillit 2913/92/EEC "Për Kodin Doganor Komunitar";
- Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 952/2013, "Kodi Doganor i Bashkimit";
- Rregullore e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93"Për përcaktimin e dispozitave për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2913/92 (31992R2913) për themelimin e Kodit Doganor të Komunitetit";
- Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC "Për tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe për tarifat e përbashkëta doganore";
- Rregullore (EC) nr. 1186/2009, "Mbi përjashtimet nga detyrimet doganore";
- Direktiva 2007/74/EC e Këshillit Evropian, "Mbi përjashtimet nga TVSH dhe Akcizën për mallrat e importuara nga udhëtarët";
- Rregullore Zbatuese e Komisionit Nr.1101/2014, që amendon shtojcën I të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2658/87 mbi Tarifën dhe Nomenklaturën Statistikore dhe mbi Tarifën e Përbashkët Doganore;
- Direktiva e Këshillit 2008/118/EC në lidhje me masat e përgjithshme për akcizën dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/EEC. Celex 32008L0118;
- Direktiva 2003/96/KE e Këshillit që ristrukturon kuadrin Komunitar për taksimin e produkteve të energjisë dhe elektricitetit;
- Direktiva 92/83/KEE mbi harmonizimin e strukturave të taksës së akcizës mbi alkoolin dhe pijet alkoolike;
- Direktiva 92/84 KEE mbi harmonizimin e niveleve te detyrimit të akcizës mbi alkoolin dhe pijet alkoolike;

- Direktiva 92/12/EEC për rregulla te përgjithshme për mbajtjen, lëvizjen dhe mbikëqyrjen e produkteve të akcizës;
- Vendimi e Komisionit nr. 428 që përcakton një markim të përbashkët fiskal për gazin dhe vajgurin;
- Rregullore 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, lidhur me zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë, e cila shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1383/2003;
- Rregullore Zbatuese e Komisionit Nr. 1352/2013,"Për vendosjen e formularëve të parashikuar në Rregulloren (BE) Nr 608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë.

II.2. Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, Administrata Doganore Shqiptare ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA.

Është miratuar ligji nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i cili është pjesërisht i përafruar me Rregulloren Nr. 952/2013 "Kodi Doganor i Bashkimit" si dhe bazohet në një sërë aktesh të tjera evropiane që rregullojnë elementë specifikë doganorë. Kodi i Ri Doganor ka hyrë pjesërisht në fuqi dhe. Administrata Doganore aplikon gjithashtu ligjin nr.8449, datë 19.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji nr.32, dt.2.04.2015, ka ndryshuar ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014, duke sjellë ndryshime në dispozitat ekzistuese të Kodit Doganor për duty-free shops në Shqipëri. Përmes këtij ndryshimi ligjor lejohet hapja e duty free shops edhe në pikat e kalimit kufitar tokësor dhe detar, duke synuar vendosjen e kushtëzimeve të atilla që sigurojnë mbikqyrje dhe kontroll doganor efektiv në balancë me nevojën e tregtisë dhe të hapjes së këtyre dyqaneve.

Më Janar 2015 hyri në fuqi VKM Nr.919, datë 29.12.2014 "Mbi dispozitat zbatuese të ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"". Ky vendim sjell një sërë përmirësimesh, lehtësime e thjeshtime të rregullave dhe procedurave doganore, duke synuar kështu përshtatjen dhe ecjen paralelisht me zhvillimet e tregtisë ndërkombëtare si dhe me nevojat e operatorëve ekonomikë. Vendimi erdhi si domosdoshmëri për zbatimin e dispozitave të Kodit të ri Doganor për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, procedurat e thjeshtuara, përjashtimet nga detyrimet. Përmes tij janë përafruar aktet e BE-ë, si: Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1186/2009, datë 16, nëntor 2009, Direktiva e Këshillit 2007/74/KE datë 20 Dhjetor 2007, Rregullorja e Komisionit Nr. 2454/93 e 2 Korrikut 1993.

Përmes VKM nr. 366, datë 30.04.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.205, Datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar, janë përafruar dispozita të Rregullores nr. 2454/93, per te bërë te mundur fillimin e zbatimit të proçedurës së thjeshtuar të zhdoganimit në ambientet e operatorëve ekonomik (zhdoganimi lokal), duke plotësuar në këtë mënyrë kuadrin e plotë të thjeshtimeve doganore që aktualisht zbatohet në Bashkimin Europian.

Legjislacioni i ri mbi akcizat është i përafruar pjesërisht me aktet e BE-së, dhe tashmë administrohet nga dogana. Së fundi ligji nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", është ndryshuar me ligjin nr. 142/2014 datë 23.10.2014, dhe ligjin nr.158/2014. Nëpërmjet ligjit nr.142/2014, janë rishikuar masa të politikës fiskale lidhur me nivelet e akcizës së disa produkteve dhe parashikohen masa për përmirësimin e procedurave të administrimit të mallrave të akcizës, rregullohen masat administrative te praktikuara nga administrata doganore në rastet e shkeljeve në fushën e akcizës, etj. Nëpërmjet ligjit nr.158/2014, jane bere disa ndryshime ne formulen e perllogaritjes se akcizes per pijet energjike.
Në zbatim të ligjit nr. 61/2012 është miratuar VKM 612/2012, datë 09.05.2012 "Mbi Dispozitat Zbatuese të Ligjit "Mbi Akcizat", i ndryshuar, përmes të cilit Shqipëria është duke përdorur praktikat më të mira të legjislacionit francez dhe italian. Ky vendim ka ndryshuar së fundi me VKM nr. 30, datë 14.1.2015, i cili nuk përafron akte të Bashkimit Europian, por përmirëson procedurat në zbatim të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat".

NK e Mallrave 2015 është miratuar me VKM nr. 920, datë 29.12.2014 "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, për vitin 2015" dhe ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2015.

Përmes ligjit nr. 159/2014, datë 27.11.2014, i cili ka ndryshuar ligjin nr. 9981 datë 08.09.2008 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", stimulohet zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe agrobiznesit nëpërmjet uljes së kostove, duke e bërë 0% tarifën doganore për importin e disa produkteve që shërbejnë si lëndë të para për industrinë apo blegtorinë, parashikohen masa lehtësuese për sektorin e përpunimit të nënprodukteve të naftës.

Se fundi eshte miratuar ligji nr. 118/2015, datë 29.10.2015 "Për një shtesë në ligjin nr. 74/2015, "Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "S2 Albania", sh.p.k. dhe "Rapiscan systems", INC, "Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve" dhe "Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013", si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit", i cili ka ndryshuar nenin 2 te ligjit nr. 74/2015, "Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "S2 Albania", sh.p.k. dhe "Rapiscan systems", INC, duke bërë disa përjashtime nga pagesat e tarifës së shërbimit të skanimit.

Është miratuarVKM nr. 247, datë 20.3.2015 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020", pjesë e së cilës është edhe administrata doganore për forcimin e integritetit të nëpunësve doganorë. Është nënshkruar një Memorandum i perbashket

“Mbi shkëmbimin e informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta dhe kryerjen e testit të integritetit” ndermjet Ministrise se Brendshme dhe Ministrisë së Financave, ku struktura zbatuese janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me qëllim parandalimin dhe luftën ndaj sjelljeve të parregullta apo veprimeve të kundërligjshme në strukturat respektive.

Është miratuar VKM nr. 814, datë 26.11.2014 “Për një shtesë në vendimin nr.663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020, dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016", pjesë e së cilës është edhe administrata doganore.

Është miratuar VKM nr. 712, date 26.08.2015 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës hyrëse të doganës Morinë”, permes se ciles bëhet shpronësim për përmbushjen e detyrimeve të shtetit shqiptar për realizimin e suksesshëm të investimeve për interes publik. Dogana e Morinës është pika kryesore që lidh Shqipërinë me Kosovën dhe si e tillë ka një rëndësi të vecantë për të dyja vendet. Aktualisht infrastruktura e kësaj pike është tejet e amortizuar dhe jo në përputhje me standartet e kërkuara.

DPD ka hartuar projekt vendimin e Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në doganë” dhe e ka dërguar pranë Ministrisë së Financave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e tij. Projekt vendimi përafron pjesërisht Rregulloren Nr.608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës të datës 12 Qershor 2013, në lidhje me zbatimin në doganë të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1383/2003, si dhe Rregulloren e Komisionit Nr. 1352/2013, të datës 4 dhjetor 2013,”Për vendosjen e formularëve të parashikuar në Rregulloren Nr 608/2013, duke unifikuar procedurat e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Doganën Shqiptare me ato të Bashkimit Evropian.

Përmes ligjit nr. 184/2014, datë 24.12.2014 pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Programin e Bashkimit Doganor “Doganat 2020”.

Republika e Shqipërisë ka aderuar në disa konventa në fushën e doganave, marrëveshje ndërkombëtare në fushën e tregtisë së lirë dhe marrëveshje bilaterale me administratat homologe doganore.

II.3. Institucionet përgjegjëse

Administrata Doganore Shqiptare përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga Degët Doganore. Ajo varet nga Ministria e Financave dhe është nën mbikëqyrjen e saj. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka si mision të saj sigurinë e tregjeve dhe të popullatës

(mbrojtja e konsumatorëve, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e kufijve kombëtare) nëpërmjet mbikëqyrjes efikase nga doganat dhe bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit; mbledhjen e detyrimeve dhe akcizës; krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e biznesit, nëpërmjet aplikimit të metodave moderne të punës.

Autoritetet doganore janë përgjegjëse për kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit doganor shqiptar, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë kontrabandë, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara, konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve doganore, përgatitjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e doganave, mbikëqyrjen dhe kontrollin e mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve doganore, etj.

Grupi Punues Ndërinstitucional për Integrim Evropian i ngarkuar me Kapitullin 29 (Doganat) drejtohet nga Ministria e Financave.

II.4. Sqarime në lidhje me parashikimet financiare

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka të akorduar buxhet në vite si më poshtë:

000/leke

Viti	2016	2017	2018
Buxheti total per kete kapitull iinstitucionit lider	3,753,312	3,786,318	3,572,232
Buxheti total per kete kapitull i institucioneve te tjera	0	0	0
Buxheti total i Kapitullit	3,753,312	3,786,318	3,572,232

Projektet e huaja nga të cilat përfiton Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë:

1. Programi IPA 2012 (Vlera e Grantit 6,500,000 €) e cila konsiston në:
    - Projekt binjakëzimi për përafrimin e legjislacionit doganor dhe procedurave me ato të BE-së nga pikëpamja e ndërveprimit të sistemeve të TI me sistemet e BE-së (Vlera e Grantit 1,800,000 €).
    - Kontratë Asistence Teknike për Fuqizimin e Drejtorise se Teknologjise se Inmformacionit ne DPD (Vlera e Grantit 700,000 €).
    - Blerja e makinave te specializuara për Drejtorinë e Anti-Kontrabandës dhe pajiset përkatëse (Vlera e Grantit 1,000,000 €).
    - Përfundimi i Rehabilitimit te PKK Morine Faza II dhe ndërtimi i PKK Hani i Hotit (Vlera e Grantit 3,000,000 €).

2. Programi IPA 2013 ((Vlera e Grantit 4,500,000 €).
    - Kontratë binjakëzimi për përafrimin e Procedurave dhe legjislacionit ne fushën e tarifës (Vlera e Grantit 1,800,000 €).
    - Kontratë shërbimi për zhvillimin e modulit ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës) (Vlera e Grantit 1,500,000 €).
    - Kontratë Blerje dhe instalimi i skemës së alarmit për radioaktivitet në të gjitha PKK dhe blerje e portaleve në 9 PKK së bashku me hardware (Vlera e Grantit 1,200,000 €).
3. Projekti i ANEAS "Vendosja e një sistemi kontrolli dhe instalimi pilot i pajisjeve zbuluese për të siguruar kontrollin e materialeve radioaktive (Vlera e Grantit 800,000 €).

Vlera totale e Grantit te Programit "Doganat 2020" eshte 345,000 €. Per vitin 2015 eshte planifikuar nje shume prej 50.000 Euro per aktivitetet e periudhes 1 prill 2015 - 31 mars 2016. Vazhdon pjesëmarrja e administrates doganore në kuadrin e këtij Programi në takime dhe vizita pune.

III. Përparësitë

Përparësitë afat-shkurtra:

- Përafrim i mëtejshëm i legjislacionit doganor, akcizat dhe procedurat me praktikat e BE-së;
- Përditësimi në kohë i tarifave kombëtare mbi bazën e Nomenklaturës së Kombinuar më të fundit;
- Përmirësimi dhe përforcimi i legjislacionit doganor për të drejtat e pronësisë intelektuale;
- Vënia në eficencë e sistemit të menaxhimit të informacionit në laboratorin doganor;
- Shmangia e praktikave të parregullta dhe korrupsionit në administratën doganore.

Përparësitë afat-mesme:

- Të përafrohet më tej legjislacioni shqiptar për doganat me *acquis* e BE-së*;*
- Përditësimi në kohë i tarifave kombëtare mbi bazën e Nomenklaturës së Kombinuar më të fundit;
- Të shtohen kapacitetet administrative për përmbushjen e misionit doganor dhe pajtueshmërinë me legjislacionin doganor;
- Të shtohen kapacitetet administrative në kuadër të luftës kundër korrupsionit, krimit ndërkufitar dhe evazionit fiskal.
- Përmirësimi i transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë shmangien apo evazionin e taksave.
- Përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI-së, kryerja e veprimeve të mëtejshme për tu përgatitur për ndërveprimin e sistemeve TI të DPD me ato të BE-së;

IV. Plani i Veprimit 2016-2018

BASHKIMI DOGANOR

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Per menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020”	MF	2014 – 2020
Strategjia e Biznesit te Administratës Doganore Shqiptare”	MF	2013 – 2017
Plani i Veprimi në zbatim të strategjisë së biznesit të DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	(miratohet çdo vit)
Strategjia e Teknologjisë së Informacionit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2013 – 2017
Strategjia ndër-sektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016”	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ i Shtetit	Plani i veprimit 2013 – 2016 Strategjia ndër-sektoriale 2013-2020
Strategjia për Menaxhimin e Integruar te Kufirit	Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit	2014 – 2020
Strategjia Kombëtare Kundër Drogës	Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e	2012 – 2016

	Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie	
Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020.	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit, (institucione përgjegjëse jane shume institucione perfshire edhe doganen)	2015 – 2020
Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve	Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore	2010 – 2025

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullore 2913/92/EEC	Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MF	I pjesshëm	27.01.1999	06.03.1999
Rregullore e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 952/2013, datë 09 tetor 2013 "Union Customs Code"	Ligji Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	I pjesshëm	31.07.2014	disa nene kanë hyrë në fuqi 15 dite pas botimit në FZ, disa më 1 janar 2015 e disa me 1 qershor 2017.
Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1186/2009, datë 16, nëntor 2009, mbi përjashtimet nga detyrimet doganore	Ligji Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	MF	I pjesshëm	31.07.2014	nenet per perjashtimet kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2015.
Direktiva e Këshillit 2007/74/KE datë 20	Ligji Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi	MF	I pjesshëm	31.07.2014	nenet per perjashtimet kanë hyrë në fuqi më 1

Dhjetor 2007.	Doganor i Republikës së Shqipërisë”				janar 2015.
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC	Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore”, i ndryshuar,	MF	I pjesshëm	21.12.2005	01.01.2006
Rregullore e BE No.1101/2014, datë 16.10.2014, që amendon shtojcën I të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87	VKM Nr. 920, datë 29.12.2014 “Mbi miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2015”	MF	I plotë	29.12.2014	01.01.2015
Direktiva e BE-se nr. 2008/118 ne lidhje me akcizën	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Direktiva e Këshillit 2003/96/ të datës 27 Tetor 2003	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Direktiva 92/83/KEE e datës 19 tetor 1992.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Direktiva 92/84 KEE e datës 19 tetor 1992.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012

Direktiva 92/12/EEC e 25 shkurt 1992.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Vendimi i Komisionit nr. 428 datë 22.06.2006	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Rregullore e Komisionit EC 2008/450.	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Per akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	01.10.2012
Rregullore e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93, të datës 02.07.1993	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 205, datë 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar	MF	I pjesshëm	13.04.1999	28.04.1999
Rregullore 1383/2003	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.547, dt. 01.05.08 “Per disa ndryshime ne VKM Nr. 205, datë 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar	MF	I pjesshëm	1.05.2008	26.05.2008
Rregullore nr.2454/93/	VKM nr. 919, date 29.12.2014 “Mbi dispozitat zbatuese	MF	I pjesshëm	29.12.2014	1.01.2015

	te ligjit nr.102/2014“Kodi Doganor i RSH”.				
Rregullore (EC) Nr. 1186/2009,	VKM nr. 919, datë 29.12.2014 “Mbi dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i RSH”.	MF	Partial	29.12.2014	1.01.2015
Direktiva 2007/74/EC	VKM nr. 919, datë 29.12.2014 “Mbi dispozitat zbatuese te ligjit nr.102/2014“Kodi Doganor i RSH”..	MF	Partial	29.12.2014	1.01.2015
Rregullore e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93, të datës 02.07.1993, e ndryshuar	VKM nr.366, datë 30.04.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar,	MF	I pjesshëm	30.04.2015	15.05.2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i	Legjislacioni Shqiptar	Status i	Institucioni	Niveli i synuar i	Data e	Hyrja në fuqi

	përkthimit në Shqip (po/jo)	**(ligjet dhe aktet nënligjore)**	**përkthimit në Anglisht (po/jo)**	**Përgjegjës dhe pika e kontaktit**	**përafrimit (i plotë/përputhje e EC**	**planifikuar për përshtatjen**	
AFAT SHKURTËR (2016)							
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2016"	Jo	MF	I pjeshsem	T 4 2015	T 1 2016
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave"	Jo	MF	I pjesshem	T 4 2016	T 1 2017
Rregullore e Këshillit 2658/87/EEC datë 23 korrik 1987	Jo	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave"	Jo	MF	I pjesshem	T 4 2017	T 1 2018
Rregullore "Per dispozitat zbatuese te EC 952/2013 (akoma draft)	jo	VKM "Per dispozitat zbatuese te ligjit nr.102/2014.	jo	MF	I pjesshem	T 2 2017	T 2 2017

V.Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e planifikuar e fondeve

Kapitulli 29: Bashkimi Doganor					
Përfituesi: Drejtoria e Pergjithshme e Doganave					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Totali (3+4+5)**
Fushatë publiciteti për sensibilizimin e subjekteve komerciale	A) Paga –stafi ekzistues	**120.000 ALL**			**120.000 ALL**
	B) Paga –stafi i ri				
	C) Trajnimi				
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme				
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	**850.000 ALL**			**850.000 ALL**
	Aktiviteti total	**970.000 ALL**			**970.000 ALL**
	Buxheti total i përfituesit	**970.000 ALL**			
	Totali i Kapitullit	**970.000 ALL**			

Tabela B – Fondet e planifikuar nga asistenca e huaj

Kapitulli:				
1	**2**	**3**	**5**	**5**
Përfituesi	**Titulli i Projektit**	**Titulli i Programit/ Donatorë**	**Vlera ne €/ EU & GoA**	**Aktivitetet**
		Totali për Kapitullin:		

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis e BE-së në fushën e marrëdhënieve me jashtë, në një pjesë të konsiderueshme mbështetet në legjislacionin e politikës së përbashkët tregtare. Ajo gjithashtu përmbledh edhe legjislacionin për politikat e zhvillimit dhe ndihmës humanitare. Legjislacioni i BE-së në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga ligjet primare (Traktati), nga aktet nënligjore të BE-së (kryesisht në formën e rregulloreve) si dhe nga marrëveshjet shumëpalëshe dhe dypalëshe të BE-së. Shqipëria do të duhet të sigurojë që regjimi i tij tregtar të jetë në përputhje me regjimin e BE-së.

Përveç marrëdhënieve ekonomike e tregtare, kapitulli marrëdhëniet me jashtme i *acquis* së BE-së, gjithashtu, përfshin edhe bashkëpunimin në aspektin e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare. Në fushën e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare, shtetet anëtare, duhet të përputhin me legjislacionin e BE-së, angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet dhe në politikat humanitare të BE-së.

Legjislacioni shqiptar do të duhet të shfuqizohet sapo Shqipëria të hyjë në BE ndërsa rregulloret e BE-së do të funksionojnë menjëherë në rendin ligjor kombëtar. Vetëm aspektet institucionale të zbatimit, duhet të rregullohen nga ligjet shqiptare që mund të referohen për normat e tyre për Rregulloren e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria zbaton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe tregtare. Politika tregtare e Shqipërisë ndjek parimet e politikës së përbashkët tregtare të Bashkimit Evropian. Shqipëria, krahas parimeve të OBT-së, respekton edhe rregullat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, CEFTA, EFTA dhe Turqinë.

Forcimi i kapaciteteve administrative është një komponent i domosdoshëm, kriteret kryesore e të cilave janë rritja e njohurive të administratës publike për Politikën e Përbashkët Tregtare, thjeshtimi i instrumenteve për hartimin dhe bashkërendimin e politikës tregtare, në mënyrë që të përputhet me politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA TREGTARE
2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe legjislacionit të BE-së

1. POLITIKA TREGTARE

Detyrimi për përafrimin e ligjit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 MSA-së, dispozitë nga cila Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por edhe të sigurohet se ajo të zbatohet. Marrëveshje Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një pjesë kryesore të tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmbledhur janë nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull, si: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74, 97.

2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

Në fushën e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmës humanitare, Shqipëria duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe angazhimeve ndërkombëtare për të siguruar kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet e BE-së dhe politikën humanitare.
Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 697 më datë. 6.08.2015 në llogarinë bankare të Ministrisë së Financave të Maqedonisë është transferuar mëdatë. 17.08.2015 shuma prej 50. 000 (pesëdhjete mijë) euro si ndihma humanitare për të prekurit nga përmbytjet në Tetovë

Legjislacioni kryesor i Bashkimit Evropian në këtë fushë përmbledh:

Politika e Përbashkët Tregtare kërkon një politikë të përbashkët tregtare të regjimit të Import/Eksportit, Masat Tregtare të Mbrojtjes si dhe Kuadrin Tregtar Shumëpalësh të OBT-së.

- Rregullorja (BE) Nr. 428/2009 "Për krijimin e regjimit të Komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferim, ndërmjetësimin dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë" e amenduar;
- Rregullorja (BE) Nr. 260/2009 "Për rregullat e përbashkëta në importe të BE-së e amenduar";
- Rregullorja (BE) Nr. 1225/2009 "Mbi mbrojtjen kundër dumpingut në importe nga vendet jo anëtare të BE-së e amenduar";
- Direktiva 98/29/KE "Mbi harmonizimin e dispozitave kryesore lidhur me sigurimin e kredive të eksportit për transaksionet afatmesme dhe afatgjatë (e ndryshuar me Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 806/2003)".
- Direktiva e 84/568/KEE "Mbi detyrimet reciproke të organizatave të sigurimit të kredive të eksportit të vendeve anëtare që veprojnë në emër të shtetit ose me mbështetjen e saj, ose të departamenteve publike që veprojnë në vend të këtyre organizatave, në rastin e garancive të përbashkëta për një kontratë që përfshin një ose më shumë te nënkontraktuar në një ose më shumë shtete anëtare të Komunitetit Evropian".

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

1. POLITIKA TREGTARE

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000 dhe **politika tregtare** ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendshëm më atë të BE-së në fushën e importit të mallrave, ndihmës shtetërore, prokurimit publik, aviacionit civil, subvencioneve, etj, në përputhje me angazhimet e saj në ketë organizatë. Shqipëria ndjek të gjitha zhvillimet ne OBT dhe përditëson në mënyrë periodike legjislacionin e saj në përputhje me parimin e transparencës.
Procedurat ligjore për pranimin e Protokollit për ndryshimin e Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi OBT-ja dhe Marrëveshjae Lehtësimit të Tregtisë është në proces.
Në lidhje me Marrëveshjen e Teknologjisë së Informacionit në OBT, Shqipëria ka bashkë-sponsorizuar propozimin e BE-së dhe së fundmi ka mbështetur deklaratën dhe listën e produkteve të propozuar që do të mbulohen nga kjo marrëveshje.

Lidhur me anëtarësim në GPA, pas kërkesës së tretë nga Komiteti i GPA-së në OBT, Shqipëria është përgjigjur tashmë zyrtarisht në korrik 2015 synimin që të mos aderojë në GPA në këtë moment. Procesi i harmonizimit të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së në të gjitha fushat është një prioritet dhe në këtë mënyrë kapacitetet e administratës publike janë të përkushtuar për këtë proces.

Përveç kësaj, Shqipëria po punon për pranimin e Marrëveshjes së rishikuar "Për Avionët Civilë në OBT. Ky proces është nën procedurat e brendshme.

Planifikimi i angazhimeve të Shqipërisë të ndërmarra në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS), si dhe kufizimet horizontale dhe angazhimet specifike sektoriale në Shqipëri, përgjithësisht ndryshojnë nga ato të ndërmarra nga BE-ja. Megjithatë, asnjë nga angazhimet e Shqipërisë në GATS nuk pengojnë aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE.

E gjithë strategjia e politikës tregtare pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë është mbështetur në (i) Raportin e Anëtarësimit së Shqipërisë në këtë organizatë, (ii) Ligjin Nr. 8649, datë 28.07.2000, "Për ratifikimin e rezultateve të Raundit të Uruguait të negociatave tregtare shumëpalëshe".

Shqipëria ka tashme në zbatim marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendet e Evropës Juglindore (CEFTA 2006), vendet EFTA dhe Turqisë. Tregtia me vendet CEFTA është liberalizuar krejtësisht me ratifikimin e Protokollit 3 shtesë ndërmjet Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

Shqipëria ka marrë pjesë aktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s. Me fokus aktual mbi liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë në shërbime, Shqipëria mori pjesë në takimin e 5-të të grupit negociator në Kishinau.

Në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë, ndryshimet në Protokollin II në lidhje me përkufizimin e konceptit "produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, duke krijuar lidhjen me PEM, janë propozuar dhe dorëzuar në Këshillin e Ministrave për miratim.
U miratua me VKM-në nr. 665, datë 29.7.2015 ndryshimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me shtetet e EFTA-s duke shtuar një kapitull mbi Tregtinë dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm, e cila u nënshkrua, më 18 shtator 2015 në Gjenevë

Republika e Shqipërisë ka në zbatim *43 marrëveshje dypalëshe* për "Nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve", të cilat janë aktualisht në fuqi. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve janë: Austri; Azerbajxhan; Unioni i përkohshëm Belgjik-Luksemburg; Bosnje Hercegovina; Britani e Madhe; Bullgari; Çeki; Danimarkë; Egjipt; Finlandë; Francë; Greqi; Gjermani; Holandë; Hungari; Itali; Izrael; Katar; Kinë; Koreja e Jugut; Kroaci; Kuvajt; Lituani; Malajzi; Maltë; Maqedoni;

Moldavi; Poloni; Portugali; Qipro; Rumani; Rusi; San Marino; Serbi; Slloveni; Spanjë; Suedi; Tunizi; Turqi; Ukrainë; SHBA; Zvicër, Kosovë(UMNIK).

- Shqipëria ka përfunduar negociatat teknike të Marrëveshjes "Për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve" me Emiratet e Bashkuara Arabe dhe aktualisht ka miratuar në parim Marrëveshjen e re "Për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve" me Kosovën, e cila pritet të nënshkruhet së shpejti;
- Shqipëria, aktualisht po negocion Marrëveshjet "Për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve" me Kanadanë, Islandën, Marokun dhe Libanin.

Republika e Shqipërisë ka në zbatim 37 marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik/memorandume me vende të ndryshme në zhvillim. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik janë: Arabi Saudite; Argjentinë; Austri; Unioni i përkohshëm Belgjik Luksemburg; Bullgari; Brazil; Çeki; Danimarkë; Emiratet e Bashkuara Arabe; Egjipt; Finlandë; Francë; Gjermani; Greqi; Hungari; Izrael; Japoni; Katar; Kinë; Kroaci; Koreja e Jugut; Kuvajt; Libi; Malajzi; Maqedoni; Poloni; Rumani; Rusi; Serbi; Slloveni; Sllovaki; Suedi; Turqi; Ukrainë; Uruguai; SHBA; Zvicër.

- Aktualisht, është në fuqi Marrëveshja e re "Për bashkëpunimin ekonomik dhe teknik" me Kinën;
- Shqipëria ka miratuar dhe nënshkruar, por ende jo në fuqi, Marrëveshjen "Për Bashkëpunim Ekonomik" me Malin e Zi dhe Memorandumin institucional të "Bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të eksporteve industriale" me Shtetin e Kuvajtit;
- Shqipëria ka miratuar në parim Marrëveshjet e "Bashkëpunimit Ekonomik" me Kazakistanin dhe Korenë, cilat janë ende të panënshkruar dhe jo në fuqi;
- Në proces negocimi teknik janë Marrëveshjet e "Bashkëpunimit ekonomik e teknik" me Bosnjë-Hercegovinën, Indinë, dhe Moldavinë.

Marrëveshjet BIT'snë paragrafin e dytë nuk kanë përfunduar ende. Ata janë në proces negociatash, prandaj ata nuk kanë qenë të përfshirë në listën e parë.

Marrëveshjeve në fushën e turizmit:

- Shqipëria ka miratuar në parim "Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e turizmit" me Serbinë;
- Shqipëria po ndjek procedurat e negocimeve teknike dhe nënshkrimit të "Memorandumeve institucionale të bashkëpunimit në fushën e turizmit" me Lituaninë dhe Republikën Çeke.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për politikën tregtare përfshijnë:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri,
2. Ministria e Integrimit Evropian,
3. Ministria e Drejtësisë,
4. Ministria e Financave,
5. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujërave,
6. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,
7. Ministria e Mbrojtjes,
8. Ministria e Shëndetësisë,
9. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit,
10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,
11. Ministria e Mjedisit,
12. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,
13. Banka e Shqipërisë,
14. Autoriteti i Konkurrencës,
15. Agjencia e Prokurimit Publik;
16. Ministri për Inovacionin, dhe Administratën Publike,
17. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave;
18. Zyra shqiptare për të Drejtat e Autorit;
19. Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil,
20. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; si dhe çdo ministri apo institucion tjetër që prek tregtinë.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Viti	2016	2017	2018
Buxheti total per kete kapitull I Institucionit lider	0	0	0
Buxheti total per kete kapitull I institucioneve te tjera	137,400.1	274,775.6	0
Buxheti total I Kapitullit	137,400.1	274,775.6	0

III. Prioritetet

Me anëtarësimin në Bashkimi Evropian, Shqipëria do të jetë e detyruar të përshtatë politikën e përbashkët tregtare me atë të BE-së. Për këtë, Shqipëria do të zbatojë të gjitha marrëveshjet tregtare autonome (preferenciale dhe jo preferenciale) që BE-ja u garanton disa vendeve jo anëtare të BE-së, duke përfshirë edhe Sistemin e Përgjithësuar të Preferencave (SPP).

Shqipëria do të duhet të përfundojë të gjitha marrëveshjet e saj të tanishme preferenciale tregtare me vendet jo anëtare të BE-së dhe të sjellë të gjitha marrëveshje te tjera, duke përfshirë marrëveshjet jo preferenciale të tregut, në përputhje me detyrimet e anëtarësimit në BE. Shqipëria do të bëhet palë e Zonës Ekonomike Evropiane dhe pas pranimit, do të duhet të zbatojnë të gjitha marrëveshjet e tregtisë ndërkombëtare të BE-së, përfshirë këtu OBT-në.

Në përputhje me detyrimet e MSA-së, Shqipëria duhet të:

- Vlerësojë mundësitë për zgjerimin e koncesioneve për produktet bujqësore dhe peshkun;
- Të ndjekë të gjitha zhvillimet në politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

Mbështetur në sa sipër prioritetet shqiptare përfshijnë:

- Ngritja e kapaciteteve të administratës publike për të ndjekur zhvillimet e Politikës së Përbashkët Tregtare me Bashkimin Evropian;
- Thellimi i integrimit rajonal në kuadër të Marrëveshjes CEFTA. Avancimi i negociatave për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve me vendet palë të kësaj marrëveshje.

  Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare, Shqipëria do të duhet të zhvillojë politikën e saj kombëtare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në mënyrë që të përputhen me standardet e BE-së.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2016– 2018

IV.1 Politika tregtare

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja (BE) Nr. 260/2009	Ligji Nr. 9790, datë 19/07/2007 "Për masat mbrojtëse në Importe"	MZHETTS	I pjesshëm	19.07.2007	3.08. 2007
Rregullorja (BE) Nr. 597/2009	Ligji Nr. 9796 23/07/2007 "Për Antidumping dhe Masave Kundër balancuese"	MZHETTS	I pjesshëm	23.07.2007	7.08. 2007
Rregullorja Nr. 1225/2009	Ligji Nr. 9796 23/07/2007 "Për Antidumping dhe Masave Kundër balancuese"	MZHETTS	I pjesshëm	23.07.2007	7.08. 2007
Rregullorja(BE) Nr. 1334/2000	Ligji Nr. 9707, datë 5.4.2007"Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë" nr. 9707, datë 5.4.2007	AKSHE	I pjesshëm	24.04.2007	9.05.2007
Rregullorja(BE) Nr. 428/2009	VKM Nr. 106 datë 9/2/ 2011 "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i	AKSHE	I pjesshëm	09.02.2011	24.02.2011

	nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”,				

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016– 2018

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016– 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet	Status i përkthim-it në Anglisht	Institucion Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje I pjesshëm)	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
RregullorjaDeleguarKomisionit (EU) Nr 1382/2014	jo	VKM “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”.	jo	AKSHE	I plotë	Tremujori i tretë i 2016	Tre mujori i katërt i 2016
AFAT MESËM (2017– 2018)							
Rregullorja e BE Nr. 428/2009 e amenduar	jo	Amendimet për Ligjin, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë” nr. 9707, datë 5.4.2007	jo	AKSHE	I plotë	Tre mujori i dyte 2017	Tre mujori i katert i 2017

V.Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve buxhetore të planifikuara

Kapitull 30 : Marredheniet me Jashte					
Përfituesi: Ministria e Mbrojtjes					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto e financuar nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
VKM "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve	A) Pagat – stafi ekzistues	**137,400.1**			
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet				**137,400.1**
AmendimetpërLigjin, "Përkontrollinshtetërortëveprimtarisësë import-eksportittëmallraveushtarakedhemallrave e teknologjive me përdorimtëdyfishtë" nr. 9707, datë 5.4.2007	A) Pagat – stafi ekzistues		274,775.6		
	B) Pagat – stafi I ri				
	C) Trajnime				
	D) Shërbime të ndryshme konsulence				
	E) Infrastruktura dhe shpenzimet operative				
	Totali për aktivitet				**274,775.6**
Buxheti total i kapitullit		**412,175.7**			

KAPITULLI 31: POLITIKAT E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Shqipëria vazhdon njehsimin e saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis) në fushën e Politikës së Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Shqipëria mbështet fuqishëm politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, e cila ka për qëllim forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si entitet politik me ndikim gjithnjë e në rritje në politikën ndërkombëtare.

Samiti i Selanikut në qershor 2003 konfirmoi perspektivën e qartë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor. Shqipëria që prej janarit 2004, i është bashkuar rregullisht qëndrimeve të përbashkëta të Bashkimit Evropian në fushën e PJSM. Për më tepër, Shqipëria ka kontribuar dhe kontribuon në misionet ushtarake të Bashkimit Evropian të ndërmarra në kuadër të PJSM.

Shqipëria, zhvillon një dialog politik të ngushtë me institucionet e Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në datën 1 Prill 2009, dialogu politik institucional me Bashkimin Evropian zhvillohet në kuadër të takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, të Komitetit dhe gjashtë Nënkomiteteve të Stabilizim Asociimit, si dhe në kuadër të Komitetit ndër-parlamentar midis Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2009 dhe iu dha statusi kandidat në qershor të vitit 2014. Me këtë rast, Këshilli konfirmoi pesë prioritetet që duhet të përmbushë Shqipëria për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Dialogu politik zhvillohet intensivisht në disa nivele ndërmjet institucioneve shqiptare edhe atyre të Bashkimit Evropian për përmbushjen e kritereve të përcaktuara për të ndërmarrë këtë hap, veçanërisht në kuadrin e Dialogut të Nivelit të Lartë për Pesë Prioritet Kyçe dhe të pesë grupeve të përbashkëta të punës për pesë prioritetet kyçe.

Ecuria e integrimit evropian të Shqipërisë diskutohet gjithshtu edhe në nivel dypalësh me vendet anëtare të Bashkimit Evropian me rastin e vizitave të nivelit të lartë.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka vazhduar të angazhohet në një dialog të rregullt politik me Bashkimin Evropian për çështjet e politikës së jashtme të sigurisë. Sa i përket PBJS (CFSP), Shqipëria i është bashkuar të gjitha qëndrimeve të Bashkimit Evropian dhe vendimeve të Këshillit, kur i është kërkuar 100 % përputhshmëri, e konfirmuar edhe nga progres-raporti i KE-së për Shqipërinë, viti 2015. Shqipëria i është bashkuar gjithashtu edhe qëndrimeve të BE në OKB, dhe ka bashkë-sponsorizuar rezolutat e Bashkimit Evropian. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në operacionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake në kuadër të politikës së përbashkët. të sigurisë dhe të mbrojtjes.

Shqipëria beson thellësisht në vlerat evropiane të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes e të drejtave të njeriut.

Në themel të vizionit të politikës së jashtme të Shqipërisë qëndron ndërtimi i marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Në zbatim të këtij orientimi themelor të politikës së jashtme, Shqipëria ka adoptuar gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm aktiv në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon, e më gjerë.

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi rajonal dhe pronësia rajonale janë jo vetëm parakushte të integrimit evropian, por edhe domosdoshmëri e kohës për të transformuar përfundimisht imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës sonë të jashtme reflektohet në të pjesëmarrjen tonë proaktive në të gjitha nismat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Shqipëria do të vendoset Fondi i Ballkanit Perëndimor, një nismë e mbështetur nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit.

Shqipëria iu bashkua nismës Bashkëpunimi i Përforcuar në Kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit (Enhanced Cooperation Within the Stabilization and Association Process/ECSAP), e cila do t'i ofrojë mbështetje politike procesit të bashkëpunimit rajonal në kontekstin e Procesit të Stabilizim Asociimit, duke u përqendruar në fushat e sundimit të ligjit, qeverisjes ekonomike dhe ndërlidhjes.

Në dt. 28 gusht 2014 u zhvillua në Berlin, nën iniciativën e Kancelares Merkel, Konferenca e Nivelit të Lartë BE-Ballkani Perëndimor (BP), e cila dëshmoi një vëmendje të shtuar ndaj BP, rikonfirmoi rëndësinë që ka procesi i integrimit në BE si shtysë për reformat në vendet e rajonit, duke u fokusuar tek rëndësia e bashkëpunimit rajonal, për një rajon të integruar që ofron potenciale konkrete zhvillimi dhe sigurie për BE dhe vendet e saj anëtare, në një kontekst gjeopolitik në ndryshim. Procesi i Berlinit synon intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, përmes adresimit të çështjeve politike në rajon dhe realizimit të projekteve rajonale, me qëllim afrimin e mëtejshëm të vendeve të rajonit me BE-në. Më 27 gusht u mbajt Samiti i Ballkanit Perëndimor në Vienë, si takimi i dytë në kuadrin e Procesit të Berlinit. Takimi konfirmoi mbështetjen politike për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidoi progresin e arritur në fusha të ndryshme, veçanërisht lidhur me ndërlidhjen.

Në kuadër të Procesit të Berlinit dhe të ECSAP, MZHETTS po koordinon me ministritë homologe të vendeve të rajonit një listë të projekteve rajonale që kanë të bëjnë me ndërlidhjen, për realizimin e të cilave do të kërkohet mbështetja e BE dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.

Gjatë kryesimit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), qershor 2014 – qershor 2015, Republika e Shqipërisë kontribuoi në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet gjithë pjesëmarrësve të organizatës. Rritja e këtij bashkëpunimi u konsiderua si elementi kyç, për tejkalimin e çështjeve ende të pazgjidhura si në rrafshin dypalësh dhe atë të brendshëm, si një element i rëndësishëm në adresimin e sfidave të stabilitetit dhe të sigurisë në rajon.

Gjatë Kryesisë Shqiptare, u organizuan më shumë se 40 aktivitete, përfshirë Samitin e Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive, tre takime të Ministrave të Punëve të Jashtme, Mbledhja e Asamblesë Parlamentare të SEECP, mbledhje të ekspertëve në fushat prioritare të bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë OJQ dhe përfaqësues nga shoqëria civile.
Kryesia Shqiptare e SEECP-së u vlerësua nga të gjithë pjesëmarrësit, për rezultatet e saj.

Themelimi i Fondit të Ballkanit Perëndimor (WBF) është një nga veprimet më të rëndësishme politiko-diplomatik të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Fondi do të ketë selinë e tij në Tiranë dhe gjithashtu, Drejtor i parë Ekzekutiv i saj do të jetë një diplomat me përvojë nga Shqipëria.

Në partneritet të ngushtë me vendet e Grupit të Vishegradit (V4), MPJ e Shqipërisë po drejton procesin për arritjen e konsensusit në lidhje me dokumentet kryesore të krijimit të Fondit, me objektivin për të hapur rrugën për aktivitetet praktike të Fondit, duke filluar nga fillimi i vitit të ardhshëm.

Në Konferencën e Vjenës, në gusht të vitit 2015, Kryeministrat e Shqipërisë dhe Serbisë prezantuan një nismë të përbashkët, për të mbështetur bashkëpunimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor, shkëmbimin e ideve bazuar në vlerat e bashkëjetesës, tolerancës, respektit të të drejtave të njeriut dhe diversitetit, si dhe angazhimin për gjithëpërfshirjen dhe në çështjet e sigurisë.

Krijimi i një zyre për Bashkëpunim Rinor Rajonal në Ballkanin Perëndimor (Ryo-BB), është pjesë e kësaj nisme.

Zyra do të ketë selitë e saj në Tiranë dhe Beograd, bazuar në përvojën e suksesshme të modelit franko-gjerman të programeve të shkëmbimit të studentëve dhe të zyrave rinore franko-gjermane. MPJ e Shqipërisë, në bashkëpunim me MPJ e Serbisë, po koordinon të gjitha përpjekjet për krijimin dhe funksionimin e Grupit të Punës, i cili do të përgatis propozime konkrete lidhur me këto çështje, brenda dt. 1 mars 2016.

Në nivelin ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, me të cilat ajo ndan vlera të përbashkëta.

Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin në planin kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, me qëllim që të zvogëlojë në maksimum rrezikun ndaj terrorizmit që lidhet me vendin dhe interesat tona, duke siguruar përmirësimin e elementeve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste.

I.3 Struktura e kapitullit

1. DIALOGU POLITIK
2. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTRAE
3. KONTROLLI I ARMËVE
4. ZBATIMI I MASAVE KUFIZUESE DHE SANKSIONEVE EKONOMIKE
5. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT
6. POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE MBROJTJES
7. SISTEMI I VIZAVE

II. Situata aktuale

Shqipëria vijon të kontribuojë me 1 (një) ushtarak në Operacionin EUFOR - Althea në Bosnjë-Hercegovinë, në funksionin “Këshilltar për Trajnimin e Stafit. Përveç kësaj, që prej muajit Nëntor 2015, Forcat e Armatosura të Shqipërisë po kontribuojnë në Misionin Trajnues të BE-së në Mali (EUTM Mali) me 3 Teknikë të Personelit EOD (Explosive Ordinance Disposal). Lidhur me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe çështjet e demontimit, Shqipëria ka vijuar zbatimin e planit të veprimit për shkatërrimin e armatimeve shtesë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për përmbylljen e një regjistri kombëtar të armëve dhe municioneve nën menaxhimin e Policisë së Shtetit.

Shqipëria nuk e ka miratuar Ligjin për Masat Kufizuese që do të ofrojë procedurën e unifikuar për zbatimin e masave kufizuese si ndaj vendeve të treta ashtu edhe ndaj aktorëve jo-shtetërorë. Baza ligjore për zbatimin e masave kufizuese të vëna nga BE dhe OKB mund të gjenden në Kushtetutën e Shqipërisë. Megjithatë, masat kufizuese financiare në fjalë janë të rregulluara në detaje në Ligjin për Masat kundër financimit të terrorizmit. Ligji parashikon përkufizimin bazë të pasurive dhe pronave të tjera që janë objekt i masave të synuara financiare kufizuese.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masave të synuara financiare kufizuese është Ministria e Financave, e cila merr vendimin për një bllokim të përkohshëm, konfiskimin apo ngrirje të fondeve dhe të pasurive të tjera financiare.

Përveç kësaj, ligji parashikon që Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, të jetë autoriteti përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e të dhënave për zbatimin e masave kundër terrorizmit. Struktura organizative dhe funksionet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave janë dhënë në kuadër të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Në bazë të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave i raporton drejtpërdrejtë Ministrit të Financave dhe shërben si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë.

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar mbi informacionin e klasifikuar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh prej nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Përsa i përket Armëve të Shkatërrimit në Masë, strategjia e BE nënvizon rëndësinë e të vepruarit ne mënyrë që të zgjidhen, parandalohen, frenohen, ndalohen dhe te eliminohen programet për shtimin e këtyre armëve dhe raketave. BE është e angazhuar në sistemin e traktateve shumëpalëshe, të cilat ofrojnë bazat ligjore dhe normative për të gjitha përpjekjet për mos shtimin e këtyre armëve. Politika e BE është e angazhuar në zbatimin dhe universalizimin e normave ekzistuese të çarmatimit dhe të mospërhapjes. Për këtë qëllim, ne do të angazhohemi në universalizimin e Traktatit për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërrimit në Masë (NPT), të marrëveshjeve të Sigurisë së Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA) dhe protokollet shtesë të tyre, Konventa e Armëve Kimike (CWC), Konventa e Armëve Biologjike dhe Toksine (BTWC), Kodi i Sjelljes së Hagës (HCoC), dhe hyrjes së mëhershme në fuqi të Traktatit për Ndalimin e Gjithanshëm të Testeve Bërthamore (CTBT). Politikat e BE-s kërkojnë që të përparohet në luftën kundër armëve biologjike dhe kimike të deklaruara universalisht të jashtëligjshme në përputhje me ligjet e detyrueshme ndërkombëtare. Politikat e BE-s zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare në ndalimin e materialeve të zbërthyeshme të armëve bërthamore ose të pajisjeve të tjera bërthamore. BE do të asistojë vendet e treta në përmbushjen e detyrimeve të tyre të bazuara në konventat dhe regjimet shumëpalëshe.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Shih më poshtë.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) është institucioni udhëheqës për GNP të Kapitullit 31. Institucione të tjera të përfshira, janë:

- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Këshilli i Ministrave
- INSTAT.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë është Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Shpërndarja financiare sipas buxhetit të shtetit

	2014	**2015**	**2016**	**2017**
Shpenzimet totale				
Buxheti i Shtetit	2350	2296	2216.2	2216.2
Asistencë e Huaj				

III. Prioritetet

Objektivi është që të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e acquis në fushën e politikës së përbashkët të jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes në të ardhmen e afërt. Prioritetet e Shqipërisë janë të lidhura me politikat e BE-së në fushën e Politikës së përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Aktualisht qeveria Shqiptare është në proçesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020, pjesë e të cilit është edhe politika e mbrojtjes, e cila është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e përfshira në këtë sektor.

Shqipëria vijon njehsimin e saj me acquis në këtë drejtim. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përmbylljen e regjistrit elektronik të armëve dhe municioneve nën menaxhimin e Policisë së Shtetit. Në tërësi, përgatitjet në fushën e politikës së jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes janë në rrugën e duhur.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2016 – 2018

IV.1 Dialogu politik

Integrimi Evropian i Shqipërisë është konsideruar si një objektiv strategjik dhe një garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit dhe më gjerë. Në këtë kontekst, Shqipëria është e gatshme të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme përsa i përket procesit të Integrimit Evropian, me qëllim hapjen e negociatave për anëtarësim.

Shqipëria zhvillon një dialog politik intensiv me Bashkimin Evropian dhe Shteteve Anëtare të saj. Ky dialog zhvillohet në vazhdimësi në kuadrin e Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe të strukturave të tjera të përbashkëta nën Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA).

IV.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Organizatat Rajonale

Organizata rajonale	Data e pranimit
SEECP Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore	1996
RCC Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal	27 Shkurt 2008
CEI Nisma e Evropës Qendrore	1996
BEDZ/BSEC Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi	25 Qershor 1992
NAJ Nisma Adriatiko-Joniane	20 Maj 2000
MARRI Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët	2003
RACVIAC Qendra Rajonale për Verifikimin e Kontrollit të Armëve	20 Shtator 2000
A-5 Karta e Partneritetit të Adriatikut	2 Maj 2003
FBP Fondi për Ballkanin Perëndimor (me seli në Tiranë)	13 Nëntor 2015
Task Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)	Nëntor 2011

Iniciativa Adriatiku dhe Joniane (ADRION)	20 maj 2000
Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Jug-Lindore (SEDM)	1996

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare

Organizatë Ndërkombëtare	Data e pranimit
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara	14 Dhjetor 1955
OSBE	20 Qershor 1991
Këshilli i Evropës	13 Korrik 1995
IAEA Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike	29 Korrik 1957
CTBTO - Organizata e Traktatit për Ndalimin Gjithëpërfshirës të Provave Bërthamore	1996
IOF - Organizatën Ndërkombëtare e Frankofonisë	1999
UNAOC - Aleanca e Qytetërimeve e Kombeve të Bashkuara	2005
UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën	1958
IACA – Akademia Ndërkombëtare Antikorrupsion	21 Shtator 2011
Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut NATO	4 prill 2009

IV.3 Kontrolli i armëve

Qeveria shqiptare ka identifikuar si një nga kërcënimet të sigurisë së vendit dhe më tej, ekzistencën e rezervave të gjera të tepricave të fishekëve si edhe të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL). Shkatërrimi i tepricave të fishekëve është në rrugën e duhur. Në përputhje me Direktivat e Mbrojtjes për vitin 2015 dhe "Planin e Veprimit për shkatërrimin e fishekëve për 2015". Në nëntor 2015, Ministria e Mbrojtjes mbylli procesin e demontimit të materialeve industriale dhe shpërthyese në mjedise të jashtme të përcaktuara, ndërsa procesi i tjetërsimit përmes shitjes pritet të përfundojë brenda 2016.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të BE-së të 9 Dhjetorit 2013, dhe të Strategjisë të BE-së për Luftën ndaj grumbullimit të paligjshëm, kursimit dhe trafikut të paligjshëm të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) si edhe të fishekëve, Ministria e Punëve të Jashtme Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP dhe SEESAC ngriten grupin e punes per Komitetin Ndër-Ministror për Armët e Vogla dhe të Lehta (SALW) në Republikën e Shqipërisë. Detyra kryesore është hartimi i Dokumentit Strategjik të AVL dhe Planit respektiv te Veprimit. Ky komitet do të shërbejë si organ koordinimi institucional përgjegjës për politikat e zhvillimit, kërkimit,

koordinimit, zbatimit dhe të monitorimit të përpjekjeve për parandalimin, luftën dhe eliminimin e posedimit dhe tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta, dhe trajtimin në nivel kombëtar të problemeve, pasojave dhe çështjeve të lidhura me të gjitha aspektet e AVL.

Aktualisht, ne kemi ngritur një grup pune në nivelin kombëtar, e cila do të fillojë hartimin e draftit të parë të kësaj strategjie.

Policia e Shtetit Shqiptar ka krijuar në vitin 2015, regjistrin kombëtar elektronik për regjistrimin e te dhënave te të gjitha armëve të vogla dhe të lehta në vend. Me mbështetjen e UNDP/ SEESAC, bazuar ne Vendimin të Këshillit të BE-së 2013/730 / CFSP, Policia e Shtetit Shqiptar ka instaluar këtë vit pajisjet informatike, ku përfshihen 110 kompjuterë, 110 UPSs, 60 printera, 15 skaner, një server, dhe gjashtë porta interneti në qarqet dhe drejtoritë e policisë në të gjithë vendin. Përveç kësaj, personeli i policisë është trajnuar, në përputhje me rrethanat e reja, për përdorimin e të dhënave të regjistrit të armëve. Regjistri elektronik do të përmirësojë kapacitetet kombëtare në mënyrë efektive dhe efikase persa i përket kontrollit te posedimit te të dhënave të sakta të armëve të vogla dhe armëve të lehta në vend. Përveç kësaj, krijimi i regjistrit elektronik do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe ekspertizën e rajonit të Evropës Juglindore, për të luftuar trafikimin e paligjshëm, zotërimin e armëve të zjarrit, njekohesisht reduktimit te kërcënimit te paqes, stabilitetit dhe zhvillimit te qëndrueshëm.

Në fushën e kontrollit të eksporteve të materialeve dhe armatimeve ushtarake, Autoriteti Kombëtar Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve (AKSHE) brenda Ministrisë së Mbrojtjes ka përgatitur listën ushtarake të përditësuar, në përputhje me Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së (të miratuar nga Këshilli më 17 Mars 2014) (armatimet e parashikuara nga Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP në përcaktimin e rregullave të përbashkëta që përcaktojnë kontrollin e eksporteve të teknologjive dhe armatimeve ushtarake). Kjo liste do te miratohet ne 6-mujorin e dytë të 2016.

Aktualisht, ne kemi ngritur një grup pune në nivelin kombëtar, e cila do të fillojë hartimin e draftit të parë të kësaj strategjie.

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Zbatimi i Dokumentit të Vjenës 2011 (Dokumenti i Vjenës është një marrëveshje midis shteteve pjesëmarrëse për implementimin dhe marrjen e masave për parandalimin e konflikteve nën ombrellën e OSBE-së) 1. Shkëmbimi i Informacionit të Kodit të Sjelljes në Aspektet Politiko-Ushtarake të	Ministria e Mbrojtjes	2012 – vijimësi

Sigurisë 2. Planifikimi i Mbrojtjes 3. Shkëmbimi i Përgjithshëm i Informacionit Ushtarak GEMI (30 Prill.....). 4. Kalendari vjetor i veprimtarive ushtarake sipas përcaktimeve të DV- 11 5. Raport mbi planet e kontakteve dhe bashkëpunimit në kuadër të DV-11 6. Raport mbi festat dhe pushimet publike kombëtare dhe fetare. 7. Shkëmbimi Vjetor i Informacionit Ushtarak AEMI, sipas DV- 11 8. Kryerja e 1 (një) vizite inspektuese në vendet e OSBE-së (Kuota kombëtare aktive) 9. Kryerja e 1 (një) vizite vlerësuese në vendet e OSBE-së (Kuota kombëtare aktive) 10. Kryerje e vizitave në Baza Ajrore apo reparte ushtarake në raste të demonstrimeve të armatimeve dhe pajisjeve të reja dhe infrastrukture ushtarake. 11. Pritja e 3 (tre) vizitave inspektuese nga vendet e OSBE-së (Kuota kombëtare pasive) 12. Pritja e 1 (një) vizite vlerësuese nga vendet e OSBE-së (Kuota kombëtare pasive) 13. Organizimi i 1 (një) vizite Baza Ajrore apo reparte ushtarake ne raste te demonstrimeve të armatimeve dhe pajisjeve të reja dhe infrastrukture ushtarake		

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1334/2000	Ligji "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar. nr. 9707, datë 05.04.2007	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve	I pjesshëm	24.04.2007	09.05.2007

Lista e përbashkët ushtarake e Bashkimit Evropian (2010/C 69/03)	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve" nr. 106, datë 09.02.2011	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve	I plotë	09.02.2011	24.02.2011
Direktivë (91/477/KEE)	Ligji nr. 74/2014 "Mbi armët"	Ministria e Punëve të Brendshme	I pjesshëm	10.7.2014	27.08.2014

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Nuk aplikohet	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
CFSP 2015/C129/01 Mbi Listën e Përbashkët Ushtarake	Jo	Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për Zbatimin listës së përditësuar e të materialeve ushtarake dhe të mirave teknologjike, për përdorimin e dyfishtë, të	n/a	Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve	i plotë	3 Q 2016	4 Q 2016

		cilat janë subjekt të kontrollit shtetëror të import-eksportit”					
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.4 Zbatimi i masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike

Në këtë kontekst, ministritë përkatëse të linjës kanë zbatuar vendimet PPJS, sidomos në lidhje me masat kufizuese për personat dhe entitetet përgjegjëse për ngjarjet në Ukrainën Lindore. Shqipëria do të vazhdojë angazhimet e saj për një dialog politik të rregullt me BE-në për çështjet e PPJS, duke synuar 100% përputhshmëri me vendimet në kuadër të PPJS.

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1167/2008	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 106, datë 9.02.2011 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve	I plotë	9.02.2011	24.02.2011
	Vendimi i Këshillit të Ministrave	Ministria e Mbrojtjes /	I pjesshëm	30.01.2008	30.01.2008

	Nr. 43, datë 16.01.2008	AKSHE			
	Ligji nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	10.10.2013	13.11.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.5 Lufta kundër terrorizmit

Shqipëria përpiqet të japë një kontribut proaktiv për paqen dhe stabilitetin dhe qëndron në mënyrë të vendosur në luftën kundër terrorizmit. Shqipëria i është bashkuar në vitin 2014 Aleancës Globale kundër ISIS dhe ka mbështetur aleatët dhe partnerët që nga fillimi i luftës së përbashkët kundër terrorizmit ndërkombëtar. Si pjesë e përpjekjeve të këtij koalicioni në luftën kundër terrorizmit, Shqipëria renditet ndër vendet me kontribute konkrete.

Qeveria Shqiptare e ka konsideruar luftën kundër terrorizmit si një prioritet kombëtar, duke marrë hapa konkrete të pasqyruara në legjislacionin kombëtar, që synojnë forcimin e aftësisë së adresimit të problemit të luftëtarëve të huaj terroristë, duke e konsideruar pjesëmarrjen si të paligjshme dhe të dënueshme, organizimin apo ndonjë nxitje për të marrë pjesë në veprimet ushtarake të shqiptarëve në një vend të huaj.

Masa të tilla të ndërmarra në luftën kundër terrorizmit janë paraprire nga krijimi i strukturave të specializuara dhe kapaciteteve njerëzore me logjistikën përkatëse.

Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar të gjitha konventat dhe protokollet e OKB-së në lidhje me luftën kundër terrorizmit. Shqipëria ka bashkë-sponsorizuar Rezolutën 2178 (2014) të Këshillit të Sigurimit dhe mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar në përpjekjet globale për të ruajtur paqen dhe sigurinë në botë.

Zhvillimi i strategjive gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar është thelbësor për të luftuar në mënyrë efektive kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Strategjitë e tilla janë të rëndësishme jo vetëm për luftimin e radikalizimit dhe të rekrutimit, por edhe për të vlerësuar siç duhet mundësinë e ri-integrimit.

Shqipëria ka shqyrtuar dhe miratuar, në korrik 2014, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe, në Nëntor 2015, Parlamenti Shqiptar miratoi Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, që harmonizon energjitë dhe angazhimin e qeverisë, shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare, për ta bërë luftën tonë kundër ekstremizmit të dhunshëm një përpjekje të suksesshme të përbashkët.

Shqipëria respekton dhe miraton listat e publikuara nga Këshilli i Sigurimit për individët dhe organizatat që financojnë terrorizmin, dhe ka miratuar, masa legjislative konkrete kundër personave dhe organizatave të listuara aty. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2015, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka miratuar një numër të vendimeve si vijon:

- VKM Nr. 31, datë 21.01.2015
- VKM Nr. 124, datë 11.02.2015
- VKM Nr. 162, datë 25.02.2015
- VKM Nr. 273, datë 01.04.2015
- VKM Nr. 311, datë 15.04.2015
- VKM Nr. 351, datë 29.04.2015
- VKM Nr. 431, datë 20.05.2015
- VKM Nr. 488, datë 10.06.2015
- VKM Nr. 721, datë 02.09.2015
- VKM Nr. 852, datë 21.10.2015

Ministria e Punëve të Jashtme vlerëson nevojën e rishikimit dhe hartimit të një ligji mbi zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

Këto masa kanë një rol të rëndësishëm me një ndikim pozitiv në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet fakti se progresi i bërë nga Shqipëria në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML / CFT), është njohur nga Task Forca e Veprimeve Financiare (FATF), e cila në takimet plenare, më 25 deri 27 shkurt 2015, uroi dhe përshëndeti progresin e rëndësishëm të Shqipërisë dhe ka përsëritur se Shqipëria ka adresuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator, duke përmbushur kështu angazhimet e saj. Për këtë qëllim Shqipëria, që nga tani nuk është më subjekt i monitorimit të FATF për AML / CFT.

Një vlerësim i tillë dhe masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare çuan në një vlerësim pozitiv të Konventës Kuadër MONEYVAL të Këshillit të Evropës, e cila më 18 shtator 2015 arriti në përfundimin se Shqipëria nuk është më subjekt i procesit vjetor të monitorimit. (Vazhdimësi e rregullt).

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Kundër Terrorizmit	Ministria e Punëve të Brendshme	2014 – 2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimi I Këshillit 2002/475/DCB	Kodi Penal, i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar.	Ministria e Punëve të Brendshme	I pjesshëm.	27.01.1995	01.06.1995

Shih më tej Kapitullin 24 të Planit Kombëtar

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.6 Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në menaxhimin e krizave dhe operacioneve ushtarake civile, nën politikën e përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes (CSDP).

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në misionin Althea të EUFOR në Bosnje-Hercegovinë (me një anëtar të shtabit të përgjithshëm).

Në fillim të vitit 2015 Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë deklaroi pozitivisht pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura në Misionin e Trajnimit të BE-së "EUTM Mali", si dhe përcaktoi muajin maj 2015 si periudhën kur trupat do të jenë të gatshme për të lëvizur në Mali.

Gjithashtu, deklaroi se kohëzgjatja e misionit tonë EOD (Explosive Ordinance Disposal) do të jetë 1 (një) vit, i ndarë në 2 (dy) rotacione me nga 6 (muaj) secili. Në përputhje me rekomandimin e Komandantit të Misionit EUTM dhe opinionin e Komitetit Ushtarak të BE-së, Komitetit Politik dhe Sigurisë të BE-së pranoi kontributin e Shqipërisë nw EUTM Mali me tre pozicione EOD. Në këtë kontekst, Këshilli i Ministrave miratoi një vendim nr. 722 më 02.09.2015 për dërgimin e personelit të FARSH në operacionin ushtarak të BE-së, me mision trajnues (EUTM Mali), të përbërë nga 3 (tre) ushtarakë, si pjesë e grupit EOD, në mbështetje të Kompanisë së Ruajtjes së Bazës në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë. Misioni i trupave EOD filloi në muajin nëntor 2015.

Gjithashtu, në përgjigje të thirrjes 2-2015 të BE- së , Shqipëria ka filluar procedurat e nevojshme për të kontribuar në misionin civil EUAM Ukrainë, i themeluar me vendim të Këshillit të datës 22 korrik 2014 dhe ndryshuar më 17 nëntor 2015.

DSIK është duke punuar për një ligj të ri "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare". Ky ligj do të shfuqizojë ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"", i ndryshuar.

Qëllimi i kësaj iniciative legjislative është përafrimi i plotë të kuadrit ligjor për informacionin e klasifikuar me Vendimin e Këshillit të BE-së 2013/488/EU, "Për rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit të klasifikuar të BE-së", i ndryshuar.

Në fushën e informacionit të klasifikuar janë rishikuar këto Vendime të Këshillit të Ministrave:

- VKM nr. 189, datë 04.03.2015, "Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare";
- VKM nr. 188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit";
- VKM nr. 190, datë 04.03.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 81, datë 28.01.2008, për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror";
- VKM "Për miratimin e rregullave të punës me VKM "Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së" (në proces);
- VKM nr. 836, datë 14.10.2015, “Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së”.

Si çështje sigurie, marrëveshja e sigurisë me BE-në për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar nuk është nënshkruar ende por DSIK ka kërkuar për një kohë të gjatë nisjen e negociatave për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

Pas marrjes së ftesës si vend kandidat për anëtarësim në BE që i është bërë Republikës së Shqipërisë nga Bashkimi Evropin, Shërbimi i Jashtëm Europian (EEAS) i ka kërkuar DSIK-së fillimin e negociatave për ne kësaj marrëveshje sigurie.

DSIK, Ministria e Punëve të Jashtme, përfaqësues të Kryeministrisë dhe strukturat e BE-së kryen një "kick off meeting", në të cilin palët prezantuan kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar dhe të politikave të sigurisë. Gjithashtu, në këtë takim, palët diskutuan mbi një draft marrëveshje "Për procedurat e sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar".

Ky hap demostron se strukturat e BE-së besojnë në punën dhe stabilitetin e shtetit shqiptar në këtë fushë. Vendi ynë ka plotësuar standardet e sigurisë së kërkuara nga NATO për informacionin e klasifikuar, dhe do të kontribuojë me të njëjtën energji dhe përkushtim për të plotësuar kërkesat ligjore të BE-së në këtë fushë. Ky është njëhap shumë i rëndësishëm, e cila do të trajtohet me një vëmendje të veçantë, për shakun se është kyçe për të dyja palët.

Takimi i dytë mes palëve është mbajtur në 28 maj 2015. Palët vendosën t'i vazhdonin negociatat mes tyre nëpërmjet një video konference, pranë Misionit të BE-së në Tiranë. Në këtë videokonferencë, palët pranuar një tekst përfundimtar. Draft marrëveshja është diskutuar nga Komiteti Politik dhe i Sigurisë së EEAS. Nga ana tjetër, pala shqiptare ka dërguar draft marrëveshjen për certifikim dhevërtetim zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë, për të vijuar me procedurat e brendshme drejt miratimit në parim të saj.

Marrëveshja "Për procedurat e sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar" ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë pritet të përfundojë brenda vitit 2015.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane "Mbi mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar", ratifikuar me ligjin nr. 28/ 2015, datë 26.03.2015.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Spanjës "Mbi shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar", ratifikuar me ligjin nr. 59/2015, datë 11.06.2015.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë "Mbi shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar", ratifikuar me ligjin nr. 34/2015, datë 02.04.2015.

Shqipëria ka nënshkruar një letër me qëllim për të marrë pjesë në "Iniciativën e Bashkëpunimit të Mbrojtjes" (vendim) - krijuar në vitin 2012, me PPSM. Gatishmëria e shprehur për të marrë pjesë në këtë nismë dhe, më tej, Brigada Ndërkombëtare që do të krijohet në bazë të këtij organizmi është një hap pozitiv, konkret dhe serioz në kontekstin e angazhimit tonë dhe pjesëmarrjen në strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive, e cila kontribuon në forcimin e stabilitetit ndërkombëtare dhe rajonal dhe prosperitetit.

Shqipëria për më tepër ,është e angazhuar të bashkëpunojë me organizata të tjera ndërkombëtare (OKB, NATO, OSBE, Këshilli i Europës, etj).

Në mars 2015, vendi ynë ka dërguar dy vëzhgues, si pjesë e OSBE-së për të monitoruar zgjedhjet parlamentare në Taxhikistan. Aktualisht, në kuadër të OSBE-së, Shqipëria vazhdon të kontribuojë me katër vëzhgues në Ukrainë: Tre vëzhgues në MPM / EMS (Mision i Posaçëm Monitorimi / Mision i Posaçëm Monitorimi) dhe një vëzhgues në Misionin Monitorues (Misioni i Vëzhgimit). Shqipëria gjithashtu ,i është përgjigjur pozitivisht thirrjes për të kontribuar me personel ushtarak në qendrën e trajnimit " Ekipi Partner i Ndërtimi të Kapaciteteve (BPC-T) & Këshillimit& të Ndihmës", në Erbil, Irak.

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU *acquis*	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendim i Këshillit 2001/264/KE,	Ligji "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 "Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 "Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e "Certifikatës së Sigurisë" personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 "Për sigurimin e informacionit të klasifikuar "Sekret Shtetëror" në	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001

	marrëdhëniet ndërkombëtare”				
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

EU *acquis*	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Vendimi 2001/844/KE	Ligji “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së Sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

	klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”				

EU *acquis*	**Legjislacioni Shqiptar**	**Institucioni kryesor**	**Niveli i përafrimit**	**Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)**	**Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)**
Direktiva 2009/81/KE	Ligji “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së Sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

	komunikimit (INFOSEC)”				

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2016 – 2018

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
“Marrëveshje ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për procedurat e Sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit sekret” Nënshkrimi i Marrëveshjeve për Sigurinë e Përgjithshme me vendet: Belgjikë, Lituani, Moldavi, Kanada, Holandë, Gjeorgji, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut	DSIK	2014 – 2016	2015	2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2016 – 2018

EU *acquis*	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2016)							
2013/488/EU	n/a	Ligj i "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare"	n/a	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	I plotë	2016	n/ a
2013/488/EU	n/a	VKM për sigurimin e informacionit në sistemet e komunikimit	n/a	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	I plotë	2016	n/ a
AFAT MESËM (2017 – 2018)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.7 Sistemi i vizave

Shih kapitullin 24

V. Implikimet financiare

Tabela A – Tabela e fondeve te buxhetit të shtetit të planifikuara

Chapter 31: "Politikat e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes					
Përfituesi: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)					
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
Ligji mbi "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare"	A) Paga –stafi ekzistues	2,506,992	-	-	2,506,992
	B) Paga –stafi i ri	-	-	-	-
	C) Trajnimi	-	-	-	-
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	-	-	-	-
	E) Infrastruktura dhe kostot në vazhdim	50,000	-	-	50,000
	Aktiviteti total	**2,556,992**	**-**	**-**	**2,556,992**
	Totali i buxhetit për përfituesin	**2,556,992**			
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
Aktiviteti	**Kosto që do të financohet nga buxheti i shtetit**	**2016**	**2017**	**2018**	**Total (3+4+5)**
VKM mbi "Siguria e informacionit të klasifikuar në sistemet e komunikimit"	A) Paga –stafi ekzistues	2,156,592	-	-	2,156,592
	B) Paga –stafi i ri	-	-	-	-
	C) Trajnimi	-	-	-	-
	D) Shërbime mbështetëse të ndryshme	-	-	-	-
	E) Infrastrukturadhe kostot në vazhdim	50,000	-	-	50,000
	Aktiviteti total	**2,206,592**	**-**	**-**	**2,206,592**

Totali i buxhetit për përfituesin	**2,206,592**
Totali i kapitullit	**4,763,584**

KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë kapitull lidhet me zbatimin e parimeve ndërkombëtare të rëna dakord për përshtatjen e legjislacionit të BE-së, standardet dhe metodat e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) që duhet të zbatohen për sistemet e kontrollit të brendshëm në të gjithë sektorin publik, duke përfshirë edhe shpenzimet e fondeve të BE-së. Në veçanti, acquis kërkon ekzistencën e një menaxhimi financiar dhe sisteme kontrolli transparente dhe efektive (duke përfshirë kontrollin e përshtatshëm ex-ante, kontrollin financiar në vazhdim dhe ex-post, apo inspektimin); sisteme të brendshme auditimi funksionale dhe të pavarura; struktura organizative përkatëse (duke përfshirë koordinimin në nivel qendror); organizim auditimi të jashtëm operativ dhe funksional për të vlerësuar mbi të gjitha, cilësinë e sistemeve të reja të KBFP. Ky kapitull përfshin gjithashtu *acquis* përmbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe luftën kundër mashtrimit duke përfshirë fondet e BE- së.

I.2 Situata aktuale e Shqipërisë

